<p style="text-align: center;">Neni 30 Shoqata</p> <p>1. Shoqata është person juridik i përbërë nga anëtarësia, e grupuar në bazë të vullnetit të lirë të personave me interes të përbashkët, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.</p> <p>2. Shoqata themelohet nga të paktën tre (3) persona.</p> <p>3. Themelues të shoqatës mund të jenë personat fizik dhe juridik.</p> <p>4. Shoqata është person juridik jo-fitimprurës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 30 Association</p> <p>1. An Association is a legal person composed of membership, established upon the free will of persons of common interest, for the realization of legitimate objectives for public benefit or mutual interest.</p> <p>2. An Association is established by at least three (3) persons.</p> <p>3. The founders of an association may be natural or legal persons.</p> <p>4. An Association is a non-profit legal person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 30 Udruženje</p> <p>1. Udruženje je pravno lice sačinjeno od članstva, grupisano prema slobodnoj volji osoba sa zajedničkim interesima, za postizanje legitimnih ciljeva za dobrobit javnosti ili zajedničkog interesa.</p> <p>2. Udruženje se osniva od najmanje tri (3.) lica.</p> <p>3. Osnivači udruženja mogu biti fizička i pravna lica.</p> <p>4. Udruženje je neprofitno pravno lice.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 31 Fondacioni</p> <p>1. Fondacioni është person juridik pa anëtarësi, i themeluar për menaxhimin e pronave dhe pasurive, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.</p> <p>2. Fondacioni themelohet nga një ose më shumë persona fizik apo juridik.</p> <p>3. Fondacioni themelohet me kapital fillestar, me testament, apo me lënie të trashëgimisë.</p> <p>4. Fondacioni është person juridik jo-fitimprurës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Foundation</p> <p>1. A Foundation is a non-membership legal person, established for the management of properties and assets, for the realization of legitimate objectives for public benefit or mutual interest.</p> <p>2. A foundation is established by one or more natural persons or legal persons.</p> <p>3. A Foundation is established with initial capital, by virtue of a will, or by inheritance.</p> <p>4. A Foundation is a non-profit legal person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Fondacija</p> <p>1. Fondacija je pravno lice bez članstva, koja je osnovana za upravljanje imovinom i sredstvima za postizanje legitimnih ciljeva za dobrobit javnosti ili zajedničkog interesa.</p> <p>2. Fondacija se osniva od jednog ili više fizičkih ili pravnih lica.</p> <p>3. Fondacija se osniva početnim kapitalom, testamentom ili nasleđivanjem.</p> <p>4. Fondacija je neprofitno pravno lice.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Fitimi i personalitetit juridik</p> <p>1. Shoqatat, fondacionet dhe shoqëritë tregtare e fitojnë personalitetin juridik, në momentin e regjistrimit në regjistrin e organizatave joqeveritare, përkatësisht në regjistrin e shoqërive tregtare.</p> <p>2. Personit juridik publik të themeluar me ligj, i cili nuk ushtron aktivitet ekonomik i njihet personaliteti juridik pa u regjistruar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Acquisition of Legal Personality</p> <p>1. Associations, foundations and business organisations acquire legal personality, at the moment of registration in the register of non-governmental organizations, and respectively in the Register of business organisations.</p> <p>2. A public legal person established by law which does not exercise economic activity shall be recognized as a legal personality without being registered.</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Sticanje pravne ličnosti</p> <p>1. Udruženja, fondacije i trgovinska društva stiču pravnu ličnost u trenutku upisivanja u registar nevladinih organizacija, odnosno u registar trgovinskih društava.</p> <p>2. Javnom pravnom licu osnovanom zakonom, koji ne obavlja privredne aktivnosti priznaje se pravna ličnost bez upisivanja.</p>

<p>3. Mënyra e themelimit, akti themelues dhe përmbajtja e tyre si dhe mënyra e regjistrimit të personave juridik rregullohet në mënyrë të detajuar me ligje të veçanta.</p>	<p>3. The particulars of establishment, the founding act and their content as well as the means of registration of legal persons shall be regulated in detail by special laws.</p>	<p>3. Način osnivanja, akt o osnivanju i njihov sadržaj i način upisivanja pravnih lica detaljno se uređuje posebnim zakonima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 33 Emri i personit juridik</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Name of the Legal person</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Naziv pravnog lica</p>
<p>Personi juridik ka emrin e tij të plotë dhe shkurtësën, i cili dallon në mënyrë të konsiderueshme nga emri i personave tjerë juridik.</p>	<p>The legal person has its full name and abbreviation, which differs considerably from the names of other legal persons.</p>	<p>Pravno lice ima svoj puni naziv i skraćenicu, koje se znatno razlikuje od naziva drugih pravnih lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Selia e personit juridik</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Registered Office of the Legal person</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Sedište pravnog lica</p>
<p>Personi juridik ka selinë e tij sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>The legal person has its registered office pursuant to the legislation in force.</p>	<p>Pravno lice ima svoje sedište u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Aftësia juridike dhe e veprimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Legal capacity and capacity to Act</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Poslovna i pravna sposobnost</p>
<p>1. Personi juridik ka aftësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime që nga momenti i fitimit të personalitetit juridik.</p> <p>2. Personi juridik mund të kryej çdo veprim juridik të lejuar me ligj, statut apo aktin e themelimit.</p>	<p>1. A legal person may acquire rights and assume obligations from the moment of gaining its legal personality.</p> <p>2. A legal person may carry out any legal action permitted by law, statute or founding act.</p>	<p>1. Pravno lice je sposobno da stiče prava i da preuzima obaveze od trenutka sticanja pravne ličnosti.</p> <p>2. Pravno lice može obavljati bilo koju pravnu radnju dozvoljenu zakonom, statutom ili aktom o osnivanju.</p>

<p>3. Vullneti i personit juridik shprehet përmes organeve të tij të përcaktuara në ligj, aktin themelues apo statut.</p> <p>4. Veprimet juridike të ndërmarra nga organet e personit juridik brenda kompetencave të tyre, konsiderohen veprime të ndërmarra nga personi juridik.</p>	<p>3. The will of a legal person is expressed through its organs defined by law, the founding act or the statute.</p> <p>4. Legal actions undertaken by the bodies of a legal person within their competences are considered actions taken by the legal person.</p>	<p>3. Volja pravnog lica se izražava preko svojih organa definisanih zakonom, aktom o osnivanju ili statutom.</p> <p>4. Pravne radnje koje su preduzete od strane organa pravnog lica u okviru svojih nadležnosti, smatraju se radnjama koje su preduzete od strane pravnog lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Shuarja e personit juridik</p> <p>1. Personi juridik shuhet sipas mënyrës së përcaktuar me statut, akt themelues apo me ligj.</p> <p>2. Me shuarjen e personit juridik përfundon veprimtaria e tij dhe subjektiviteti juridik.</p> <p>3. Mënyra e shuarjes së personave juridik është rregulluar në mënyrë specifike me ligje të veçanta.</p> <p>4. Likuidimi i personit juridik është rregulluar me ligj të veçantë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Dissolution of the Legal person</p> <p>1. The legal person shall be dissolved in the manner defined by statute, founding act or by law.</p> <p>2. With the dissolution of a legal person, its activity and legal subjectivity ends.</p> <p>3. The manner of dissolution of legal person is regulated specifically by specific laws.</p> <p>4. Liquidation of a legal person is regulated by special law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Prestanak pravnog lica</p> <p>1. Pravno lice prestaje na način utvrđen statutom, aktom o osnivanju ili zakonom.</p> <p>2. Nakon prestanka pravnog lica prestaje njegova delatnost i pravna ličnost.</p> <p>3. Način prestanka pravnog lica je posebno uređen posebnim zakonima.</p> <p>4. Likvidacija pravnog lica je uređena posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 37 Shoqëritë pa personalitet juridik</p> <p>Për shoqërinë tregtare apo shoqatën pa personalitet juridik, personi që vepron në emër të saj është përgjegjës personalisht në raport</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Associations without a Legal Personality</p> <p>For a business association or company without legal personality, the person acting on its behalf is personally liable in relation to</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Udruženja bez pravne ličnosti</p> <p>Za trgovinska društva ili udruženje bez pravne ličnosti, lice koje deluje u njihovo ime je lično</p>

<p>me palët e treta për çdo transaksion të ndërmarrë në emër të saj.</p>	<p>third parties for any transaction undertaken on its behalf.</p>	<p>odgovorno prema trećim stranama za svaku transakciju, preduzetu u njegovo ime.</p>
<p>KAPITULLI III - SENDET DHE KAFSHËT</p>	<p>CHAPTER III – THINGS AND ANIMALS</p>	<p>POGLAVLJE III - STVARI I ŽIVOTINJE</p>
<p>Neni 38 Objekti i së drejtës</p>	<p>Article 38 Subject to the law</p>	<p>Član 38 Predmet prava</p>
<p>Objekt janë sendet, të drejtat personale me karakter pasuror, veprimet e njeriut me karakter pasuror, kërkesa me karakter pasuror dhe përfitimet tjera që mund të jenë objekt i së drejtës.</p>	<p>Objects are things, personal rights, person's actions, and claims with property character, and other benefits that may be subject to law.</p>	<p>Predmet su stvari, lična prava imovinskog karaktera, ljudske radnje imovinskog karaktera, potraživanja imovinskog karaktera druge koristi koje mogu biti premet prava.</p>
<p>Neni 39 Sendet</p>	<p>Article 39 Things</p>	<p>Član 39 Stvari</p>
<p>Sendet konsiderohen objektet trupore dhe jotrupore nëse nuk parashihet ndryshe me ligj të veçantë.</p>	<p>Things are considered corporeal and non-corporeal unless otherwise regulated by special law.</p>	<p>Stvarima se smatraju telesni i ne telesni predmeti, osim ako nije drukčije predviđeno posebnim zakonom.</p>
<p>Neni 40 Kafshët</p>	<p>Article 40 Animals</p>	<p>Član 40 Životinje</p>
<p>1. Kafshët mbrohen me ligje të veçanta. 2. Rregullat që aplikohen për sendet me modifikime të nevojshme aplikohen edhe për</p>	<p>1. Animals are protected by special laws. 2. The rules applied to things also apply to animals with the necessary modifications, unless otherwise provided by law.</p>	<p>1. Životinje su zaštićene posebnim zakonima. 2. Pravila koja se odnose na stvari sa potrebnim izmenama, odnose se i na</p>

<p>kafshët përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Sendet e luajtshme</p> <p>Sendet e luajtshme janë objektet trupore të pavarura që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin nga një vend në vendin tjetër, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 41 Movables</p> <p>Movables are independent corporeal things not permanently attached to the land or parts of land, and can generally be moved from one place to another, unless otherwise provided by law.</p>	<p>životinje, osim ako nije drugačije predviđeno zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 41 Pokretne stvari</p> <p>Pokretne stvari su nezavisni telesni objekti koji nisu trajno povezani sa zemljom ili delovima zemlje, i mogu se pomerati sa jednog mesta na drugo, osim ako nije drugačije predviđeno zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 42 Paluajtshmëria</p> <p>Paluajtshmëria është një sipërfaqe e kufizuar e tokës dhe ato sende që në mënyrë përhershme janë të lidhura me këtë sipërfaqe të tokës. Paluajtshmëria është toka bujqësore, pyjet, kullotat, toka ndërtimore, instalimet dhe ndërtimet mbi të dhe nën të, të cilat janë të lidhura në mënyrë të fortë për tokë, bimët me rrënjë në tokë dhe çdo gjë që nuk mund të lëvizë nga një vend në tjetrin pa u dëmtuar në thelb.</p>	<p style="text-align: center;">Article 42 Immovables</p> <p>Immovables are a limited surface of land and the things permanently attached to the surface of land. Immovable is the land (agricultural, forests, pastures), construction areas, installations and constructions on and under it which are heavily attached to the ground, plants with their roots on the ground, and anything that cannot be moved from one place to another without being substantially damaged.</p>	<p style="text-align: center;">Član 42 Nepokretnost</p> <p>Nepokretnost je ograničena površina zemljišta i one stvari koje su stalno povezane za tu površinu zemljišta. Nepokretnost je poljoprivredno zemljište, šume, pašnjaci, građevinsko zemljište, instalacije i zgrade iznad i ispod, koje su jako povezane sa zemljom, biljke koje su ukorenjene na zemlji i sve ono što ne može da se pomeri od jednog na drugo mesto bez značajnog oštećenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 43 Pjesët esenciale të sendit</p> <p>Pjesët e një sendi janë ato sende që nuk mund të ndahen ose kur ndahen ndonjëra nga pjesët</p>	<p style="text-align: center;">Article 43 Essential parts of a thing</p> <p>Parts of a thing that cannot be separated or when any part separated it gets destroyed or</p>	<p style="text-align: center;">Član 43 Bitni delovi stvari</p> <p>Delovi stvari su one stvari koje se ne mogu odvojiti ili kada se odvajaju, neki od delova se</p>

<p>shkatërrohen apo u ndryshohet natyra e tyre, dhe ne këtë rast nuk mund të jenë objekt i një të drejte të veçantë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 44 Pjesët esenciale të tokës ose ndërtesës</p> <p>1. Pjesët esenciale të një toke përfshijnë sendet e ngulitura dhe që janë të lidhura me tokën, në veçanti ndërtesat dhe prodhimet e tokës deri sa janë të lidhura me tokën. Fara bëhet një pjesë thelbësore e pjesës së tokës kur mbillet, ashtu njëjtë edhe një bimë kur mbillet.</p> <p>2. Pjesët esenciale të një ndërtese përfshijnë sendet e vendosura për tu ndërtuar ndërtesa.</p>	<p>changed in its nature, and thus cannot be subject to a specific right.</p> <p style="text-align: center;">Article 44 Essential parts of a land or building</p> <p>1. Essential parts of a land include embedded and earth-bound objects, in particular buildings and land products as far as they are connected to the land. The seed becomes an essential part of the soil when sown, as well as a plant when sown.</p> <p>2. Essential parts of a building include things set up to construct the buildings</p>	<p>uništava ili se menja njihova priroda, i u tom slučaju ne mogu biti predmet posebnog prava.</p> <p style="text-align: center;">Član 44 Bitni delovi zemljišta ili zgrade</p> <p>1. Bitni delovi zemljišta uključuju predmete koji su ugrađeni i koji su vezani za zemljište, posebno zgrade i zemljišni proizvodi dok su vezani sa zemljom. Seme postaje bitan deo dela zemljišta kada je posejano, isto kao i biljka kad je zasađena.</p> <p>2. Bitne delove zgrade uključuju stavke navedene za izgradnju objekata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 45 Sendet e konsumueshme</p> <p>1. Sendet e konsumueshme janë sende të luajtshme ashtuqë qëllimi i përdorimit të tyre është konsumi ose disponueshmeria.</p> <p>2. Sendet e luajtshme ndryshe konsiderohen si të harxhueshme nëse ato janë pjesë e një depoje ose një bashkësie tjetër të sendeve, përdorimi i synuar i të cilave është disponimi i sendeve individuale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 45 Consumable things</p> <p>1. Consumable things are movable things whose purpose of use is consumption or disposal.</p> <p>2. Movable things are otherwise considered as expendable if they are part of a warehouse or other group (aggregation) of things, the intended use of which is the availability of individual things.</p>	<p style="text-align: center;">Član 45 Potrošne stvari</p> <p>1. Potrošne stvari su pokretne stvari, tako da je svrha njihovog korišćenja potrošnja ili raspoloživost.</p> <p>2. Pokretne stvari se inače smatraju potrošnim ako su deo skladišta ili druge zajednice stvari, čija je ciljna namena raspoloživost pojedinačnih stvari.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 46 Sendet e zëvendësueshme</p> <p>Sendet e zëvendësueshme janë sende të luajtshme që në marrëveshjet ekonomike zakonisht janë të specifikuara me numër, masë dhe peshë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Pjesët për përdorim të përkohshëm</p> <p>1. Pjesët e një ngastre toke nuk përfshijnë sende që lidhen me tokën vetëm për një qëllim të përkohshëm.</p> <p>2. Sendet që futen në një ndërtesë për një qëllim të përkohshëm nuk janë pjesë esenciale e ndërtesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Sendet aksesore</p> <p>1. Aksesorët janë sende të luajtshme të cilat pa qenë pjesë e sendeve kryesore kanë për qëllim t'i shërbejnë qëllimit ekonomik të sendeve kryesore dhe janë në një marrëdhënie hapësinore me të dhe që korrespondon me këtë qëllim. Një send nuk është një aksesorë nëse nuk konsiderohet si një aksesor në marrëdhëniet e biznesit të sendit kryesor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 46 Replaceable things</p> <p>Replaceable things are movable things that in financial agreements are usually specified by number, size and weight.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Parts for temporary use</p> <p>1. Parts of a land parcel do not include objects that are attached to the land for only a temporary purpose.</p> <p>2. Things embedded in a building for a temporary purpose are not an essential part of the building.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Accessory things</p> <p>1. The accessories are movables which, without being part of the main things, are intended to serve the economic purpose of the main things, are in a spatial relationship with it, and correspond to this purpose. A thing is not accessory if it is not considered as such within the business relationship of the main thing.</p>	<p style="text-align: center;">Član 46 Zamenjive stvari</p> <p>Zamenjive stvari su pokretne stvari koje u ekonomskim sporazumima su obično određene brojem, veličinom i težinom.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Delovi za privremenu upotrebu</p> <p>1. Delovi parcele ne uključuju stvari koje se vezuju za zemlju samo za privremenu namenu.</p> <p>2. Stvari koje se unose u zgradu za privremenu namenu nisu bitni delovi zgrade.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Dodatne stvari</p> <p>1. Dodaci su pokretne stvari koje, dok nisu deo glavne stvari, imaju za cilj da služe ekonomskoj nameni glavne stvari i imaju prostorni odnos koji odgovara sa ovom namenom. Stvar nije dodatna ako se ne smatra dodatkom u poslovnim odnosima glavne stvari.</p>
--	--	--

<p>2. Përdorimi i përkohshëm i një sendi për qëllimin ekonomik të një sendi tjetër nuk i jep atij cilësinë e një sendi aksesori. Ndarja e përkohshme e një sendi aksesori nga sendi kryesor nuk e privon atë nga cilësia e një aksesori.</p>	<p>2. Temporary use of a thing for the economic purpose of another thing does not grant it the quality of an accessory thing. The temporary division of an accessory thing from the main thing does not deprive it of the quality of an accessory.</p>	<p>2. Privremena upotreba stvari u ekonomske svrhe druge stvari ne daje mu svojstvo dodatne stvari. Privremeno razdvajanje dodatne stvari od glavne stvari ne lišava je svojstva dodatka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 49 Sendet në qarkullim juridik</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Things in legal circulation</p>	<p style="text-align: center;">Član 49 Stvari u pravnom opticaju</p>
<p>Vetëm sendet që janë në qarkullim juridik mund të jenë objekt i marrëdhënies juridike civile.</p>	<p>Only objects that are in legal circulation may be subject to civil law relationship.</p>	<p>Samo stvari koje su u pravnom opticaju mogu biti predmet građanskopravnog odnosa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 50 Sendet në pronësi publike</p>	<p style="text-align: center;">Article 50 Things in public ownership</p>	<p style="text-align: center;">Član 50 Stvari u javnom vlasništvu</p>
<p>Sendet në pronësi publike rregullohen me ligj të veçantë.</p>	<p>Things in public ownership are regulated by special law.</p>	<p>Stvari u javnom vlasništvu uređuju se posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 51 Frutat</p>	<p style="text-align: center;">Article 51 Fruits</p>	<p style="text-align: center;">Član 51 Plodovi</p>
<p>1. Frutat janë produktet e sendit dhe të ardhurat e tjera të marra nga sendi në përputhje me qëllimin e përdorimit të tij.</p>	<p>1. Fruits are products of the thing and other proceeds received from the thing in accordance with the purpose of its use.</p>	<p>1. Plodovi su proizvodi stvari i ostalih prihoda dobijenih od stvari u skladu sa svrhom njegove upotrebe.</p>
<p>2. Frutat e një të drejte janë të ardhurat që prodhon e drejta në përputhje me qëllimin përdorimit të saj, në veçanti në rastin e një të drejte për nxjerrjen e pjesëve përbërëse të tokës.</p>	<p>2. Fruits of a right are the proceeds that produce the right in accordance with the purpose of its use, in particular in the case of a right to extract the constituent parts of the land.</p>	<p>2. Plodovi određenog prava su prihod koji proizvodi pravo u skladu sa svrhom njegove upotrebe, posebno u slučaju prava za izvlačenje sastavnih delova zemljišta.</p>

<p>3. Frutat janë gjithashtu të ardhurat nga një send ose një e drejtë në bazë të një marrëdhënie juridike-civile.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Të ardhurat dhe përfitimet</p> <p>Të ardhurat, përfitimet janë frutet e një sendi ose të drejtës dhe përfitimet që rrjedhin nga përdorimi i sendit ose i të drejtës dhe duhet të përdoren sipas mënyrës së parapare me ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Rimbursimi i shpenzimeve për fruta</p> <p>Një person që ka për detyrë t'i dorëzojë frutat mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve të prodhimit të frutave në atë masë që nuk mund ta kalojnë vlerën e frutave.</p> <p>KAPITULLI IV - PUNËT JURIDIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 54 Kuptimi i punëve juridike</p> <p>1. Puna juridike është shprehja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, me qëllim që të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.</p>	<p>3. Fruits are also proceeds from one thing or a right based on a juridical-civil relationship.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Incomes/benefits</p> <p>Incomes / benefits are the fruits of a thing or a right and the benefits derived from the use of the thing or the right, and should be used in the fashion prescribed by law.</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Reimbursement of fruit expenses</p> <p>A person who has a duty to deliver the fruits may require reimbursement of fruit production costs to the extent that cannot exceed the value of the fruit.</p> <p>CHAPTER IV – LEGAL TRANSACTIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 54 Meaning of Legal transactions</p> <p>1. A legal transaction is a legal declaration of the will of a natural or legal person in order to create, change or terminate civil rights or obligations.</p>	<p>3. Plodovi su takođe i prihodi od jedne stvari ili prava iz građansko pravnog odnosa.</p> <p style="text-align: center;">Član 52 Prihodi i koristi</p> <p>Prihodi, koristi su plodovi jedne stvari ili prava i koristi koje proističu iz upotrebe stvari ili prava i moraju se koristiti u skladu sa načinom predviđenim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Naknade troškova za plodove</p> <p>Lice koje je dužno da isporuči plodove može zahtevati naknadu troškova proizvodnje plodova do te mere da ne može biti veća od iznosa plodova.</p> <p>POGLAVLJE IV – PRAVNI POSLOVI</p> <p style="text-align: center;">Član 54 Značenje pravnih poslova</p> <p>1. Pravni posao je pravno izražavanje volje fizičkog ili pravnog lica, u cilju stvaranja, izmene ili prestanka građanskih prava i obaveza.</p>
---	--	--

<p>2. Puna juridike mund të jetë e njëanshme ose e dyanshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 55 Forma e punëve juridike</p> <p>1. Puna juridike mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.</p> <p>2. Puna juridike mund të jetë në formë të shkresës ose në formë të aktit noterial.</p> <p>3. Puna juridike me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.</p> <p>4. Puna juridike që ka për objekt bartjen e pronësisë mbi paluajtshmëri dhe krijimin e të drejtat tjera sendore duhet të bëhet në formë noteriale.</p>	<p>2. A legal transaction may be unilateral or bilateral.</p> <p style="text-align: center;">Article 55 Form of Legal transactions</p> <p>1. A legal transaction may be performed in writing, verbally, and with any other unambiguous manifestation of will.</p> <p>2. A legal transaction may be in the form of a letter or in the form of a notarial act.</p> <p>3. A legal transaction in writing must be signed by the person performing it.</p> <p>4. A legal transaction dealing with immovable property shall be done in the form of a notarial act.</p>	<p>2. Pravni posao može biti jednostran ili obostran.</p> <p style="text-align: center;">Član 55 Oblik pravnih poslova</p> <p>1. Pravni posao se može obaviti u pisanom obliku, usmeno i na bilo koji drugi nedvosmislen izraz volje.</p> <p>2. Pravni posao može biti u obliku dopisa ili u obliku javno beležničkog akta.</p> <p>3. Pravni posao preko dopisa mora biti potpisan od strane lica koji ga obavlja.</p> <p>4. Pravni posao koji ima za cilj prenos svojine nad nepokretnostima i stvaranje drugih stvarnih prava vrši se u javno beležničkom obliku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 56 Punët juridike me kusht</p> <p>1. Puna juridike është me kusht kur krijimi ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në të, varen nga një ngjarje e ardhshme e cila nuk dihet nëse do të ndodhë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 56 Conditional Legal transactions</p> <p>1. A legal transaction is conditional when the creation or termination of the rights and obligations set forth therein depend on a future event which is not known whether it will occur.</p>	<p style="text-align: center;">Član 56 Pravni poslovi pod uslovom</p> <p>1. Pravni posao pod uslovom je onda kada stvaranje ili prestanak prava i obaveza predviđenih u njemu zavisi od budućeg događaja za koji nije poznato da li će se dogoditi.</p>

<p>2. Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet krijohen po të ndodhë ngjarja.</p> <p>3. Kushti është zgjidhës kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja.</p> <p>4. Kur vërtetimi i kushtit është ndaluar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga mos vërtetimi i tij, kushti konsiderohet se është vërtetuar.</p> <p>5. Kur vërtetimi i kushtit është shkaktuar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga vërtetimi i tij, kushti konsiderohet se nuk është vërtetuar.</p> <p>6. Kur e drejta që varet nga vërtetimi i kushtit cenohet ose humbet nga veprimet e palës së detyruar me kusht, kjo duhet të shpërblejë dëmin e shkaktuar në rast se kushti vërtetohet.</p> <p>7. Pasojat që lidhen me vërtetimin e kushtit fillojnë nga çasti që është vërtetuar kushti, përveç kur nga përmbajtja e veprimit juridik del se këto pasoja duhet të fillojnë në një kohë të mëparshme.</p>	<p>2. The condition is precedent when the rights and obligations arise if the event occurs.</p> <p>3. The condition is subsequent when rights and obligations cease if the event occurs.</p> <p>4. When the verification of the condition is prohibited by the bad faith of the party that would benefit from its non-verification, the condition shall be deemed to have been verified.</p> <p>5. When the verification of the condition is caused by a bad faith of the party that would benefit from its verification, the condition shall be deemed not to have been verified.</p> <p>6. When the right that depends on the verification of the condition is infringed or lost by the actions of the conditional-bound party, it must reimburse the damage caused if the condition is verified.</p> <p>7. The consequences related to the verification of the condition begin from the point the condition is verified, except when it emerges from the content of the legal act that these consequences should begin at an earlier time.</p>	<p>2. Uslov je odložen kada se prava i obaveze stvore ako se događaj dogodi.</p> <p>3. Uslov je rešavajući kada se prava i obaveze gase nakon ako se događaj dogodi.</p> <p>4. Kada je potvrđivanje uslova zabranjeno, u lošoj veri od strane koja bi imala koristi od nepotvrđivanja, smatra se da je uslov potvrđen.</p> <p>5. Kada je proveravanje uslova izazvano u lošoj veri od strane koja bi imala koristi od njegove provere, smatra se da uslov nije proveren.</p> <p>6. Kada je pravo koje zavisi od potvrđivanja uslova uskraćeno ili izgubljeno zbog aktivnosti stranke koja je uslovno dužna, ovo mora nadoknaditi štetu nastalu ako je potvrđen uslov.</p> <p>7. Posledice vezane za potvrđivanje uslova počinju od trenutka kada je uslov potvrđen, osim ako iz sadržaja pravne radnje proističe da bi ove posledice trebale početi u ranije vreme.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 57 Punët juridike me afat</p> <p>1. Afati i punës juridike është momenti i caktuar kohor, nga i cili fillon ose pushon puna juridike ose disa nga efektet e saj.</p> <p>2. Kur afati është caktuar me ditë, nuk llogaritet dita në të cilën ndodh ngjarja ose koha nga e cila ai duhet të fillojë.</p> <p>3. Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite, mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ai ka filluar. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.</p> <p>4. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit. Nëse afati zgjatet, ai fillon pas ditës së fundit të skadimit të afatit të parë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 57 Term of Legal transactions</p> <p>1. Term of a legal transaction is a set period of time when the legal transaction or some of its effects begin or end.</p> <p>2. When the term is set in days, the day on which the event occurs or the time from which it shall commence is not calculated.</p> <p>3. The term that is set in weeks, months or years, ends with the passing of the last day of that particular week or last month that has the same name or number as that of the day it has begun. When such a day is missing in the last month, the term ends with the passing of the last day of this month.</p> <p>4. When the last day of a term is on a day of a holiday, the term ends on the working day following the holiday. If the term is extended, it starts after the last day of the expiry of the first term.</p>	<p style="text-align: center;">Član 57 Pravni poslovi sa rokovima</p> <p>1. Rok pravnog posla je određeni vremenski trenutak, od kojeg počinje i prestaje pravni posao ili neki od njegovih dejstava.</p> <p>2. Kada je rok utvrđen u danima, ne računa se dan na koji se dogodi događaj ili vreme od kada bi trebalo početi.</p> <p>3. Rok koji je utvrđen u nedeljama, mesecima ili godinama isteći će na dan isteka poslednjeg dana te nedelje ili poslednjeg meseca koji ima isto ime ili broj sa danom u kojem je počeo. Kada nema takvih dana u poslednjem mesecu, rok se završava na kraju poslednjeg dana ovog meseca.</p> <p>4. Kada posljednji dan roka pada u danu odmora, rok ističe prvog radnog dana nakon tog praznika. Ukoliko se rok produži, počinje da teče nakon poslednjeg dana isteka prethodnog roka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 58 Pavlefshmëria absolute e punëve juridike</p> <p>1. Punët juridike absolutisht të pavlefshme nuk krijojnë efekte juridike që nga krijimi i tyre. Të tilla janë ato që:</p>	<p style="text-align: center;">Article 58 Absolute Nullity of Legal transactions</p> <p>1. Legal transactions with absolute nullity do not create legal effects from their inception. Such are the ones that:</p>	<p style="text-align: center;">Član 58 Apsolutna ništavnost pravnih poslova</p> <p>1. Apsolutno ništavni pravni poslovi ne stvaraju pravno dejstvo od njihovog stvaranja. Takvi su oni koji:</p>

<p>1.1 janë në kundërshtim me një dispozitë detyruese të ligjit;</p> <p>1.2 janë në kundërshtim me rendin juridik;</p> <p>1.3 janë në kundërshtim me moralin shoqëror;</p> <p>1.4 kryhen nga të miturit nën moshën (14) katërbëdhjetë vjeç;</p> <p>1.5 kryhen nga personat që i'u është hequr plotësisht aftësia e veprimit;</p> <p>1.6 bëhen në marrëveshje të palëve pa pas për qëllim që të sjellin pasojë juridike, respektivisht punët fiktive ose të simuluar.</p> <p>2. Për pavlefshmëri absolute të këtyre punëve juridike gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar.</p> <p>3. Kërkesa për anulim mund të paraqitet në çdo kohë.</p>	<p>1.1 are in conflict with a binding provision of the law;</p> <p>1.2 are in conflict with the public order;</p> <p>1.3 are contrary to social morality;</p> <p>1.4 are committed by minors under (14) fourteen years of age;</p> <p>1.5 are committed by persons whose capacity to act has been completely deprived;</p> <p>1.6 are made in the agreement of the parties without having an intention to bring legal consequences (namely, fictitious or simulated works).</p> <p>2. For the absolute nullity of these legal transactions, the court shall attend ex officio and any person concerned may make reference to it.</p> <p>3. The request for nullity may be filed at any time.</p>	<p>1.1. su u suprotnosti sa obavezujućom odredbom zakona;</p> <p>1.2. su u suprotnosti sa pravnim poretkom;</p> <p>1.3. su u suprotnosti sa javnim moralom;</p> <p>1.4. se obavljaju od maloletnika mlađih od četnaest godina;</p> <p>1.5. se obavljaju od lica koja su u potpunosti lišena poslovne sposobnosti;</p> <p>1.6. se čine u dogovoru između stranaka, a koje nemaju za cilj stvaranje pravnih posledica, odnosno fiktivne ili simulirane poslove.</p> <p>2. O apsolutnoj ništavnosti takvih pravnih poslova sud se stara po službenoj dužnosti, i može se svako zainteresovano lice pozivati na tome.</p> <p>3. Zahtev za poništenje se može podneti u bilo koje vreme.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 59 Pavlefshmëria relative e punëve juridike</p>	<p align="center">Article 59 Relative Nullity of Legal transactions</p>	<p align="center">Član 59 Relativna ništavnost pravnih poslova</p>
<p>1. Punët relativisht të pavlefshme janë punët juridike të cilat prodhojnë efekte juridike apo ndryshe konsiderohen të vlefshme, gjersa me kërkesën e palës se interesuar, gjykata i shpall të pavlefshme për shkak të mungesave juridike. Të tilla janë punët juridike të kryera nga:</p> <p>1.1 të miturit mbi katërmbëdhjetë vjet, kur puna juridike është kryer pa lejen apo pëlqimin e prindit ose të kujdestarit;</p> <p>1.2 personat, të cilët për shkak të paaftësisë për të gjykuar u është kufizuar aftësia për të vepruar dhe punën juridike e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit;</p> <p>1.3 personat, të cilët në kohën e kryerjes së punës juridike nuk ishin në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr aftësia për të vepruar;</p> <p>1.4 personi që ka kryer punën juridike duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës ekstreme.</p>	<p>1. Legal transactions with relative nullity are the ones producing legal effects (considered valid) until the court declares them invalid at the request of the interested party, due to legal vices. Such are the legal transactions committed by:</p> <p>1.1 minors over 14 years of age when the legal transaction is carried out without the permission or consent of the parent or guardian;</p> <p>1.2 persons who, due to incapacity to judge, have been restricted in their capacity to act when the legal transaction is performed without the consent of the guardian;</p> <p>1.3 persons who at the time of performing the legal transaction were not able to understand the importance of their actions, even though at that time their capacity to act was not abolished;</p> <p>1.4 a person who has performed the legal transaction under fraud, threat, in error or because of extreme need.</p>	<p>1. Relativno ništavni pravni poslovi su pravni poslovi, koji proizvode pravna dejstva ili se drugačije smatraju važećim, dok ih na zahtev zainteresovane stranke, sud ne proglasi ništavnim zbog pravnih nedostataka. Takvi su pravni poslovi koji su obavljeni od:</p> <p>1.1. maloletnika preko četrnaest godina, kad je pravni posao obavljen bez dozvole, odnosno pristanka roditelja ili staratelja;</p> <p>1.2. lica kojima je zbog nesposobnosti rasuđivanja ograničena poslovna sposobnost i koji su obavili pravni posao bez pristanka staratelja;</p> <p>1.3. lice koje u vreme obavljanja pravnog posla nisu bili u stanju da shvate značaj svojih postupaka, iako u to vreme nisu bili lišeni poslovne sposobnosti;</p> <p>1.4. lice koje je obavilo pravne poslove obmanom, pod pretnjom, u zabludi ili zbog krajnje nužde.</p>

<p>2. Afati për shpalljen e pavlefshmërisë relative rregullohet me librat e veçanta të këtij kodi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 60 Kanosja</p> <p>1. Kanosja mund të shkaktojë shpalljen e punës juridike të pavlefshme, në rast kur është e tillë sa të frikësojë personin në atë mënyrë, ai vetë, bashkëshorti, pasardhësit ose paraardhësit e tij do të pësojnë një dëm fizik ose material të padrejtë dhe të rëndë.</p> <p>2. Kanosja mund të kryhet edhe nga një person i tretë që nuk merr pjesë në lidhjen e punës juridike.</p>	<p>2. The deadline for declaring relative nullity is regulated by the special Books of this Code.</p> <p style="text-align: center;">Article 60 Threat</p> <p>1. Threat can cause the legal transaction to be nullified when it is such as to intimidate the person that he himself, his spouse, his offspring or his predecessors will suffer an unjust and grave physical or material harm.</p> <p>2. Threat can also be performed by a third person who does not participate in the legal transaction.</p>	<p>2. Rok za proglašenje relativne ništavnosti se uređuje posebnim knjigama ovog zakonika.</p> <p style="text-align: center;">Član 60 Pretnja</p> <p>1. Pretnja može uzrokovati proglašenje pravnog posla ništavnim, u slučaju kada je takav da zastrašuje lice na taj način da će, on sam, njegov suprug, potomci ili njegovi preci pretrpeti nepravednu i tešku fizičku ili materijalnu štetu.</p> <p>2. Pretnja se može izvršiti i od strane trećeg lica koje ne učestvuje u sklapanju pravnog posla.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 61 Mashtrimi</p> <p>1. Mashtrimi mund të shkaktojë që puna juridike të shpallet e pavlefshme, kur mashtrimi i përdorur nga njëra palë me qëllim për ta venë në gabim palën tjetër, është e tillë që pa atë pala nuk do ta kishte kryer punën juridike.</p> <p>2. Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së punës juridike</p>	<p style="text-align: center;">Article 61 Fraud</p> <p>1. Fraud may cause a legal transaction to be declared null and void when the deception used by one party in order to put the other party in error is such that without it the party would not have concluded the legal transaction.</p> <p>2. When fraud is committed by a third person, the deceived party may require the declaration of the legal transaction as null only when, at</p>	<p style="text-align: center;">Član 61 Obmana</p> <p>1. Obmana može uzrokovati proglašenje pravnog posla ništavnim, kada je obmana koju koristi jedna strana kako bi učinili drugu stranu da greši, takva da bez te stranke ne bi izvršila pravni posao.</p> <p>2. Kada je obmana učinjena od trećeg lica, obmanuta stranka može zahtevati proglašenje ništavnosti pravnog posla samo kada je u</p>

<p>vetëm kur në kohën e kryerjes së tij pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 62 Lajthimi</p> <p>1. Lajthimi mund të shkaktojë që puna juridike të shpallet e pavlefshme vetëm në qoftë se lidhet me cilësinë e sendit, me identitetin ose cilësitë e personit tjetër, apo me rrethana aq thelbësore sa që pa ato, pala nuk do të kishte kryer punën juridike.</p> <p>2. Lajthimi në llogaritje nuk sjell shpalljen e punës juridike si të pavlefshëm, por vetëm korrigjimin e tij, përveç kur gabimi në sasi ka qenë përcaktues për marrëveshjen.</p>	<p>the time of its performance, the other party knew or ought to have known of the fraud.</p> <p style="text-align: center;">Article 62 Mistake</p> <p>1. A mistake may cause a legal transaction to be declared invalid only if it relates to the quality of the thing, the identity or qualities of the other person, or under such circumstances as if without them the party would not have concluded the legal transaction.</p> <p>2. A mistake in calculation does not render the declaration of legal transaction as invalid, but only its correction, unless the amount error has been crucial for the agreement.</p>	<p>trenutku njenog činjenja druga strana znala ili je trebala da zna o obmani.</p> <p style="text-align: center;">Član 62 Zabluda</p> <p>1. Zabluda može uzrokovati proglašenje pravnog posla ništavnim samo ako se odnosi na svojstvo stvari, sa identitetom ili svojstvom druge osobe, ili u tako bitnim okolnostima da bez tih okolnosti, stranka ne bi obavljala pravne poslove.</p> <p>2. Zabluda u obračunu ne donosi do proglašenja pravnog posla ništavnim, već samo njegovu ispravku, osim ako je zabluda u količini bila odlučujuća za dogovor.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 63 Kontrata</p> <p>1. Kontrata është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e cila ka për qëllim të krijojë, ndryshoj ose shuaj një marrëdhënie juridike detyruese midis tyre, apo të ketë ndonjë efekt tjetër juridik.</p> <p>2. Çështjet tjera rregullohen me librin dy (2) të këtij kodi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 63 Contract</p> <p>1. The contract is an agreement between two or more parties which is intended to create, change or terminate a binding legal relationship between them, or to have any other legal effect.</p> <p>2. Other matters are regulated under Book Two (2) of this Code.</p>	<p style="text-align: center;">Član 63 Ugovor</p> <p>1. Ugovor je sporazum između dve ili više stranaka koji ima za cilj stvaranje, promenu ili prestanak obavezujućeg pravnog odnosa između njih, ili da imaju bilo koje drugo pravno dejstvo.</p> <p>2. Ostala pitanja se uređuju knjigom dva (2.) ovog zakonika.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 64 Testamenti</p> <p>1. Testamenti është shprehje e fundit e vullnetit të trashëgimlënësit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashëgimlënësi urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij.</p> <p>2. Çështjet tjera rregullohen me librin pesë (5) të këtij kodi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 64 Testament</p> <p>1. The testament is the last expression of the will of the decedent given in the form prescribed by law, by which the decedent orders how to deal with his property after his death.</p> <p>2. Other issues are regulated under Book Five (5) of this Code.</p>	<p style="text-align: center;">Član 64 Testament</p> <p>1. Testament je krajnji izraz volje ostavioca koji je dat u zakonom propisanom obliku, u kojem ostavilac nalaže kako da se deluje njegovom imovinom nakon njegove smrti.</p> <p>2. Ostala pitanja se uređuju knjigom pet (5.) ovog zakonika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 65 Premtimi publik i shpërblimit</p> <p>1. Premtimi i shpërblimit i bërë me anë të shpalljes publike për atë që kryen një veprim të caktuar, arrin ndonjë sukses, gjendet në situatë të caktuar ose në qoftë se premtimi është bërë në ndonjë kusht tjetër e detyron premtuesin që të përmbushë premtimin.</p> <p>2. Çështjet tjera rregullohen me librin dy (2) të këtij kodi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 65 Public Promise of Reward</p> <p>1. The promise of a reward made by public announcement to one who performs a certain act, achieves any success, is found in a particular situation or if the promise is made in any other condition, obliges the promisor to fulfil the promise.</p> <p>2. Other issues are regulated under Book Two (2) of this Code.</p>	<p style="text-align: center;">Član 65 Javno obećanje nagrađivanja</p> <p>1. Obećanje nagrađivanja koje je obavljeno putem javnog oglasa za onoga koji izvodi određenu radnju, postigne neki uspeh, nalazi se u određenoj situaciji ili ako je obećanje obavljeno u bilo kojem drugom stanju obavezuje obećavaoca da ispuni obećanje.</p> <p>2. Ostala pitanja se uređuju knjigom dva (2.) ovog zakonika.</p>

<p>KAPITULLI V - PËRFAQËSIMI</p> <p style="text-align: center;">Neni 66 Përfaqësimi</p> <p>1. Me përfaqësim, përfaqësuesi kryen veprime juridike në emer dhe për llogari të një personi tjetër fizik ose juridik si i përfaqësuar, brenda autorizimeve që i janë dhënë nga ligji, akti themelues, kontrata, prokura ose nga gjykata.</p> <p>2. Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet të kryhet sipas ligjit nga vetë personi.</p> <p>3. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka aftësi të plotë për të vepruar.</p> <p>4. Përfaqësues mund të jenë personat fizik dhe juridik.</p>	<p>CHAPTER V REPRESENTATION</p> <p style="text-align: center;">Article 66 Representation</p> <p>1. By representation, the representative carries out legal transactions on behalf and on the account of a natural or other legal person as represented, within the powers given to him by law, the founding act, the contract, authorization or by the court.</p> <p>2. Representation is not permitted when the legal act is to be performed by the person himself by law.</p> <p>3. A person who does not have full capacity to act, cannot act as a representative.</p> <p>4. Representatives may be natural and legal persons.</p>	<p>POGLAVLJE V – ZASTUPANJE</p> <p style="text-align: center;">Član 66 Zastupanje</p> <p>1. Preko zastupanja, zastupnik obavlja pravne radnje u ime i za račun drugog fizičkog ili pravnog lica, kao zastupnik u okviru ovlašćenja koja su mu data zakonom, aktom osnivanja, ugovorom, prokurom ili sudom.</p> <p>2. Zastupanje nije dozvoljeno kada se prema zakonu pravna radnja treba sprovesti od strane samog lica.</p> <p>3. Lice koje nema potpunu poslovnu sposobnost ne može delovati kao zastupnik.</p> <p>4. Zastupnici mogu biti fizička i pravna lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 67 Kufijtë e përfaqësimit</p> <p>1. Autorizimet e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa autorizimet e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 67 Limits of Representation</p> <p>1. Legal representation authorizations are determined by provisions of law conferring this quality, while the authorizations of the representative appointed by the principal are assigned by power of attorney.</p>	<p style="text-align: center;">Član 67 Granice zastupanja</p> <p>1. Ovlašćenja pravnog zastupanja se određuju odredbama zakona koje im daju ovo svojstvo, dok se ovlašćenja zastupnika koji je imenovan od strane zastupljenog određuju prokurom.</p>

<p>2. Autorizimet e përfaqësuesit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse.</p> <p style="text-align: center;">Neni 68 Efektet dhe pasojat e përfaqësimit</p> <p>Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda autorizimeve që i janë dhënë, krijojnë pasoja juridike drejtpërdrejt për të përfaqësuarin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 69 Kufizimet e përfaqësimit</p> <p>Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as për veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e të përfaqësuarit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 70 Përfaqësimi nga shumë persona</p> <p>Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e</p>	<p>2. The authorizations of the representative may also be concluded from the circumstances in which the respective legal actions are performed.</p> <p style="text-align: center;">Article 68 Effects and Consequences of Representation</p> <p>Legal actions performed by the representative, within the powers granted to him, cause direct consequences for the principal.</p> <p style="text-align: center;">Article 69 Limitations of Representation</p> <p>The representative cannot perform legal actions on behalf of the principal neither for himself nor for other persons represented by him, except when the represented has explicitly permitted, or where the content of the legal action does not affect the interests of the represented.</p> <p style="text-align: center;">Article 70 Representation by many persons</p> <p>When two or more representatives are appointed for the performance of a legal act, each of them may perform it without the</p>	<p>2. Ovlašćenja zastupnika se mogu izneti i od okolnosti u kojima se obavljaju odgovarajuće pravne radnje.</p> <p style="text-align: center;">Član 68 Dejstvo i posledice zastupanja</p> <p>Pravne radnje obavljene od strane zastupnika u okviru ovlašćenja koja su mu data, stvaraju direktne pravne posledice za zastupljenog.</p> <p style="text-align: center;">Član 69 Ograničenja zastupanja</p> <p>Zastupnik ne može obavljati pravne radnje u ime zastupljenog ni sam za sebe niti sa ostalim licima koje on zastupa, osim ako je zastupljeni izričito dozvolio to, ili kada sadržaj pravne radnje ne ugrožava interese zastupljenog.</p> <p style="text-align: center;">Član 70 Zastupanje od strane mnogih lica</p> <p>Kada su za obavljanje pravne radnje određena dva ili više zastupnika, svaki od njih bi mogao to učiniti bez učešća drugih zastupnika, izuzev</p>
--	--	---

<p>përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 71 Përgjegjësitë e përfaqësuesit</p> <p>1. Përfaqësuesi detyrohet të veprojë personalisht dhe nuk mund të emërojë zëvendës të tij, përveç kur është lejuar nga i përfaqësuari, kur e drejta pasurore që përmendet në prokurë ndodhet jashtë territorit të komunës ku banon përfaqësuesi, si dhe kur caktimi i zëvendësimit konsiderohet i nevojshëm për mbrojtjen interesave të të përfaqësuarit.</p> <p>2. Përfaqësuesi duhet të njoftojë menjëherë të përfaqësuarin për zëvendësimin që ka caktuar, përndryshe ai përgjigjet për veprimet e zëvendësimit. Zëvendësimi mund të hiqet në çdo kohë nga i përfaqësuari ose nga përfaqësuesi që e ka caktuar.</p>	<p>participation of other representatives, unless otherwise specified in the power of attorney.</p> <p style="text-align: center;">Article 71 Responsibilities of Representative</p> <p>1. The representative is obliged to act personally and cannot appoint his substitute, unless allowed by the principal, when the property mentioned in the power of attorney is located outside the jurisdiction of the municipality where the representative resides, as well as when the appointment of the substitute is deemed necessary for the protection of the interests of the represented.</p> <p>2. The representative must immediately notify the represented of the substitute he has appointed, otherwise he is responsible for the actions of the substitute. The substitute may be removed at any time by the represented or by the representative who designated him.</p>	<p>slučajeva kada je u prokuri predviđeno drugačije.</p> <p style="text-align: center;">Član 71 Odgovornosti zastupnika</p> <p>1. Zastupnik mora delovati lično i ne može imenovati njegovog zamenika, osim ako je to dozvoljeno od strane zastupljenog kad se svojinška prava navedena u prokuri nalaze izvan teritorije opštine u kojoj živi zastupnik, kao i kada se imenovanje zamenika smatra potrebnim za zaštitu interesa zastupljenog.</p> <p>2. Zastupnik treba odmah obavestiti zastupljenog o zameniku kojeg je postavio, u suprotnom on je odgovoran za postupke zamenika. Zamena se može ukloniti u bilo koje vreme od zastupljenog ili od zastupnika koji ga je postavio.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 72 Shuarja e përfaqësimit</p> <p>1. Përfaqësimi shuhet me:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. kalimin e afatit. Ne rast kur nuk është caktuar afati me këtë kod ose ligj të veçantë, autorizimi nuk mund të jetë më i gjatë se (10) dhjetë vite;</p>	<p style="text-align: center;">Article 72 Termination of Representation</p> <p>1. The representation ceases with:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1 Lapse of time. In cases when the deadline is not set by this code or a special law, the authorization cannot last longer than (10) ten years;</p>	<p style="text-align: center;">Član 72 Prestanak zastupanja</p> <p>1. Zastupanje prestaje:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. istekom roka. U slučajevima kada nije određen rok ovim zakonikom ili posebnim zakonom, ovlašćenje ne može biti duže od 10 godina;</p>

<p>1.2. vdekjen e personit fizik;</p> <p>1.3. shuarjen e personit juridik;</p> <p>1.4. revokim;</p> <p>1.5. denoncim.</p> <p>2. Përfaqësimi mund të shuhet edhe në rastet tjera të parapara me ligj të veçantë.</p> <p>KAPITULLI VI - PARASHKRIMI</p> <p>Rregullat e përgjithshme të parashkrimit</p> <p>1. Parashkrimi është institut juridik me anë të së cilit fitohet ose humbet një e drejtë me kalimin e një afati kohor të caktuar me ligj.</p> <p>2. Të drejtat sendore nuk shuhen, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.</p> <p>3. E drejta e kërkesës nga marrëdhëniet e detyrimeve shuhet kur të ketë kaluar afati i caktuar, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.</p>	<p>1.2 death of natural person</p> <p>1.3 dissolution of legal person</p> <p>1.4 revocation</p> <p>1.5 denunciation</p> <p>2. Representation may be ceased even in other cases foreseen by a specific law.</p> <p>CHAPTER VI – STATUTORY LIMITATIONS</p> <p>Article 73 General Rules of Statutory Limitations</p> <p>1. Statutory Limitation is a legal institute through which a right is acquired or lost upon expiration of a time limit set by law.</p> <p>2. Real rights are not statutory limited unless otherwise stipulated by law.</p> <p>3. The right of request from obligational relationships shall cease when the due date has expired within which the creditor may have required the fulfilment of the obligation.</p>	<p>1.2. smrću fizičkog lica;</p> <p>1.3. prestankom pravnog lica;</p> <p>1.4. opozivom;</p> <p>1.5. otkazivanjem.</p> <p>2. Zastupanje može prestati i u drugim slučajevima predviđenim posebnim zakonom.</p> <p>POGLAVLJE VI – ZASTARELOST</p> <p>Član 73 Opšta pravila zastarelosti</p> <p>1. Zastarelost je pravni institut preko kojeg se stiče ili gubi neko pravo istekom određenog roka koji je određen zakonom.</p> <p>2. Stvarna prava ne prestaju, osim ako nije drugačije propisano zakonom.</p> <p>3. Pravo potraživanja od obligacionih odnosa prestaje kada istekne navedeni rok, u okviru kojeg je poverilac mogao zahtevati ispunjenje obaveze.</p>
---	---	--

<p>4. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në parashkrim.</p> <p>5. Marrëveshja e palëve për ndryshimin e afateve të parashkrimit është e pavlefshme.</p> <p>6. Kur parashkruhet kërkesa kryesore, atëherë parashkruhen edhe kërkesat aksesore në kuptim të këtij kodi.</p> <p>7. Parashkrimi vlen edhe për personat me aftësi të kufizuar veprimi kur e kanë përfaqësuesin ligjor. Në rast se nuk kanë përfaqësues ligjor, afati i parashkrimit nuk përfundon më herët se 6 (gjashtë) muaj kur e kanë fituar aftësinë e plotë të veprimit ose kur kanë pranuar përfaqësues ligjor ose kujdestar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 74 Arritja e parashkrimit</p> <p>Parashkrimi arrin kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj.</p>	<p>4. The court may not take notice of statute-barring if the debtor makes no reference thereto.</p> <p>5. The parties' agreement to change the limitation period is invalid.</p> <p>6. When the main request becomes statutory limited -barred, then the accessory request in this code becomes statutory limited.</p> <p>7. The statutory limitation also applies to persons with limited ability to act when they have a legal representative. If they do not have a legal representative, the statutory limitation period shall not end earlier than six (6) months when they have acquired the full capability to act or when they have received a legal representative or guardian.</p> <p style="text-align: center;">Article 74 Reaching of the Statutory Limitation</p> <p>The statutory limitation is reached when the last day of the period stipulated by law expires.</p>	<p>4. Sud ne može razmatrati zastarelost, ako se dužnik ne poziva na zastarevanje.</p> <p>5. Sporazum stranaka o izmeni rokova zastarelosti je nevažeći.</p> <p>6. Kada glavno potraživanje zastari, onda zastare i dodatna potraživanja u smislu ovog zakonika.</p> <p>7. Zastarelost važi i za osobe sa ograničenim sposobnostima delovanja kada oni imaju pravno zastupnika. Ukoliko nemaju pravnog zastupnika, rok zastarelosti ne ističe pre 6 (šest) meseci od kada su stekli punu sposobnost delovanja ili od kada su dobili pravnog zastupnika ili staratelja.</p> <p style="text-align: center;">Član 74 Dospeće zastarelosti</p> <p>Zastarevanje dospeva kada je istekao zadnji dan roka koji je utvrđen zakonom.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 75 Fillimi i parashkrimit</p> <p>1. Afati i parashkrimit fillon rrjedhë nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e kërkesës, të cilën mund ta kërkojë në rrugë gjyqësore duke u bazuar në ligji.</p> <p>2. Për kërkesat e veçanta dhe periodike, afati fillon të rrjedhë prej momentit të arritjes së seciles kërkesë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 75 Commencement of Statutory Limitation</p> <p>1. The statutory limitation period begins to run from the day when the subject has been granted the right of claim, which can be sought through court on the basis of the law.</p> <p>2. For specific and periodic claims, statutory limitation begins to run from the moment of arrival of each request.</p>	<p style="text-align: center;">Član 75 Početak zastarelosti</p> <p>1. Rok zastarevanja počinje od dana kada je subjekat stekao pravo na potraživanje, koje prema zakonu može zatražiti od strane suda.</p> <p>2. Za posebna i periodična potraživanja, rok počinje teći od trenutka prijema svakog potraživanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 76 Ndalimi i ndryshimit të afatit të parashkrimit</p> <p>1. Me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit se sa koha e caktuar me ligj.</p> <p>2. Me punë juridike nuk mund të caktohet që mos rrjedhë parashkrimi për një kohë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 76 Prohibition of Changing the Statutory Limitation Period</p> <p>1. A legal transaction cannot impose a longer or shorter period of statutory limitation than the time set by law.</p> <p>2. It cannot be decided by legal transactions that the statutory limitation will not run for a certain period of time.</p>	<p style="text-align: center;">Član 76 Zabrana promene roka zastarelosti</p> <p>1. Pravnim poslom se ne može odrediti duži ili kraći rok zastarevanja od onoga koji je propisan zakonom.</p> <p>2. Pravnim poslom se ne može odrediti da zastarevanja ne teče za neko vreme.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 77 Afati i parashkrimit</p> <p>1. Afati i përgjithshëm i parashkrimit në marrëdhëniet me karakter detyrimor është 5 (pesë) vite.</p>	<p style="text-align: center;">Article 77 Deadline of Statutory Limitation</p> <p>1. The total term of statutory limitation in the relationship of mandatory character is 5 (five) years.</p>	<p style="text-align: center;">Član 77 Rok zastarelosti</p> <p>1. Opšti rok zastarevanja u odnosima obavezujućeg karaktera je pet (5.) godina.</p>

<p>2. Afati i veçantë i parashkrimit për marrëdhëniet tjera juridike civile caktohet në librat tjera të këtij kodi ose me ligje të veçanta.</p> <p style="text-align: center;">Neni 78 Llogaritja e afateve të parashkrimit</p> <p>1. Afati i parashkrimit që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit apo të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës në të cilën ka filluar afati dhe, kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaj.</p> <p>2. Fillimi i muajit shënon ditën e parë të muajit, mesi i muajit me ditën e pesëmbëdhjetë (15) të muajit, dhe fundi i muajit në ditën e fundit të muajit, në qoftë se diçka tjetër nuk rezulton nga qëllimi i palëve, nga natyra e marrëdhënies, ose nga doket dhe praktikat e mira afariste.</p> <p>3. Afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit të afatit.</p>	<p>2. The special deadline of statutory limitation for other civil-law relations is determined in other Books of this Code or by special law.</p> <p style="text-align: center;">Article 78 Calculation of Statutory Limitation Deadlines</p> <p>1. The statutory limitation period, which is fixed per week, month or year, expires on the day of the last week or the last month having the same name or number as that of the day on which the period has started, and, when such a day is missing in the last month, the deadline ends with the passing of the last day of this month.</p> <p>2. The beginning of the month marks the first day of the month, the middle of the month on the fifteenth (15) of the month, and the end of the month on the last day of the month, if something else does not result from the purpose of the parties, by the nature of the relationship, or from good business practices.</p> <p>3. The deadline set for day begins to run on the first day after the event from which the time limit can be calculated, and ends with the expiration of the last day of the deadline.</p>	<p>2. Posebni rok zastarevanja za druge građanskopravne odnose određuje se u drugim knjigama ovog zakonika ili posebnim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 78 Izračunavanje rokova zastarelosti</p> <p>1. Rok zastarevanja koji je određen u nedeljama, mesecima ili godinama istekom toga dana poslednje nedelje ili poslednjeg meseca koji ima isto ime ili broj kao i dan kada je počeo rok i kada takav dan ne postoji u poslednjem mesecu, rok ističe istekom poslednjeg dana ovog meseca.</p> <p>2. Početak meseca označava prvi dan u mesecu, sredina meseca petnaestim (15.) danom u mesecu, a kraj meseca poslednjim danom u mesecu, ako nešto drugo nije rezultat namere stranaka od prirode odnosa ili od običaja i dobrih poslovnih praksi.</p> <p>3. Određeni rok počinje da teče prvog dana nakon događaja od kojeg se može izračunavati rok, a završava se istekom poslednjeg dana roka.</p>
--	--	--

<p>4. Kur dita e fundit e afatit të parashkrimit bie në një ditë pushimi, quhet si e fundit ajo ditë pune që vjen pas asaj të pushimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 79 Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit</p> <p>1. Parashkrimi mund të ndërpritet me paraqitjen e kërkeses brenda afatit në rastet e afatit të parapara me këtë kod dhe ligje tjera të veçanta.</p> <p>2. Në qoftë se parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë për arsye të ndonjë shkaku ligjor ose fuqie madhore ai fillon të rrjedhë posa ai shkak të ketë pushuar së ekzistuari.</p> <p>3. Në qoftë se parashkrimi ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkaku i cili e ka ndalur rrjedhën e tij të mëtejshëm, ai vazhdon të rrjedhë kur të pushojë së ekzistuari ai shkak, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.</p> <p>4. Parashkrimi i ndërprerë kundër njërit prej debitorëve solidarë ose njërit prej bashkëshortëve të një detyrimi të papjesëtueshëm, shtrihet edhe ndaj secilit nga këta debitorë të tjerë.</p>	<p>4. When the last day of statutory limitation fails on a day off, the working day after the holiday is deemed as the last day.</p> <p style="text-align: center;">Article 79 Stopping and Termination of Statutory Limitation</p> <p>1. The statutory limitation may be terminated with the submission of claim within the deadline in the cases foreseen by this Code and other specific laws.</p> <p>2. If the statutory limitation could not be initiated for any legal reason or force majeure, it begins to run when it ceases to exist.</p> <p>3. If the statutory limitation has begun to run before the cause of the case has stopped its further course, it continues to flow when that cause ceases to exist, whereas the time it has passed prior to the stopping is calculated in the due legal deadline for statutory limitation.</p> <p>4. Terminated of statutory limitation against one of the joint debtors or one of the spouses of an unbundled obligation extends to each of these debtors.</p>	<p>4. Kada poslednji dan roka padne na praznični dan, kao poslednji dan smatra se prvi radni dan nakon praznika.</p> <p style="text-align: center;">Član 79 Zastoj i prekid zastarelosti</p> <p>1. Zastarelost se može prekinuti podnošenjem zahteva u predviđenom roku, u slučajevima rokova koji su predviđeni ovim zakonom i drugim posebnim zakonima.</p> <p>2. Ako zastarelost nije moglo početi da teče iz bilo kojeg pravnog razloga ili više sile ono počinje teći odmah nakon prestanka postojanja tog razloga.</p> <p>3. Ako je zastarelost počelo da teče pre nego što se desio uzrok koji je zaustavio njegov dalji tok, on nastavlja da teče kada prestane postojati taj uzrok, dok vreme koje je prošlo pre prestanka računa se u okviru zakonskog roka za zastarelost.</p> <p>4. Prekinuta zastarelost prema jednom od solidarnih dužnika ili jednom od supružnika neodvojive obaveze, prostire se na svakog od ovih drugih dužnika.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 80 Pezullimi i parashkrimit</p> <p>1. Parashkrimi mund të pezullohet me paraqitjen e kërkesës brenda afatit në rastet e parapara me këtë kod dhe ligje të veçanta.</p> <p>2. Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatin e parashkrimit. Kur pas shuarjes së shkakut pezullues, koha që mbetet për t'u plotësuar parashkrimi është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 80 Suspension of Statutory Limitation</p> <p>1. The statutory limitation may be suspended by filling the claim within the deadline foreseen by this code and other special laws.</p> <p>2. Suspension time is not counted in the period of statutory limitation. When, after the expiration of the suspended cause, the time remaining to meet the statutory limitation is less than six months, it is extended to six months.</p>	<p style="text-align: center;">Član 80 Zastoj zastarelosti</p> <p>1. Zastarelost se može zaustaviti podnošenjem zahteva u roku, u slučajevima koji su propisani ovim zakonikom i posebnim zakonima.</p> <p>2. Period zastoja se ne računa na rok zastarelosti. Kada nakon prestanka uzroka zastoja, vreme koje preostaje za ispunjavanje zastarelosti, je kraće od šest meseci, ono će biti produženo do šest meseci.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 81 Ndalimi i heqjes dorë nga parashkrimi</p> <p>1. Nuk lejohet heqja dorë ose ndryshimi i afatit të parashkrimit.</p> <p>2. Heqja dorë nga parashkrimi lejohet vetëm pasi të jetë arritur afati i parashkrimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 81 Prohibition of renouncing from statutory limitation</p> <p>1. Renunciation of statutory limitation or the change of statutory limitation deadline is not allowed.</p> <p>2. Renunciation of statutory limitation is allowed only upon reaching the deadline of statutory limitation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 81 Zabrana odricanja od zastarelosti</p> <p>1. Nije dozvoljeno odricanje ili dopuna roka zastarelosti.</p> <p>2. Odricanje od zastarelosti je dozvoljeno samo nakon što je postignut u zakonskom roku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 82 Moszbatimi i rregullave për parashkrimin</p> <p>Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të</p>	<p style="text-align: center;">Article 82 Failure to apply statutory limitation rules</p> <p>The rules on statutory limitation do not apply in cases when the law sets terms within which</p>	<p style="text-align: center;">Član 82 Nepoštovanje pravila za zastarelost</p> <p>Pravila za zastarelost se neće primenjivati u slučajevima kada su zakonom određeni rokovi</p>

<p>cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim nën kërcënim të humbjes së të drejtave.</p> <p style="text-align: center;">LIBRI I DYTË - DETYRIMET</p> <p>PJESA E PARË - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>KAPITULLI I - PARIMET THEMELORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 83 Përkufizimi i detyrimit</p> <p>1. Detyrimi është detyra për përmbushje, ku njëra palë në marrëdhënie juridike, debitori, i detyrohet një pale tjetër, kreditorit.</p> <p>2. Detyrimi krijohet nga kontrata, dëmi i shkaktuar një personi tjetër, pasurimi i pabazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi, shprehja e njëanshme e vullnetit dhe çdo fakt tjetër që mund të krijoj detyrime sipas ligjit.</p>	<p>the claim must be filed or to be taken an action, under threat of losing rights</p> <p style="text-align: center;">BOOK TWO - OBLIGATIONS</p> <p>PART ONE – GENERAL PROVISIONS</p> <p>CHAPTER I – BASIC PRINCIPLES</p> <p style="text-align: center;">Article 83 Definition of obligation</p> <p>1. An obligation is a duty to perform, when one party is in a legal relationship, the debtor, owes to another party, the creditor.</p> <p>2. An obligation may arise from a contract, damage caused to another [unlawful act], unjust enrichment, management of another’s affairs, unilateral acts and any other fact which is capable of generating it according to the law.</p>	<p>u okviru kojih se treba podneti tužba ili izvesti neka radnja pod pretnjom gubitka prava.</p> <p style="text-align: center;">KNJIGA DRUGA - OBLIGACIJE</p> <p>PRVI DEO - OPŠTE ODREDBE</p> <p>POGLAVLJE I – OSNOVNA NAČELA</p> <p style="text-align: center;">Član 83 Definicija obligacija</p> <p>1. Obligacija je dužnost da se ispuni, gde jedna stranka u pravnom odnosu, dužnik duguje drugoj stranci, poveriocu.</p> <p>2. Obligacije proizlaze iz ugovora, štete prouzrokovane drugom licu prouzrokovanja štete drugom licu, neosnovanog obogaćenja, nezvanog vršenja tuđih poslova, jednostranog izjavljivanja volje i bilo koje druge činjenice koje mogu stvoriti obligacije u skladu sa zakonom.</p>
--	---	--

<p>3. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve mund të jenë persona fizik ose juridik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 84 Liria e kontraktimit</p> <p>1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë për të rregulluar marrëdhëniet e tyre kontraktuale në bazë të vullnetit të tyre, brenda kufijve të përcaktuar nga dispozitat e detyrueshme (urdhëruese), rendi publik dhe doket e mira.</p> <p>2. Brenda kufijve të përmendur në paragrafin 1, palët mund të lidhin kontrata të tjera nga ato të parapara me ligj dhe të përcaktojnë përmbajtjen e tyre.</p>	<p>3. Parties to an obligation may be either natural or legal persons.</p> <p style="text-align: center;">Article 84 Freedom of contract</p> <p>1. Parties are free to regulate their contractual relations according to their will, subject to the limits established by mandatory provisions, public order and good custom.</p> <p>2. Within the limits referred to in paragraph 1, parties may conclude contracts other than those foreseen by law and determine their contents.</p>	<p>3. Učesnici u obligacionim odnosima mogu biti fizička ili pravna lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 84 Sloboda ugovaranja</p> <p>1. Učesnici u obligacionim odnosima su slobodni da urede svoje ugovorne odnose na osnovu njihove volje, u granicama utvrđenim obaveznim (prinudnim) odredbama, javnim redom i dobrim običajima.</p> <p>2. U pomenutim granicama iz stava 1, stranke mogu zaključivati druge ugovore osim onih predviđenih zakonom i da odrede njihov sadržaj.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 85 Mirëbesimi ne marrëdhëniet e detyrimeve</p> <p>1. Pjesëmarrësit duhet të veprojnë me mirëbesim gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre</p> <p>2. Mirëbesimi i referohet një standardi të sjelljes që karakterizohet nga ndershmëria, ndërgjegjshmëria dhe konsiderata për interesat e pjesëmarrësit tjetër në marrëdhënien e detyrimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 85 Good faith in obligational relationships</p> <p>1. Parties should act in good faith while fulfilling their obligations,</p> <p>2. Good faith refers to a standard of conduct characterized by honesty, openness and consideration for the interests of the other party to an obligation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 85 Savesnost u obligacionim odnosima</p> <p>1. Učesnici trebaju delovati savesno u toku ispunjavanja svojih obaveza.</p> <p>2. Dobra vera se odnosi na standard ponašanja koje odlikuje poštenje, svest i obzir za interese drugih učesnika u obligacionom odnosu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 86 Detyra e bashkëpunimit</p> <p>1. Pjesëmarrësit në një marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në përmbushjen e detyrimeve të tyre.</p> <p>2. Pjesëmarrësit në një marrëdhënie të detyrimit duhet të përmbahen nga çdo veprim me të cilin vështirësojnë përmbushjen e detyrimeve të palëve të tjera.</p>	<p style="text-align: center;">Article 86 Duty of cooperation</p> <p>1. Parties to an obligation have a duty to cooperate with each other in the performance of their obligations.</p> <p>2. Parties in an obligation relationship must refrain from any action that hinders the fulfilment of the obligations of other parties.</p>	<p style="text-align: center;">Član 86 Obaveza saradivanja</p> <p>1. Učesnici u obligacionim odnosima imaju obavezu da međusobno saraduju u ispunjavanju svojih obaveza.</p> <p>2. Učesnici u obligacionom odnosu treba da se suzdrže od bilo kakvih delatnosti koje otežavaju ispunjenje obaveza drugih stranaka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 87 Ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave në marrëdhëniet e detyrimeve</p> <p>1. Ndalohet ushtrimi i të drejtave nga marrëdhëniet e detyrimeve në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë vendosur ose njohur me ligj.</p> <p>2. Çdo sjellje përmes të cilit bartësi i një të drejte vepron haptazi me qëllimin e vetëm të dëmtimit të tjetrit konsiderohet keqpërdorim i të drejtës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 87 Prohibition of abuse of rights in obligational relationships</p> <p>1. It is forbidden to exercise rights from the relationship of obligations contrary to the purpose for which they are established or recognized by law.</p> <p>2. Any behaviour through which the rights holder acts openly for the sole purpose of inflicting harm to another is considered to be an abuse of rights.</p>	<p style="text-align: center;">Član 87 Zabrana zloupotrebe prava u obligacionim odnosima</p> <p>1. Zabranjeno je ostvarivanja prava iz obligacionih odnosa u suprotnosti sa ciljem zbog kojeg su osnovana ili priznata zakonom.</p> <p>2. Svako ponašanje kojim nosilac prava postupa otvoreno sa jednim ciljem oštećenja drugoga smatraće se zloupotrebom prava.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 88 Kujdesi në marrëdhëniet e detyrimeve</p> <p>1. Pjesëmarrësit në një marrëdhënie të detyrimit duhet të veprojnë me kujdesin që</p>	<p style="text-align: center;">Article 88 Duty of care in obligational relationships</p> <p>1. Parties to an obligation must act with the diligence required by the nature of their</p>	<p style="text-align: center;">Član 88 Dužna pažnja u obligacionim odnosima</p> <p>1. Učesnici u obligacionim odnosima treba da deluju sa dužnom pažnjom koju zahteva</p>

<p>kërkohet nga natyra e detyrimeve të tyre dhe të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të priten në përputhje me rrethanat.</p> <p>2. Gjatë përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga veprimtaria e tyre profesionale, pjesëmarrësit në një marrëdhënie të krijuar të detyrimit duhet të ushtrojnë detyrën më të lartë të kujdesit të kërkuar nga ligji. Nëse ata janë anëtarë të një grupi profesionistësh, standardet për të cilat janë përcaktuar nga një autoritet përkatës, ose nga vetë grupi, ata duhet të ushtrojnë kujdesin e shprehur në këto standarde.</p>	<p>obligations and which can reasonably be expected in the circumstances.</p> <p>2. When fulfilling obligations deriving from their professional activity, parties to an obligation must exercise the higher duty of care required by law. If they are members of a group of professionals for which standards have been set by a relevant authority or by the group itself, they must exercise the care expressed in those standards.</p>	<p>priroda njihove obligacije i koje se razumno mogu očekivati u skladu sa tim okolnostima.</p> <p>2. Tokom ispunjenja obligacija koja proističu od njihove profesionalne delatnosti, učesnici u stvorenom obligacionom odnosu trebaju vršiti najveći zadatak dužnu pažnju propisanu zakonom. Ukoliko su članovi grupe stručnjaka, čiji standardi su određeni od strane nadležnog organa, ili same grupe, oni trebaju da deluju sa pažnjom koja je izražena u ovim standardima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 89 Punët e tjera juridike</p>	<p style="text-align: center;">Article 89 Other legal affairs</p>	<p style="text-align: center;">Član 89 Ostali zakonski pravni poslovi</p>
<p>Përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, dispozitat që rregullojnë kontratat do të zbatohen, për aq sa është praktike, për punët tjera juridike.</p>	<p>Unless otherwise provided by law, provisions regulating contracts are applied to the possible extent with other legal issues.</p>	<p>Osim ako nije drugačije predviđeno zakonom, odredbe koje uređuju ugovore će se primenjivati, u meri u kojoj je to praktično, za ostale pravne poslove.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 90 Fusha e aplikimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 90 Scope of application</p>	<p style="text-align: center;">Član 90 Područje primene</p>
<p>Dispozitat e këtij Libri do të zbatohen për detyrimet e rregulluara me ligje të tjera në masën që këto ligje nuk rregullojnë çështjet të cilat janë të rregulluara nga ky libër.</p>	<p>The provisions of this Book shall apply to obligations regulated by other laws to the extent that such laws do not govern matters which are governed by this Book.</p>	<p>Odredbe ove Knjige će se primenjivati na obaveze uređene drugim zakonima u meri u kojoj ti zakoni ne uređuju pitanja koja su uređena u ovoj Knjizi.</p>

<p>KAPITULLI II – BURIMET E DETYRIMEVE</p> <p>Nënkapitulli I – Dispozitat e Përgjithshme për Kontratat</p> <p>Neni 91 Përkufizimi i kontratës</p> <p>Kontrata është marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e cila ka për qëllim të krijojë, ndryshojë ose shuaj një marrëdhënie juridike detyruese midis tyre, apo të ketë ndonjë efekt tjetër juridik.</p> <p>Neni 92 Efektet e kontratës</p> <p>1. Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese.</p> <p>2. Kontrata mund ta japë një të drejtë në dobi të një personi të tretë.</p> <p>Neni 93 Shprehja e vullnetit</p> <p>1. Vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij.</p>	<p>CHAPTER II – SOURCES OF OBLIGATION</p> <p>Sub-chapter I – General Provisions for Contracts</p> <p>Article 91 Definition of contract</p> <p>The contract is an agreement between two or more parties which is intended to create, amend or terminate a binding legal relationship between them, or have any other legal effect.</p> <p>Article 92 Effects of a contract</p> <p>1. A contract creates rights and obligations for the contracting parties.</p> <p>2. A contract may grant a right in favour of a third person.</p> <p>Article 93 Declaration of will</p> <p>1. The will to conclude a contract can be declared in words, with common signs or with any other behaviour from which it can be concluded with certainty about its existence.</p>	<p>POGLAVLJE II - IZVORI OBLIGACIJA</p> <p>Potpoglavlje I - Opšte odredbe o ugovorima</p> <p>Član 91 Definicija ugovora</p> <p>Ugovor je sporazum između dve ili više stranaka koji ima za cilj da stvori, promeni ili ukine obavezujući pravni odnos između njih, ili da ima bilo koji drugo pravno dejstvo.</p> <p>Član 92 Dejstvo ugovora</p> <p>1. Ugovor stvara prava i obaveze ugovornih stranaka.</p> <p>2. Ugovor može dati pravo u korist trećeg lica.</p> <p>Član 93 Izražavanje volje</p> <p>1. Volja za zaključivanje ugovor može se izraziti rečima, običnim znakovima ili bilo kakvim drugim ponašanjem od kojeg se može sa sigurnošću zaključiti njegovo postojanje.</p>
---	---	---

<p>2. Shprehja e vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht.</p> <p style="text-align: center;">Neni 94 Negociatat</p> <p>1. Palët janë të lira të negociojnë dhe nuk janë përgjegjëse për mos arritjen e një marrëveshjeje.</p> <p>2. Pala që ka zhvilluar negociata pa pasur qëllim që të lidhë kontratë, mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar gjatë zhvillimit të negociatave.</p> <p>3. Përgjegjësi për dëmin mban edhe pala që i ka zhvilluar negociatat me qëllim që të lidhë kontratë, e pastaj heqë dorë nga ky qëllim pa ndonjë shkak të bazuar dhe në këtë mënyrë i shkakton dëm palës tjetër.</p> <p>4. Në qoftë se nuk mirren vesh ndryshe, secila palë bartë shpenzimet e veta rreth përgatitjes për lidhjen e kontratës, kurse shpenzimet e përbashkëta i bartin në pjesë të barabarta.</p>	<p>2. Declaration of will must be free and genuine.</p> <p style="text-align: center;">Article 94 Negotiations</p> <p>1. The parties are free to negotiate and are not responsible for not reaching an agreement.</p> <p>2. A party that has negotiated with no real intention of reaching an agreement with the other party shall be liable for any damage caused during negotiations.</p> <p>3. Responsibility for damages is borne by the other party who negotiated with the purpose of concluding the contract, and after that gave up the conclusion of contract without any justified reason and thus caused damage to the other party.</p> <p>4. Unless otherwise agreed, each party shall bear its own costs in connection with the preparation for the conclusion of the contract, and the joint costs shall be borne in equal shares.</p>	<p>2. Izražavanje volje treba biti učinjeno slobodno i ozbiljno.</p> <p style="text-align: center;">Član 94 Pregovori</p> <p>1. Stranke su slobodne da pregovaraju i nisu odgovorne za neuspeh da se postigne sporazum.</p> <p>2. Stranka koja je vodila pregovore bez namere da zaključi ugovor, snosi odgovornost za štetu nastalu tokom pregovora.</p> <p>3. Odgovornost za štetu snosi i stranka koja je vodila pregovore radi zaključivanja sporazuma, a onda odustaje od ovog cilja bez nekog zasnovanog razloga i time nanosi štetu drugoj stranci.</p> <p>4. Ako se ne dogovore drugačije, svaka stranka snosi svoje troškove oko pripreme za zaključivanje ugovora, a zajedničke troškove snose u jednakim delovima.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 95 Përmbajtja e detyrueshme e një kontrate</p> <p>Dispozitat ligjore, me të cilat caktohet pjesërisht apo tërësisht përmbajtja e kontratës janë pjesë përbërëse e këtyre kontratave, kështu që i plotësojnë ato, ose hyjnë në vend të dispozitave kontraktuese që nuk janë në pajtim me to.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Elementet Esenciale</p> <p style="text-align: center;">Neni 96 Elementet esenciale</p> <p>1. Një kontratë nuk konsiderohet e lidhur deri sa palët ta arrijnë marrëveshjen për elementet esenciale të kontratës.</p> <p>2. Elementet esenciale të kontratës janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. pajtimi i vullnetit të palëve;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. lënda e kontratës;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. baza e kontratës;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. forma, kur kërkohet me këtë kod apo me ligj të vecantë.</p> <p>3. Palët, pasi të dakordohen për elementet esenciale të kontratës, mund të vazhdojnë me</p>	<p style="text-align: center;">Article 95 Mandatory content of a contract</p> <p>Legal provisions which partially or completely set the content of a contract are an integral part of these contracts, so they complement them or are used instead of contractual provisions that are inconsistent with them.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Essential Elements</p> <p style="text-align: center;">Article 96 Essential elements</p> <p>1. A contract is not concluded until the parties have reached an agreement on all essential elements of the contract.</p> <p>2. The essential elements of a contract are:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Consent of the will of the parties;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. The subject of the contract;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. The basis of the contract;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. The form, when required by this code or by a specific law.</p> <p>3. The parties, after having agreed on the essential elements of the contract, may</p>	<p style="text-align: center;">Član 95 Obavezni sadržaj ugovora</p> <p>Zakonske odredbe kojima se u potpunosti ili delimično određuje sadržaj ugovora sastavni su deo tih ugovora, tako da ih dopunjuju, ili se uvrštavaju na mesto ugovornih odredbi koje nisu u skladu sa njima.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Osnovni elementi</p> <p style="text-align: center;">Član 96 Osnovni elementi</p> <p>1. Ugovor se ne smatra zaključenim sve dok stranke na postignu sporazum o osnovnim elementima ugovora.</p> <p>2. Osnovni elementi ugovora su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1.pomirenje volje stranaka;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2.predmet ugovora;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3.osnova ugovora;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4.oblik, kada se to zahteva ovim zakonom ili posebnim zakonima.</p> <p>3. Nakon što se dogovore o osnovnim elementima ugovora, stranke mogu nastaviti sa</p>
---	--	--

<p>marrëveshjen për elementet sekondare. Megjithatë, në rast të dështimit për të arritur një marrëveshje për elementet e tilla, gjykata do t'i përcaktojë ato duke pasur parasysh rregullat për interpretimin e kontratave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 97 Koha dhe vendi i lidhjes së kontratës</p> <p>1. Kontrata është e lidhur kur dhe në vendin ku pala që ka bërë ofertën merr pranimin nga pala tjetër.</p> <p>2. Në rastin e pranimin me anë të përmbushjes, kontrata është e lidhur kur njoftimi i fillimit të përmbushjes arrin te ofertuesi. Në qoftë se, me kërkesë të ofertuesit, nga natyra e kontratës, për arsye të praktikave të cilat palët kanë përcaktuar ndërmjet tyre, ose sipas përdorimit, pala tjetër mund të pranojë ofertën pa e njoftuar ofertuesin, kontrata është lidhur kur fillon përmbushja e ofertës.</p> <p>3. Në rastin e një kontratë të lidhur me mjete elektronike, kontrata konsiderohet e lidhur në vendin ku ofertuesi e ka selinë e regjistruar ose vendin e tij të banimit.</p>	<p>continue with the agreement on the secondary terms. However, in the event of a failure to reach an agreement on such terms, the court will determine them in the light of the rules for the interpretation of the contracts.</p> <p style="text-align: center;">Article 97 Time and place of conclusion of a contract</p> <p>1. A contract is concluded when and at the place where the party who made the offer receives the acceptance of the other party.</p> <p>2. In the case of acceptance by means of performance, the contract is concluded when notice of commencement of performance reaches the bidder. If, at the request of the bidder, by the nature of the contract, or by the virtue of practices which the parties have established between themselves, or by use, the other party may accept the bid without notifying the bidder, the contract is concluded when the bid's performance begins.</p> <p>3. In the case when a contract is concluded through electronic means, the contract is considered to be concluded at the place where the bidder has his registered office or place of residence.</p>	<p>sporazumom o sekundarnim elementima. Međutim, u slučaju neuspeha da se postigne sporazum o takvim elementima, sud će ih odrediti na osnovu pravila o tumačenju ugovora.</p> <p style="text-align: center;">Član 97 Vreme i mesto zaključivanja ugovora</p> <p>1. Ugovor je zaključen kada u mestu gde je stranka koja je podnela ponudu dobije prihvatanje od druge stranke.</p> <p>2. U slučaju prihvatanja ispunjavanjem, ugovor je zaključen kada obaveštenje o početku ispunjavanja stigne kod ponuđača. Ako je, uz zahtev ponuđača, usled prirode ugovora, zbog prakse koje su stranke uspostavile između sebe, ili upotrebom, druga stranka može prihvatiti ponudu bez obaveštenja ponuđača, ugovor je zaključen kada počinje ispunjenje ponude.</p> <p>3. U slučaju ugovora koji je zaključen elektronskim putem, ugovor se smatra zaključenim u mestu gde ponuđač ima registrovano sedište ili njegovo prebivalište.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 98 Pëlqimi i palës së tretë</p> <p>1. Në qoft se për lidhjen e një kontrate nevojitet pëlqimi i personit të tretë, ky pëlqim mund të jepet para lidhjes së kontratës, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.</p> <p>2. Pëlqimi i palës së tretë duhet të jepet në formën e përcaktuar të kontratës për të cilën kërkohet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 98 Consent of a third party</p> <p>1. If a third party's consent is required for the conclusion of a contract, such consent may be granted prior to the conclusion of the contract unless otherwise foreseen by law.</p> <p>2. The consent of a third party must be given in the form prescribed for the contract for which it is required.</p>	<p style="text-align: center;">Član 98 Saglasnost treće stranke</p> <p>1. Ako je za zaključivanje ugovora potrebna saglasnost trećeg lica, ova saglasnost se može dati pre zaključenja ugovora, osim ako zakonom nije drugačije određeno.</p> <p>2. Saglasnost treće stranke treba se dati u propisanom obliku ugovora za koji se zahteva.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkaptulli III – Oferta</p> <p style="text-align: center;">Neni 99 Oferta</p> <p>1. Oferta është një propozim i cili ka për qëllim lidhjen e një kontrate.</p> <p>2. Propozimi përbën një ofertë nëse është bërë për një ose më shumë persona të veçantë dhe përmban elementet esenciale të kontratës.</p> <p>3. Një propozim i bërë për publikun dhe i cili përmban elementet esenciale të kontratës do të konsiderohet si ofertë, nëse nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat apo përdorimi.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter III - Offer</p> <p style="text-align: center;">Article 99 Offer</p> <p>1. An offer is a proposal aiming to the conclusion of a contract.</p> <p>2. The proposal constitutes an offer if it is made to one or more persons and contains the essential elements of the contract.</p> <p>3. A proposal made to the public and which contains the essential elements of the contract shall be considered as an offer, unless it is different from the circumstances or use.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje III - Ponuda</p> <p style="text-align: center;">Član 99 Ponuda</p> <p>1. Ponuda je predlog koji ima za cilj zaključenje ugovora.</p> <p>2. Predlog predstavlja ponudu ako je učinjena za jednog ili više određenih lica i sadrži osnovne elemente ugovora.</p> <p>3. Predlog koji je učinjen za javnost i koji sadrži osnovne elemente ugovora smatraće se ponudom , ukoliko drugačije ne proizilazi iz okolnosti ili korišćenja.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 100 Ekspozimi i mallit</p> <p>Ekspozimi i mallit të etiketuar me çmim, dhe propozimi për furnizimin e mallrave nga stoku me çmim të deklaruar, të bërë në një shpallje publike, qoftë me anë të transmetimit, shtypit, me telefon ose mjete të tjera të tilla si interneti, trajtohet si një ofertë deri kur stoku i mallrave nuk shpenzohet, përveç nëse rrethanat apo përdorimi tregojnë ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 100 Display of goods</p> <p>The display of goods labelled with a price, and the proposal to supply goods from stock at a stated price made in a public advertisement, whether via broadcast, print, telephone or any other means such as the Internet, are treated as an offer until the stock of goods is exhausted, unless the circumstances or use indicate otherwise.</p>	<p style="text-align: center;">Član 100 Izlaganje robe</p> <p>Izlaganje robe označene cenom, i predlog za snabdevanje robe iz zaliha u naznačenoj ceni, koje je objavljeno u javnom oglasu, bilo putem prenosa, štampe, telefona ili drugim sredstvima kao što je Internet, smatra se kao ponuda dok se ne potroše zalihe robe, osim ako okolnosti ili upotreba ne ukazuju na nešto drugo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 101 Katalogët dhe njoftimet tjera</p> <p>1. Dërgimi i katalogëve, i çmimoreve, tarifave dhe i njoftimeve të tjera, si dhe shpalljet e bëra me anë të shtypit, trakteve, postes, radios, televizionit ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme elektronike, nuk përbëjnë ofertë për lidhjen e kontratës, por vetëm ftesë që të bëhet oferta nën kushtet e shpallura.</p> <p>2. Megjithatë, dërguesi i thirrjeve të tilla do të përgjigjet për dëmin, të cilin do ta pësonte ofertuesi, po që se dërguesi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e ka pranuar ofertën e ofertuesit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 101 Catalogues and other notices</p> <p>1. Catalogues, price lists, tariffs and other notices, as well as other announcements made in press, tracts, post, radio, television or any other applicable electronic form, shall not be deemed offers for the conclusion of a contract, but merely invitations to make an offer according to the announced conditions..</p> <p>2. However, the sender of such calls shall be liable for the damage which the Bidder would incur, if the sender, without any reasonable cause, has not accepted the Bidder's offer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 101 Katalozi i druga obaveštenja</p> <p>1. Slanje kataloga, cenovnika, tarifa i drugih obaveštenja, kao i oglasi koji se obavljaju preko štampe, letaka, pošte, radija, televizije ili na bilo koji drugi odgovarajući elektronski način, ne predstavljaju ponudu za zaključivanje ugovora, već samo poziv da se sastavi ponuda pod objavljenim uslovima.</p> <p>2. Međutim, pošiljalac takvih poziva odgovaraće za štetu, koju će pretrpeti ponuđač, ako pošiljalac bez nekog opravdanog razloga nije prihvatio ponudu ponuđača.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 102 Efekti i ofertës dhe i revokimit</p> <p>1. Ofertuesi është i lidhur me ofertën, përveç nëse ofertuesi detyrimin e vet për ta mbajtur ofertën e ka përjashtuar, apo në qoftë se ky përjashtim rrjedh nga rrethanat e rastit.</p> <p>2. Oferta mund të revokohet vetëm në qoftë se i ofertuari e ka marrë revokimin përpara marrjes së ofertës, apo njëkohësisht me të.</p>	<p style="text-align: center;">Article 102 Effect of offer and withdrawal</p> <p>1. The offeror shall be bound by an offer, unless the offeror excluded the obligation to adhere to the offer or if such an exclusion follows from the circumstances of the transaction.</p> <p>2. The offeror may only withdraw an offer if the addressee receives the withdrawal before receiving the offer or at the same time as receiving the offer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 102 Dejstvo ponude i opoziva</p> <p>1. Ponuđać je povezan sa ponudom, osim ukoliko je ponuđać isključio svoju obavezu da zadrži ponudu, ili ako to isključenje proizilazi iz okolnosti slućaja.</p> <p>2. Ponuda se moųe opozvati samo ako je ponuđać primio opoziv pre prijema ponude ili istovremeno sa njom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 103 Vdekja ose paaftësia e një pale</p> <p>Oferta nuk e humb efektin, në qoftë se vdekja ose paaftësia e një pale ka lindur përpara përpara pranimit të saj përveç nës qoftë se e kundërta rezulton nga qëllimi i palës, nga zakoni ose nga natyra e punës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 103 Death or incapacity of a party</p> <p>The offer does not lose its effect if the death or incapacity of a party has arisen before its admission unless the opposite results from the purpose of the party, the habit or the nature of the work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 103 Smrt ili nesposobnost jedne stranke</p> <p>Ponuda ne gubi dejstvo ako je smrt ili nesposobnost jedne stranke nastupila pre njenog prihvatanja osim ako suprotno proizilazi iz namere stranke, iz obićaja ili prirode posla.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV – Pranimi i ofertes</p> <p style="text-align: center;">Neni 104 Pranimi i ofertës</p> <p>1. Oferta është e pranuar kur ofertuesi e merr deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Acceptance</p> <p style="text-align: center;">Article 104 Acceptance</p> <p>1. Acceptance is any statement or conduct which indicates the addressee’s assent to the offer.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV - Prihvatanje ponude</p> <p style="text-align: center;">Član 104 Prihvatanje ponude</p> <p>1. Ponuda je prihvaćena kada ponuđać primi izjavu ponuđenog da prihvata ponudu.</p>

<p>2. Heshtja ose mosveprimi nga ana e të ofertuarit nuk përbën pranim. Megjithatë, në qoftë se i ofertuari është i detyruar që mos të mbetet i heshtur ose joaktiv në pajtim me ligjin ose me marrëveshje ndërmjet palëve, në bazë të praktikave të cilat palët i kanë përcaktuar ndërmjet tyre ose me përdorim, heshtja apo mosveprimi i të ofertuarit përbën pranim.</p> <p>3. Pa rënë ndesh me nenin 23 të këtij libri çdo klauzolë në një ofertë ku heshtja ose mosveprimi i pranuesit do të interpretohet si pranim i ofertës është e paefektshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 105 Kontrata e detyrueshme vetëm për ofertuesin</p> <p>Oferta për lidhjen e një kontrate që krijon detyrime vetëm për ofertuesin është e pakthyeshme menjëherë pasi që vjen në dijeni të të ofertuarit. Ky i fundit mund ta refuzojë ofertën brenda afatit të kërkuar për nga natyra e kontratës ose për nga përdorimi. Në mungesë të refuzimit të tillë, kontrata konsiderohet e lidhur.</p>	<p>2. The addressee's silence or inactivity does not in itself amount to acceptance. However, if the addressee was obliged to not remain silent or inactive pursuant to the law or by agreement between the parties, by virtue of practices which the parties have established between themselves or of usages, the silence or inactivity of the addressee amounts to acceptance.</p> <p>3. Without prejudice to Article 23 of this Book, any clause in an offer whereby the silence or inaction of the addressee will be construed as acceptance of the offer shall be ineffective,</p> <p style="text-align: center;">Article 105 Mandatory contract only for the offeror</p> <p>An offer for the conclusion of a contract that creates obligations only for the bidder is irrevocable as soon as it comes to the knowledge of the addressee. The latter can reject the offer within the time required by the nature of the contract or by use. In the absence of such rejection the contract is deemed concluded.</p>	<p>2. Ćutanje ili ne delovanje ponuđenog ne predstavlja prihvatanje. Međutim, ako ponuđač je dužan da ne ćuti ili da ostaje neaktivan, u skladu sa zakonom ili sporazumom između stranaka, na osnovu praksi koje su stranke odredile između sebe ili korišćenjem, ćutanje ili ne delovanje ponuđenog predstavlja prihvatanje.</p> <p>3. Ne dolazeći u sukob sa članom 23 ove knjige, svaka klauzula u ponudi, gde ćutanje ili ne delovanje ponuđenog će se tumačiti kao prihvatanje ponuda, je neefikasno.</p> <p style="text-align: center;">Ćlan 105 Ugovor koji je obavezujući samo za ponuđača</p> <p>Ponuda za zaključenje ugovora koji stvara obaveze samo za ponuđača je nepovratna čim dođe do saznanja ponuđenog. Ovaj poslednji može da odbije ponudu u roku koji je predviđen po prirodi ugovora ili korišćenja. U nedostatku takvog odbijanja, ugovor se smatra zaključenim.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 106 Forma e ofertës</p> <p>1. Oferta e kontratës për lidhjen e së cilës ligji kërkon formë specifike e detyron ofertuesin vetëm po qe se është bërë në këtë formë.</p> <p>2. Ky rregull vlen edhe për pranimin e ofertës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 106 Form of offer</p> <p>1. The contract offer for which the law requires a specific form obligates the bidder only if it is done in this form.</p> <p>2. This rule shall also apply to the acceptance of the offer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 106 Forma ponude</p> <p>1. Ponuda ugovora za zaključivanje kojom zakon zahteva specifičnu formu obavezuje samo ponuđača ukoliko je obavljeno na ovaj način.</p> <p>2. Ovo pravilo važi i za prihvatanje ponude.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 107 Afati i fundit për pranim</p> <p>1. Pranimi i një oferte është efektiv vetëm nëse i dorëzohet ofertuesit brenda kohës së përcaktuar nga ofertuesi, apo si kërkohet nga natyra e kontratës ose sipas përdorimit.</p> <p>2. Një pranim i vonshëm është megjithatë efektiv nëse ofertuesi menjëherë njofton palë tjetër se është trajtuar si një pranim i efektshëm.</p> <p>3. Në qoftë se është e qartë nga dokumenti që përmban pranimin me vonesë i cili po të kishte arritur tek ofertuesi në kohën e duhur, po të mos kishte pasur vonesa në dërgimin e tij, pranimi me vonesë është pranim efektive, përveç nëse ofertuesi menjëherë njofton palën tjetër se ai e konsideron ofertën e tij si joefektive.</p>	<p style="text-align: center;">Article 107 Deadline for acceptance</p> <p>1. Acceptance of an offer is effective only if it is submitted to the Bidder within the time determined by the Bidder, or as required by the nature of the Contract or by use.</p> <p>2. Subsequent acceptance is however effective if the Bidder immediately notifies the other party that it has been treated as an effective admission.</p> <p>3. If it is evident from the document containing a late acceptance that it would have reached the offer or in due time had there been no delays in its transmission, the late acceptance is effective as an acceptance, unless the bidder immediately gives notice to the other party that he considers his offer as ineffective.</p>	<p style="text-align: center;">Član 107 Krajnji rok za prihvatanje</p> <p>1. Prihvatanje ponuda je efikasno samo ako se ponuđaču dostavi u roku koji odredi ponuđač, ili kako zahteva priroda ugovora ili korišćenja.</p> <p>2. Kasno prihvatanje je ipak delotvorno ukoliko ponuđač odmah obavesti drugu stranku da je ponuda tretirana kao efikasno prihvatanje.</p> <p>3. Ako je jasno iz dokumenta koji sadrži kasno prihvatanje koji kada bi stigao do ponuđača u dogledno vreme, kada ne bi bilo kašnjenja u njegovoj dostavi, prihvatanje sa zakašnjenjem je efektivno prihvatanje, osim ako ponuđač odmah obavestava stranke da on smatra njegovu ponudu kao neefikasnu.</p>

<p align="center">Neni 108 Pranimi i ofertës me propozimin për ndryshim</p>	<p align="center">Article 108 Acceptance with different or additional terms</p>	<p align="center">Član 108 Prihvatanje ponude sa predlogom za izmenu</p>
<p>1. Pranimi i cili deklaron apo nënkupton shtesa apo ndryshime të cilat në thelb ndryshojnë kushtet e ofertës konsiderohet si ofertë e re.</p> <p>2. Nëse shtesat apo modifikimet e deklaruar ose të nënkuptuara nga një pranim nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet e ofertës, kushtet shtesë ose të ndryshme bëhen pjesë e kontratës, përveç nëse oferta shprehimisht kufizon pranimin e kushteve të ofertës apo nëse ofertuesi menjëherë paraqet kundërshtim.</p> <p>3. Shtesat apo ndryshimet në lidhje me çmimin, pagesën, cilësinë dhe sasinë e performancës, vendin dhe kohën e dorëzimit, shtrirjen e përgjegjësisë së njërës palë ndaj tjetrës ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konsiderohen se në mënyrë thelbësore ndryshojnë kushtet e ofertës</p>	<p>1. Acceptance which declares or implies additions or changes that substantially alter the terms of the bid is considered as a new offer.</p> <p>2. If the additions or modifications stated or implied by an acceptance do not substantially alter the terms of the offer, the additional or different terms become part of the contract, unless the offer expressly limits acceptance to the terms of the offer or if the bidder objects immediately.</p> <p>3. Additions or modifications relating to the price, payment, quality and quantity of performance, place and time of delivery, extent of one party's liability to the other or the settlement of disputes are considered to alter the terms of the offer substantially.</p>	<p>1. Prihvatanje u kojem se navode ili podrazumevaju dopune ili izmene koje znatno menjaju uslove ponude smatraju se novom ponudom.</p> <p>2. Ako navedene ili podrazumevane izmene ili dopune iz prihvatanje ne menjaju bitno uslove ponude, dodatni ili drugi uslovi postaju deo ugovora, osim ako ponuda izričito ograničava prihvatanje uslova ponude ili ako ponuđač odmah podnese prigovor.</p> <p>3. Dopune ili promene o ceni, plaćanju, kvalitetu i kvantitetu učinka, mestu i vremenu dostave, obimom odgovornosti jedne stranke prema drugoj ili rešavanje nesporazuma smatraju se da se značajno menjaju uslove ponude.</p>

KAPITULLI III PARAKONTRATA	CHAPTER III – PRE-CONTRACT	POTPOGLAVLJE III -
<p style="text-align: center;">Neni 109 Nocioni i parakontratës</p> <p>1. Parakontrata është kontratë në bazë të së cilës palët marrin përsipër detyrimin për ta lidhur kontratën kryesore në të ardhmen. Parakontrata mund të bëhet e detyrueshme për njërën ose të dyja palët.</p> <p>2. Parakontrata obligon në qoftë se i përmban elementet esenciale të kontratës kryesore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 109 Definition of pre-contract</p> <p>1. Pre-contract is a contract under which the parties assume the obligation to conclude the main contract in the future. Pre-contract may be mandatory for one or both parties.</p> <p>2. The pre-contract shall contain the essential elements of the definitive contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 109 Pojam predugovora</p> <p>1. Predugovor je ugovor prema kojem stranke se obavezuju za zaključivanje glavnog ugovora u budućnosti. Predugovor može postati obavezujući prema jednoj ili prema obeju strankama.</p> <p>2. Predugovor obavezuje ako sadrži osnovne elemente glavnog ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 110 Forma e parakontratës</p> <p>Dispozitat mbi formën e kontratës kryesore vlejné edhe për parakontratën, në qoftë se forma e parashikuar është kusht i vlefshmërisë së kontratës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 110 Pre-contract form</p> <p>Provisions on the form of the main contract are also valid for the pre-contract, if the foreseen form is a condition of the contract's validity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 110 Forma predugovora</p> <p>Određbe o obliku glavnog ugovora važe i za predugovor, ako predviđena forma je uslov za valjanost ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 111 Afati kohor</p> <p>1. Parakontrata përcakton afatin kohor për lidhjen e kontratës kryesore. Në qoftë se nuk ka afat kohor të përcaktuar, ose nëse pala e cila e ka të drejtën për ta vendosur afatin kohor në parakontratë nuk e vendosë atë datë, gjykata</p>	<p style="text-align: center;">Article 111 Deadline</p> <p>1. The pre-contract shall stipulate the deadline for the conclusion of the definitive contract. If no deadline is stipulated, or the party entitled to set it under the pre-contract fails to do so, an appropriate deadline for performance is set</p>	<p style="text-align: center;">Član 111 Vremenski rok</p> <p>1. Predugovor određuje vremenski rok za zaključivanje glavnog ugovora. Ako ne postoji određeni vremenski rok, ili ako stranka koja ima pravo određivanja vremenskog roka u predugovoru ne odredi taj datum, sud će</p>

<p>do të vendosë një afat të përshtatshëm kohor për kryerje, pasi që marrëveshja mes palëve dështon.</p> <p>2. Afati për lidhjen e kontratës kryesore nuk konsiderohet i domosdoshëm, përveç kur rrjedh ndryshe nga qëllimi i palëve ose nga natyra e kontratës.</p> <p>3. Nëse pala nuk vepron në përputhje me detyrimin për ta lidhur kontratën kryesore, pala tjetër mund të kërkojë nga gjykata që të urdhërojë palën tjetër ta lidhë kontratën kryesore gjer në një afat kohor.</p> <p>4. E drejta e paraparë në paragrafin 3 skadon gjashtë (6) muaj nga kalimi i afatit kohor të përcaktuar për lidhjen e kontratës kryesore.</p>	<p>by the court, failing an agreement between the parties.</p> <p>2. The deadline for the conclusion of the definitive contract shall not be deemed essential, unless it is different from the intention of the parties or the nature of the contract.</p> <p>3. If a party fails to comply with the obligation to conclude the main contract, the other party may request the court to order the other party to enter into the main contract within an appropriate deadline.</p> <p>4. The right provided for in paragraph 3 shall expire six (6) months from the lapse of the deadline set for the conclusion of the main contract.</p>	<p>odrediti odgovarajući vremenski rok za obavljanje, nakon što sporazum između stranaka ne uspe.</p> <p>2. Rok za zaključivanje glavnog ugovora ne smatra se neophodnim, osim ako se drugačije izražava iz namere stranaka ili prirode ugovora.</p> <p>3. Ako stranka ne postupi u skladu sa obavezom za zaključivanje glavnog ugovora, druga stranka može zahtevati od suda da nalaže drugoj stranci da zaključi glavni ugovor do određenog vremenskog roka.</p> <p>4. Pravo predviđeno u stavu 3 ističe šest (6) meseci od isteka propisanog roka za zaključivanje glavnog ugovora.</p>
<p>Kapitulli IV– Objekti</p> <p>Neni 112 Objekti i detyrimit kontraktues</p> <p>1. Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, veprimi, mosvperimi ose durimi.</p> <p>2. Detyrimi duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar ose i caktueshëm.</p>	<p>Chapter IV - Object</p> <p>Article 112 Object of the contractual obligation</p> <p>1. A contractual obligation may consist of giving, acting, non-execution or endurance.</p> <p>2. Obligation should be possible, permissible, fixed or definable.</p>	<p>Poglavlje IV – Predmet</p> <p>Član 112 Predmet ugovorne obaveze</p> <p>1. Ugovorna obaveza se može sastojati od davanja, delovanja, ne delovanja ili strpljenja.</p> <p>2. Obaveza treba da bude moguća, dozvoljena, određena ili određiva.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 113 Kontrata nule</p> <p>Kontrata është nule, kur objekti i detyrimit është absolutisht i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 113 Null contract</p> <p>A contract shall be null if the subject of the obligation is absolutely impossible, unlawful, unspecific or unspecifiable.</p>	<p style="text-align: center;">Član 113 Ništavi ugovor</p> <p>Ugovor je ništavan kada predmet obaveze je apsolutno nemoguć, nedozvoljen, ne određen ili se ne može odrediti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 114 Kushti shtyrës</p> <p>Kontrata e lidhur nën kushtin shtyrës ose me afat kohorë, është e vlefshme në qoftë se objekti i detyrimit i cili në fillim ishte i pamundur është bërë i mundur para realizimit të kushtit apo skadimit të afatit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 114 Subsequent possibility</p> <p>A contract concluded with a suspensive condition or deadline shall be valid if the object of the obligation, having initially been impossible, becomes possible before the condition is completed or before the deadline expires.</p>	<p style="text-align: center;">Član 114 Odložni uslov</p> <p>Ugovor zaključen pod odložnim uslovom ili u vremenskom roku je važeći ako je predmet obaveze koji je u početku bio nemoguć postao moguć pre izvršenja uslova ili isteka roka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 115 Objekti i palejueshëm</p> <p>Objekti i një detyrimi është i palejueshëm në qoftë se është në kundërshtim me dispozitat urdhëruese,, me rendin publik dhe me doket e mira.</p>	<p style="text-align: center;">Article 115 Unlawful object</p> <p>The object of an obligation shall be deemed unlawful if it is contrary to mandatory provisions, public order and good custom.</p>	<p style="text-align: center;">Član 115 Nedopustivi predmet</p> <p>Predmet obaveze je nedopustiv ako je u suprotnosti sa obavezujućim odredbama, javnim redom i dobrim običajima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 116 Kur objekti i detyrimit është i caktueshëm</p> <p>1. Objekti i detyrimit është i caktueshëm në qoftë se kontrata përmban të dhënat me ndihmën e të cilave mund të caktohet objekti,</p>	<p style="text-align: center;">Article 116 When the object of an obligation is specifiable</p> <p>1. The object of an obligation shall be deemed specifiable if the contract contains information with which it is possible to</p>	<p style="text-align: center;">Član 116 Kada predmet obaveze je odrediv</p> <p>1. Predmet obaveze je odrediv ako ugovor sadrži podatke pomoću kojih se može odrediti predmet, ili ako su stranke prepustile trećem</p>

<p>apo nëse palët ia kanë lënë personit të tretë që ta caktojë objektin.</p> <p>2. Në qoftë se ky person i tretë nuk dëshiron apo nuk mund ta caktojë objektin e detyrimit, kontrata është absolutisht nule.</p>	<p>specify the object, or if the parties have left it to a third person to specify the object.</p> <p>2. If such third person does not want or cannot specify the subject of the obligation, the contract shall be absolutely null.</p>	<p>licu da odredi predmet.</p> <p>2. Ako ovo treće lice ne želi ili ne može odrediti predmet obaveze, ugovor je apsolutno ništavim.</p>
<p>KAPITULLI V– BAZA</p> <p>Neni 117 Baza e lejueshme</p> <p>1. Secili detyrim kontraktues duhet të ketë bazën e lejueshme.</p> <p>2. Baza është i palejueshme nëse është në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik ose doket e mira.</p> <p>3. Nëse nuk provohet ndryshe, prezumohet se çdo kontratë ka bazë të lejueshme.</p> <p>4. Në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është absolutisht i pavlefshme.</p>	<p>CHAPTER V – CAUSE</p> <p>Article 117 Lawful cause of contract</p> <p>1. A contract must have a lawful cause.</p> <p>2. The cause is unlawful if it is contrary to mandatory provisions, public order, or good custom.</p> <p>3. Unless proved otherwise, it shall be presumed that each contract has a lawful cause.</p> <p>4. If there is no cause or the cause is unlawful, the contract is null.</p>	<p>POGLAVLJE V - OSNOVA</p> <p>Član 117 Dozvoljena osnova</p> <p>1. Svaka ugovorna obaveza treba imati dozvoljenu osnovu.</p> <p>2. Osnova je nedozvoljena ako je u suprotnosti sa obavezujućim odredbama, javnim redom ili dobrim običajima.</p> <p>3. Ukoliko se suprotno ne dokaže , pretpostavlja se da svaki ugovor ima dozvoljenu osnovu.</p> <p>4. Ako nema osnova ili je osnova nedozvoljena, ugovor je apsolutno nevažeći.</p>
<p>Neni 118 Motivet për lidhjen e kontratës</p> <p>1. Motivet nga të cilat është lidhur kontrata nuk ndikojnë në plotfuqishmërinë e saj.</p>	<p>Article 118 Motives for concluding a contract</p> <p>1. The motives out of which a contract is concluded shall not affect its validity.</p>	<p>Član 118 Motivi za zaključivanje ugovora</p> <p>1. Motivi zbog kojih je zaključen ugovor ne utiču na njegovu pravosnažnost.</p>

<p>2. Megjithatë, në qoftë se motivi i paligjshëm ka ndikuar esencialisht që një nga kontraktuesit të vendosë lidhjen e kontratës dhe në qoftë se kontraktuesi tjetër e ka ditur ose është dashur ta dinte atë motiv, kontrata do të jetë nule.</p> <p>3. Kontrata pa shpërblim është gjithashtu nule kur kontraktuesi tjetër nuk ka ditur se motivi i paligjshëm ka pasur ndikim të madh në vendimin e palës tjetër kontraktuese.</p>	<p>2. If an unlawful motive had a significant effect on the decision by one of the contracting parties to conclude the contract and the other contracting party knew or should have known of such motive the contract shall be null.</p> <p>3. A gratuitous contract shall also be null when the contracting party did not know that an unlawful motive had a significant effect on the decision by the other contracting party.</p>	<p>2. Međutim, ako je nezakonit motiv značajno uticao da jedna od ugovornih stranaka odluči o zaključivanju ugovora i ako je druga ugovorna stranka znala ili je trebala znati taj motiv, ugovor će biti ništav.</p> <p>3. Ugovor bez naknade je takođe ništavim kada druga ugovorna stranka nije bila upoznata da je nezakonit motiv imao veliki uticaj na odluku druge ugovorne stranke.</p>
<p>KAPITULLI VI – FORMA E KONTRATËS</p>	<p>CHAPTER VI – CONTRACT FORM</p>	<p>POGLAVLJE VI - FORMA UGOVORA</p>
<p>Neni 119 Joformaliteti i kontratës</p>	<p>Article 119 Informality of contract</p>	<p>Član 119 Neformalnost ugovora</p>
<p>1. Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj është rregulluar ndryshe.</p> <p>2. Kontrata mund të ndryshohet ose të ndërpritet thjesht me marrëveshje të palëve, përveç kur forma specifike kërkohet me ligj.</p>	<p>1. No particular form shall be required for the conclusion of a contract, unless otherwise provided by law.</p> <p>2. A contract may be modified or terminated by the mere agreement of the parties, except when a specific form is required by law.</p>	<p>1. Zaključivanje ugovora ne podleže nikakvoj formi, osim ako je drugačije propisano zakonom.</p> <p>2. Ugovor se može menjati ili raskinuti jednostavnim sporazumom stranaka, osim ako se zakonom zahteva specifična forma.</p>
<p>Neni 120 Forma e kërkuar me ligj</p>	<p>Article 120 Form required by law</p>	<p>Član 120 Forma u skladu sa zakonom</p>
<p>1. Kur ligji kërkon një formë të veçantë për</p>	<p>1. When the law requires a specific form to</p>	<p>1. Kada zakon zahteva posebnu formu za</p>

<p>lidhjen e kontratës, kërkesa e tillë vlen për të gjitha modifikimet e mëvonshme në kontratë.</p> <p>2. Kontrata mund të zgjidhet nga palët vetëm në të njëjtën formë të paraparë me ligj për lidhjen e saj.</p> <p>3. Kontratat duhet të hartohen në formën e akteve noteriale në rastet e parapara me ligj.</p>	<p>conclude a contract, such requirement applies to all subsequent modifications to the contract.</p> <p>2. A contract may only be terminated by the parties in the same form required by law for its conclusion.</p> <p>3. Contracts must be drafted in the form of notary acts in the cases provided by law.</p>	<p>zaključivanje ugovora, takav zahtev se odnosi na sve naknadne izmene ugovora.</p> <p>2. Ugovor se može raskinuti od stranaka samo u istoj formi kao što je propisano zakonom o njegovom zaključenju.</p> <p>3. Ugovori se trebaju izraditi u formi javno beležničkih akata u slučajevima propisanim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 121 Forma e kontraktuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 121 Agreed form</p>	<p style="text-align: center;">Član 121 Ugovorena forma</p>
<p>1. Palët kontraktuese mund të merren vesh, që forma e veçantë të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës së tyre.</p> <p>2. Kontrata për lidhjen e së cilës është kontraktuar forma e veçantë mund të zgjidhet, të plotësohet ose të ndryshohet në ndonjë mënyrë tjetër edhe me marrëveshje joformale.</p> <p>3. Në qoftë se palët kontraktuese kanë parashikuar formën e caktuar vetëm për të siguruar provën për lidhjen e kontratës së tyre, ose për të arritur diçka tjetër, kontrata konsiderohet e lidhur kur të jetë arritur pëlqimi për përmbajtjen e saj, ndërsa për kontraktuesit ka lindur në të njëjtën kohë detyrimi që kontratës t'i japin formën e parashikuar.</p>	<p>1. Contracting Parties may agree that a special form shall be a condition for the validity of their contract.</p> <p>2. The special form of contract may be selected, supplemented or otherwise amended in any other way by an informal agreement.</p> <p>3. If the contracting parties have provided the form designated solely to provide proof of the conclusion of their contract or to achieve something else, the contract shall be deemed to have been concluded when the consent to its content has been reached. While for the contractor is the obligation to give the contract the foreseen form.</p>	<p>1. Ugovorne stranke mogu se sporazumeti, da određena forma bude uslov za valjanost njihovog ugovora.</p> <p>2. Ugovor za zaključivanje koje je ugovoren posebna forma, može se izabrati da se izmeni i dopuni, na bilo koji način ili pak preko neformalnog dogovora.</p> <p>3. Ako su ugovorne stranke predvidele određena forma samo da bi obezbedili dokaz za zaključivanje njihovog ugovora, ili da se postigne nešto drugo, ugovor se smatra zaključenim kada se postigne saglasnost o njegovom sadržaju, a za ugovorne stranke je u isto vreme obaveza da ugovoru daju predviđenu formu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 122 Sanksioni për mungesë të formës së nevojshme</p> <p>1. Përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe, kontrata e cila nuk është lidhur në formën e përcaktuar me ligj është nule.</p> <p>2. Kur palët pajtohen se kontrata duhet të lidhet në formë të veçantë, prezumohet se kontrata nuk është menduar të jetë ligjërishit e detyrueshme përveç nëse është në atë formë</p>	<p style="text-align: center;">Article 122 Sanction for lack of necessary form</p> <p>1. Unless the law provides otherwise, a contract which is not concluded in the form prescribed by law is null.</p> <p>2. When the parties agree that the contract must be concluded in a specific form, it shall be presumed that the contract is not intended to be legally binding unless it is in that form.</p>	<p style="text-align: center;">Član 122 Sankcija zbog nedostatka potrebne forme</p> <p>1. Ako zakonom nije drugačije određeno, ugovor koji nije zaključen u formi propisanim zakonom je nevažećim.</p> <p>2. Ako se stranke slažu da se ugovor treba zaključiti u posebnoj formi, pretpostavlja se da ugovor nije zamišljen da bude pravno obavezujući, osim ako je u toj formi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 123 Dyshimet mbi plotësinë e dokumentit</p> <p>1. Në qoftë se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të vullnetit të palëve, vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë.</p> <p>2. Do të jenë të vlefshme ujdite e njëkohshme gojore për elementet sekondare për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me përmbajtjen e saj, apo nëse nuk janë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma.</p> <p>3. Marrëveshjet e njëkohshme gojore që i</p>	<p style="text-align: center;">Article 123 Doubts over completeness of document</p> <p>1. If a contract is concluded in a special form either pursuant to law or at the will of the parties only that which is expressed in such form shall apply.</p> <p>2. Simultaneous verbal agreements on accessory points about which nothing is mentioned in the formal contract shall be valid if not in contravention of the content thereof or in contravention of the purpose for which the form is prescribed.</p> <p>3. Subsequent simultaneous verbal</p>	<p style="text-align: center;">Član 123 Sumnje o potpunosti dokumenta</p> <p>1. Ako je ugovor zaključen u posebnoj formi, kao u skladu sa zakonom i u skladu sa voljom stranaka, važeće je samo ono što je izraženo u ovoj formi.</p> <p>2. Biće važeće istovremena usmena poravnjanja za sekundarne elemente za koje se u formalnom ugovoru ništa ne govori, ako nisu u suprotnosti sa njenim sadržajem, ili ako nisu u suprotnosti sa svrhom za koju je predviđen određena forma.</p> <p>3. Istovremeni usmeni dogovori koji</p>

<p>zvogëlojnë ose i lehtësojnë detyrimet e njëjës ose të të dy palëve, janë gjithashtu të vlefshme, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 124 Përpilimi i dokumentit</p> <p>1. Kur për lidhjen e kontratës nevojitet përpilimi i dokumentit, kontrata është e lidhur kur dokumentin ta nënshkruajnë të gjithë personat që detyrohen prej saj.</p> <p>2. Kontraktuesi që nuk di të shkruajë do të vë shenjën e gishtit në dokument të vërtetuar nga dy dëshmitarë ose nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër.</p> <p>3. Për lidhjen e kontratës dypalëshe mjafton që të dy palët ta nënshkruajnë një dokument ose që secila prej palëve të nënshkruajë kopjen e dokumentit të destinuar palës tjetër.</p> <p>4. Kërkesa e formës me shkrim është e përmbushur, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që e bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën.</p>	<p>agreements to reduce or alleviate the obligation of either or both of the parties shall also be valid if the special form is prescribed solely in the interest of the contracting parties.</p> <p style="text-align: center;">Article 124 Drafting of document</p> <p>1. When the drafting of a document is required to enter into a contract, the contract is considered concluded when the document is signed by all parties.</p> <p>2. A contracting party who does not know to write on his own (illiterate) shall sign by placing his fingerprint on the document, to be verified by two witnesses, the court, or another authoritative institution.</p> <p>3. For the conclusion of bilateral contract, it is sufficient that both parties sign a document, or that each party signs a copy of a document destined for the other party.</p> <p>4. The requirement of written form is met if the parties exchange letters or agree through other means that enable both the content and the person who made the statement(s) be established with certainty.</p>	<p>zmanjuju ili olakšavaju obaveze jedne ili obeju stranaka, su takođe važeći, ako je posebna forma predviđen samo u interesu ugovornih stranaka.</p> <p style="text-align: center;">Član 124 Sastavljanje dokumenta</p> <p>1. Kada je za zaključivanje ugovora potrebno izraditi dokumenat, ugovor je zaključen kada se dokument potpiše od svih osoba koja se obavezuju njime.</p> <p>2. Ugovorna stranka koja ne zna pisati, staviće svoj otisak prsta na dokumentu koji je potvrđen od dva svedoka ili od strane suda ili bilo koje druge institucije.</p> <p>3. Za zaključivanje bilateralnog ugovora dovoljno je da obe stranke potpišu dokumenat ili da svaka od stranaka potpiše primerak dokumenta koja je namenjena drugoj stranci.</p> <p>4. Zahtev pismene forme je ispunjen, ukoliko stranke razmenjuju pisma ili se sporazumevaju preko nekog drugog sredstva koji omogućuju da se sigurno utvrdi sadržaj i lica koja je dala izjavu.</p>
---	---	---

<p>5. Në qoftë se me ligj shprehimisht nuk caktohet ndryshe, forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklarata me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 125 Përmbushja e kontratës të cilës i mungon forma e kërkuar</p> <p>1. Kontrata për të cilën ligji ka paraparë formë të veçantë do të konsiderohet e vlefshme edhe nëse nuk është lidhur në formën e tillë, kur palët plotësisht përmbushin detyrimet që rrjedhin nga kontrata.</p> <p>2. Dispozita e paragrafit 1 nuk do të zbatohet nëse një kontrate i mungon forma noteriale e paraparë me ligj.</p> <p>KAPITULLI VII– ELEMENTET AKSIDENTALE</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I - Kushtet</p> <p style="text-align: center;">Neni 126 Kushtet dhe efektet e tyre</p> <p>1. Kontrata quhet e lidhur me kusht, në qoftë se krijimi ose shuarja e saj varen nga një ngjarje e ardhme e pasigurt.</p>	<p>5. If the law does not provide otherwise, the form in writing may be replaced by electronic means, for which the provisions of the special law shall apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 125 Performance of contract lacking the required form</p> <p>1. A contract for which a particular form is required by law shall be deemed valid even if not concluded in such form where the parties fully perform the obligations arising from the contract.</p> <p>2. The provision of paragraph 1 shall not apply if a contract lacks the notarial form required by law.</p> <p>CHAPTER VII – ACCIDENTAL ELEMENTS</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter I – Conditions</p> <p style="text-align: center;">Article 126 Conditions and their effects</p> <p>1. A contract shall be deemed to have been concluded under a condition if its initiation or termination is dependent on an uncertain event.</p>	<p>5. Ako zakon izričito ne navodi drugačije, pismena forma se zamenjuje i sa izjavama koje su date elektronskim putem, za koje primenjuju odredbe posebnih zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 125 Ispunjenje ugovora kojem nedostaje odgovarajuća forma</p> <p>1. Ugovori za koje je zakon predvideo posebnu formu smatraće se važećim iako nisu zaključeni u takvoj formi, kao stranke u potpunosti ispunjavaju obaveze obavezama koje proističu iz ugovora.</p> <p>2. Odredba stava 1 ne primenjuje se ako ugovor nema javno beležnički akt koji je propisan zakonom.</p> <p>POGLAVLJE VII - SLUČAJNI ELEMENTI</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje I - Uslovi</p> <p style="text-align: center;">Član 126 Uslovi i njihovo dejstvo</p> <p>1. Ugovor se zove zaključenim, ukoliko njegovo stvaranje i prestanak zavisi od neizvesnog budućeg događaja.</p>
--	---	---

<p>2. Në qoftë se kontrata lidhet nën kusht shtyrës dhe kushti plotësohet, efekti i kontratës fillon që nga lidhja e saj, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe, natyra e kontratës ose vullneti i palëve del të jetë ndryshe.</p> <p>3. Në qoftë se kontrata lidhet nën kushtin zgjidhës, kontrata pushon të vlejë në qoftë se ky kusht plotësohet.</p> <p>4. Kushti konsiderohet se është realizuar, në qoftë se realizimi i tij, në kundërshtim me ndershmërinë, e parandalon pala në dëm të së cilës është caktuar, ndërsa konsiderohet se nuk është plotësuar në qoftë se realizimi i tij, në kundërshtim me ndërgjegjshmërinë dhe ndershmërinë, e shkakton pala në dobi të së cilës është caktuar.</p>	<p>2. If a contract is concluded under a suspensive condition and the condition is fulfilled the contract shall take effect from the moment of conclusion, unless foreseen otherwise by law, the nature of the contract or the parties' intention.</p> <p>3. If a contract is concluded under a dissolving condition, the contract shall cease to be valid if the condition is fulfilled.</p> <p>4. A condition shall be deemed to have been fulfilled if in contravention of the principle of fairness the party upon whom the burden was defined prevents it from being realised, and shall be deemed not to have been fulfilled if in contravention of the principle of conscientiousness and fairness the party for whom the benefit was defined causes it to be realised.</p>	<p>2. Ako se ugovor zaključuje odložnim uslovom i uslov se ispuni, dejstvo ugovora počinje od samog njegovog zaključivanja, osim ako nije drugačije predviđeno zakonom, ili se pokazuje da je priroda ugovora ili volja stranaka drugačija.</p> <p>3. Ako je ugovor zaključi pod uslovom ukidanja, ugovor prestaje da važi ako je ispunjen ovaj uslov.</p> <p>4. Uslov se smatra ispunjenim, ako se njegovo izvršenje, u suprotnosti sa iskrenošću, sprečava stranke prema čijoj je šteti određena, a smatra se da nije ispunjen ako njegovo izvršenje, u suprotnosti sa poštenjem i iskrenošću uzrokuje stranka na čiju je korist određena.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 127 Efekti prapaveprues</p>	<p style="text-align: center;">Article 127 Retrospective effect</p>	<p style="text-align: center;">Član 127 Retroaktivno dejstvo</p>
<p>Nëse në përputhje me përmbajtjen e kontratës pasojat që krijohen me përmbushjen e një kushti kanë efekt që nga një moment më i hershëm kohor, atëherë, në rast të përmbushjes së këtij kushti, pjesëmarrësit janë të detyruar që t'i mundësojnë njëri tjetrit atë që do të kishin mundësuar, sikur pasojat të kishin</p>	<p>If according to the content of the contract, the consequences that are created with the fulfilment of condition have an effect from an earlier period, in the event of the fulfilment of the present condition, participants are obliged to enable to each other what has been enabled to them, also as if the consequences have</p>	<p>Ako u skladu sa sadržajem ugovora posledice koje proizilaze ispunjenjem određenog uslova imaju dejstvo od nekog predašnjeg trenutka, dakle, u slučaju ispunjenja ovog uslova, učesnici su dužni da omoguće jedni drugima ono što bi oni omogućili, ako bi posledice nastale u nekom predašnjem trenutku.</p>

<p>lindur në çastin më të hershëm kohorë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 128 Kushti i palejueshëm ose i pamundur</p> <p>1. Kontrata me kusht shtyrës ose zgjidhës e cila është në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik dhe doket e mira është nule.</p> <p>2. Kontrata e lidhur nën kusht të pamundshëm shtyrës është e pavlefshme, ndërsa kushti i pamundshëm zgjidhës konsiderohet i paqenë.</p>	<p>arisen at an earlier moment.</p> <p style="text-align: center;">Article 128 Unlawful or impossible condition</p> <p>1. A contract subject to a suspensive or dissolving condition which is contrary to mandatory provisions, public order and good custom shall be null.</p> <p>2. A contract concluded under an impossible suspensive condition shall be null; an impossible dissolving condition shall be deemed non-existent.</p>	<p style="text-align: center;">Član 128 Nedozvoljen ili nemoguć uslov</p> <p>1. Ugovor pod odložnim ili ukidajućim uslovom koja je u suprotnosti sa obavezujućim odredbama, javnim redom i dobrim običajima je nevažećim.</p> <p>2. Ugovori koji su zaključeni pod nemogućim odložnim uslovom je nevažeći, a nemogući uslov ukidanja se smatra nepostojećim.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 129 Sigurimi i të drejtës kushtëzuese</p> <p>Në qoftë se kontrata është e lidhur me kusht shtyrës, kreditori, e drejta e të cilit është kushtëzuar, mund të kërkojë sigurimin përkatës të kësaj të drejte në qoftë se realizimi i saj është rrezikuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 129 Securing of conditioned right</p> <p>If a contract is concluded under a suspensive condition the creditor whose right is conditioned may request appropriate securing of the right, if the exercise thereof is endangered.</p>	<p style="text-align: center;">Član 129 Obezbeđivanje uslovnog prava</p> <p>Ako je ugovor vezan preko odložnih uslova, poverilac čije je pravo uslovljeno, može zahtevati odgovarajuće obezbeđivanje ovog prava ako je ugroženo njegovo izvršenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 130 Mbrojtja e së drejtës së kushtëzuar</p> <p>1. Përfituesi nga puna juridike e lidhur nën kushtin shtyrës, në rast të përmbushjes së këtij kushti, mund të kërkojë shpërblimin e dëmit nga pala tjetër, në qoftë se para përmbushjes së kushtit me fajin e saj e ka pamundësuar ose</p>	<p style="text-align: center;">Article 130 Protection of conditional right</p> <p>1. The beneficiary of the legal affair concluded under the delayed condition, may in the event of the fulfilment of the condition seek the compensation of damage from the other party if before the fulfilment of</p>	<p style="text-align: center;">Član 130 Zaštita uslovnog prava</p> <p>1. Korisnik pravnih poslova zaključenih odložnim uslovom, u slučaju ispunjenja ovog uslova može zahtevati nadoknadu štete od druge stranke, ako je pre ispunjenja uslova svojom krivicom onemogućila ili ograničila</p>

<p>kufizuar të drejtën e cila varet nga ky kusht.</p> <p>2. Në rast të kontratës së lidhur nën kushtin zgjidhës, të njëjtën të drejtë dhe nën të njëjtat kushte e ka ai në dobi të të cilit rikthehet gjendja e mëhershme juridike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 131 Pavlefshmëria e disponimeve gjatë kohëzgjatjes së kushtit</p> <p>1. Nëse dikush e ka në dispozicion një objekt nën kushtin shtyrës, atëherë çdo dispon tjetër i supozuar, para plotësimit të kushtit, bëhet e pavlefshëm në momentin e plotësimit të kushtit, për aq sa disponimi do të pengonte ose dëmtonte arritjen e qëllimit që varet nga kushti.</p> <p>2. E njëjta vlen në rast të një kushti zgjidhës për disponimet , e cila shuhet me plotësimin e këtij kushti.</p> <p>3. Dispozitat mbi mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë në mirëbesim zbatohen me ndryshimet e nevojshme.</p>	<p>condition with his fault he has prevented or limited the realisation of the right deriving from this condition.</p> <p>2. In case of the contract entered into under the termination condition, he/she in favour of whom the previous legal situation is restored enjoys the same right.</p> <p style="text-align: center;">Article 131 Invalidity of availability during the duration of the condition</p> <p>1. If someone has in his availability the object under the suspensive condition, then every other availability which is assumed before the fulfilment of a condition becomes null at the moment of the fulfilment of condition, as far as the availability will prevent or damage the realisation of the purpose deriving from that condition.</p> <p>2. The same applies to the termination condition for the availability, which ceases for the fulfilment of this condition.</p> <p>3. Provisions on the protection of the rights of third persons in good faith shall be applied with the necessary changes (<i>mutatis mutandis</i>).</p>	<p>pravo koje zavisi od ovog uslova.</p> <p>2. U slučaju ugovora zaključenog pod uslovom ukidanja, ista prava i pod istim uslovima ima on u čiju se korist vraća prethodno pravno stanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 131 Ništavnost raspolaganja tokom trajanja uslova</p> <p>1. Ako neko ima na raspolaganju objekat pod odložnim uslovom, onda svako drugo navodno raspolaganje, pre ispunjavanja uslova, postaje nevažeće u trenutku ispunjavanja uslova, za onoliko koliko bi raspolaganje ometalo i oštetilo ostvarivanje cilja koji zavisi od uslova.</p> <p>2. Isto se odnosi i na slučaju uslova za ukidanje u vezi sa raspolaganjem, koje prestaju u trenutku ispunjenja tog uslova.</p> <p>3. Odredbe o zaštiti prava trećih lica u dobroj veri primenjuju se uz odgovarajuće promene.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Afatet Kohore</p> <p style="text-align: center;">Neni 132 Afatet kohore të efektit të kontratës</p> <p>1. Përveç nëse me ligj është paraparë ndryshe, palët kontraktuese kanë të drejtë të pajtohen për një afat kohor pas të cilit kontrata do të ketë fuqi ose në fund të së cilit kontrata pushon të ketë efekt.</p> <p>2. Për llogaritjen e afateve kohore vlejnë dispozitat e nenit 77 (llogaritja e afateve të parashkrimit) të librit të parë të këtij kodi.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Deadline</p> <p style="text-align: center;">Article 132 Deadline to the contract’s effects</p> <p>1. Unless the law provides otherwise, the contracting parties shall have the right to agree a time period after which the contract shall have effect or at the end of which the contract shall cease to have effect.</p> <p>2. For the calculation of deadlines, shall apply provisions of Article 77 (Calculation of prescriptions periods) of the first Book of this code.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II – Vremenski rokovi</p> <p style="text-align: center;">Član 132 Vremenski rokovi dejstva ugovora</p> <p>1. Osim ako nije drugačije predviđeno zakonom, ugovorne stranke imaju pravo da pristanu na neki vremenski rok nakon kojeg će ugovor biti pravosnažan ni na kraju kojeg ugovor prestaje da deluje.</p> <p>2. Za izračunavanje rokova primenjuju se odredbe člana 77. (uračunavanje rokova zastarelosti) prve knjige ovog zakonika.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli III – Kapari dhe Pendesa</p> <p style="text-align: center;">Neni 133 Kapari</p> <p>1. Në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës njëra palë i jep palës tjetër një shumë të hollash, ose një sasi sendesh të tjera të zëvendësueshme si shenjë se kontrata është lidhur (kapari), kontrata konsiderohet e lidhur kur kapari t’I jetë dhënë në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter III – Earnest and reimbursement</p> <p style="text-align: center;">Article 133 Earnest</p> <p>1. If at the time of conclusion of a contract one party gives the other party a sum of money or other substitutable articles as a sign that contract is entered into (earnest), the contract is considered as concluded when earnest is given if nothing else has been contracted.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje III – Kapara i odustanica</p> <p style="text-align: center;">Član 133 Kapara</p> <p>1. Ako je u trenutku zaključenja ugovora jedna stranka dala drugoj izvestan iznos novca, ili izvesnu količinu zamenjivih stvari kao znak da je ugovor zaključen (kapara), ugovor se smatra zaključenim kada je kapara data ako nije ugovoreno nešto drugo.</p>

<p>2. Nëse pala që ka dhënë kaparin është në vonesë të detyrimit, pala tjetër mund të tërhiqet nga kontrata dhe ta mbajë kaparin, ose mund të kërkojë përmbushjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmeve ashtu që kapari mbahet në llogari të dëmeve të cilat do të kompensohen nga gjykata.</p> <p>3. Nëse pala që ka marrë kaparin është në vonesë të detyrimit, pala tjetër mund të tërhiqet nga kontrata dhe ta kërkojë dyfishin e kaparit, ose mund të kërkojë përmbushjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmeve ashtu që kapari mbahet në llogari të dëmeve të cilat do të kompensohen nga gjykata.</p>	<p>2. If the party that provided earnest is in default the other party may withdraw from the contract and retain the earnest, or he may request the performance of the contract and the compensation of damages with the earnest being retained in account of damages to be compensated by the court.</p> <p>3. If the party that received the earnest is in default, the other party may withdraw from the contract and claim double the earnest, or he may request the performance of the contract and the compensation of damages with the earnest being retained in account of damages to be compensated by the court.</p>	<p>2. Ako stranka koja je dala kaparu docni u svojim obavezama, druga stranka može odustati od ugovora i zadržati kaparu, ili može zahtevati izvršenje ugovora i naknadu štete tako da se kapara zadržava na račun štete koja će biti nadoknađena od strane suda.</p> <p>3. Ako stranka koja je dobila kaparu docni u svojim obavezama, druga stranka može odustati od ugovora i zahtevati dvostruku kaparu, ili može zahtevati izvršenje ugovora i nadoknađivanje štete tako da se kapara zadržava na račun štete koja će biti nadoknađena od strane suda.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 134 Kapari për heqje dorë nga kontrata</p> <p>1. Nëse është paraparë se kapari i jep të drejtë njërës ose të dyja palëve për të hequr dorë nga kontrata, konsiderohet se kapari është dhënë në këmbim të së drejtës për t'u tërhequr nga kontrata.</p> <p>2. Pala që heq dorë nga kontrata humbë kaparin e dhënë ose duhet ta kthejë dyfishin e kaparit të marrë.</p> <p>3. E drejta e një pale për tërheqje nga kontrata ushtrohet duke njoftuar palën tjetër. Pala që</p>	<p style="text-align: center;">Article 134 Earnest for withdrawal from the contract</p> <p>1. If it is foreseen that the earnest gives the right to one or both parties to waive the contract, it is considered that the earnest is granted in exchange for the right to withdraw from the contract.</p> <p>2. The party that withdraws from the contract shall forfeit the earnest provided or must return double the earnest received.</p> <p>3. The right of a party to withdraw from the contract is exercised by giving notice to the</p>	<p style="text-align: center;">Član 134 Kapara za odustajanje od ugovora</p> <p>1. Ako je predviđeno da kapara daje prava jednoj ili obeju strankama da odustanu iz ugovora, smatra se da je kapara data u zamenu za pravo da se odustane od ugovora.</p> <p>2. Stranka da koja odustaje od ugovora gubi kaparu koju je dala ili treba vratiti dvostruko od primljene kapare.</p> <p>3. Pravo stranke da odustane od ugovora vrši se obaveštenjem druge stranke. Stranka koja</p>

<p>heq dorë nga kontrata ka për detyrë ta japë kaparin njëkohësisht me ushtrimin e heqjes dorë. E drejta e heqjes dorë nuk mund të ushtrohet nëse pala që ka të drejtë të heq dorë nga kontrata fillon ta përmbushë detyrimin ose pranon punën nga pala tjetër.</p> <p>4. Në rast dyshimi, kapari që njëra palë ia ka dhënë palës tjetër konsiderohet si konfirmim.</p> <p>5. Në qoftë se palët nuk e kanë përcaktuar kohën deri kur e drejta për të hequr dorë nga kontrata mund të ushtrohet, ajo e drejtë mund të ushtrohet në çdo kohë brenda afatit kohor të kryerjes.</p>	<p>other party. The party that withdraws from the contract shall provide the earnest at the same time as exercising the withdrawal. The withdrawal right may not be exercised if the party has the right to withdraw from the contract begins to perform the obligation or accepts performance by the other party.</p> <p>4. In the case of doubt, the earnest that one party provided to the other shall be deemed confirmative.</p> <p>5. If the parties have not stipulated until when the right to withdraw from the contract may be exercised, such right may be exercised at any time within the deadline for performance.</p>	<p>odustaje od ugovora dužna je da daje kaparu istovremeno sa vršenjem odustajanja. Pravo na odustajanje se ne može ostvariti ako stranka koja ima pravo da odustane od ugovora počinje da ispuni obavezu ili prihvati radove od druge stranke.</p> <p>4. U slučaju sumnje, kapara koju je jedna stranka dala drugoj smatra se kao potvrda.</p> <p>5. Ako stranke nisu odredile period do kada se pravo na odustajanje od ugovora može se ostvariti, to pravo se može ostvariti u bilo kojem periodu u roku izvođenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 213 Përgjegjësia e personave me aftësi të përkohëshme për gjykim</p> <p>1. Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të paaftësisë së përkohshme për gjykim është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë.</p> <p>2. Në qoftë në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, për dëmin do të përgjigjet ai që e ka sjellë në gjendje të tillë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 213 Liability of persons with temporary judgement capacity</p> <p>1. Whoever causes damage to others in a state of temporary disability is liable for it, unless it proves that it was brought to such a state without its fault.</p> <p>2. If this is caused by someone's fault, the one who caused that state of mind/disability will be the one responsible for the damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 213 Odgovornost lica sa privremenom sposobnošću rasuđivanja</p> <p>1. Ko nanese štetu drugom u stanju privremene nesposobnosti za rasuđivanje, odgovoran za to, osim ako dokazuje da je bez njegove krivice doveden u takvo stanje.</p> <p>2. Ako je u ovo stanje doveden tuđom krivicom, za štetu biće odgovoran taj koji ga je doveo u takvom stanju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 214 Përgjegjësia e të miturit</p> <p>1. I mituri deri në moshën shtatë (7) vjeç nuk përgjigjet për dëmin të cilin ia shkakton tjetrit.</p> <p>2. I mituri prej moshës shtatë (7) vjeçare, deri në moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar.</p> <p>3. I mituri mbasi t'i ketë mbushur katërbëdhjetë (14) vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin.</p>	<p style="text-align: center;">Article 214 Liability of minors</p> <p>1. A minor up to the age of seven (7) years shall not be liable for the damage caused to others.</p> <p>2. A minor from the age of seven (7) years, up to the age of fourteen (14), shall not be liable for the damage caused, unless it is proved that during the damage he has been able to adjudicate.</p> <p>3. The minor, after having completed fourteen (14) years, responds to the general rules of liability for damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 214 Odgovornost maloletnika</p> <p>1. Maloletnik do navršene sedme (7) godine ne odgovara za štetu koju prouzrokuje.</p> <p>2. Maloletnik od sedam (7) godina starosti do (14) godina starosti ne odgovara za prouzrokovanu štetu, osim ukoliko se dokaže da je tokom prouzrokovanja štete bio sposoban za rasuđivanje.</p> <p>3. Maloletnik sa navršenih četrnaest (14) godina odgovara prema opštim pravilima o odgovornosti za štetu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 215 Mbrojtja e nevojshme</p> <p>Personi i cili në mbrojtje të nevojshme i shkakton dëm sulmuesit, nuk e ka për detyrë ta kompensojë dëmin, përveç në rastin e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 215 Necessary protection</p> <p>Person who, in the necessary protection, causes damage to the attacker, is not obliged to compensate the damage except in the case of exceeding the necessary protection.</p>	<p style="text-align: center;">Član 215 Nužna odbrana</p> <p>Lice koje u nužnoj odbrani nanosi štetu napadaču, nije dužan da nadoknadi štetu, osim u slučaju prekoračenja nužne odbrane.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 216 Gjendja e nevojës, menjanimi i dëmit nga tjetri</p> <p>1. Nëse personi i shkakton dëm një personi në gjendje të nevojës ekstreme tjetër për t'a shpëtuar veten nga një rrezik të afërt ndaj jetës, lëndimit trupor ose dëmitimit të shëndetit, ose të pronës, ose të ndonjë të drejte tjetër themelore, dhe rreziku nuk mund të eliminohej pa shkaktuar dëme, detyrohet ta paguajë dëmshpërblimin në shumën e përcaktuar nga gjykata.</p> <p>2. Dispozita e paragrafit 1 zbatohet gjithashtu në qoftë se dëmi është shkaktuar për t'a ruajtur një person të tretë nga rreziku i pashmangshëm i lëndimit të jetës, trupit apo shëndetit, pasurisë, apo ndonjë të drejte tjetër themelore të personit të tillë të tretë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 216 Condition of need, avoidance of damage from the other</p> <p>1. If a person causes damage to a person in a state of extreme need to save himself from a risk to life, bodily harm or damage to health or property, or any other fundamental right, and the risk could not be eliminated without causing damage, it is obliged to pay the indemnity in the amount determined by the court.</p> <p>2. The provision of paragraph 1 shall also apply if the damage is caused to preserve a third person from the inevitable danger of life, body or health damage, property, or any other fundamental right of such third person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 216 Stanje nužde, otklanjanja štete od drugog</p> <p>1. Ako lice prouzrokuje štetu drugoj osobi u stanju krajnje nužde, kako bi spasio sebe od neke neposredne opasnosti po život, telesne povrede ili oštećenja zdravlja, ili imovinu, ili bilo kojeg drugog osnovnog prava, a opasnost se ne bi mogla izbeći bez prouzrokovanja štete, dužan je da plati nadoknadu u iznosu koji odredi sud.</p> <p>2. Odredba stava 1. primenjuju se takođe iako je šteta prouzrokovana kako bi se zaštitilo neko treće lice iz neposredne opasnosti od povrede života, tela ili zdravlja, imovine, ili bilo kojeg drugog osnovnog prava takvog trećeg lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 217 Pëlqimi i të dëmtuarit</p>	<p style="text-align: center;">Article 217 Consent of the damaged party</p>	<p style="text-align: center;">Član 217 Saglasnost oštećenog</p>

<p>1. Kush në dëm të vet i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, nuk mund të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim.</p> <p>2. Është e pavlefshme deklarata e të dëmtuarit me të cilën e ka dhënë pëlqimin që t'i shkaktohet dëmi me veprimin e ndaluar me ligj.</p> <p>3. Dispozita nga paragrafi 1 zbatohet edhe në qoftë se personi i cili pëson dëmin, ka marrë vullnetarisht këtë rrezik duke e ditur rrezikun e dëmit të pësuar.</p>	<p>1. Whoever at his own damage, allows another to undertake any action, cannot claim from him the compensation of the damage caused by such action.</p> <p>2. The statement of the damaged party with which he/she has given consent to cause the damage with the act prohibited by law shall be invalid.</p> <p>3. The provision from paragraph 1 shall also apply if the person who is suffering the damage has voluntarily taken that risk knowing the risk of the damage sustained.</p>	<p>1. Ko u njegovoj šteti omogućuje drugima da preuzmu bilo kakve radnje, ne mogu zahtevati od te osobe nadoknadu štete koja je prouzrokovana od ove radnje.</p> <p>2. Nevažeća je izjava oštećenog kojom je dao saglasnost da mu se nanese šteta radnjom koja je zabranjena zakonom.</p> <p>3. Odredba iz stava 1. primenjuju se i ako je osoba koja pretrpi štetu, dobrovoljno preuzela taj rizik znajući rizik od pretrpljene štete.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 218 Kontributi në faj nga ana e të dëmtuarit</p>	<p style="text-align: center;">Article 218 Contribution to guilt by the damaged party</p>	<p style="text-align: center;">Član 218 Doprinos u krivici od strane oštećenog</p>
<p>Kur i dëmtuari i kontribuon shfaqjes së dëmit, shpërblimi zvogëlohet në përputhje me shkallën e fajit.</p>	<p>When the damaged party contributes to the occurrence of the damage, the compensation is reduced according to the degree of guilt.</p>	<p>Kada oštećeni doprinosi nanošenju štete, nadoknada se smanjuje u skladu sa stepenom krivice.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli III – Përgjegjësia për të Tjerët</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter III – Liability for Others</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje III - Odgovornost za druge</p>
<p style="text-align: center;">Neni 219 Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga personat me të meta në zhvillimin mendor apo çrregullime të tjera mendore</p>	<p style="text-align: center;">Article 219 Liability for damages caused by persons with mental disorders or other mental health problems</p>	<p style="text-align: center;">Član 219 Odgovornost za štete uzrokovane od strane lica zaostallog umnog razvoja ili drugim umnim poremećajima</p>

<p>Nëse dëmi shkaktohet nga një person i paaftë për gjykim për shkak të çrregullimeve në zhvillimin mendor ose çrregullime tjera mendore, shpërblimi bëhet nga personat që ishin të obliguar për ta mbikëqyrë personin e tillë, përveç nëse tregohet se mbikëqyrja është kryer me kujdesin e duhur ose që dëmi nuk mund të ishte shmangur.</p>	<p>If the damage is caused by a person who has no capacity to be sued due to mental development or other mental disorders, the persons obliged to supervise such person are liable for compensation, unless it is shown that the supervision was performed with due care or the damage could not have been avoided.</p>	<p>Ako je šteta uzrokovana od strane lica koja je nesposobna za rasuđivanje zbog poremećaja u zaostalost umnog razvoju ili drugih umnih poremećaja, nadoknada se vrši od strane lica koje su bile dužne da nadziru takva lica , osim ako se pokazuju da je nadzor obavljan sa dužnom pažnjom ili se šteta nije mogla izbeći.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 220 Përgjegjësia e prindërve, shkollave, organeve dhe institucioneve tjera</p>	<p style="text-align: center;">Article 220 Responsibility of parents, schools, bodies and other institutions</p>	<p style="text-align: center;">Član 220 Odgovornost roditelja, škola, organa i drugih institucija</p>
<p>1. Prindërit ose personat tjerë të detyruar me ligj për të ofruar kujdes prindëror për një të mitur nën shtatë (7) vjet janë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar prej tij dikujt tjetër.</p>	<p>1. Parents or other persons legally required to provide parental care to a minor under seven (7) years are liable for any damage caused by him to another person.</p>	<p>1. Roditelji ili druge zakonom obavezne lica da pruže roditeljsko staranje za maloletnika ispod sedam (7) godina starosti su odgovorni za bilo kakvu štetu koja je naneta od njega nekom drugom.</p>
<p>2. Nëse i mituri është i moshës mbi shtatë (7) vjeçare por nën katërbëdhjetë (14) vjet, personat e përmendur në paragrafin 1, lirohen nga përgjegjësia nëse fëmija i mitur ishte në gjendje për të gjykuar kur dëmi është shkaktuar.</p>	<p>2. If the minor is over seven (7), but under fourteen (14) years, the persons referred to in paragraph 1 are exempted from liability, if the minor child was able to judge when the damage was caused.</p>	<p>2. Ako je maloletnik stariji od sedam (7) godina, ali ispod četrnaest (14) godina, navedena lica u stavu 1, oslobađaju se od odgovornosti ako je maloletnik bio u stanju da rasuđuje kada je prouzrokovana šteta.</p>
<p>3. Nëse personi që e ka pësuar dëmin nuk mund ta merr shpërblimin nga i mituri, gjykata, duke marrë parasysh kushtet financiare të palëve dhe të gjitha rrethanat tjera, mund t'i urdhërojë personat e përmendur</p>	<p>3. If the person who has suffered the damage cannot obtain compensation from the minor, the court may, subject to the financial conditions of the parties and all other</p>	<p>3. Ako lice koje je pretrpelo štetu ne može primiti nadoknadu od maloletnika sud, uzimajući u obzir finansijske uslove stranaka i sve druge okolnosti, može naložiti navedenim licima u stavu 1 da plate nadoknadu u</p>

<p>në paragrafin 1 që të paguajnë shpërblimin e barabartë.</p> <p>4. Në qoftë se detyra e mbikëqyrjes mbi personin e mitur nuk bie mbi prindërit, por mbi ndonjë person tjetër, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga prindërit kur dëmi është krijuar për shkak të edukatës së keqe të të miturit, shembujve të këqij ose të shprehive familjare të cilat ia kanë dhënë prindërit ose kur edhe ashtu dëmi mund t'i dedikohej fajit të prindërve.</p> <p>5. Personi në të cilin në këtë rast bie përgjegjësi e mbikëqyrjes ka të drejtë të kërkojë nga prindërit që t'ia shpërblejnë shumën e paguar, në qoftë se ai ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit.</p> <p>6. Në qoftë se në kohën kur është shkaktuar dëmi i mituri i është besuar një shkollë, organi ose institucioni, ajo shkollë, ai organ apo institucion do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga i mituri, gjersa ai ishte nën mbikëqyrjen e tyre, përveç nëse tregohet se mbikëqyrja është kryer me kujdesin e duhur apo se dëmi nuk mund të ishte shmangur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 221 Përgjegjësia në bazë të drejtshmërisë</p>	<p>circumstances, order the persons referred to in paragraph 1 to pay equal compensation.</p> <p>4. If the duty of supervision over a minor does not fall on the parents, but on any other person, the damaged party has the right to seek compensation from the parents when the damage is caused because of the ill treatment of the minor, bad or the family habits that parents have given or where the damage can on any way be devoted to the parents' guilt.</p> <p>5. The person in which the supervisory responsibility falls in this case shall have the right to require the parents to reimburse the amount paid if he has paid the remuneration to the damaged.</p> <p>6. If, at the time when the damage was caused, the minor was entrusted to a school, body or institution, that school, body or institution shall be liable for any damage caused by the minor while he was under their supervision, except if it is shown that supervision was carried out with due care or that the damage could not have been avoided.</p> <p style="text-align: center;">Article 221 Responsibility based on fairness</p>	<p>jednakim delovima.</p> <p>4. Ako obaveza nadzora nad maloletnikom ne spada na roditelje, već na bilo koje drugo lice, oštećeni ima pravo tražiti naknadu od roditelja kada je šteta prouzrokovana zbog lošeg postupanja prema maloletniku, lošem ili porodičnim navikama koje su roditelji dali ili gde se šteta može posvetiti krivici roditelja.</p> <p>5. Osoba kojoj u ovom slučaju pripada nadzorna odgovornost ima pravo da zahteva od roditelja da nadoknadi uplaćeni iznos ako je platio naknadu štetniku.</p> <p>6. Ako je u vreme kada je prouzrokovana šteta maloletnik poveren školi, telu ili instituciji, ta škola to telo ili institucija će biti odgovorna za bilo kakvu štetu koju je prouzrokovao maloletnik dok je bio pod njihovim nadzorom, osim ako se pokaže da je nadzor obavljen sa dužnom pažnjom i da se šteta nije mogla izbeći</p> <p style="text-align: center;">Član 221 Odgovornost na osnovu pravičnosti</p> <p>1. Ukoliko se nanosi šteta koju je</p>
---	---	--

<p>1. Në rast se shkaktohet dëmi, të cilën e ka shkaktuar personi, i cili për atë dëm nuk ka qenë përgjegjës, ndërsa shpërblimi nuk mund të nxirret nga personi, i cili e ka pasur për detyrë të kryejë mbikëqyrjen mbi te, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të dëmtuesit dhe të të dëmtuarit, ta gjykojë dëmtuesin që ta shpërblejë dëmin tërësisht ose pjesërisht.</p> <p>2. Në qoftë se dëmin e ka shkaktuar i mituri me aftësi për të gjykuar, i cili nuk është në gjendje ta shpërblejë, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të prindërve dhe të dëmtuesit, t'i detyrojë prindërit ta shpërblejnë dëmin, tërësisht ose pjesërisht.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV – Përgjegjësia e Punëdhënësit për Punëmarrësin</p> <p style="text-align: center;">Neni 222 Përgjegjësia e punëdhënësit</p> <p>1. Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkakimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar</p>	<p>1. In the case of damage caused by the person who was not responsible for that damage and the remuneration cannot be obtained by the person who was obliged to perform the supervision over him, the court may, when fairness requires this, and in particular taking into account the material condition of the damaging party and the damaged party, to adjudicate the damaging party to remunerate the damage in whole or in part.</p> <p>2. If the damage is caused by the juvenile with a capacity to judge, who is unable to remunerate, the court may, when fairness requires this, and in particular taking into account the material condition of the parents and the damaging party, to oblige the parents to remunerate the damage, in whole or in part.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Employer liability for Employees</p> <p style="text-align: center;">Article 222 Employer liability</p> <p>1. The legal or natural person with whom an employee was working at the time the damage was inflicted shall be liable for damage</p>	<p>prouzrokovala osoba koja nije bila odgovorna za tu štetu, a ne može se dobiti naknada od lica koje je bilo dužno da vrši nadzor nad njim, sud može: kada to zahteva pravičnost, a posebno uzimajući u obzir materijalno stanje oštećene strane i štetnika strane, presuditi oštećenoj strani da nadoknadi štetu u celosti ili delimično.</p> <p>2. Ako je štetu prouzrokovao maloletnik sa sposobnošću za rasuđivanje, koji nije u stanju da nadoknadi, sud može, kada to zahteva pravičnost, a posebno uzimajući u obzir materijalno stanje roditelja i štetnika, prisiliti roditelje da u celosti ili delimično nadoknade štetu.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV - Odgovornost poslodavaca za zaposlenog</p> <p style="text-align: center;">Član 222 Odgovornost poslodavaca</p> <p>1. Pravno ili fizičko lice sa kojim je zaposleni radio u vreme prouzrokovanja štete je odgovorno za štetu prouzrokovanu trećem licu</p>
--	--	--

<p>ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete.</p> <p>2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje.</p> <p>3. Secili person që shpërblen të dëmtuarin për dëmin e shkaktuar nga punonjësi me dashje apo nga pakujdesia e rënde ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga punonjësi.</p> <p>4. Kjo e drejtë shuhet gjashtë (6) muaj pas ditës së pagesës së shpërblimit.</p> <p>5. Me dispozitën e paragrafit 1 të këtij neni nuk preken në rregullat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme.</p>	<p>inflicted on a third person by an employee during work or in connection with work, unless it is shown that the employee acted as was necessary under the given circumstances.</p> <p>2. The injured party shall have the right to request the compensation of damage directly from the employee if such damage is inflicted intentionally.</p> <p>3. Any person that compensates an injured party for damage inflicted by an employee intentionally or out of gross negligence shall have the right to request the reimbursement of the sum paid out from the employee.</p> <p>4. This right shall expire (6) six months after the day the compensation was paid.</p> <p>5. The provision of the first paragraph of this article shall not encroach upon the rules on liability for damage originating from dangerous objects or dangerous activities.</p>	<p>od strane zaposlenog tokom rada ili u vezi sa radom, osim ako se dokaže da je zaposleni u datim okolnostima postupao onako kako je trebalo.</p> <p>2. Oštećena stranka ima pravo da zatraži nadoknadu štete neposredno od zaposlenog ako je štetu prouzrokovao sa namerom.</p> <p>3. Bilo koje lice koje obeštećuje oštećenog za štetu prouzrokovanu od zaposlenog namerno ili krajnjom nepažnjom ima pravo da traži vraćanje isplaćenog iznosa od strane zaposlenog.</p> <p>4. To pravo ističe šest (6) meseci od dana isplate nadoknade štete.</p> <p>Odredbom iz stava 1. ovog člana ne dodiruju na pravilima o odgovornosti za štetu koja je prouzrokovana od opasnih predmeta ili opasnih aktivnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 223 Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga organi i një personi juridik</p> <p>1. Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 223 Legal person's liability for damage inflicted by body thereof</p> <p>1. A legal person shall be liable for damage inflicted on a third person by a body of the legal person during the performance of its functions or in connection therewith.</p>	<p style="text-align: center;">Član 223 Odgovornost za prouzrokovanu štetu od organa pravnog lica</p> <p>1. Pravno lice odgovara za štetu koju njegov organ prouzrokuje trećem licu u obavljanju ili u vezi sa obavljanjem svojih funkcija.</p>

<p>2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, personi juridik ka të drejtë në shpërblim nga personi i cili e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.</p> <p>3. Kjo e drejtë parashkruhet gjashtë (6) muaj pas ditës së pagesës së shpërblimit të dëmit.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli V – Përgjegjësia për Dëmet e Shkaktuara nga Sendet dhe Veprimtaritë e Rrezikshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 224 Prezumimi i kauzalitetit dhe personat përgjegjës</p> <p>1. Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.</p> <p>2. Pronari ose poseduesi i sendit të rrezikshëm është përgjegjës për çdo dëm që rezulton nga ai send.</p> <p>3. Personi i besuar me përdorimin e sendit të rrezikshëm, ose personi përgjegjës për mbikëqyrjen e sendit i cili nuk është i punësuar nga pronari ose poseduesi, është përgjegjës</p>	<p>2. Unless stipulated otherwise by law for the individual case, the legal person shall have the right to request compensation of the sum paid out from a person that inflicted the damage intentionally or out of gross negligence.</p> <p>3. This right shall expire six (6) months upon payment of compensation.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter V- Liability for Damages Caused by Dangerous Object or Activities</p> <p style="text-align: center;">Article 224 Presumption of causality and liable persons</p> <p>1. The damage caused to the dangerous object, respectively by the dangerous activity is considered to be derived from this item, respectively from this activity, unless it is proved that they were not the cause of the damage.</p> <p>2. The owner or possessor of a dangerous object shall be liable for any damage resulting from such object.</p> <p>3. A person entrusted with the use of a dangerous object, or a person responsible for overseeing it who is not employed by the owner or possessor, shall be liable for any</p>	<p>2. Ako nije drukčije određeno zakonom, pravno lice ima pravo na naknadu od lica koja je uzrokovala štetu namerno ili krajnjom nepažnjom.</p> <p>3. Ovo pravo će zastareti šest (6) meseci nakon nadoknade štete.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje V - Odgovornost za štete prouzrokovane od opasnih stvari ili delatnosti</p> <p style="text-align: center;">Član 224 Pretpostavljanje uzročne veze i Odgovorne osobe</p> <p>1. Šteta koja je prouzrokovana opasnom stvari, odnosno opasnom delatnošću, pretpostavlja se da proističe iz ove stvari odnosno sa ove delatnosti, osim ako se dokaže da one nisu bile uzrok štete.</p> <p>2. Vlasnik ili imalac opasne stvari je odgovoran za bilo kakvu štetu koja nastaje od te stvari.</p> <p>3. Lice koja je poverena u korišćenju te opasne stvari, ili osoba odgovorna za nadzor stvari koja pritom nije zaposlena od strane sopstvenika ili imaoca je odgovorna za bilo</p>
--	--	--

<p>për çdo dëm që rezulton nga ai send, përveç nëse tregohet se dëmi ishte rezultat i të metave ose attributeve të fshehura të sendit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 225 Marrja e kundërligjshme e sendit të rrezikshëm nga zotëruesi, dorëzimi i sendit personit të tretë dhe lirimi nga përgjegjësia</p> <p>1. Në qoftë se pronarit i është marre sendi i rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshëm, për dëmin që rrjedh nga kjo, nuk përgjigjet ai, por ai që ia ka marre sendin e rrezikshëm, në qoftë se pronari nuk është përgjegjës për këtë.</p> <p>2. Në vend të pronarit të sendit, dhe njësojë si ai, përgjigjet personi të cilit pronari ia ka besuar sendin që të shërbehet me te, ose personi i cili përndryshe e ka për detyrë ta mbikëqyrë, ndërsa nuk ndodhet në punë te ai.</p> <p>3. Përveç tij do të përgjigjet edhe pronari i sendit, po që se dëmi ka rrjedhë nga ndonjë e metë e fshehur ose nga veçoria e fshehur e sendit për të cilën pronari nuk ia ka tërhequr vëmendjen.</p>	<p>damage resulting from such object, unless it is shown that the damage was the result of concealed defects or hidden attributes of the object.</p> <p style="text-align: center;">Article 225 Unlawful taking of the dangerous object form the possessor, delivery of the object to the third person and exemption from përgjegjësia</p> <p>1. If dangerous object was unlawfully taken from the owner, he is not the one to be liable for the damage resulting from this, but the one who has taken the dangerous object if the owner is not responsible for it.</p> <p>2. The person to whom the owner has entrusted the object to use it, or the person who otherwise has the duty to supervise it, while not being used by him, will be liable instead of the owner of the object, and similar to him.</p> <p>3. Except him, the owner of the object shall also be liable, if the damage is caused by any hidden defect or by the concealed feature of the object for which the owner has not reminded him.</p>	<p>kakvu štetu nastalu od te stvari, osim ako se pokaže da je šteta bila rezultat skrivenih nedostataka ili atributa te stvari.</p> <p style="text-align: center;">Član 225 Nezakonito oduzimanje opasne stvari od imaoaca, predaja stvari trećem licu i oslobađanje od odgovornosti</p> <p>1. Ako je vlasniku nezakonito oduzeta opasna stvar, on ne odgovara za štetu koja nastaje od njega, već onaj koji je uzeo opasnu stvar ako vlasnik nije odgovoran za to.</p> <p>2. Umesto vlasnika stvari i slično njemu, odgovara lice kojem je vlasnik poverio stvar da se posluži njime, ili lice koje je inače dužno da ga nadzire, ali nije kod njega.</p> <p>3. Vlasnik stvari će takođe biti odgovoran prema njemu, osim ako je šteta prouzrokovana bilo kakvim skrivenim nedostatkom ili skrivenom osobinom stvari za koju vlasnik nije napomenuo.</p>
--	---	---

<p>4. Në këtë rast personi përgjegjës i cili ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit ka të drejtë të kërkojë shumën e plotë të saj nga pronari.</p>	<p>4. In this case the responsible person who has paid the remuneration to the damaged party, has the right to claim its full amount from the owner.</p>	<p>4. U ovom slučaju odgovorno lice koje je platilo naknadu štetniku ima pravo da potraži pun iznos od vlasnika od.</p>
<p>5. Pronari i sendit të rrezikshëm i cili ia ka besuar atë personit që nuk është i aftësuar apo nuk është i autorizuar të manipulojë me atë, përgjigjet për dëmin që rrjedhë nga ky send</p>	<p>5. The owner of the dangerous object who has entrusted it to the person who is not capable or is not authorized to manipulate it shall be liable for the damage arising from this object.</p>	<p>5. Vlasnik opasne stvari koja je poverio osobi koja nije ili nije osposobljen ili ovlaštena da manipulira njome će biti odgovorna za štetu nastalu iz ove stavke</p>
<p>6. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet.</p>	<p>6. The possessor shall be exempted from liability if it is shown that the damage was exclusively caused by an act that could not have been foreseen or avoided.</p>	<p>6. Imalac se oslobađa od odgovornosti ako se dokaže da je šteta rezultat iz bilo kojeg razloga koji je nastavo van stvari čiji efekat nije mogao da se predvidi, ukloni ili izbegne.</p>
<p>7. Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanoje.</p>	<p>7. The possessor of the object is relieved of liability even if it is proved that the damage was caused only by the action of the damaged party or the third person which he could not foresee and whose consequences could not have been avoided.</p>	<p>7. Imalac te stvari se oslobađa od odgovornosti, čak i ako se dokaže da je šteta nastala samo usled delovanja oštećenog ili trećeg lica , što on nije mogao predvideti i čije posledice nije mogao izbeći ili ukloniti.</p>
<p>8. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit.</p>	<p>8. The possessor is partially released from liability if the damaged party has partially contributed to causing the damage.</p>	<p>8. Imalac se delimično oslobađa od odgovornosti ako je oštećeni delimično doprineo prouzrokovanju štete.</p>
<p>9. Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit.</p>	<p>9. If the third party contributed partially to the damage caused, he/she responds to the damaged party in solidarity with the possessor of the object.</p>	<p>9. Ako u prouzrokovanju štete delimično doprinela treće lice, to lice odgovara oštećenij stranci solidarno zajedno sa imaoem stvari.</p>

<p>10. Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.</p> <p>11. Në bazë të të njetave kushte, lirohet nga përgjegjësia edhe personi i cili merret me veprimtarinë e rrezikshme.</p>	<p>10. A person assisting the owner or possessor in the use of the object shall not be deemed as a third person.</p> <p>11. The person who deals with the dangerous activity, is exempted from liability on the basis of the same conditions.</p>	<p>10. Lice koje pomaže imaocu da koristi tu stvar ne smatra se kao treće lice.</p> <p>11. I osoba koja se bavi opasnom delatnošću se oslobađa odgovornosti pod istim uslovima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 226 Largimi i paligjshëm i sendit të rrezikshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 226 Unlawful removal of a dangerous object</p>	<p style="text-align: center;">Član 226 Nezakonito uklanjanje opasne stvari</p>
<p>Nëse sendi i rrezikshëm largohet në mënyrë të paligjshme, personi i cili e ka larguar sendin e rrezikshëm është përgjegjës për çdo dëm që rezulton prej tij.</p>	<p>If a dangerous object was removed unlawfully, the person who removed the dangerous object shall be liable for any damage resulting from it.</p>	<p>Ako se opasna stvar nezakonito ukloni, lice koje je uklonilo opasnu stvar je odgovorno za bilo kakvu štetu koja proizilazi od njega.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 227 Veprimtaria e rrezikshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 227 Dangerous activities</p>	<p style="text-align: center;">Član 227 Opasna delatnost</p>
<p>1. Personi i cili e kryen veprimtari të rrezikshme është përgjegjës për çdo dëm që rezulton nga ajo veprimtari.</p> <p>2. Veprimtaria është e rrezikshme në qoftë se e rritë rrezikun për dëm edhe kur kryhet me kujdesin e duhur dhe nuk është çështje e përdorimit të zakonshëm. Rreziku i dëmit mund të jetë i rëndësishëm duke pasur parasysh seriozitetin e dëmit apo gjasat për paraqitjen e dëmit.</p>	<p>1. The person who carries on a dangerous activity shall be liable for any damage originating from such activity.</p> <p>2. An activity is dangerous if it creates a significant risk of damage even when conducted with due care and it is not a matter of common usage. A risk of damage may be significant having regard to the seriousness or the likelihood of the damage.</p>	<p>1. Lice koja obavlja opasne delatnosti odgovorna je za bilo kakvu štetu nastalu od te delatnosti.</p> <p>2. Delatnost je opasna ako povećava opasnost od štete, čak i kada se obavlja s dužnom pažnjom i nije pitanje uobičajene upotrebe. Opasnost od štete može biti značajna s obzirom na ozbiljnost štete ili mogućnosti za pojavu štete.</p>

<p>3. Përgjegjësia civile për dëmet që rezultojnë nga veprimtaritë e rrezikshme në mjedis rregullohet me ligj të veçantë.</p> <p>Nënkapitulli VI – Përgjegjësia për Dëmet e Shkaktuara nga Mjetet Motorike</p> <p>Neni 228 Dëmi i shkaktuar nga mjetet motorike</p> <p>1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.</p> <p>2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre.</p> <p>3. Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshëmrisë nuk kërkojnë diç tjetër.</p> <p>4. Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht.</p>	<p>3. Civil liability for damage resulting from activities dangerous to the environment shall be regulated by special law.</p> <p>Sub-chapter VI – Liability for Damages Caused by Motor Vehicles</p> <p>Article 228 Damage caused by motor vehicles</p> <p>1. The driver of a motor vehicle shall be obliged to compensate damages caused by fault.</p> <p>2. Except in the case of exclusive fault of one driver, each driver shall be liable in proportion to his respective fault.</p> <p>3. Unless proved otherwise, it is presumed that each driver equally contributed to cause the accident.</p> <p>4. The owner of the vehicle or its possessor is jointly and severally liable with the driver, unless he proves that the vehicle was used without his authorization.</p>	<p>3. Građanska odgovornost za štetu koja nastaje od opasnih delatnosti po životnu sredinu uređuje se posebnim zakonom.</p> <p>Potpoglavlje VI - Odgovornost za štete prouzrokovane od motornih vozila</p> <p>Član 228 Šteta prouzrokovana od motornih vozila</p> <p>1. U slučaju udesa izazvanog motornim vozilom u pokretu koji je prouzrokovan isključivom krivicom jednog imaoča, primenjuju se pravila o odgovornosti po osnovu krivice.</p> <p>2. Ako postoji obostrana krivica, svaki imalac motornog vozila odgovara za ukupnu štetu koju su oni pretrpeli srazmerno stepenu svoje krivice.</p> <p>3. Ako nema krivice ni jedne strane, imalac motornog vozila odgovara na ravne delove ako razlozi pravičnosti ne zahtevaju što drugo.</p> <p>4. Za štetu koju pretrpe treća lica imaoči motornih vozila odgovaraju solidarno.</p>
--	--	--

<p>5. Pronari i mjetit motorik apo poseduesi i tij është përgjegjës për dëmet rrjedhin nga të metat në mirëmbajtje apo prodhim të mjetit motorik, pa paragjykuar të drejtën e parashtresave kundër prodhuesit.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli VII - Përgjegjësia për të Metat e Produkteve</p> <p style="text-align: center;">Neni 229 Fusha e zbatimit</p> <p>Në rastin kur një produkt me të meta shkakton vdekjen e personit, lëndimin trupor apo shëndetit të tij, apo dëmton pronën e tij, prodhuesi i produktit detyrohet ta shpërblejë dëmin e shkaktuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 230 Produkti</p> <p>Për qëllim të këtij Nënkapitulli, produkt është çdo pronë e luajtshme, edhe nëse është montuar brenda një prone tjetër të luajtshme apo të paluajtshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 231 Të metat</p> <p>1. Produkti ka të meta kur nuk ofron sigurinë që personi ka të drejtë të presë, duke marrë</p>	<p>5. The owner of the vehicle or its possessor is liable for damages arising from defects in the maintenance or the manufacture of the vehicle, without prejudice to the right of redress against the manufacturer.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter VII – Liability for Defective Products</p> <p style="text-align: center;">Article 229 Scope of application</p> <p>When a defective product causes a person’s death, bodily injury or health, or damage to his property, the producer of the product shall be obliged to compensate the damage caused.</p> <p style="text-align: center;">Article 230 Product</p> <p>For the purpose of this Sub-chapter, a product is any movable property, even though incorporated into another movable property or into an immovable property.</p> <p style="text-align: center;">Article 231 Defect</p> <p>1. A product has a defect when it does not provide the safety which a person is entitled</p>	<p>5. Sopstvenik vozila ili njegov imalac je odgovoran za štete nastale od nedostatak u održavanju ili proizvodnji motornog vozila, bez prejudiciranja prava na podnošenje podnesaka protiv proizvođača.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje VII - Odgovornost za neispravnost proizvoda</p> <p style="text-align: center;">Član 229 Delokrug</p> <p>U slučaju kada neispravan proizvod uzrokuje smrt jedne osobe, telesne povrede ili njegovu zdravlje, ili ošteti njegovu imovinu, proizvođač proizvoda je dužan da nadoknadi štetu.</p> <p style="text-align: center;">Član 230 Proizvod</p> <p>Za potrebe ovog poglavlja, proizvod je svaka pokretna imovina, čak i ako je montirana unutar neke druge pokretne ili nepokretne imovine.</p> <p style="text-align: center;">Član 231 Nedostaci</p> <p>1. Proizvod je neispravan kad ne daje sigurnost da lice ima pravo da očekuju,</p>
--	---	--

<p>parasysh të gjitha rrethanat, si dhe posaçërisht prezantimin e tij, destinimin për të cilin arsyeshëm mund të pritet ta shërbejë, si dhe kohën kur është vënë në qarkullim.</p> <p>2. Produkti nuk është i mangët thjesht për arsyen që në qarkullim është vënë një produkt më i mirë më vonë.</p>	<p>to expect, taking all circumstances into account, including its presentation, the use to which it could reasonably be expected to serve, and the time when it was put into circulation.</p> <p>2. A product is not defective for the sole reason that a better product is subsequently put into circulation.</p>	<p>uzimajući u obzir sve okolnosti, a posebno njegovu prezentaciju, nameni koja se razumno može očekivati da posluži, kao i vremenu kada je pušten u promet.</p> <p>2. Proizvod nije manjkav jednostavno samo zato što je kasnije stavljen u promet neki bolji proizvod.</p>
<p>Neni 232 Prodhuesi</p>	<p>Article 232 Producer</p>	<p>Član 232 Proizvođač</p>
<p>1. Për qëllim të këtij Nënkapitulli, prodhuesi është personi që ka prodhuar produktin final, lëndën e parë apo një pjesë përbërëse. Prodhues është gjithashtu kushdo që me vënien e emrit, markës tregtare apo trajtave të tjera dalluese mbi produktin e paraqet veten si prodhuesi i atij produkti.</p> <p>2. Prodhues është gjithashtu kushdo që importon produktin për shitje, huazim, qiradhënie apo ndonjë formë tjetër të shpërndarjes me qëllim ekonomik në rrjedhën e biznesit të tij.</p> <p>3. Në rastet kur prodhuesi i produktit nuk mund të identifikohet, secili furnizues i produktit konsiderohet të jetë prodhuesi i tij, përveç nëse ai e informon të dëmtuarin , brenda një (1) muaji nga pranimi i kërkesës</p>	<p>1. For the purpose of this Sub-chapter, a producer is a person who has produced the final product, a raw material or a component part. A producer is also anyone who by putting his name, trademark or other distinguishing feature on the product presents himself as its producer.</p> <p>2. A producer is also anyone who imports a product for sale, hire, leasing or any form of distribution with an economic purpose in the course of his business.</p> <p>3. Where the producer of the product cannot be identified, each supplier of the product shall be deemed to be its producer unless he informs the injured person within one (1) month of his request of the identity of the</p>	<p>1. Za potrebe ovog potpoglavlja, proizvođač je lice koje je proizvelo završni proizvod, sirovinu ili neki sastavni deo. Proizvođač je takođe svako ko postavljanjem svojeg imena, zaštitnog znaka ili drugih istaknutih obeležja na proizvodu predstavlja sebe kao proizvođač tog proizvoda.</p> <p>2. Proizvođač je takođe svako ko uvozi proizvod za prodaju, najam, zakup ili bilo koji drugi oblik distribucije za ekonomsku svrhu u toku svog poslovanja.</p> <p>3. U slučajevima kada se proizvođač ne može identifikovati, svaki snabdevač proizvoda smatra se da je njegov proizvođač, osim ako on obavesti oštećenog, u roku od jednog (1) meseca od prijema zahteva za identitet</p>

<p>për identitetin e prodhuesit apo personit që e ka furnizuar me atë produkt. Rregulli i njëjtë vlen në rastin e produktit të importuar, nëse ky produkt nuk e tregon identitetin e personit të përmendur në paragrafin 2, edhe nëse emri i prodhuesit është i njohur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 233 Dëmi nga produktet me të meta</p> <p>1. Për qëllime të këtij nënkapitulli, dëmi do të thotë:</p> <p>1.1. dëmi i shkaktuar me vdekja ose me lëndime personale;</p> <p>1.2. dëmtimi ose shkatërrimi i pronës përtej produktit me të meta, me kusht që kjo pronë tjetër është e një lloji zakonisht të destinuar për përdorim apo konsum privat, si dhe është përdorur nga personi i dëmtuar kryesisht për përdorimin apo konsumin e tij privat.</p>	<p>producer or of the person who supplied him with the product. The same rule shall apply, in the case of an imported product, if this product does not indicate the identity of the person referred to in paragraph 2, even if the name of the producer is known.</p> <p style="text-align: center;">Article 233 Damage due to faulty products</p> <p>1. For the purpose of this Sub-chapter, damage means:</p> <p>1.1. damage caused by death or by personal injuries; and</p> <p>1.2. damage or destruction of any property other than the defective product itself, provided that this other property is of a type ordinarily intended for private use or consumption, and was used by the damaged person mainly for his own private use or consumption.</p>	<p>proizvođača ili lica koje mu je isporučila taj proizvod. Isto pravilo važi u slučaju uvezenih proizvoda, ako ovaj proizvod ne dokazuje identitet lica iz stava 2, čak i ako je ime proizvođača poznato.</p> <p style="text-align: center;">Član 233 Šteta prouzrokovana od neispravnih proizvoda</p> <p>1. Za potrebe ovog potpoglavlja, šteta znači:</p> <p>1.1. šteta prouzrokovana smrću ili telesnim povredama;</p> <p>1.2. oštećenje ili uništenje imovine preko neispravnog proizvoda, pod uslovom da takva druga imovina obično namenjena za upotrebu ili privatnu potrošnju, i da ju je oštećeno lice koristilo uglavnom za svoju privatnu upotrebu ili potrošnju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 234 Përgjegjësia e dy apo më shumë palëve për shpërblim monetar</p> <p>Nëse dy apo më shumë prodhues janë përgjegjës për shpërblimin monetar të dëmeve për të njëjtin dëm, ato mbajnë përgjegjësi solidare dhe të ndarë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 234 Joinder of parties liable to monetary compensation</p> <p>If two or more producers are liable to pay monetary compensation for the same damage, they shall be liable jointly and severally.</p>	<p style="text-align: center;">Član 234 Odgovornost dvoje ili više stranaka za novčanu nadoknadu</p> <p>Ukoliko dvoje ili više proizvođača su odgovorni za novčanu nadoknadu za istu štetu, oni snose solidarnu i podeljenu odgovornost.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 235 Përgjegjësia e zvogëluar</p> <p>1. Përgjegjësia e prodhuesit ulet kur dëmi shkaktohet nga të metat në produkt edhe nga veprimi ose mosveprimi i një pale të tretë.</p> <p>2. Përgjegjësia e prodhuesit mund të ulet edhe kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, dëmi është shkaktuar nga të metat në produkt si dhe nga faji i personit të dëmtuar ose të ndonjë personi për të cilin personi i dëmtuar është përgjegjës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 235 Reduced liability</p> <p>1. The liability of the producer shall be reduced when the damage is caused both by a defect in product and by the act or omission of a third party.</p> <p>2. The liability of the producer may also be reduced when, having regard to all the circumstances, the damage is caused both by a defect in product and by the fault of the damaged person or any person for whom the damaged person is responsible.</p>	<p style="text-align: center;">Član 235 Smanjena odgovornost</p> <p>1. Odgovornost proizvođača se smanjuje kada je šteta prouzrokovana usled nedostataka u proizvodu i zbog delovanja ili ne delovanja treće stranke.</p> <p>2. Odgovornost proizvođača se može smanjiti čak i kada se uzmu u obzir sve okolnosti, šteta je prouzrokovana od nedostatka u proizvodu i krivicom oštećenog ili bilo kog lica za koje je oštećeni odgovoran.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 236 Kur prodhuesi nuk është obligohet ta paguajë shpërblimin monetar</p> <p>1. Përgjegjësia e prodhuesit përjashtohet nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. ai nuk ka vënë produktin në qarkullim;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. në rrethanat e dhëna, është e provueshme që të metat që kanë</p>	<p style="text-align: center;">Article 236 When the producer is not liable to pay monetary compensation</p> <p>1. The producer's liability is excluded if:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. he did not put the product into circulation;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. under the circumstances it is probable that the defect which caused the damage</p>	<p style="text-align: center;">Član 236 Kada proizvođač nije obavezan da plati novčanu nadoknadu</p> <p>1. Odgovornost proizvođača je isključena ako :</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.on nije stavio proizvod u promet;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.se u datim okolnostima, dokazuje da su nedostaci koji su prouzrokovali štetu</p>

<p>shkaktuar dëmin nuk ka ekzistuar në kohën kur prodhuesi e ka vënë produktin në qarkullim;</p> <p>1.3. produkti as nuk është prodhuar nga ai për shitje apo për ndonjë formë tjetër të shpërndarjes për qëllime ekonomike, e as është prodhuar apo shpërndarë nga ai në rrjedhën e biznesit të tij;</p> <p>1.4. të metat paraqiten për shkak të përputhshmërisë së produktit me ligjet dhe me rregulloret; ose</p> <p>1.5. njohuritë shkencore dhe teknike në kohën kur prodhuesi ka vënë produktin në qarkullim nuk kanë qenë të tilla sa të mundësojnë zbulimin e të metave.</p> <p>2. Obligimi i prodhuesit për ta paguar shpërblimin monetar për një pjesë përbërëse gjithashtu përjashtohet nëse mangësia apo defekti mund t'i atribuohet dizajnit të produktit në të cilin është montuar ajo pjesë apo udhëzimeve që jepen nga prodhuesi i produktit.</p>	<p>did not exist at the time when the producer put the product into circulation;</p> <p>1.3. the product was neither manufactured by him for sale or any other form of distribution for economic purpose nor manufactured or distributed by him in the course of his business;</p> <p>1.4. the defect is due to compliance of the product with laws and regulations; or</p> <p>1.5. the state of scientific and technical knowledge at the time when the producer put the product into circulation was not such as to enable the defect to be discovered.</p> <p>2. The obligation to pay monetary compensation of the producer of a component part is also excluded if the defect is attributable to the design of the product in which the component has been fitted or to the instructions given by the manufacturer of the product.</p>	<p>nisu postojali u vreme kada je proizvođač stavio proizvod u promet;</p> <p>1.3. proizvod nije proizveden od njega za prodaju ili bilo koji drugi oblik distribucije za ekonomsku svrhu niti je proizveden ili distribuiran od njega u njegovom lancu poslovanja;</p> <p>1.4. nedostaci nastaju zbog usklađenosti proizvoda sa zakonima i propisima; ili</p> <p>1.5. naučna i tehnička znanja u vreme kada je proizvođač stavio proizvod u promet nisu bila takve da omoguće otkrivanje nedostataka.</p> <p>2. Obaveza proizvođača da plati novčanu nadoknadu za sastavni deo se takođe isključuje ako se nedostatak ili kvar može prepisati dizajn proizvoda u kojem je montiran taj deo ili uputstava od strane proizvođača proizvoda.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 237 Barra e provës e personit të dëmtuar</p> <p>Personi i dëmtuar bart barrën e dëshmisë për mangësinë, dëmin dhe marrëdhënien kauzale ndërmjet mangësisë dhe dëmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 237 Burden of proof of the injured person</p> <p>The injured person bears the burden of proving the defect, the damage and the causal relationship between defect and damage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 237 Teret dokazivanja oštećenog lica</p> <p>Oštećeno lice snosi teret dokazivanja nedostataka, štete i uzročne veza između nedostataka i štete.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 238 Barra e provës së prodhuesit</p> <p>Prodhuesi mban barrën e provës për arsyet për përjashtimin e përgjegjësisë së përmendur në nenin 236 të këtij libri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 238 Burden of proof of the producer</p> <p>The producer bears the burden of proving the grounds for exclusion of liability referred to in Article 236 of this Book.</p>	<p style="text-align: center;">Član 238 Teret dokazivanja proizvođača</p> <p>Proizvođač snosi teret dokazivanja o razlozima za isključenje odgovornosti iz člana 236 ove knjige.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 239 Parashkrimi</p> <p>1. Kërkesa për shpërblim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita në të cilën pala me të drejtë të shpërblimit merr njohuri, apo pritet të ketë njohuri, për dëmin, të metat dhe identitetin e palës përgjegjëse për atë shpërblim monetar.</p> <p>2. Në cilindo rast, kërkesa parashkruhet dhjetë (10) vite nga data në të cilën prodhuesi ka vënë në qarkullim produktin që ka shkaktuar dëmin, përveç nëse personi i dëmtuar në ndërkohë ka iniciuar procedurë ligjore kundër prodhuesit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 239 Statutory limitation</p> <p>1. The compensation claim shall prescribe after three (3) years from the day on which the party entitled to compensation became aware, or should have become aware, of the damage, the defect and the identity of the party liable to pay monetary compensation.</p> <p>2. In any event, the claim shall expire (10) ten years from the day when the producer put into circulation the product that caused the damage, unless the injured person has in the meantime instituted legal proceedings against the producer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 239 Zastarelost</p> <p>1. Zahtev za nadoknadu zastareva nakon tri (3) godine od dana na koju je stranka sa pravom na nadoknadu dođe do saznanja, ili se očekuje da ima saznanja o šteti, nedostacima, i o identitetu stranke koja je odgovorna za novčanu nadoknadu.</p> <p>2. U svakom slučaju, zahtev zastareva deset (10) godina od dana na koji je proizvođač stavio u promet proizvod koji je prouzrokovao štetu, osim ako je oštećeno lice u međuvremenu pokrenuo pravni postupak protiv proizvođača.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 240 Natyra detyruese</p> <p>Përgjegjësia e prodhuesve nuk mund të përjashtohet apo kufizohet paraprakisht. Çfarëdo marrëveshje në të kundërtën do të jetë e pavlefshme.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli VIII – Rastet e Veçanta të Përgjegjësisë</p> <p style="text-align: center;">Neni 241 Përgjegjësia e organizatorëve të manifestimeve</p> <p>Organizatori i tubimit të një numri të madh njerëzish në ambiente të mbyllura apo të hapura përgjigjet për dëmin e krijuar me vdekjen ose me lëndimin trupor që pëson dikush për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që mund të krijohen në situatat e tilla siç janë lëkundja e masës, çrregullimet e përgjithshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 242 Përgjegjësia për zotëruesin e kafshës</p> <p>1. Zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 240 Mandatory nature</p> <p>The liability of the producers may not be excluded or limited in advance. Any agreements to the contrary shall be null.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter VIII – Special Cases of Liability</p> <p style="text-align: center;">Article 241 Event organisers' liability</p> <p>The organizer of an assembly of a large number of people in a closed area or in the open air shall be liable for damage caused by death or physical injury occurring because of the extraordinary circumstances that can arise in such opportunities such as mass movement and general disorder.</p> <p style="text-align: center;">Article 242 Liability arising from animals</p> <p>1. The keeper of a dangerous animal shall be liable for any damage caused by it.</p>	<p style="text-align: center;">Član 240 Obavezujuća priroda</p> <p>Odgovornost proizvođača ne može se isključiti ili ograničiti unapred. Svaki sporazum u suprotnom će biti nevažeći.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje VIII – Posebni slučajevi odgovornosti</p> <p style="text-align: center;">Član 241 Odgovornost organizatora događaja</p> <p>Organizator okupljanja većeg broja ljudi u zatvorenom ili otvorenim prostorijama odgovoran-za štetu nastalu smrću ili telesnim povredama koje zadobije neko zbog vanrednih okolnosti koje mogu nastati u tim situacijama kao što je ljuljanje mase kao i opšti poremećaji.</p> <p style="text-align: center;">Član 242 Odgovornost imaoaca životinje</p> <p>1. Imalac životinje je odgovoran za štetu koju ona prouzrokuje.</p>
--	---	---

<p>2. Zotëruesi i kafshës shtëpiake është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka vepruar me kujdesin e duhur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 243 Përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës dhe për shembjen e ndërtimit</p> <p>1. Pronari ose poseduesi i një ndërtese ose strukture tjetër është përgjegjës për çdo dëm që buron nga rrënojat apo nga shembja e ndërtesës ose strukturës, përveç nëse tregohet se dëmi nuk ishte rezultat i neglizhencës në mirëmbajtje ose cilësisë së dobët të ndërtimit dhe se pronari ose poseduesi ka vepruar me kujdesin e duhur.</p> <p>2. Pronari ose poseduesi i një ndërtese ose strukture tjetër është përgjegjës për çdo dëm që buron nga objektet të cilat kanë rënë poshtë nga ndërtesa dhe të cilat kanë qenë të vendosura në mënyrë të pakujdeshme.</p> <p>3. Zotëruesi i ndërtimit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se pjesë të një ndërtimi shemben ose rrëzohen, përveç nëse provohet se ngjarja nuk ka qenë rezultat i cilësisë së papërshtatshme të ndërtimit dhe se zotëruesi ka bërë çdo gjë për të shmangur rrezikun.</p>	<p>2. The keeper the domestic animal shall be responsible for any damage caused by it, unless it is shown that he has acted with due care.</p> <p style="text-align: center;">Article 243 Liability of the possessor of the building and for the collapse of the construction</p> <p>1. The owner or possessor of a building or other structure shall be liable for any damage originating from the ruins or collapse of such building or structure, unless it is shown that the damage was not the result of neglected maintenance or inadequate quality of construction and that the owner or possessor acted with due care.</p> <p>2. The owner or possessor of a building or other structure shall be liable for any damage originating from objects which have fallen down from the building and which were incautiously positioned.</p> <p>3. The owner of the construction is responsible for the damage caused if parts of a construction collapses or falls, unless it is proven that the event was not the result of inappropriate construction quality and that the possessor has done everything to avoid the risk.</p>	<p>2. Imalac domaće životinje je odgovoran za štetu koju ona prouzrokuje, osim ako se dokaže da je imalac postupao uz potrebnu pažnju i nadgledanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 243 Odgovornost imaoaca zgrade i za rušenje građevine</p> <p>1. Vlasnik ili imalac zgrade ili strukture je odgovoran za bilo kakvu štetu nastalu iz ruševina ili rušenje zgrade ili strukture, osim ako se pokaže da šteta nije rezultat nemara u održavanju ili lošeg kvaliteta gradnje i da je vlasnik ili imalac postupao sa dužnom pažnjom.</p> <p>2. Vlasnik ili imalac zgrade ili druge strukture je odgovoran za bilo kakvu štetu nastalu iz objekata u kojima su pale iz zgrade i koji su postavljeni na nepažljiv način.</p> <p>3. Imalac građevine je odgovoran za nastalu štetu ukoliko se neki deo građevine sruši ili padne, osim ako se dokaže da događaj nije bio rezultat neodgovarajućeg kvaliteta gradnje i da je imalac uradio sve da bi se izbegla opasnost.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 244 Përgjegjësia për shkak të refuzimit të dhënies së ndihmës së domosdoshme</p> <p>1. Çdo person i cili pa pasur rrezik për vete e refuzon dhënien e ndihmës personit, jeta ose shëndeti i të cilit rrezikohet haptazi, përgjigjet për dëmin e pësuar, në qoftë se ai këtë dëm sipas rrethanave të rastit është dashur të parashihej.</p> <p>2. Gjykata mund ta përjashtojë këtë person nga shpërblymi i dëmit nëse kërkohet nga rrethanat e rastit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 244 Liability because of omission of emergency aid</p> <p>1. Any person who without any risk to himself fails to aid anyone whose life or health is endangered shall be liable for the damage suffered by, if the circumstances of the case the damage should have been foreseen.</p> <p>2. The court may exempt such person from compensating the damage if the circumstances of the case so require.</p>	<p style="text-align: center;">Član 244 Odgovornost za odbijanje pružanja neophodne pomoći</p> <p>1. Svako lice koji bez opasnosti za sebe odbije da pruži pomoć licu, čiji je život ili zdravlje jasno ugroženo, odgovora za pretrpljenu štetu, ako je on s obzirom na okolnosti slučaja trebao da predvidi ovu štetu.</p> <p>2. Sud može isključiti to lice od nadoknade štete ako to zahtevaju okolnosti slučaja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 245 Përgjegjësia që rrjedh lidhur me detyrimin e lidhjes së kontratës</p> <p>Çdo person i detyruar me ligj që ta lidhë një kontratë, duhet t'i kompensojë dëmet e shkaktuara nga moslidhja e asaj kontrate, në kohën e duhur me kërkesë të personit të interesuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 245 Liability arising in connection with the obligation to conclude a contract</p> <p>Any person obliged by law to conclude a contract must compensate any damage caused by failure to conclude such contract in due time at the request of the interested person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 245 Odgovornost koja proizlazi iz obaveze za zaključenje ugovora</p> <p>Svako lice koje je po zakonu obavezno da zaključi neki ugovor, dužna je da na zahtev zainteresovane stranke i u odgovarajuće vreme da nadoknadi štetu zbog ne zaključenja ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 246 Përgjegjësia lidhur me ushtrimin e punëve me interes të përgjithshëm</p> <p>Organizatrat që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes publik, përgjigjen për dëmin në qoftë</p>	<p style="text-align: center;">Article 246 Liability in connection with performance of transactions of general importance</p> <p>Any person that performs municipal or other similar activities of general importance shall be liable for damage if such person ceases to</p>	<p style="text-align: center;">Član 246 Odgovornost za obavljanje radova od opšteg interesa</p> <p>Organizacije koje obavljaju komunalne delatnosti ili bilo koje druge slične delatnosti od javnog interesa, odgovaraju za štetu ukoliko</p>

<p>se pa shkak të arsyeshëm ndërpresin ose kryejnë shërbimin jo me rregull.</p> <p>KAPITULLI XIV – SHPËRBLIMI I DËMIT</p> <p>Nënkapitulli I – Dispozitat e Përgjithshme për Dëmin Material</p> <p>Neni 247 Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla</p> <p>1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.</p> <p>2. Nëse rivendosja e gjendjes paraprahe është tërësisht apo pjesërisht e pamundur, personi përgjegjës detyrohet të paguajë shpërblimin në të holla.</p> <p>3. Nëse kërkohet nga personi i dëmtuar, personi përgjegjës detyrohet ta paguajë shpërblimin monetar, përveç nëse rrethanat e rastit e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes paraprahe.</p>	<p>perform the services or performs the services irregularly without justifiable grounds.</p> <p>CHAPTER XIV – COMPENSATION OF DAMAGE</p> <p>Sub-chapter I – General Provisions for Material Damage</p> <p>Article 247 Restoration of original situation and monetary compensation</p> <p>1. The liable person shall be obliged to restore the situation existing prior to the occurrence of the damage.</p> <p>2. If restoration of the original situation is totally or partially impossible, the liable person shall be obliged to pay monetary compensation.</p> <p>3. If the injured person so requests, the liable person shall be obliged to pay monetary compensation, unless the circumstances of the case justify the restoration of the original situation.</p>	<p>bez opravdanog razloga prekinu ili izvršavaju neredovnu uslugu.</p> <p>POGLAVLJE XIV - NAKNADA ŠTETE</p> <p>Potpoglavlje I - Opšte odredbe o materijalnoj šteti</p> <p>Član 247 Uspostavljanje predašnjeg stanja i novčana naknada</p> <p>1. Odgovorno lice je dužno da uspostavi predašnje stanje koje je bilo pre prouzrokovanja štete.</p> <p>2. Ako vraćanje u prvobitno stanje je potpuno ili delimično nemoguće, odgovorno lice je dužno da plati novčanu naknadu.</p> <p>3. Ako to zahteva oštećeno lice, odgovorno lice je obavezno da plati novčanu naknadu, osim ako okolnosti slučaja opravdavaju vraćanje u prvobitno stanje.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 248 Arritja për pagesë e detyrimit të shpërblimit të dëmit dhe shpërblimi në formë të rentës në të holla</p>	<p align="center">Article 248 Reaching for payment of remuneration for damage liability and compensation in the form of cash allowance</p>	<p align="center">Član 248 Dospeće obaveza za plaćanje naknade za štetu i naknada u obliku novčane naknade</p>
<p>1. Detyrimi i shpërblimit të demit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.</p> <p>2, Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.</p> <p>3. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër.</p> <p>4. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme.</p> <p>5. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së</p>	<p>1. The obligation to compensate the damage is considered to be reached for payment, at the moment when the damage occurred.</p> <p>2. In case event of death, bodily injury or damage to health, the compensation shall, as a rule be determined, in the form of a cash allowance, for a lifetime or for a fixed period of time.</p> <p>3. Cash allowance tried in the name of compensation for damages shall be paid for each month in advance, unless the court assigns anything else.</p> <p>4. The creditor has the right to request the necessary insurance for the payment of allowance, unless it is, according to the circumstances of the case, not justified.</p> <p>5. If the debtor does not provide the insurance ordered by the court, the creditor has the right to demand that instead of the allowance to be paid a total amount, the amount of which will be determined according to the amount of the allowance and the duration of the possible life</p>	<p>1. Smatra se da je obaveza za plaćanje naknade dospela za plaćanje od trenutka prouzrokovanja štete.</p> <p>2. U slučaju smrti, telesne povrede ili oštećenja zdravlja, naknada se po pravilu određuje, u obliku novčanih naknada, doživotno ili za određeni vremenski period.</p> <p>3. Novčana naknada koji koja je određena na ime naknade štete, plaća se za svaki mesec unapred, osim ako sud ne odredi nešto drugo.</p> <p>4. Poverilac ima pravo da zatraži neophodno osiguranje za plaćanje naknade, osim ako to nije neosnovano, prema okolnostima slučaja,.</p> <p>5. Ako dužnik ne obezbedi osiguranje koje je sud odredio, poverilac ima pravo da zahteva da se umesto mesečne naknade uplati ukupan iznos, čiji će iznos biti određen prema visini naknade i mogućeg trajanja života poverioca, uz izuzeće relevantne kamatne stope.</p>

<p>kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse.</p> <p>6. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Rregullat për Përcaktimin e Shumës së Shpërblimit</p> <p style="text-align: center;">Neni 249 Dëmi real dhe fitimi i humbur</p> <p>1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit real, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.</p> <p>2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet në bazë të vlerës së tregut dhe çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.</p> <p>3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin.</p>	<p>of the creditor, with discounts on relevant interest rates.</p> <p>6. The creditor may, for serious reasons at other times, also require, promptly or later that a total amount to be paid instead of the allowance.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Rules for Determining the Amount of Compensation</p> <p style="text-align: center;">Article 249 Actual loss and lost profit</p> <p>1. The damaged party shall have the right to compensation of the loss which such party has suffered (actual loss) and gain of which he has been deprived (lost profit).</p> <p>2. The amount of compensation provided shall be calculated according to the market values and prices at the time when the court decision is issued.</p> <p>3. When estimating the amount of profit lost, consideration is given to the profit that could have been expected based on the regular flow of objects or under special circumstances and whose performance has been hampered by the act of the doer or by the omission to take action.</p>	<p>6. Iz ozbiljnih razloga, poverilac može i u drugim slučajevima zatražiti odmah ili kasnije da se umesto mesečne naknade plati ukupan iznos.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Pravila za određivanje iznosa naknade</p> <p style="text-align: center;">Član 249 Stvarna šteta i izgubljena dobit</p> <p>1. Oštećeni ima pravo kako na nadoknađivanje stvarne štete, tako i na nadoknađivanje izgubljene dobiti.</p> <p>2. Visina naknade se određuje na osnovu tržišne vrednosti i cena u vreme donošenja sudske odluke, osim ako je drugačije propisano zakonom.</p> <p>3. Tokom izračunavanja visine iznosa izgubljene dobiti uzima se u obzir dobit koja se mogla očekivati na osnovu načina u redovnom toku stvari, ili u posebnim okolnostima, čija je ostvarenje sprečeno štetnikovom radnjom ili iz ispusta za preduzimanje radnje.</p>
--	--	---

<p>4. Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin.</p>	<p>4. When the object is destroyed or damaged by a criminal offense committed intentionally, the court may set the amount of compensation according to the value that the object had for the damaged party.</p>	<p>4. Kad je stvar uništena ili oštećena krivičnim delom učinjenim sa umišljajem, sud može odrediti visinu naknade prema vrednosti koju je stvar imala za oštećenika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 250 Dëmi që rrjedhë nga moskryerja ose vonesa në kryerjen e një detyrimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 250 Damage arising from non-performance or delay in performance of an obligation</p>	<p style="text-align: center;">Član 250 Šteta koja proističe od neispunjenja ili od docnje u izvršavanju obaveza</p>
<p>1. Në rast të mospërmbushjes ose vonesës në përmbushjen e një detyrimi, shpërblimi duhet t'a vendosë kreditorin në pozitën në të cilën ai do të kishte qenë, po që se detyrimi të ishte përmbushur në mënyrë të rregullt.</p>	<p>1. In the case of non-performance or delay in performance of an obligation, compensation shall put the creditor as nearly as possible into the position in which he would have been if the obligation had been duly performed.</p>	<p>1. U slučaju neispunjenja ili docnje u izvršenju obaveze ili, naknada treba da postavi poverioca u poziciji u kojoj bi bio, ako bi se izvršila na redovnoj osnovi.</p>
<p>2. Debitori është përgjegjës vetëm për dëmin që e ka paraparë ose është dashur ta kishte paraparë në kohën kur detyrimi është krijuar, përveç nëse mospërmbushja ose vonesa në përmbushje ishte me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.</p>	<p>2. The debtor is liable only for the damage that he foresaw or should have foreseen at the time when the obligation was incurred, unless the non-performance or delay in performance was intentional or grossly negligent.</p>	<p>2. Dužnik je odgovoran samo za štetu koju je predvideo ili je trebalo da predvidi u trenutku kada je nastala obaveza, osim ako je neispunjenje ili docnja u ispunjavanju bila namerna ili od teškog nemara.</p>
<p>3. Debitori nuk është përgjegjës për dëmet e pësuar nga kreditori nëse kreditori i ka kontribuar mospërmbushjes ose vonesës në përmbushjen e detyrimit.</p>	<p>3. The debtor is not liable for damage suffered by the creditor to the extent that the creditor contributed to the non-performance or delay in performance of the obligation.</p>	<p>3. Dužnik ne odgovara za štetu koja poverioca ako je poverilac doprineo neispunjenju ili docnji u ispunjavanju obaveza.</p>
<p>4. Debitori nuk është përgjegjës për dëmet e pësuar nga kreditori nëse kreditori ka mundur t'i zvogëlonte humbjet duke ndërmarrë veprime të arsyeshme. Kreditori ka të drejtë t'i</p>	<p>4. The debtor is not liable for damage suffered by the creditor to the extent that the creditor could have reduced the loss by taking reasonable steps. The creditor is entitled to</p>	<p>4. Dužnik ne odgovara za štetu koju je pretrpeo poverilac ako je poverilac bio u mogućnosti da smanji gubitak preko preduzimanja razumnih radnji. Poverilac ima</p>

<p>mbulojë të gjitha shpenzimet e bëra në mënyrë të arsyeshme në përpjekje për ta zvogëluar dëmin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 251 Shpërblimi i plotë dhe zvogëlimi i shpërblimit</p> <p>1. Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të silllet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.</p> <p>2. Gjykata mundet, duke pasur kujdes për gjendjen materiale të të dëmtuarit, ta urdhërojë personin përgjegjës ta paguajë shpërblimin më të vogël nga shuma e dëmit, në qoftë se dëmi nuk është shkaktuar as me dashje e as nga pakujdesia rende, ndërsa personi përgjegjës është në gjendje të rende materiale, kështu që pagimi i shumës së plotë do ta sjellte në varfëri.</p> <p>3. Në qoftë se dëmtuesi ka shkaktuar dëm duke punuar diç për dobi të të dëmtuarit, gjykata mund të caktojë shpërblim më të vogël, duke pasur parasysh kujdesin që tregon dëmtuesi në</p>	<p>recover any expenses reasonably incurred in attempting to reduce the damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 251 Full compensation and reduction of compensation</p> <p>1. The court, taking into account the circumstances that have been incurred after the damage is caused, shall judge the compensation in an amount which is necessary for the material condition of the damaged party to be brought in the condition in which it would have been if the damaging action or omission wouldn't happen.</p> <p>2. The court may, by taking care of the material condition of the damaged party, order the responsible person to pay the lowest compensation from the amount of the damage, if the damage is not caused by intentional or gross negligence, while the responsible person is in bad material condition, so paying the full amount would lead to poverty.</p> <p>3. If the damage was caused while the damaging party was acting for the benefit of the damaged party, the court may order the damaging party to pay reduced compensation,</p>	<p>pravo da povrati sve troškove koji su nastali na razuman način, u nastojanju da se smanji šteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 251 Potpuna naknada i smanjenje naknade</p> <p>1. Sud će, uzimajući u obzir okolnosti koje su nastale nakon nanošenja štete, suditi o nadoknadi u iznosu koji je neophodan za materijalno stanje oštećene strane da se ponaša u stanju u kojem bi bilo da nije bilo radnje oštećenje ili nečinjenja.</p> <p>2. Sud može, vodeći računa o finansijskoj situaciji oštećenog, da naloži odgovornoj osobi da plati manju naknadu od iznosa štete, ako šteta nije uzrokovana ni namerno ili iz teškog nemara, i odgovorna osoba je u teškom materijalnom stanju, tako da bi ga isplata punog iznosa dovela do siromaštva.</p> <p>3. Ako je štetnik naneo štetu radeći nešto u korist oštećenog, sud može odrediti manju naknadu, s obzirom da pažnju koju pokazuje štetnik u svojim poslovima.</p>
---	---	---

<p>punët e veta.</p> <p>4. Gjykata mund ta zvogëlojë shpërblimin nëse i dëmtuari duke e ditur rrezikun e dëmit që mund t'i shkaktohej, vullnetarisht e ka marrë atë rrezik dhe konsiderohet se e ka pranuar atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 252 Përgjegjësia e ndarë</p> <p>1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të shkaktohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të zvogëluar.</p> <p>2. Për paragrafin para prak vihen përshtatshmërisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin.</p> <p>3. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të caktojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit.</p> <p>4. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e njëri tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij.</p>	<p>taking into consideration the care that the damaging party pays in doing his job.</p> <p>4. The court may also reduce the compensation if the person suffering the damage, knowing the risk of damage of the type caused, voluntarily takes that risk and is to be regarded as accepting it.</p> <p style="text-align: center;">Article 252 Shared liability</p> <p>1. The damaged party, who has contributed to the damage created, or made the damage greater than it would be otherwise, has the right only to accordingly lower compensation.</p> <p>2. For the previous paragraph, the provisions on the liability of the legal representative and his assistant shall apply <i>mutatis mutandis</i>.</p> <p>3. When it is impossible to verify which part of the damage results from the action of the damaged party, the court shall rule on compensation by taking the circumstances of the case into account.</p> <p>4. The damaging and the damaged party bear the burden of proof of each's contribution to the damage caused, and the causality of the contribution to the damage and its weight.</p>	<p>4. Sud može smanjiti naknadu ako je oštećeni znajući rizik od štete koja mu se može naneti, svesno preuzeo taj rizik i smatra se da ga je prihvatio.</p> <p style="text-align: center;">Član 252 Podeljena odgovornost</p> <p>1. Oštećeni koji je doprineo da se nanese šteta ili bude veća nego što bi inače bila, ima pravo samo na proporcionalno smanjenje naknade.</p> <p>2. Za prethodni stav se na odgovarajući način primenjuju odredbe odgovornosti za zakonskog zastupnika i pomoćnika.</p> <p>3. Kada je nemoguće potvrditi koji deo štete je rezultat delovanja oštećenog, sud će odrediti naknadu imajući u obzir okolnosti slučaja.</p> <p>4. Štetnik i oštećeni snose teret dokazivanja doprinosa jedni drugima u uzrokovanju i kauzalnost ovog doprinosa na štetu i njegovu visinu.</p>
---	--	--

<p>Nënkapitulli III – Rregullat e Veçanta për Shpërblim në Rast të Vdekjes, Lëndimit Trupor dhe Dëmtimit të Shëndetit</p> <p>Neni 253 Humbja e fitimit, shpenzimet e mjekimit e të varrosjes dhe e drejta e personit të cilin e ka ushqyer i vdekuri</p> <p>1. Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.</p> <p>2. Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë.</p> <p>3. Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës.</p> <p>4 Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk</p>	<p>Sub-chapter III – Special Rules for Compensation in the Event of Death, Bodily Injury and Damage to Health</p> <p>Article 253 Loss of profit, treatment and burial expenses and the right of the person that was fed by the deceased</p> <p>1. Who causes the death of someone has the duty to compensate his usual burial expenses.</p> <p>2. He is also obliged to compensate the costs of his treatment for the injuries he has suffered and other necessary expenses related to treatment and the profit lost due to inability to work.</p> <p>3. A person who has been regularly fed or assisted by a person who has been subject to death and who, under the law, has been entitled to seek alimony from the person to whom death has been caused shall be entitled to compensation for the damage he suffers from loss of food or aid.</p> <p>4 This damage is compensated with the payment of the cash allowance, the amount of which is determined taking into account all</p>	<p>Potpoglavlje III - Posebna pravila za naknadu u slučaju smrti, telesne povrede i narušavanja zdravlja</p> <p>Član 253 Gubitak profita, troškovi lečenja i sahrane kao i pravo osobe koju je hranio pokojnik</p> <p>1. Ko uzrokuje smrt nekoga, dužan je da nadoknadi uobičajene troškove njegove sahrane.</p> <p>2. Takođe je dužan da nadoknadi troškove njegovog lečenja od povrede koje je dobio kao i ostale neophodne troškove vezane za lečenje i gubitak profita zbog nesposobnosti rada.</p> <p>3. Lice koje je redovno nahranjeno ili dobijalo pomoć od strane lica kojoj je uzrokovana smrt, kao i ono lice koje je prema zakonu imala pravo da zahteva hranu od osobe kojoj je prouzrokovana smrt, ima pravo na naknadu štete od gubitka hrane ili pomoći.</p> <p>4. Ova šteta se nadoknađuje isplatom gotovinskih naknada, čiji se iznos utvrđuje uzimajući u obzir sve okolnosti slučaja, koje</p>
---	--	--

<p>mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë</p> <p style="text-align: center;">Neni 254 Shpërblimi i demit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit</p> <p>1. Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.</p> <p>2. Në qoftë se i lënduari për shkak të paftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësi të e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 255 Shkalla e përgjegjësisë në rastin e vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit</p>	<p>the circumstances of the case, which cannot be greater than the one that the injured party would gain if the person to whom the death was caused would remain alive.</p> <p style="text-align: center;">Article 254 Compensation of damage in case of death, bodily injury and damage to health</p> <p>1. Who causes bodily injury to another person or harms his health is obliged to compensate for the costs of treatment and other necessary expenses associated with this as well as lost earnings due to inability to work during the time of treatment.</p> <p>2. If the injured party due to partial or partial inability to work loses profit or needs are added continuously, or opportunities for further development and progress have disappeared or are diminished, the person in charge has a duty to pay the injured person a fixed amount of money in return for this damage.</p> <p style="text-align: center;">Article 255 Extent of liability in the case of death, bodily injury and damage to health,</p>	<p>ne može biti veće od onog koje bi oštećeni ostvario od osobe kojoj je prouzrokovana smrt ukoliko bi ostao živ</p> <p style="text-align: center;">Član 254 Naknada štete u slučaju smrti, telesne povrede i narušavanja zdravlja</p> <p>1. Ko izaziva drugom telesne povrede ili naruši zdravlje ima dužnost da naknadi troškove oko lečenja i druge neophodne troškove u vezi sa time, kao i gubitak zarade zbog nesposobnosti za rad za vreme lečenja.</p> <p>2. Ako povređeni zbog potpune ili delimične nesposobnosti za rad gubi zaradu, ili se potrebe stalno povećavaju, odnosno nestale su ili su pak smanjenje mogućnosti njegovog daljeg razvoja i napretka, odgovorno lice je dužno da plati oštećenom određenu novčanu rentu kao naknadu za ovu štetu.</p> <p style="text-align: center;">Član 255 Stepen odgovornosti u slučaju smrti, telesne povrede ili narušavanju zdravlja</p>
---	--	--

<p>1. Në rast të vdekjes, shpërblimi bëhet me anë të mbulimit të shpenzimeve të shërimit si dhe shpenzimeve të shkaktuara nga i vdekuri për shkak të ndalimit apo zvogëlimit të kapacitetit të fitimprurjes apo rritjes pasuese të nevojave të tij për kohëzgjatjen e sëmundjes para vdekjes.</p> <p>2. Nëse në kohën e dëmtimit, pala e vdekur ka pasur marrëdhënie me një palë të tretë në lidhje me të cilën ka qenë nën detyrim ligjor të mbajtjes së asaj pale të tretë, si dhe nëse pala e tretë është privuar nga e drejta e mbajtjes si rezultat i vdekjes, pala përgjegjëse për pagesën monetare kompenson palën e tretë në formë të rentës. Përgjegjësia për dëmet zbatohet edhe nëse në kohën e dëmtimit, pala e tretë nuk ka qenë e lindur, por ka qenë e ngjizur.</p> <p>3. Çdo person që shkakton vdekjen e tjetrit obligohet të kompensojë shpenzimet e varrimit të palës së vdekurit.</p> <p>4. Në rast të lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit, shpërblimi bëhet me rimbursimin e shpenzimeve të shërimit, bashkë me humbjet e shkaktuara nga i dëmtuari si pasojë e ndalimit apo zvogëlimit të përkohshëm apo të përhershëm të kapacitetit të tij të fitimprurjes,</p>	<p>1. In the case of death, compensation shall be made by reimbursing the costs of an attempted cure as well as the losses incurred by the deceased party because of the suspension or reduction of his earning capacity or the resulting increase in his needs for the duration of the period of illness preceding his death.</p> <p>2. If at the time of the injury, the deceased party maintained a relationship with a third party by virtue of which he was under the legal obligation to maintain or support this third party and if the third party was deprived of the right to maintenance or support as a result of the death, the party liable to pay monetary compensation shall compensate the third party in the form of an allowance. Liability for damages shall also be enforced if, at the time of injury, the third party had been conceived but not yet born.</p> <p>3. Any person that causes the death of another shall be obliged to compensate the funeral costs of the deceased party.</p> <p>4. In the case of injury to a person's body or damage to his health, compensation shall be made by reimbursing the costs of the treatment as well as the losses incurred by the injured party as a result of the temporary or permanent suspension or reduction of his</p>	<p>1. U slučaju smrti, naknada se vrši preko pokrivanja troškova lečenja i troškova koji su nastali od poginulog zbog prekida ili smanjenja kapaciteta zarađivanja ili naknadnog rasta njegovih potreba za vreme trajanja bolesti pre smrti.</p> <p>2. Ako je u trenutku povrede, poginula stranka imala odnose sa trećom strankom u odnosu na koje je pod zakonskom obavezom izdržavanja te treće stranke, a ako je trećoj stranci uskraćeno pravo izdržavanja kao rezultat smrti, odgovorna stranka za novčanu isplatu nadoknađuje treću stranku u obliku rente. Odgovornost za štete se primenjuju čak i ako u vreme povrede, treća stranka nije bila rođena ali je bila začeta.</p> <p>3. Svako lice koje uzrokuje smrt drugom licu dužna je da naknadi troškove sahrane preminule stranke.</p> <p>4. U slučaju telesne povrede ili narušavanju zdravlja, naknada se obavlja pokrivanjem troškova lečenja, uz gubitke koje je oštećeni izgubio kao rezultat prekida ili privremenog ili trajnog smanjenja kapaciteta zarađivanja, ili naknadnog povećanja njegovih potreba</p>
---	---	--

<p>apo rritjes pasuese të nevojave të tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 256 Shpërblimi në formën e rentës</p> <p>1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.</p> <p>2. Renta e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër.</p> <p>3. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme.</p> <p>4. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilit e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse.</p> <p>5. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një</p>	<p>earning capacity or the resulting increase in his needs.</p> <p style="text-align: center;">Article 256 Compensation in the form of annuity</p> <p>1. In the event of death, physical injury or damage to health the compensation shall as a rule have the form of an annuity, either lifelong or for a specific period.</p> <p>2. An annuity awarded as compensation shall be paid monthly in advance, unless the court decides otherwise.</p> <p>3. The creditor shall have the right to request the necessary security for the payment of the annuity, unless such would not be justified given the circumstances of the case.</p> <p>4. If the debtor fails to provide the security stipulated by the court the creditor shall have the right to request that a one-off sum be paid thereto instead of the annuity; this shall be levied in respect of the size of the annuity and the creditor's probable lifespan, with a rebate for the appropriate interest.</p> <p>5. On serious grounds the creditor may also request that the debtor immediately or</p>	<p style="text-align: center;">Član 256 Naknada u obliku rente</p> <p>1. U slučaju smrti, telesne povrede ili narušavanja zdravlja, naknada se po pravilu određuje u obliku rente za život ili za određeno vreme.</p> <p>2. Presuđena renta u ime naknade štete plaća se svakog meseca unapred, ako sud ne odredi nešto drugo.</p> <p>3. Poverilac ima pravo da zahteva potrebno osiguranje za isplatu rente, osim ako pod tim okolnostima to ne bi bilo razumno.</p> <p>4. Ako dužnik ne pruži osiguranje koje je odredio sud, poverilac ima pravo da traži da mu se umesto rente plati neki opšti iznos, čija bi se visina odredila prema visini rente i mogućem trajanju poveriočevog života, uz odbitak relevantnih kamata.</p> <p>5. Za ozbiljne razloga poverilac može i u drugim slučajevima da odmah ili kasnije zatraži, da mu se umesto rente plati u ukupnom</p>
--	---	---

<p>shumë e përgjithshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 257 Ndryshimi në rrethana</p> <p>Gjykata mundet me kërkesë të të dëmtuarit, që për të ardhmen ta rritë rentën, por mundet me kërkesë të dëmtuesit ta zvogëlojë ose ta heq, në qoftë se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm për shpërblim të dëmit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 258 Mosbartja e të drejtave</p> <p>1. E drejta e shpërblimit të dëmit në formë rente në rast të vdekjes së personit të afërt ose të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit nuk mund t'i bartet personit tjetër.</p> <p>2. Shumat e shpërblimit, të cilat kanë arritur munden t'i barten tjetrit, në qoftë se lartësia e shpërblimit është caktuar me marrëveshje të shkruar të palëve ose me vendim të formës së prerë.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV – Dëmi Moral</p>	<p>subsequently pay a one-off sum instead of the annuity in other cases.</p> <p style="text-align: center;">Article 257 Change in circumstances</p> <p>The court may increase an annuity at the request of the injured party or may reduce or revoke it at the request of the injurer if there is a substantial change in the circumstances that were taken into consideration at the time when compensation of damage was awarded.</p> <p style="text-align: center;">Article 258 Non-transferability of rights</p> <p>1. It shall not be possible to transfer a right to compensation in the form of an annuity for the death of a person or for bodily injury or damage to health to another person.</p> <p>2. Sums of compensation that have fallen due may be transferred to another person if the compensation sum was set by a written agreement between the parties or by a final court decision.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Moral Damage</p>	<p>iznosu.</p> <p style="text-align: center;">Član 257 Promene u okolnostima</p> <p>Sud može da na zahtev oštećenog, poveća rentu za buduće, ali može na zahtev štetnika da smanji ili da ukine rentu, ukoliko je došlo do značajne promene okolnosti koje je sud uzeo u obzir pri donošenju prethodne odluke za naknadu štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 258 Neprenosivost prava</p> <p>1. Pravo na naknadu štete u vidu rente u slučaju smrti bliskog lica, ili telesne povrede ili narušavanja zdravlja se ne može preneti na drugo lice.</p> <p>2. Dospeli iznosi naknade mogu se preneti drugome, ako je iznos naknade određen pismenim sporazumom stranaka ili pravnosnažnom sudskom odlukom.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV – Moralna šteta</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 259 Modalitetet e reparacionit</p> <p>1. Dëmi moral mund të kompenzohet përmes shpërblimit monetar apo formave të tjera të reparacionit ekuivalente me shpërblimin monetar.</p> <p>2. Shpërblimi për dëmet morale dhe materiale të shkaktuara me shpifje dhe fyerje rregullohet me ligj të veçantë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 259 Modalities of reparation</p> <p>1. Moral damage may be compensated through monetary compensation or other form of reparation equivalent to monetary compensation.</p> <p>2. Compensation for moral and material damage caused by defamation and insult shall be regulated by special law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 259 Modaliteti reparacije</p> <p>1. Moralna šteta se može nadoknaditi novčanom naknadom ili drugim oblicima reparacije ekvivalentnim sa novčanom naknadom.</p> <p>2. Naknada za moralne i materijalne štete prčinjene klevetama i uvredama uređuje se posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 260 Shpallja e aktgjykimit ose ndreqja e gabimit dhe shpërblimi në të holla</p> <p>1. Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim</p> <p>2. Në vlerësimin e dëmeve morale, duhen marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë intensitetin, kohëzgjatjen dhe pasojat e dëmtimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 260 Announcement of the verdict or correction of the error and monetary compensation</p> <p>1. In case of a violation of the right of personality, the court may order the announcement of the judgment, respectively the correction at the expense of the damaging party, or order that the damaging party withdraw the statement by which the offense was committed or something else by which the goal that would have been achieved by the compensation is realised.</p> <p>2. In the assessment of moral damage, all circumstances of the case, including the gravity, duration and consequences of the damage, have to be taken into account.</p>	<p style="text-align: center;">Član 260 Izricanje presude ili ispravka greške i novčana naknada</p> <p>1. U slučaju povrede prava ličnosti, sud može naložiti izricanje presude, odnosno ispravku na štetu šetnika, ili naložiti da šetnik povuče izjavu kojom je učinjena povreda ili nešto drugo čime se može ostvariti cilj koji se postiže naknadom.</p> <p>2. U proceni moralnih šteta, treba uzeti u obzir sve okolnosti, uključujući i intenzitet, trajanje i posledice štete.</p>

<p>3. Kodi mund të përcaktojë se si llogaritet shpërblimi i dëmeve morale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 261</p> <p style="text-align: center;">Dëmi moral i pësuar nga personat e tretë si pasojë e vdekjes, lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit të një personi dhe shpërblimi në të holla</p> <p>1. Nëse dëmi moral i shkaktohet një personi të tretë si pasojë e vdekjes, lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit të një personi, personi përgjegjës për ato dëme obligohet t'i ofrojë shpërblim monetar atij personit të tretë nëse në kohën e vdekjes, lëndimit apo dëmtimit të shëndetit ai person ka marrëdhënie personale posaçërisht të afërt me personin e lënduar.</p> <p>2. Marrëdhënia e përmendur në paragrafin 1 prezumohet të ekzistojë, përveç nëse nuk vërtetohet e kundërta, ndërmjet të vdekurit apo personit të lënduar dhe bashkëshortëve, fëmijëve, prindërve dhe motrave e vëllezërve të tij.</p> <p>3. Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore</p>	<p>3. The Code may determine how compensation for moral damage is to be quantified.</p> <p style="text-align: center;">Article 261</p> <p style="text-align: center;">Moral damage suffered by third persons as a result of another's death, bodily injury or damage to health, and monetary compensation</p> <p>1. If moral damage is inflicted on a third person as a result of another's death, bodily injury or damage to health, the person liable for such damage shall be obliged to provide monetary compensation to the third person if at the time of death, injury or damage that person is in a particularly close personal relationship to the injured person.</p> <p>2. The relationship referred to in paragraph 1 shall be presumed to exist, unless the contrary is proved, between the deceased or injured person and his spouse, children, parents and siblings.</p> <p>3. In case of death of a person, the court may assign close family members (spouse, children, and parents) a fair monetary compensation for their suffered spiritual pain.</p>	<p>3. Zakonik može odrediti kako se izračunava naknada moralne štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 261</p> <p style="text-align: center;">Moralna šteta pretrpljena od trećih lica, kao rezultat smrti, telesne povrede ili narušavanja zdravlja osobe i novčana naknada</p> <p>1. Ako se trećem licu nanese moralna šteta, kao rezultat smrti, telesne povrede ili narušavanja zdravlja lica, lica odgovorna za takve štete dužna je da ponudi novčanu naknadu trećem licu ako u trenutku smrti, povrede ili narušavanja zdravlja to lice osoba ima posebno bliske lične odnose, sa povređenim licem.</p> <p>2. Odnos naveden u stavu 1, pretpostavlja se da postoji, osim ako se ne dokaže suprotno, između preminulog ili povređenog lica i supružnika, dece, roditelja i njegove braće i sestara.</p> <p>3. U slučaju smrti neke osobe, sud može odrediti članovima njegove uže porodice (supružniku, deci i roditeljima) pravičnu naknadu za njihov duševni bol.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 353 Dorëzimi për ruajtje personit tjetër</p>	<p style="text-align: center;">Article 353 Appointment of a third party for safekeeping</p>	<p style="text-align: center;">Član 353 Predaja na čuvanje drugom licu</p>
<p>1. Në rastin kur objekti i detyrimit është dorëzimi i një prone të paluajtshme, apo</p>	<p>1. Where the object of the obligation is the delivery of an immovable property, or any</p>	<p>1. U slučaju kada je predmet obaveze predaja nepokretne imovine, ili bilo koji druge stvari</p>

<p>ndonjë sendi tjetër që nuk mund të depozitohet në gjykatë, debitori mund të kërkojë që të emërohet një palë e tretë nga gjykata për ruajtjen në interesin e kreditorit.</p> <p>2. Në rastin e pronës së paluajtshme, pala e tretë duhet të veprojë si kujdestar.</p> <p>3. Gjykata mund të urdhërojë që sendi borxh të dorëzohet në një depo publike.</p> <p>4. Emërimi i një pale të tretë për ruajtje ka efektin e depozitimit në gjykatë.</p>	<p>other object that cannot be deposited with the court, the debtor may request that a third party be appointed by the court for safekeeping in the interest of the creditor.</p> <p>2. In the case of immovable property, the third party shall act as a custodian.</p> <p>3. The court may order that the owed object be delivered to a public warehouse.</p> <p>4. The appointment of a third party for safekeeping shall have the effect of deposit with the court.</p>	<p>koja se ne može položiti u sudu, dužnik može tražiti od suda da se imenuje treća stranka za očuvanje u interesu poverioca.</p> <p>2. U slučaju nepokretne imovine, treća stranka treba delovati kao čuvar.</p> <p>3. Sud može narediti da se dugovana stvar može položiti u nekom javnom skladištu.</p> <p>4. Imenovanje trećeg lica za čuvanje ima dejstvo polaganja na sudu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 354 Efektin e depozitimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 354 Effect of deposit</p>	<p style="text-align: center;">Član 354 Dejstvo polaganja</p>
<p>Nëse sendi i depozituar është pranuar nga kreditori, ose vendimi i formës së prerë nga gjykata konstaton se kërkesat për vlefshmërinë e ofertës formale dhe depozitimit janë plotësuar, debitori lirohet nga detyrimi.</p>	<p>If the deposit object is accepted by the creditor, or a final court decision determines that the requirements for the validity of the formal offer and the deposit are fulfilled, the debtor shall be released from his obligation.</p>	<p>Ako je položena stvar prihvaćena od strane poverioca, odnosno ukoliko pravosnažna sudska odluka zaključi da su ispunjeni uslovi za valjanost formalne ponude i polaganja, dužnik se oslobađa od obaveze.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 355 Rikthimi i sendit të depozituar</p>	<p style="text-align: center;">Article 355 Retrieval of deposit</p>	<p style="text-align: center;">Član 355 Uzimanje položene stvari natrag</p>
<p>1. Debitori mund ta rikthejë depozitën derisa kreditori të deklarojë se sendi i depozituar është pranuar ose një vendim i formës së prerë nga gjykata të konstatojë se kërkesat për</p>	<p>1. The debtor may retrieve the deposit until the creditor declares that the deposited object is accepted or a final court decision determines</p>	<p>1. Dužnik može vratiti položenu stvar dok poverilac proglasi da je položena stvar primljena ili kada pravosnažna sudska odluka zaključi da su ispunjeni uslovi za valjanost</p>

<p>vlefshmërinë e ofertës formale dhe depozitimit janë plotësuar.</p> <p>2. Për rikthimin e sendit të depozituar ka për detyrë ta njoftojë kreditorin.</p> <p>3. Në qoftë se debitori e merr sendin e depozituar konsiderohet se depozitimi nuk ka ndodhur kurrë.</p>	<p>that the requirements for the validity of the formal offer and the deposit are fulfilled.</p> <p>2. The debtor must inform the creditor that the object has been retrieved.</p> <p>3. If the debtor retrieves the deposited object the deposit shall be deemed to have never occurred.</p>	<p>formalne ponude i polaganja.</p> <p>2. Za vraćanje položene stvari dužan je da obavesti poverioca.</p> <p>3. Ako dužnik vrati položenu stvar smatra se da se polaganje nikada nije dogodilo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 356 Shpenzimet e depozitimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 356 Costs of deposit</p>	<p style="text-align: center;">Član 356 Troškovi polaganja</p>
<p>Shpenzimet e depozitimit të bërë në mënyrë të vlefshme mbulohen nga kreditori.</p>	<p>The costs of a deposit validly made shall be borne by the creditor.</p>	<p>Troškovi valjanog polaganja pokrivaju se od strane poverioca.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 357 Shitja në vend të depozitimit të sendit</p>	<p style="text-align: center;">Article 357 Sale instead of deposit of object</p>	<p style="text-align: center;">Član 357 Prodaja umesto polaganja stvari</p>
<p>1. Nëse një send nuk është i përshtatshëm për depozitim ose për ruajtje, ose në qoftë se kostot e depozitimit ose ruajtjes janë të tepërta në krahasim me vlerën e saj, debitori mund të kërkojë nga gjykata që të autorizohet për ta shitur atë në ankand publik dhe, pasi që të zbriten kostot e shitjes, ta depozitojnë shumën e fituar tek gjykata.</p> <p>2. Në qoftë se sendi ka çmimin vijues, apo në qoftë se ka vlerë të vogël në krahasim me shpenzimet e shitjes publike, debitori lirisht</p>	<p>1. If an object is not suitable for deposit or safekeeping, or if the costs of deposit or safekeeping are excessive in comparison to its value, the debtor may request from the court to be authorized to sell it at a public auction and, after deducting the costs of the sale, to deposit the amount so obtained with the court.</p> <p>2. If the object has a daily price or if it is of little value in comparison to the cost of a public auction the debtor may sell it out of</p>	<p>1. Ako je stvar nepodesna za čuvanje, ili ako su za njeno čuvanje ili za njeno održavanje potrebni troškovi nesrazmerni sa njenom vrednošću, dužnik može zatražiti od suda da bude ovlašćen za prodaju u javnoj aukciji nakon odbijanja troškova prodaje, da polože zarađeni iznos u sudu.</p> <p>2. Ako stvar ima tekuću cenu, ili ako je male vrednosti u poređenju sa troškovima javne</p>

<p>mund ta shesë.</p> <p>3. Në qoftë se sendi është i tillë që mund të shkatërrohet apo të prishet, debitori ka për detyrë ta shesë pa shtyrje në një mënyrë sa më të përshtatshme.</p> <p>4. Në çdo rast, debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për shitjen që ka ndërmend ta bëjë kurdo që të jetë e mundur, e pas shitjes së bërë ta njoftojë për çmimin e realizuar dhe për depozitimin e tij në gjykatë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 358 Shitja për të mbuluar shpenzimet e ruajtjes</p> <p>1. Në qoftë se shpenzimet e ruajtjes nuk paguhen brenda afatit të arsyeshëm, gjykata do të urdhërojë me kërkesën e ruajtësit, që sendi të shitet dhe do të caktojë mënyrën e shitjes.</p> <p>2. Nga shuma e realizuar prej shitjes do të zbriten shpenzimet e shitjes dhe shpenzimet e ruajtjes, ndërsa pjesa që mbetet do të depozitohet në gjykatë për kreditorin.</p>	<p>hand.</p> <p>3. If the object is such that it could be rapidly destroyed or spoilt the debtor must sell it without delay in the most suitable manner.</p> <p>4. In each case the debtor must whenever possible notify the creditor regarding the intended sale and, after the sale, regarding the price obtained and the deposit thereof with the court.</p> <p style="text-align: center;">Article 358 Sale to cover costs of safekeeping</p> <p>1. If the costs of safekeeping are not paid by an appropriate deadline the court shall at the request of the depositary order the sale of the object and shall stipulate the manner of sale.</p> <p>2. The costs of the sale and the costs of safekeeping shall be deducted from the sum obtained and the remainder shall be deposited with the court for the creditor.</p>	<p>prodaje, dužnik je može prodati iz slobodne ruke.</p> <p>3. Ako je stvar takva da može brzo propasti ili se pokvariti, dužnik je dužan prodati je bez odlaganja na najpogodniji način.</p> <p>4. U svakom slučaju, dužnik je dužan obavestiti poverioca o nameravanoj prodaji kad god je to moguće, a po izvršenoj prodaji, o postignutoj ceni i njenom polaganju kod suda.</p> <p style="text-align: center;">Član 358 Prodaja radi pokrića troškova čuvanja</p> <p>1. Ako troškovi čuvanja ne budu isplaćeni u razumnom roku, sud će, na traženje čuvara, narediti da se stvar proda i odrediti način prodaje.</p> <p>2. Od iznosa dobijenog prodajom odbiće se troškovi prodaje i troškovi čuvanja, a ostatak položiti kod suda za poverioca.</p>
---	--	---

<p>KAPITULLI XXIII – MËNYRAT TJERA TË SHUARJES SË DETYRIMIT</p> <p>Nënkapitulli I - Kompensimi</p> <p>Neni 359 Kushtet e përgjithshme</p> <p>1. Kur dy palë i kanë borxh njëri-tjetrit të holla ose sende tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj dhe të njëjtës cilësi, cildo prej tyre mund ta kompensojë detyrimin e tij ndaj palës tjetër, nëse është konstatuar ekzistenca e dy detyrimeve si dhe vlera e tyre [shuma] dhe se janë vonuar në përmbushjen e tyre.</p> <p>2. Edhe në qoftë se kushtet e këtij neni nuk janë plotësuar, palët mund t'i japin efekt me marrëveshje.</p> <p>Neni 360 Efektet</p> <p>1. Kompensimi shuan detyrimet e palëve deri në ujdinë për detyrimin më të vogël nga koha e ekzistencës së tij.</p> <p>2. Nëse kompensimi paraqitet në procedurë ligjore, kompensimi futet në fuqi nga data kur gjykata vendosë për meritat e</p>	<p>CHAPTER XXIII – OTHER MODALITIES OF TERMINATION OF AN OBLIGATION</p> <p>Sub-chapter I – Compensation</p> <p>Article 359 General Conditions</p> <p>1. Where two parties owe each other money or other replaceable items of the same type and the same quality, either of them may compensation its obligation against that of the other party if both obligations are ascertained as to their existence and value [amount] and have fallen due.</p> <p>2. Even if the conditions of this article are not met, the parties may give effect by an agreement.</p> <p>Article 360 Effects</p> <p>1. Compensation extinguishes the obligations of the parties up to concurrence of the lesser obligation from the time of their coexistence.</p> <p>2. If compensation is invoked in a legal proceeding, the compensation is effective from the date when the court decides the</p>	<p>POGLAVLJE XXIII - OSTALI NAČINI PRESTANKA OBAVEZA</p> <p>Potpoglavlje I - Nadoknada</p> <p>Član 359 Opšti uslovi</p> <p>1. Kad dve stranke duguju jedna-drugoj novac ili druge zamenjive stvari iste vrste i istog kvaliteta, bilo koji od njih može nadoknaditi svoju obavezu prema drugoj stranci, ako je utvrđeno postojanje dveju obaveza i njihove vrednosti [iznos] i da docne u njihovom ispunjenju.</p> <p>2. Čak i ako se ne ispune uslovi ovog člana, stranke mogu dati dejstvo preko sporazuma.</p> <p>Član 360 Dejstvo</p> <p>1. Nadoknadom prestaju obaveze ugovornih stranaka do saglasnosti za manje obaveze iz vremena njihovog postojanja.</p> <p>2. Ako se nadoknadom predstavlja u sudskom postupku, to stupa na snagu od dana kada je sud odlučuje o meritumu spora. Međutim, ako</p>
---	--	--

<p>mosmarrëveshjes. Megjithatë, nëse kundërpadia e palës që kërkon kompensim nuk kundërshtohet nga pala tjetër, zbatohet dispozita e paragrafit 1.</p> <p>3. Kompensimi nuk mund të përdoret <i>ex officio</i> nga gjyqtari.</p>	<p>merits of the dispute. However, if the counterclaim of the party invoking compensation was not contested by the other party, the provision of paragraph 1 applies.</p> <p>3. Compensation cannot be invoked <i>ex officio</i> by the court.</p>	<p>se protivtužba stranke koja traži nadoknadi ne osporava od druge stranke, primenjuju se odredbe iz stava 1.</p> <p>3. Nadoknada se ne može koristiti po službenoj dužnosti od strane sudije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 361 Njoftimi i kompensimit</p> <p>1. Kompensimi hyn në fuqi duke njoftuar palën tjetër. Njoftimi hyn në fuqi kur të arrin tek pala tjetër.</p> <p>2. Kur pala që ka dhënë njoftimin për kompensim ka dy ose më shumë detyrime ndaj palës tjetër, njoftimi është efektiv vetëm nëse përcakton detyrimin për të cilën ka të bëjë kompensimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 361 Notice of compensation</p> <p>1. Compensation is effected by notice to the other party. The notice shall be effective when it reaches the other party.</p> <p>2. Where the party giving notice of compensation has two or more obligations against the other party, the notice is effective only if it specifies the obligation to which the compensation relates.</p>	<p style="text-align: center;">Član 361 Najava o nadoknadi</p> <p>1. Nadoknada stupa najavom druge stranke. Najava stupa na snagu kada stigne kod druge stranke.</p> <p>2. Kada stranka koja je dala najavu o naknadi ime dve ili više obaveza prema drugoj stranci, najava stupa na snagu samo ako određuje obavezu za koju se vrši nadoknada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 362 Mungesa e reciprocitetit</p> <p>1. Garantuesi ka të drejtë për kompensim të detyrimit të debitorit ndaj kreditorit kundrejt detyrimit të kreditorit ndaj debitorit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 362 Lack of reciprocity</p> <p>1. The guarantor shall have the right to compensate the debtor's obligation to the creditor against the creditor's obligation to the debtor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 362 Odsustvo uzajamnosti</p> <p>1. Garant ima pravo na nadoknadu obaveze dužnika prema poveriocu naspram obaveze dužnika prema poveriocu.</p>

<p>2. E njëjta e drejtë i jepet palës së tretë që ka krijuar një peng apo hipotekë mbi pronën e tij si garanci për detyrimin tjetrit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 363 Kërkesa e parashkruar</p> <p>1. Një borxh mund të kompensohet me një kërkesë të parashkruar, vetëm nëse kjo kërkesë e parashkruar nuk ka qenë e parashkruar në momentin kur kanë ekzistuar kushtet për kompensim.</p> <p>2. Në qoftë se kushtet për kompensim janë krijuar pasi që një nga kërkesat është parashkruar, kompensimi nuk krijohet në qoftë se debitori i kërkesës së parashkruar ka theksuar kundërshtimin për parashkrim.</p>	<p>2. The same right is granted to the third party that has established a lien or mortgage on his own property as security for the obligation of another.</p> <p style="text-align: center;">Article 363 Prescribed claim</p> <p>1. A debt may be compensated by a statutory requirement only if this statutory requirement has not been complied with at the time when the conditions for compensation existed.</p> <p>2. If the conditions for compensation are established after one of the requirements has been prescribed, the compensation shall not be incurred if the debtor of the statutory claim has emphasized the objection to prescription.</p>	<p>2. Isto pravo se daje i trećoj stranci koja je stvorila hipoteku ili jemstvo nad njegovom imovinom kao osiguranje za obavezu drugoga.</p> <p style="text-align: center;">Član 363 Zastarelost potraživanja</p> <p>1. Jedan dug se može nadoknaditi zastarelim potraživanjem, samo ako ovo zastarelo potraživanje nije bilo zastarelo u trenutku kad su se stekli uslovi za nadoknadu.</p> <p>2. Ako su uslovi za nadoknadu nastali pošto je jedno od potraživanja zastarelo, nadoknada nastaje ako je dužnik zastarelog potraživanja istakao prigovor zastarelosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 364 Kompensimi në monedhë të huaj</p> <p>Kur palët i detyrohen njëra-tjetrës të holla në monedha të ndryshme, secila palë mund ta kompensojë të drejtën e palës kundër të drejtës së palës tjetër, përveç kur palët kanë rënë dakord që pala që e shpallë kompensimin duhet të paguhet vetëm në një monedhë të caktuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 364 Compensation in foreign currency</p> <p>Where parties owe each other money in different currencies, each party may compensate that party's right against the other party's right, unless the parties agreed that the payment is to be paid exclusively in a specified currency.</p>	<p style="text-align: center;">Član 364 Nadoknada u stranoj valuti</p> <p>Ukoliko stranke duguju jedna drugoj novac u različitim valutama, svaka stranka može nadoknaditi pravo stranke u odnosu na pravo druge stranke, osim ako su se stranke složile da ta stranka najavljuje nadoknadu treba platiti samo u određenoj valuti.</p>

<p align="center">Neni 365 Kompensimi me kërkesën e ceduar</p>	<p align="center">Article 365 Compensation against assigned claim</p>	<p align="center">Član 365 Nadoknada sa ustupljenim potraživanjem</p>
<p>1. Debitori i kërkesës së ceduar mund t'ia kompensojë marrësit ato kërkesa të veta të cilat deri në njoftimin mbi cedimin ka mundur t'ia kompensojë ceduesit.</p> <p>2. Ai mund ti kompensojë edhe ato kërkesa të veta nga ceduesi që i ka fituar para njoftimit për cedimin, afati i të cilave për cedim nuk ka skaduar në çastin kur është njoftuar për cedimin, por vetëm në qoftë se ky afat bie para afatit për përmbushjen e kërkesës së ceduar ose në të njëjtën kohë.</p> <p>3. Debitori që i ka deklaruar pa rezervë marrësit se e pranon cedimin, nuk mund t'i kompensojë me kurrë farë kërkesë të vet nga ceduesi.</p> <p>4. Në qoftë se kërkesa e ceduar është shkruar në regjistrat publikë, debitori mund t'ia bëjë kompensimin marrësit vetëm në qoftë se kërkesa e tij është e regjistruar me rastin e kërkesës së ceduar apo në qoftë se marrësi është njoftuar me rastin e cedimit për ekzistimin e kësaj kërkesë.</p>	<p>1. The debtor of an assigned claim may exercise with the recipient a compensation of the debtor's claims that could have been set off with the assignor prior to notification of assignment.</p> <p>2. The debtor may also compensation with the recipient those of the debtor's claims against the assignor that were acquired prior to the notification of assignment but whose deadline for fulfilment had not fallen due when the debtor was notified regarding the assignment, but only if they fall due before the deadline for the fulfilment of the assigned claim or simultaneously therewith.</p> <p>3. A debtor that without reservation declares to the recipient consent to the assignment may no longer exercise a compensation therewith of any of the debtor's claims against the assignor.</p> <p>4. If the assigned claim is recorded in public registers the debtor may only exercise a compensation of the debtor's claim with the recipient if such claim is recorded as an assigned claim or if the recipient was informed of its existence during assignment.</p>	<p>1. Dužnik ustupljenog potraživanja može nadoknaditi prijemniku ona svoja potraživanja koja je do obaveštenja o ustupanju mogao kompenzirati ustupiocu.</p> <p>2. Dužnik može nadoknaditi i ona svoja potraživanja od ustupioca koja je stekao pre obaveštenja o ustupanju, a čiji rok za ispunjenje nije bio dospeo u trenutku kada je obavešten o ustupanju, ali samo ako taj rok pada pre roka za ispunjenje ustupljenog potraživanja ili u isto vreme.</p> <p>3. Dužnik koji je bez rezerve izjavio prijemniku da pristaje na ustupanje ne može mu više nadoknaditi nikakvo svoje potraživanje od ustupioca.</p> <p>4. Ako je ustupljeno potraživanje upisano u javne registre, dužnik može izvršiti nadoknadu prijemniku samo ako je njegovo potraživanje upisano kod ustupljenog potraživanja ili ako je prijemnik izvešten prilikom ustupanja o postojanju tog potraživanja.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 366 Rastet e përjashtimit të kompensimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 366 When compensation is excluded</p>	<p style="text-align: center;">Član 366 Slučajevi kada je nadoknada isključena</p>
<p>1. Nuk mund të shuhen me kompensim:</p> <p>1.1. kërkesat të cilat nuk mund të sekuestrohen;</p> <p>1.2. kërkesat e sendeve, apo të vlerës së sendeve të cilat i janë dhënë debitorit për ruajtje, ose për huapërdorje, apo të cilat debitori i ka marrë në mënyrë të kundërligjshme, ose i ka mbajtur në mënyrë të kundërligjshme;</p> <p>1.3. kërkesat e krijuara nga shkaktimi i dëmit me dashje;</p> <p>1.4. kërkesat e kompensimit të dëmit, të cilat kërkesa janë krijuar me dëmtimin e shëndetit apo me shkaktimin e vdekjes;</p> <p>1.5. kërkesat që rrjedhin nga detyrimi ligjor i ushqimit.</p>	<p>1. The following may not terminate via compensation:</p> <p>1.1 claims that cannot be seized (sequestered);</p> <p>1.2 claims for objects or the value of objects that were placed with debtor for safekeeping or made available for loan for the debtor, or that the debtor unlawfully took or retained;</p> <p>1.3 claims arising through the intentional infliction of damage;</p> <p>1.4 compensation claims for damage done with damage to health or cause of death;</p> <p>1.5 claims deriving from a lawful obligation for maintenance.</p>	<p>1.ne mogu se prekinuti nadoknadom:</p> <p>1.1.potraživanja koja ne mogu biti oduzeta;</p> <p>1.2.potraživanja stvari ili vrednosti stvari koje su dužniku bile date na čuvanje, ili na posudu, ili koje je dužnik uzeo bespravno, ili ih bespravno zadržao;</p> <p>1.3.potraživanja nastala namernim prouzrokovanjem štete;</p> <p>1.4.potraživanja za nadoknadu štete pričinjene narušenjem zdravlja ili prouzrokovanjem smrti;</p> <p>1.5.potraživanja koja potiču iz zakonske obaveze izdržavanja.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Falja e Borxhit</p> <p style="text-align: center;">Neni 367 Marrëveshja</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Release from Debt</p> <p style="text-align: center;">Article 367 Agreement</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Otpuštanje duga</p> <p style="text-align: center;">Član 367 Sporazum</p>

<p>1. Detyrimi shuhet kur kreditori i deklaroi debitorit se nuk do të kërkojë përmbushjen e tij dhe debitori të jetë dakord me këtë.</p> <p>2. Për vlefshmërinë e kësaj marrëveshje nuk nevojitet që ajo të lidhet në formën sikur është kontraktuar puna nga e cila është krijuar detyrimi.</p>	<p>1. An obligation shall terminate if the creditor declares to the debtor that the creditor will not request performance thereof and the debtor consents to such.</p> <p>2. It shall not be necessary for the agreement to be concluded in the form in which the transaction from which the obligation originated was concluded for it to be valid.</p>	<p>1. Obaveza prestaje kad poverilac izjavi dužniku da neće tražiti njeno ispunjenje i dužnik se sa tim saglasi.</p> <p>2. Za punovažnost ovog sporazuma nije potrebno da bude zaključen u formi u kojoj je zaključen posao iz koga je nastala obaveza.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 368 Falja e borxhit dorëzanit</p>	<p style="text-align: center;">Article 368 Surety's release from debt</p>	<p style="text-align: center;">Član 368 Otpuštanje duga jemcu</p>
<p>1. Falja e borxhit dorëzanit nuk e liron debitorin kryesor, ndërsa falja e borxhit debitorit kryesor e liron dorëzanin.</p> <p>2. Kur ka disa dorëzanë dhe kreditori e liron nga detyrimi njërin prej tyre, të tjerëve u mbetet detyrimi, por detyrimi i tyre zbritet për pjesën e dorëzanit të liru.</p>	<p>1. The release from debt of the surety shall not release the principal debtor; upon the release from debt of the principal debtor the surety shall be released.</p> <p>2. If there are several sureties and the creditor releases one of them from the obligation the others shall remain bound; however, their obligation shall be reduced by the part falling to the released surety.</p>	<p>1. Otpuštanje duga jemcu ne oslobađa glavnog dužnika, dok otpuštanje duga glavnom dužniku oslobađa jemca.</p> <p>2. Kad ima više jemaca, pa poverilac oslobodi obaveze jednog od njih, ostali ostaju u obavezi, ali se njihova obaveza smanjuje za deo koji otpada na oslobođenog jemca.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 369 Falja e përgjithshme e borxheve</p>	<p style="text-align: center;">Article 369 General release from debt</p>	<p style="text-align: center;">Član 369 Opšte otpuštanje duga</p>
<p>Me faljen e përgjithshme të borxheve shuhet të gjitha kërkesat e kreditorit ndaj debitorit, përveç atyre për të cilat kreditori nuk ka ditur</p>	<p>Through a general release from debt all of the creditor's claims against the debtor shall expire, with the exception of those of which</p>	<p>Opštim otpuštanjem dugova prestaju sva poveriočeva potraživanja prema dužniku, izuzev onih za koja poverilac nije znao da</p>

<p>se ekzistojnë në çastin kur është bërë falja.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli III - Përtrirja</p> <p style="text-align: center;">Neni 370 Kushtet për përtëritje</p> <p>1. Detyrimi shuhet në qoftë se kreditori dhe debitori janë pajtuar që detyrimin ekzistues të zëvendësojnë me një tjetër dhe në qoftë se detyrimi tjetër ka objekt të ndryshëm ose bazë juridike të ndryshme.</p> <p>2. Marrëveshja e kreditorit dhe e debitorit me të cilën ndryshohet ose plotësohet dispozita mbi afatin, mbi vendin ose mbi mënyrën e përbushjes, pastaj marrëveshja e mëvonshme mbi kamatën, mbi dënimin kontraktues, mbi sigurimin e përbushjes, ose mbi ndonjë dispozitë tjetër aksesore, si dhe marrëveshja mbi dhënien e dokumentit të ri mbi borxhin, nuk konsiderohen si novacion.</p> <p>3. Dhënia e kambialit ose e çekut për shkak të ndonjë detyrimi të mëparshëm nuk konsiderohet si novacion, përveç nëse kjo është kontraktuar ashtu.</p> <p style="text-align: center;">Neni 371 Vullneti për të bërë novacion</p>	<p>the creditor did not know when the making the release from debt.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter III – Novation</p> <p style="text-align: center;">Article 370 Conditions for novation</p> <p>1. An obligation shall terminate if the creditor and the debtor agree to replace the existing obligation with a new obligation, and if the new obligation has a different subject or a different legal basis.</p> <p>2. Agreements between the creditor and the debtor by which a provision on the deadline , the place or the manner of performance are changed, much later agreements on interest, penalty, security for performance or on any other accessory provision, and agreements on the issue of a new debt document shall not be deemed novation.</p> <p>3. The issue of a bill of exchange or a cheque for reason of any previous obligation shall not be deemed novation, unless such is agreed.</p> <p style="text-align: center;">Article 371 Intention to enact novation</p>	<p>postoje u trenutku kad je izvršeno otpuštanje.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje III – Prenov (Novacija)</p> <p style="text-align: center;">Član 370 Uslovi za prenov</p> <p>1. Obaveza prestaje se ako se poverilac i dužnik saglase da postojeću obavezu zamene novom i ako nova obaveza ima različit predmet ili različit pravni osnov.</p> <p>2. Sporazum poverioca i dužnika kojim se menja ili dopunjuje odredba o roku, o mestu, ili o načinu ispunjenja, zatim naknadni sporazum o kamati, ugovornoj kazni, obezbeđenju ispunjenja ili o kojoj drugoj dodatnoj odredbi, kao i sporazum o izdavanju nove isprave o dugu, ne smatraju se novacijom.</p> <p>3. Izdavanje menice ili čeka zbog neke ranije obaveze ne smatra se novacijom, izuzev kad je to ugovoreno.</p> <p style="text-align: center;">Član 371 Volja da se izvrši novacija</p>
--	---	--

<p>Novacioni nuk ekziston, në qoftë se palët nuk e kanë deklaruar qëllimin që ta shuajnë detyrimin ekzistues kur kanë krijuar detyrimin e ri; atëherë detyrimi i mëparshëm nuk shuhet, por ekziston edhe më tutje krahas detyrimit të ri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 372 Efekti i novacionit</p> <p>1. Me kontratën për novacionin detyrimi i mëparshëm shuhet, kurse detyrimi i ri krijohet.</p> <p>2. Me detyrimin e mëparshëm shuhet edhe pengu dhe dorëzania, përveç nëse me dorëzanimin ose me pengdhënësin është kontraktuar ndryshe.</p> <p>3. E njëjta gjë vlen edhe për të drejtat e tjera aksesore, të cilat kanë qenë të lidhura me detyrimin e mëparshëm.</p>	<p>Novation shall not be presumed; therefore if the parties fail to express the intent that the current obligation should expire when the new obligation is created, the previous obligation shall not terminate but shall remain in addition to the new obligation.</p> <p style="text-align: center;">Article 372 Effects of novation</p> <p>1. Through a contract of novation the previous obligation shall terminate and a new obligation shall originate.</p> <p>2. Both pledge and surety shall terminate with the previous obligation, unless otherwise agreed with the surety or pledger.</p> <p>3. This shall also apply to other accessory rights in connection with the previous obligation.</p>	<p>Novacija ne postoji ako stranke nisu izrazile nameru da prestaju postojeću obavezu kad su stvarale novu obavezu; u tom slučaju ranija obaveza ne prestaje, već postoji i dalje pored nove obaveze.</p> <p style="text-align: center;">Član 372 Dejstvo novacije</p> <p>1. Ugovorom o novaciji prestaje ranije obaveza, i nastaje nova obaveza.</p> <p>2. Sa ranijom obavezom prestaju se i zalog i jemstvo, izuzev ako je drukčije ugovoreno sa jemcem ili zalogodavcem.</p> <p>3. Isto važi i za ostala dodatna prava koja su bila vezana za raniju obavezu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 373 Mungesa e detyrimit të mëparshëm</p> <p>1. Novacioni është pa efekt në qoftë se detyrimi i mëparshëm ka qenë nul ose është shuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 373 If there was no previous obligation</p> <p>1. The novation shall be ineffective if the previous obligation was null or had already expired.</p>	<p style="text-align: center;">Član 373 Nedostatak ranije obaveze</p> <p>1. Novacija je bez dejstva ako je ranija obaveza bila ništava ili je pretao.</p>

<p>2. Në qoftë se detyrimi i mëparshëm ka qenë vetëm i rrëzueshëm, novacioni është i vlefshëm po qe se debitori e ka ditur për të metën e detyrimit të mëparshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 374 Efekti i anulimit</p> <p>Kur kontrata mbi novacionin është shpallur e pavlefshme, konsiderohet se nuk ka pasur novacion dhe se detyrimi i mëparshëm as që ka pushuar së ekzistuari.</p>	<p>2. If the previous obligation was merely challengeable the novation shall be valid, if the debtor knew of the grounds for challenge.</p> <p style="text-align: center;">Article 374 Effect of invalidity</p> <p>If a contract of novation is annulled the novation shall be deemed never to have existed and the previous obligation shall be deemed never to have terminated.</p>	<p>2. Ako je ranija obaveza bila samo rušljiva, novacija je punovažan ako je dužnik znao za nedostatak ranije obaveze.</p> <p style="text-align: center;">Član 374 Dejstvo poništenja</p> <p>Kad je ugovor o novacija proglašen nevažećim smatra se da nije ni bilo novacije i da ranija obaveza nije ni prestala postojati.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV - Konfondimi</p> <p style="text-align: center;">Neni 375 Konfondimi</p> <p>1. Detyrimi shuhet me konfondim, kur i njëjti person bëhet si debitor ashtu edhe kreditor.</p> <p>2. Kur dorëzani bëhet kreditor, detyrimi i debitorit kryesor nuk shuhet.</p> <p>3. Detyrimet e regjistruara në regjistrat publike shuhet me anë të konfondimit vetëm pasi të bëhet regjistrimi i fshirjes.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Confounding</p> <p style="text-align: center;">Article 375 Confusion</p> <p>1. An obligation shall terminate through confounding if therein the same person becomes creditor and debtor.</p> <p>2. If the surety becomes the creditor the principal debtor’s obligation shall not terminate.</p> <p>3. An obligation recorded in a public register shall only terminate through confounding when the deletion thereof is recorded.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV - Sjedinjenje</p> <p style="text-align: center;">Član 375 Sjedinjenje</p> <p>1. Obaveza prestaje sjedinjenjem kada ista osoba postane kako dužnik tako i poverilac.</p> <p>2. Kada jemstvo postane poverilac, obaveza glavnog dužnika ne prestaje.</p> <p>3. Obaveza upisana u javnoj knjizi prestaju sjedinjenjem tek kad se izvrši ispis.</p>

<p align="center">Nënkapitulli V - Pamundësia e Përbushjes</p> <p align="center">Neni 376 Shuarja e detyrimit për shkak të pamundësisë së përbushjes</p> <p>1. Detyrimi shuhet kur përbushja e tij bëhet e pamundur për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi.</p> <p>2. Debitori duhet të provojë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë e tij.</p> <p align="center">Neni 377 Kur objekt i detyrimit është sendi i llojit specifik</p> <p>1. Në qoftë se objekt i detyrimit janë sendet e caktuara sipas llojit, detyrimi nuk shuhet as atëherë kur të gjitha ato që ka debitori nga këto sende zhduken për shkak të rrethanave, për të cilat ai nuk mban përgjegjësi.</p> <p>2. Mirëpo, kur detyrimi ka si objekt sendet e caktuara sipas llojit që duhet të merren nga masa e caktuar e atyre sendeve, atëherë detyrimi shuhet kur zhduket e gjithë ajo masë.</p>	<p align="center">Sub-chapter V – Impossibility of Performance</p> <p align="center">Article 376 Termination of the obligation due to impossibility to perform</p> <p>1. An obligation shall terminate if the performance thereof becomes impossible because of circumstances for which the debtor is not responsible.</p> <p>2. The debtor must prove circumstances that exclude the responsibility thereof.</p> <p align="center">Article 377 If the object is of a specific type</p> <p>1. If the object of an obligation is objects of a specific type the obligation shall not terminate when all such objects held by the debtor are destroyed because of circumstances for which the debtor is not responsible.</p> <p>2. Nevertheless an obligation shall terminate if the object of an obligation is objects of a specific type that it is necessary to take from a mass of such objects and the entire mass is destroyed.</p>	<p align="center">Potpoglavlje V – Nemogućnost ispunjenja</p> <p align="center">Član 376 Prestanak obaveze zbog nemogućnosti ispunjenja</p> <p>1. Obaveza prestaje kad njeno ispunjenje postane nemoguće usled okolnosti zbog kojih dužnik ne odgovara.</p> <p>2. Dužnik treba da dokaže okolnosti koje isključuju njegovu odgovornost.</p> <p align="center">Član 377 Kada je predmet obaveze stvar određene vrste</p> <p>1. Ako su predmet obaveze stvari određene vrste, obaveza ne prestaje čak i kad sve što dužnik ima od takvih stvari nestaju, usled okolnosti za koje on ne odgovara.</p> <p>2. Međutim, kad su predmet obaveza stvari određene vrsti koje se imaju uzeti iz određene mase tih stvari, obaveza prestaje kad nestaju cela ta masa.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 378 Cedimi i të drejtave ndaj të tretit përgjegjës për pamundësinë e përbushjes</p> <p>Debitori i sendit të caktuar që është shkarkuar nga detyrimi i vet për shkak të pamundësisë së përbushjes ka për detyrë t'i cedojë kreditorit të drejtën që do ta kishte ndaj personit të tretë për shkak të pamundësisë së krijuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 378 Cession of rights against third person responsible for impossibility of performance</p> <p>The debtor of a specific object that is released from an obligation because of the impossibility of performance must cede to the creditor the right that would be held against a third person due to whom the impossibility arose.</p>	<p style="text-align: center;">Član 378 Ustupanje prava prema trećem odgovornom za nemogućnost ispunjenja</p> <p>Dužnik određene stvari koji je oslobođen svoje obaveze usled nemogućnosti ispunjenja dužan je ustupiti poveriocu pravo koje bi imao prema trećem licu zbog nastale nemogućnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli VI - Mohimi i Ndërsjellë, Skadimi dhe Njoftimi i Shuarjes</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter VI – Mutual Dissent, Expiration and Notice of Termination</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje VI – Medusobno poricanje, istek i obaveštenje o prestanku</p>
<p style="text-align: center;">Neni 379 Shuarja me marrëveshje të ndërsjellë</p> <p>1. Me marrëveshje të ndërsjellë, palët janë të lira të zgjidhin kontratën në çdo moment.</p> <p>2. Zgjidhja e njëanshme lejohet vetëm në lidhje me kontratat për afat të pacaktuar dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 379 Termination by mutual agreement</p> <p>1. By their mutual agreement, the parties are free to terminate the contract at any moment.</p> <p>2. Unilateral termination is only allowed in respect of contracts for an indefinite period and in other cases provided by law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 379 Sporazumni raskid</p> <p>1. Stranke su slobodne da sporazumno, raskinu ugovor u bilo kojem trenutku.</p> <p>2. Jednostrani raskid je dozvoljen samo u vezi sa ugovorima na neodređeno vreme i u drugim slučajevima utvrđenim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 380 Data e skadimit dhe ripërtërirja automatike</p> <p>1. Kontrata për afat të pacaktuar pushon të prodhojë efekte në kohën e pajtuar nga palët,</p>	<p style="text-align: center;">Article 380 Expiry date and automatic renewal</p> <p>1. A contract for a definite period ceases to produce its effects at the time agreed by the</p>	<p style="text-align: center;">Član 380 Datum isteka i automatska obnova</p> <p>1. Ugovor na neodređeno vreme prestaje da proizvodi dejstva u vreme kako su se složile</p>

<p>përveç nëse kontrata siguron ripërtërirjen automatike të kontratës. Në këtë rast, kontrata heshturazi përtërihet nëse pala nuk jep njoftimin e anulimit për palën tjetër brenda afatit kohor të specifikuar në kontratë.</p> <p>2. Në rast të ripërtërirjes automatike të kontratës, kontrata ripërtërihet për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e kontratës fillestare, përveç nëse kontrata apo ligji përcaktojnë ndryshe.</p>	<p>parties, unless the contract provides for the automatic renewal of the contract. In this case, the contract is tacitly prolonged if a party fails to give notice of cancellation to the other party within the deadline specified in the contract.</p> <p>2. In case of automatic renewal of the contract, the contract is prolonged for a period equal to the original duration of the contract, unless the contract or the law provide otherwise.</p>	<p>stranke, osim ako ugovor predviđa automatsku obnovu ugovora. U ovom slučaju, ugovor se prećutno obnavlja ako stranka ne daje obaveštenje o raskidu drugoj stranci u navedenom roku u ugovoru.</p> <p>2. U slučaju automatskog obnova ugovora, ugovor se obnavlja za period koji je jednak trajanju osnovnog ugovora, osim ako ugovor ili zakon predviđa drugačije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 381 Denoncimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 381 Notice of termination</p>	<p style="text-align: center;">Član 381 Otkazivanje</p>
<p>1. Përveç nëse ligji përcakton ndryshe, secila palë në kontratën me afat të pacaktuar mund të zgjidhë kontratën duke i dhënë njoftim paraprak palës tjetër.</p> <p>2. Kontrata konsiderohet e zgjidhur kur skadon periudha e njoftimit e përcaktuar me kontratë apo me ligj. Nëse periudha e tillë nuk ekziston, kontrata konsiderohet e zgjidhur pas skadimit të periudhës së kërkuar sipas përdorimit të saj, apo pas një afati kohor të përshtatshëm për natyrën e kontratës.</p>	<p>1. Unless the law provides otherwise, either party to a contract for an indefinite period may terminate the contract by giving advance notice to the other.</p> <p>2. The contract shall be deemed terminated when the notice period specified in the contract or in the law expires. If no such period exists, the contract shall be deemed terminated after the expiry of the period required according to usages, or of an appropriate deadline having regard to the nature of the contract.</p>	<p>1. Ako zakonom nije drugačije određeno, svaka stranka u ugovoru na neodređeno vreme može raskinuti ugovor davanjem prethodnim obaveštenjem drugoj stranci.</p> <p>2. Ugovor se smatra raskinutim po isteku otkaznog roka navedenog u ugovoru ili po zakonu. Ako nema tog perioda, ugovor se smatra raskinutim po isteku potrebnog perioda u skladu sa njegovom upotrebom, ili nakon odgovarajućeg vremenskog roka za prirodu ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 382 Efektet e zgjidhjes</p>	<p style="text-align: center;">Article 382 Effects of termination</p>	<p style="text-align: center;">Član 382 Dejstva raskida</p>

<p>Përveç nëse palët pajtohen ndryshe, zgjidhja e kontratës përmes pajtimit të ndërsjellë apo njoftimit për zgjidhje, apo për shkak të datës së skadimit, nuk ndikon në përmbushjen e ndonjë detyrimi që është dashur të bëhet para zgjidhjes së saj.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli VII - Vdekja</p> <p style="text-align: center;">Neni 383 Vdekja</p> <p>Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njëres nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit.</p> <p>KAPITULLI XXIV – PARASHKRIMI</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I – Afati i Parashkrimit</p> <p style="text-align: center;">Neni 384 Kërkesat periodike</p> <p>1. Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato</p>	<p>Unless the parties agree otherwise, termination of the contract through mutual agreement or a notice of termination, or due to the expiration date, does not affect the performance of any obligation performance of which was due before termination.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter VII – Death</p> <p style="text-align: center;">Article 383 Death</p> <p>An obligation shall terminate through the death of the creditor or the debtor only if it originated with regard to the personal attributes of either of the contracting parties or with regard to the personal capabilities of the debtor.</p> <p>CHAPTER XXIV STATUTE-BARRING</p> <p style="text-align: center;">Subchapter I - Statute-barring period</p> <p style="text-align: center;">Article 384 Periodic claims</p> <p>1. Claims for periodic charges that fall due annually or at specific shorter time intervals</p>	<p>Osim ako se stranke ne dogovore drugačije, sporazumni raskid ugovora ili obaveštenja o raskidu, ili zbog isteka roka trajanja, ne utiče na ispunjenje obaveze koja je trebala učiniti pre njenog raskida.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje VII – Smrt</p> <p style="text-align: center;">Član 383 Smrt</p> <p>Smrcu dužnika ili poverioca prestaje obaveza samo kada je stvorena uzimajući u obzir prestanak lične pojedinosti jedne od ugovornih strana ili lične sposobnosti dužnika.</p> <p>POGLAVLJE XXIV - ZASTARELOST</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje I – Rok zastarelosti</p> <p style="text-align: center;">Član 384. Periodična potraživanja</p> <p>1. Potraživanja periodičnih davanja koja dospevaju godišnje ili u kraćim određenim razmacima vremena (periodična potraživanja),</p>
---	---	---

<p>kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.</p> <p>2. E njëjta gjë vlen për pensionet vjetore me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shuma të barabarta të përcaktuara më parë, por nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjesshme.</p> <p>3. Pavarësisht paragrafit të parë të këtij neni, kamata në kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se tri (3) vjet, parashkruhen pas kalimit të periudhës së njëjtë si për kërkesën kryesore.</p>	<p>(periodic claims) shall become statute-barred three (3) years after each individual charge falls due, whether they are accessory periodic claims, such as interest claims, or such periodic claims by which a right itself is drawn upon, such as maintenance claims.</p> <p>2. The same shall apply to annuities by which a principal and interest is repaid in equal periodic amounts stipulated in advance, but shall not apply to instalments and other part performance.</p> <p>3. Irrespective of the first paragraph of this article interest on claims whose statute-barring period is less than three (3) years shall become statute-barred after the same period as the principal claim.</p>	<p>bilo da se radi o dodatnim periodičnim potraživanjima, kao što je potraživanje kamata, bilo da se radi o takvim periodičnim potraživanjima u kojima se iscrpljuje samo pravo, kao što je potraživanje izdržavanja, zastarevaju za tri (3) godine od dospelosti svakog pojedinog davanja.</p> <p>2. Isto važi za godišnje penzije kojima se plaćaju iznos glavnice i kamate u jednakim unapred određenim iznosima, ali ne važi za otplate na rate ili za druga delimična ispunjenja.</p> <p>3. Nezavisno od stava 1 ovog člana, kamata na potraživanja čiji je rok zastarelosti manji od tri (3) godine, zastareva posle isteka istog roka kao i za glavnice.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 385 Parashkrimi i vet të drejtës</p> <p>1. Vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhet për pesë (5) vite duke llogaritur nga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie.</p> <p>2. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të</p>	<p style="text-align: center;">Article 385 Statute-barring of actual right</p> <p>1. The actual right from which periodic claims originate shall become statute-barred five (5) years after the oldest unfulfilled claim following which the debtor failed to fulfil any more charges fell due.</p> <p>2. If a right from which periodic claims originate becomes statute-barred the creditor shall lose not only the right to demand future</p>	<p style="text-align: center;">Član 385 Zastarelost samog prava</p> <p>1. Samo pravo iz koga proističu periodična potraživanja zastareva za pet (5) godina, računajući od dospelosti najstarijeg neispunjenog potraživanja posle koga dužnik nije vršio davanja.</p> <p>2. Kad zastari pravo iz koga proističu periodična potraživanja, poverilac gubi pravo ne samo da zahteva buduća periodična</p>

<p>ardhshme periodike, por edhe prestime periodike të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi.</p> <p>3. Nuk mund të parashkruhet e drejta e ushqimit e caktuar me ligj.</p>	<p>periodic charges, but also the right to claim periodic charges that fell due before the statute-barring.</p> <p>3. The right to maintenance pertaining to someone by law may not become statute-barred.</p>	<p>davanja, nego i periodična davanja koja su dospela za isplatu pre ove zastarelosti.</p> <p>3. Ne može zastariti pravo na izdržavanje određeno zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 386 Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale</p> <p>1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite.</p> <p>2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.</p>	<p style="text-align: center;">Article 386 Claims from commercial contracts</p> <p>1. Claims from commercial contracts and claims for the return of expenditure arising in connection with such contracts shall become statute-barred after three (3) years.</p> <p>2. The statute-barring period shall run separately for each supply of goods, performance of work and provision of services.</p>	<p style="text-align: center;">Član 386 Međusobna potraživanja iz privrednih ugovora</p> <p>1. Međusobna potraživanja iz privrednih ugovora kao i potraživanja naknade za izdatke učinjene u vezi s tim ugovorima, zastarevaju za tri (3) godine.</p> <p>2. Zastarevanje teče odvojeno za svaku isporuku robe, izvršeni rad ili uslugu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 387 Kërkesa e qirasë</p> <p>Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht, ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shuma totale, parashkruhet për tri (3) vite.</p>	<p style="text-align: center;">Article 387 Claims for rent</p> <p>Claims for rent, whether it is stipulated that it be paid periodically or in a lump sum, shall become statute-barred after three (3) years.</p>	<p style="text-align: center;">Član 387 Potraživanje zakupnine</p> <p>Potraživanje zakupnine, bilo da je određeno da se plaća povremeno, bilo u jednom ukupnom iznosu, zastareva za tri (3) godine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 388 Kërkesa e shpërblimit të dëmit</p>	<p style="text-align: center;">Article 388 Compensation claims</p>	<p style="text-align: center;">Član 388 Potraživanje naknade štete</p>

<p>titullarit i cili e ka kërkesën e siguruar me rezervim</p> <p style="text-align: center;">Neni 950 Shlyerja e rezervimit për kërkesat e përjashtuara</p> <p>1. Nëse parashtrimi i kërkesës, të cilën shënimi duhet ta sigurojë është e përjashtuar për kohë të gjatë, pala e detyruar mund të kërkojë nga kreditori pëlqimin për mënjanimin e shënimit.</p> <p>2. Në qoftë se kreditori, kërkesa e të cilit është siguruar përmes shënimit është i panjohur, atëherë përmes një procedure të shpalljes ai mund të përjashtohet nga e drejta e tij, nëse që nga regjistrimi i fundit në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri i cili ka të bëjë me shënimin kanë kaluar (10) dhjetë vjet dhe në këtë periudhë kohore nuk ka pasuar asnjë njohje të së drejtës nga i detyruari.</p>	<p>are liable to the person whose claim is secured by the reservation</p> <p style="text-align: center;">Article 950 Removal of reservation for barred claims</p> <p>1. If the assertion of the claim, which is secured by the priority notice, is permanently precluded, the obliged party may demand the removal of the priority notice from the creditor.</p> <p>2. If the creditor, whose claim is secured by the priority notice, is unknown, he may be precluded by means of public notice if ten (10) years since the last entry regarding the priority notice in the register have passed and if the obliged party has not acknowledged the claim in this period of time.</p>	<p>obezbeđeno potraživanje rezervacijom.</p> <p style="text-align: center;">Član 950 Ispisivanje rezervacije za isključena potraživanja</p> <p>1. Ako podnošenje potraživanja, koju beleška treba da osigura, je isključeno na dugo vreme, obavezna strana može potražiti od poverioca saglasnost za uklanjanje beleške.</p> <p>2. Ako poverilac, čije je potraživanje obezbeđeno preko beleške nepoznato, onda, preko postupka proglašenja on može da bude isključen od svog prava, ako je od zadnjeg upisa u registru prava na nepokretnostima, u vezi sa beleškom, isteklo (10) deset godina i u tom vremenskom periodu nije imalo nikakvog priznanja prava od obavezanog.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 951 Prezumimi ligjor</p> <p>1. Në qoftë se një e drejtë është regjistruar në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri, prezumohet se ajo e drejtë i takon atij për të cilin është regjistruar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 951 Legal presumption</p> <p>1. If a right has been registered in the Immovable Property Rights Register for the benefit of a person, it is presumed that such person is entitled to the right so registered.</p>	<p style="text-align: center;">Član 951 Pravna pretpostavka</p> <p>1. Ako je pravo upisano u registar prava na nepokretnostima, pretpostavlja se da to pravo pripada onom na koga je upisano.</p>

<p>2. Në qoftë se një e drejtë është shlyer nga Regjistri i të drejtave në paluajtshmëri, prezumohet se ajo e drejtë nuk ekziston më.</p> <p style="text-align: center;">Neni 952 Korrigjimi i Regjistrit të të Drejtave në Paluajtshmëri</p> <p>1. Nëse përmbajtja e Regjistrit të të Drejtave në paluajtshmëri nuk është e përputhshme me statusin e vërtetë juridik në lidhje me të drejtën në paluajtshmëri, personi, e drejta e të cilit nuk është regjistruar apo është regjistruar gabimisht, apo është dëmtuar nga regjistrimi i pengut apo kufizimit që nuk ekziston, mund të kërkojë miratimin e korrigjimit të Regjistrit të të Drejtave në paluajtshmëri nga personi, e drejta e të cilit preket nga ky korrigjim.</p> <p>2. Kërkesat për korrigjim të regjistrit të paluajtshmërive nuk i nënshtrohen parashkrimit.</p> <p>PJESA E PESTË - TË DREJTAT E SIGURIMIT SENDOR</p> <p>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p>	<p>2. If a registered right is deleted from the Immovable Property Rights Register, it is presumed that such right does not exist anymore.</p> <p style="text-align: center;">Article 952 Correction of the Immovable Property Rights Register</p> <p>1. If the contents of the Immovable Property Rights Register are not consistent with the actual legal position with regard to a right in the immovable property, the person whose right is not registered or not correctly registered or is disadvantaged by the registration of an encumbrance that does not exist may require approval of the correction of the Immovable Property Rights Register from the person whose right is affected by the correction.</p> <p>2. The claims for correction of the Immovable Property Rights Register are not subject to the prescription.</p> <p>PART FIVE - PROPRIETARY SECURITY RIGHTS</p> <p>CHAPTER I – GENERAL PROVISIONS</p>	<p>2. Ako je pravo ispisano iz registra prava na nepokretnostima, pretpostavlja se da takvo pravo više ne postoji.</p> <p style="text-align: center;">Član 952 Ispravka u registru prava na nepokretnostima</p> <p>1. Ako sadržaj registra prava na nepokretnostima nije u skladu sa stvarnim pravnim stanjem u pogledu prava na nepokretnostima, lice, čije pravo nije upisano ili je pogrešno upisano, ili je oštećen od upisa zaloge ili ograničenja koje ne postoji, može potražiti odobrenje ispravke registra prava na nepokretnostima, od lica čije se pravo trpi od ove ispravke.</p> <p>2. Zahtevi za ispravku registra prava na nepokretnostima nisu predmet zastarelosti.</p> <p>DEO PETI – PRAVO STVARNOG OSIGURANJA</p> <p>POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 953 Të drejtat e sigurimit sendor</p> <p>1. Një e drejtë e sigurimit sendor e legjitimon kreditorin e siguruar (sigurimarrësin), që në rast të shfaqjes së kushteve të caktuara me kontratë ose të caktuara me ligj, në veçanti tek arritshmëria e kërkesës së siguruar me përparësi para kreditorëve të tjerë të siguridhënësit të kërkojë përmbushjen e kërkesës së siguruar si edhe të kamatës dhe kostove nga e mira e siguruar.</p> <p>2. Siguridhënësi mund ta krijojë të drejtën siguruese për sigurimin e një borxhi të vet ose si një dorëzanë për sigurimin e borxhit të një personi tjetër.</p>	<p style="text-align: center;">Article 953 Proprietary security rights</p> <p>1. A security of real right entitles the secured creditor (“Secured Party”), to obtain payment of the secured claim and of interest and costs from the encumbered assets with priority before the other creditors of the party granting security (“Security Grantor”), if the contractually agreed or legally prescribed conditions have occurred, in particular upon maturity of the secured claim.</p> <p>2. The Security Grantor can create a security right in order to secure a personal debt or as a surety to secure the debt of another person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 953 Prava stvarnog osiguranja</p> <p>1. Pravo stvarnog osiguranja legitimiše osiguranog poverioca (osiguranik), da u slučaju pojave određenih uslova ugovorom ili zakonom, posebno kod dospeća osiguranog potraživanja sa prednošću pred ostalim poveriocima, osiguravača da od osiguranog potraži ispunjavanje osigurane potražnje kao i kamate i troškova od osiguranog dobra.</p> <p>2. Osiguravač može stvoriti osiguravajuće pravo osiguraa lični dug ili kao jemstvo za osiguranje duga nekog drugog lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 954 Baza ligjore</p> <p>Të drejtat e sigurimit sendor mund të krijohen vetëm në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe ligjeve të veçanta.</p>	<p style="text-align: center;">Article 954 Legal basis</p> <p>Proprietary security rights can be created only pursuant to the provisions of this Code and specific laws.</p>	<p style="text-align: center;">Član 954 Pravni osnov</p> <p>Prava stvarnog osiguranja se mogu stvoriti samo u skladu sa odredbama ovog zakonika i posebnim zakonima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 955 Fusha e aplikimit</p> <p>1. Dispozitat e këtij titulli zbatohen në të gjitha punët juridike dhe disponimet pa marrë</p>	<p style="text-align: center;">Article 955 Scope of application</p> <p>1. The provisions of this Chapter apply to all legal transactions and dispositions, regardless</p>	<p style="text-align: center;">Član 955 Delokrug primene</p> <p>1. Odredbe ovog poglavlja odnose se na sve pravne poslove i raspolaganja bez obzira na</p>

<p>parasysh formën e tyre, të cilat pas rregullimit të tyre ndjekin qëllimin që të krijojnë një siguri sendore. Dispozitat e këtij titulli zbatohen sidomos në:</p> <p>1.1. një kontratë, përmes së cilës shitësi ia lë për shfrytëzim blerësit vlerat pasurore të blera, por kalimin e pronësisë mbi blerësin e bënë të varur nga kushti, që blerësi të paguajë çmimin e blerjes për vlerën pasurore të blerë (pengu i çmimit të blerjes); si dhe</p> <p>1.2. një kontratë të qirasë, respektivisht një kontratë të lizingut (qirasë financiare), në të cilën qiradhënësi si pronar i vlerave pasurore të dhëna me qira respektivisht me lizing ia dorëzon qiramarrësit ose lizingmarrësit për shfrytëzim dhe për një fitim të mëvonshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 956 Përjashtimet</p>	<p>of their form, which have the purpose of creating a proprietary security right. The provisions of this Chapter also apply in particular to:</p> <p>1.1. a contract through which the seller transfers the sold assets for use to the buyer but subject to the transfer of ownership to the buyer on the condition that the buyer pays the purchase price for the assets acquired (“pledge for the price of purchase”); and</p> <p>1.2. a lease contract, respectively a leasing contract (financial lease), by which the lessor as owner of the assets leased, respectively given for leasing, transfers these assets to the lessee, respectively financial lessee, for use and subsequent acquisition.</p> <p style="text-align: center;">Article 956 Exclusions</p>	<p>njihov oblik, koje nakon njihovog regulisanja imaju za cilj stvaranje stvarnog osiguranja. Odredbe ovog poglavlja, konkretno se primenjuju na:</p> <p>1.1. ugovor kojim prodavac daje kupljene imovinske vrednosti kupcu na korišćenje, ali prenos državine na kupca čini ovisnim od uslova da kupac plati kupovnu cenu za kupljenu imovinu (zaloga za kupovnu cenu); i</p> <p>1.2. ugovor o zakupu, odnosno ugovor o lizingu (finansijski zakup), kojim zakupodavac kao sopstvenik svojine koju daje pod zakup, odnosno lizing, prenese zakupcu ili primaocu lizinga ovu svojinu, radi korišćenja i docnijeg sticanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 956 Izuzeci</p>
<p>1. Dispozitat e kësaj pjese nuk zbatohen në:</p> <p>1.1. krijimin e një të drejte siguroese mbi kërkesën për pagën të një punëtori; dhe</p> <p>1.2. shitjen e kërkesave në të holla në kuadër të shitjes së një ndërmarrje.</p>	<p>1. The provisions of this Chapter do not apply to:</p> <p>1.1. the creation of a security right in the salary claims of an employee; and</p> <p>1.2. sale of pecuniary claims in the context of the sale of a business organization.</p>	<p>1. Odredbe ovog dela se ne primenjuju na:</p> <p>1.1. stvaranje osiguravajućeg prava na potraživanje plate zaposlenog; i</p> <p>1.2. prodaju potraživanja u novcu u okviru prodaje preduzeća.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 957 Marrëveshja siguruese</p> <p>1. Përmes marrëveshjes siguruese, siguridhënësi detyrohet që sigurimarrësit t'ia vë një siguri sendore.</p> <p>2. Marrëveshja siguruese mund të jetë një kontratë e pavarur apo të jetë e përmbajtur në një kontratë tjetër, në veçanti në një kontratë kredie.</p> <p>3. Siguridhënësi mund të jetë debitori i kërkesës së siguruar apo një i tretë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 957 Security agreement</p> <p>1. By means of a security agreement, the Security Grantor assumes the obligation to grant a proprietary security right to the secured creditor.</p> <p>2. The security agreement can be an independent contract or can be included in another contract, in particular in a credit agreement.</p> <p>3. The Security Grantor may be the debtor of the secured claim or a third party.</p>	<p style="text-align: center;">Član 957 Osiguravajući sporazum</p> <p>1. Kroz osiguravajući sporazum, osiguravač se obavezuje da osiguraniku izda osiguranje stvari.</p> <p>2. Osiguravajući sporazum može biti nezavistan ili sadržajni ugovor u drugom ugovoru, posebno u ugovoru o kreditu.</p> <p>3. Osiguravač može biti dužnik osiguranog potraživanja ili treća strana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 958 Marrëveshjet nule</p> <p>1. Marrëveshja, e cila është lidhur para arritshmërisë të kërkesës së siguruar është nule, nëse ajo përcakton që në rast të mos pagesës pas arritjes të kërkesës së siguruar vlera pasurore e siguruar të kalojë në pronësi të sigurimarrësit ose vlera pasurore e siguruar të shitet me një çmim të caktuar, përveç nëse me ligj të veçantë nuk parashihet ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 958 Void agreements</p> <p>1. An agreement, entered into before the secured claim has matured, is void if it provides that upon non-payment after maturity of the secured claim the encumbered assets are to become or to be transferred into the ownership of the secured creditor or the encumbered assets are to be sold at a fixed price, unless stipulated otherwise by a specific law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 958 Ništavi sporazumi</p> <p>1. Sporazum koji je sklopljen pre dospevanja osiguranog potraživanja je ništav, ako se u istom predviđa da u slučaju neplaćanja nakon dospevanja osiguranog potraživanja opterećena svojina se prenosi u državini osiguranika; ili osigurana svojina bude prodana fiksnom cenom, osim ako posebnim zakonom nije drugačije određeno.</p>

<p>2. Pas arritshmërisë të kërkesës së siguruar janë të lejuara marrëveshjet e përmendura në paragrafin e mëparshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 959 Kërkesa e siguruar</p> <p>Një e drejtë sendore e sigurimit mund të caktohet për sigurimin e kërkesave aktuale, të ardhshme ose të kushtëzuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 960 Parashkrimi i kërkesës së siguruar</p> <p>E drejta e sigurimit sendor mund të ushtrohet edhe atëherë, kur kërkesa e siguruar është parashkruar.</p>	<p>2. After maturity of the secured claim, the agreements mentioned in the preceding paragraph can validly be concluded.</p> <p style="text-align: center;">Article 959 Secured claim</p> <p>A security of a real right can be granted for securing present, future and conditional claims.</p> <p style="text-align: center;">Article 960 Extinctive prescription of a secured claim</p> <p>A security of a real right can be exercised even if the period of extinctive prescription for the secured claim has expired.</p>	<p>2. Nakon dospevanja osiguranog potraživanja, navedeni sporazumi iz prethodnog stava su dozvoljeni.</p> <p style="text-align: center;">Član 959 Osigurano potraživanje</p> <p>Stvarno pravo osiguranja se može odrediti za osiguranje sadašnjih, budućih ili uslovnih potraživanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 960 Zastarelost osiguranog potraživanja</p> <p>Pravo stvarnog osiguranja može se ostvariti čak i kada je osigurano potraživanje zastarelo.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI II – PENGU</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I - Dispozitat e Përgjithshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 961 Pengu</p> <p>1. E drejta e pengut do të thotë krijimi i ndonjë interesi mbi sendin e luajtshëm ose mbi ndonjë të drejte me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për ta marrë në posedim atë send ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë detyrimi ekzistues dhe</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER II – PLEDGE</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter I – General Provisions</p> <p style="text-align: center;">Article 961 Pledge</p> <p>1. “Pledge” means the creation by agreement or by law of an interest in movable asset or over a right, which gives the pledgee the right to take possession of such property or exploit such right for the purpose of satisfying an existing and sufficiently identifiable obligation that is secured by the pledge.</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE II - ZALOG</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje I - Opšte odredbe</p> <p style="text-align: center;">Član 961. Zalog</p> <p>1. Založno pravo podrazumeva stvaranje nekog interesa nad pokretnoj stvari ili na neko pravo na osnovu sporazuma ili na osnovu zakona, koji daje pravo zalogoprimcu da raspolaže tom svojinom ili da iskoristi to pravo u cilju ispunjavanja neke postojeće i prepoznatljive obaveze koja je osigurana</p>

<p>të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut.</p> <p>2. Kontrata e pengut mund t'i shmanget dispozitave të këtij kapitulli. Në raste të veçanta ajo mund të parasheh që pengu të sigurojë ndonjë detyrim i cili ka efekt vetëm pas lidhjes së kontratës së pengut.</p>	<p>2. The pledge agreement may deviate from the provisions of this Chapter. It may in particular provide for a pledge to secure an obligation that will only come into existence after the conclusion of the pledge agreement.</p>	<p>zalogram.</p> <p>2. Ugovor o zalozi može odstupiti od odredaba ove glave. U posebnim slučajevima može da predviđa da zaloga osigura neku obavezu koja ima dejstvo samo nakon zaključivanja ugovora o zalogu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 962 Llojet e pengut</p>	<p style="text-align: center;">Article 962 Types of pledge</p>	<p style="text-align: center;">Član 962 Vrste zaloga</p>
<p>1. Nëse pengdhënësi dhe pengmarrësi nuk janë marrë vesh në kontratën për pengun që pengu të jetë posedimor, pengdhënësi e ruan të drejtën për ta poseduar, përdorur dhe për t'i gëzuar të gjitha të drejtat në sendin e lënë peng, në aso mënyre siç ai send përdoret zakonisht.</p>	<p>1. Unless the pledger and the pledgee agree in the pledge agreement that the pledge is possessory, the pledger retains the right to possess, use and otherwise enjoy all rights in the pledged property in a manner consistent with the ordinary use of such property.</p>	<p>1. Ako se zalagodavac i zalogoprimec nisu dogovorili u ugovoru o zalogu da zalog bude posedni, zalagodavac zadržava pravo na raspolaganje, korišćenje i da uživa sva prava o stvari koja je pod zalogom na način koji je u skladu sa uobičajenom upotrebom takve stvari.</p>
<p>2. Pengu posedimor ka efekt ndaj personave të tretë vetëm atëherë kur të nënshkruhet kontrata për pengun dhe kur sendi i lënë peng të ketë kaluar në posedim të pengmarrësit ose të agjentit të caktuar nga pengmarrësi.</p>	<p>2. A possessory pledge is effective against third parties at the time the pledge agreement is signed and the pledged property has come into the possession of the pledge holder or the pledge holder's designated agent.</p>	<p>2. Posedni zalog ima dejstvo prema trećim licima onda kada u vreme zaključivanja ugovora o zalogu i kada založena imovina pređe u svojину zalogoprimeca ili agenta određenom od strane zalogoprimeca.</p>
<p>3. Dhënia e bashkëposedimit mjafton në vend të dorëzimit të sendit të lënë peng nëse sendi është nën kontrollin e përbashkët të pengmarrësit, ose, nëse është në posedim të një pale të tretë, mund të dorëzohet vetëm bashkërisht tek pengdhënësi dhe pengmarrësi.</p>	<p>3. Granting co-possession suffices instead of delivery of the pledged property if the property is under the joint control of the pledge holder or, if it is in the possession of a third party, it may be delivered only to the pledger and the pledge holder jointly.</p>	<p>3. Odobravanje su državine je dovoljno umesto dostavljanja založene stvari ako je stvar pod zajedničkom kontrolom zalogoprimeca ili, ako je na raspolaganju trećeg lica, može se dostaviti samo zalagodavcu i zalogoprimecu zajedno.</p>

<p>4. Pengu pa posedim ka efekt ndaj palëve të treta vetëm atëherë kur të parashtrohet deklarata për njoftim sipas kritereve të vendosura me ligj.</p> <p>5. Krijimi i të drejtë së pengut mbi ndonjë të drejtë kërkon regjistrimin e pengut në regjistrin e pengut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 963 Pengu ligjor</p>	<p>4. A non-possessory pledge is effective against third parties at the time a notification statement is filed in accordance with the law.</p> <p>5. The creation of pledge over a right requires the registration of the pledge in the pledge register.</p> <p style="text-align: center;">Article 963 Statutory pledge</p>	<p>4. Zalog bez poseda ima dejstvo prema trećim licima samo onda kada se dostavi izjava o obaveštenju u skladu sa zakonom.</p> <p>5. Stvaranje prava zaloge nad nekim pravom zahteva upis zaloge u registru zalogu.</p> <p style="text-align: center;">Član 963 Zakonska zalogu</p>
<p>1. Dispozitat vijuese vlejné edhe për të drejtën e pengut e cila krijohet në bazë të ligjit (e drejta pengut ligjor).</p> <p>2. E drejta e pengut ligjor ka efekt ndaj palëve të treta vetëm atëherë kur të parashtrohet deklarata për njoftim sipas kritereve të vendosura me ligj.</p> <p>3. E drejta e pengut ligjor mund të krijohet me këtë Kod dhe ligje të veçanta.</p> <p style="text-align: center;">Neni 964 Kontrata e pengut</p>	<p>1. The following provisions also apply to a pledge which is created by operation of the law (statutory pledge).</p> <p>2. The statutory pledge is effective against third parties at the time a notification statement is filed in accordance with the law.</p> <p>3. Right of a legal pledge is created by special laws.</p> <p style="text-align: center;">Article 964 Pledge agreement</p>	<p>1. Sledeće odredbe važe i za pravo zaloge koja se stvara na osnovu zakona (pravo na zakonsku zalogu).</p> <p>2. Pravo na zakonsku zalogu ima dejstvo prema trećim licima samo kada se podnosi obaveštenje o zalogu u skladu sa zakonom.</p> <p>3. Pravo zakonske zaloge se može stvoriti ovim zakonikom i posebnim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 964 Ugovor o zalogu</p>
<p>1. Që një kontratë e pengut të jetë e vlefshme, nevojitet një dokument me shkrim i cili përmban të paktën këto të dhëna:</p>	<p>1. The validity of a pledge agreement requires a written document and shall contain at least the following:</p>	<p>1. Kako bi ugovor o zalogu bio punovažan potreban je dokument u pisanom obliku koji najmanje treba da sadrži sledeće podatke:</p>

<p>1.1. emrin dhe adresën e pengdhënësit dhe debitorit, në rast se pengdhënësi është një person tjetër nga debitori;</p> <p>1.2. përshkrimin e detyrimit që duhet të sigurohet;</p> <p>1.3. përshkrimin e sendit të lënë peng;</p> <p>1.4. e dhëna se qëllimi i kontratës është caktimi i një pengu për pengmarrësin;</p> <p>1.5. nënshkrimet e palëve të kontratës; dhe</p> <p>1.6. data, në të cilën pengdhënësi e nënshkruan kontratën e pengut.</p> <p>2. Nëse kontrata e pengut është nënshkruar nga ndonjë person në emër të pengdhënësit, pengut është i vlefshëm vetëm nëse personi i cili e nënshkruan kontratën e pengut është i pavarur nga pengmarrësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 965 Specifikimi i marrëveshjes</p> <p>Një kontratë pengut mundet, përveç të dhënave të kërkuara sipas dispozitave të nenit të mësipërm apo sipas dispozitave të tjera të</p>	<p>1.1. the name and address of the pledger and if the pledger is a person other than the debtor;</p> <p>1.2. a description of the obligation to be secured;</p> <p>1.3. a description of the pledged property;</p> <p>1.4. a statement that the purpose of the agreement is to create a pledge in favor of the pledge holder;</p> <p>1.5. signatures of the parties to the agreement; and</p> <p>1.6. date on which the pledger signs the pledge agreement.</p> <p>2. If the pledge agreement is signed by a person who acts on behalf of the pledger, the pledge is only valid if the person signing the pledge agreement is independent from the pledge holder.</p> <p style="text-align: center;">Article 965 Specification of the agreement</p> <p>A pledge agreement may, in addition to being subject to the requirements in the preceding article and other mandatory provisions, also</p>	<p>1.1. ime i adresa zalogodavaca i zalogoprimca (dužnika) ukoliko je zalogodavac drugo lice od dužnika;</p> <p>1.2. opis obaveze koja se treba osigurati;</p> <p>1.3. opis stvari koja se stavlja u zalog;</p> <p>1.4. podatak da je cilj ugovora određivanje zaloge u korist zalogoprimaca;</p> <p>1.5. potpisi ugovornih strana; i</p> <p>1.6. datum kada zalogodavac potpisuje ugovor o zalogu.</p> <p>2. Ukoliko je ugovor o zalogu potpisan od strane lica u ime zalogodavca, zalog je punovažan jedino ako lice koje je potpisalo ugovor o zalogu je nezavisno od zalogoprimca.</p> <p style="text-align: center;">Član 965 Specifikacija ugovora</p> <p>Ugovor o zalogu, pored traženih podataka prema gorepomenutom članu ili ostalim obavezujućim odredbama, takođe može</p>
--	--	--

<p>kushtëzuese, të përmbajë edhe marrëveshjen e palëve rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre të ndërsjella. Kontrata mund të plotësohet, ndryshohet apo shkëputet në çdo kohë, me shkrim dhe me nënshkrimin e saj nga palët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 966 Sendi i lënë peng</p> <p>1. Peng mund të lihet çfarëdo vlere pasurore e luajtshme ose ndonjë e drejtë e cila mund të bartet në mënyrë të ligjshme.</p> <p>2. Pengu shtrihet edhe produktet që janë ndarë nga sendi i lënë peng.</p> <p>3. Nëse pengu përfshin më shumë se një send, secili send mbulon të gjithë kërkesën.</p> <p>4. Licencat dhe lejet mbi minerale mund të lihen peng në përputhje me dispozitat për bartjen dhe barrën në minerale që përcaktohen me ligje të veçanta.</p>	<p>contain agreements between the parties with respect to their reciprocal rights and obligations. The agreement may be supplemented, modified or terminated at any time in writing and signed by the parties</p> <p style="text-align: center;">Article 966 Pledged asset</p> <p>1. Any movable property or right that is lawfully transferable can be pledged.</p> <p>2. The pledge extends to the products that are separated from the pledged property.</p> <p>3. If the pledge extends to more than one property, each property covers the entire claim.</p> <p>4. Licenses and permits to minerals can be pledged in accordance with the provisions for the transfer and encumbrance of minerals contained in special laws.</p>	<p>sadržati i sporazum stranaka u vezi njihovih uzajamnih prava i obaveza. Ugovor može u svako vreme da se dopuni, menja ili poništi u pisanom obliku i potpisom ugovornih strana.</p> <p style="text-align: center;">Član 966 Založena stvar</p> <p>1. Bilo koja vrednost pokretne svojine ili drugo pravo koje se može preneti na zakoniti način, može biti založeno.</p> <p>2. Zalog se odnosi i na proizvode koji su odvojeni od stvari koja se stavlja u zalog.</p> <p>3. Ako se zalog obuhvata više od jedne stvari, svaka stvar obuhvata celokupno potraživanje.</p> <p>4. Licence i dozvole za minerale se mogu staviti u zalog u skladu sa odredbama za prenos i mineralno terećenje koje se određuju u posebnim zakonima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 967 Autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng</p> <p>1. Pengdhënësi duhet të jetë pronar i sendit të lënë peng në kohën e pengdhënies. Nëse pengdhënësi nuk është pronar i sendit të lënë</p>	<p style="text-align: center;">Article 967 Authority to dispose the pledged asset</p> <p>1. The pledger must be the owner of the pledged property at the time the pledge becomes effective. If the pledger is not the</p>	<p style="text-align: center;">Član 967 Ovlašćenje za prodaju založene stvari</p> <p>1. Zalogodavac treba da bude sopstvenik stvari koja se stavlja u zalog u vremenu založenja. Ukoliko zalogodavac nije sopstvenik stvari</p>

<p>peng, ai duhet të ketë autorizimin ligjor për pengdhënie.</p> <p>2. Sendi që është në bashkëpronësi mund të lihet peng vetëm me pëlqimin për pengdhënie nga të gjithë bashkëpronarët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 968 Fitimi me mirëbesim i të drejtës së pengut</p> <p>1. Në qoftë se pengdhënësi nuk është pronar i sendit të lënë peng apo nuk e ka autorizimin ligjor për ta lënë pengun, pengmarrësi e fiton të drejtën e pengut vetëm nëse në kohën kur pengun prodhon efekt, pengdhënësi e ka në posedim sendin e lënë peng dhe pengmarrësi mund të supozojë me mirëbesim se pengdhënësi është pronar ose e ka autorizimin ligjor për të lënë sendin peng.</p> <p>2. Nëse ndaj një sendi të lënë peng ekziston një e drejtë e ndonjë pale të tretë, pengmarrësi e fiton të drejtën e pengut pa ngarkesa, vetëm atëherë kur pengdhënësi e ka në posedim sendin e lënë peng në kohën kur pengun prodhon efekt dhe pengmarrësi mund të supozojë me mirëbesim se ndaj pengut nuk ekziston ndonjë e drejtë tjetër.</p>	<p>owner of the pledged property, he/she must have the legal authority to pledge the property.</p> <p>2. Property that is co-owned may be pledged only if all co-owners consent to the pledge.</p> <p style="text-align: center;">Article 968 Acquisition of pledge right in good faith</p> <p>1. If the pledger is not the owner of the pledged asset or does not otherwise have legal authority to pledge the property, the pledge holder acquires the pledge only if at the time the pledge becomes effective the pledger is in possession of the pledged property and the pledge holder could assume in good faith that the pledger is the owner or has legal authority to pledge the property.</p> <p>2. If the pledged property is encumbered with the right of a third party, the pledge holder acquires the pledge unencumbered only if the pledger is in possession of the pledged property at the time the pledge becomes effective and the pledge holder could assume in good faith that the pledge is unencumbered.</p>	<p>koja se stavlja u zalog, on mora da ima zakonsko ovlašćenje o založenju.</p> <p>2. Stvar koja je u suvlasništvu može se založiti samo ukoliko svi suvlasnici daju saglasnost za zalog.</p> <p style="text-align: center;">Član 968 Sticanje založnog prava u dobroj veri</p> <p>1. Ukoliko zalagodavac nije sopstvenik založene stvari ili nema zakonsko ovlašćenje za založenje, zalogoprimac stiće pravo zaloga jedino ako je u vremenu kada zalog proizvodi dejstvo, zalagodavac poseduje založenu stvar i zalogoprimac može savesno pretpostaviti da je zalagodavac sopstvenik stvari ili ima zakonsko ovlašćenje da založi stvar.</p> <p>2. Ukoliko nad založenom stvari postoji pravo treće strane, zalogoprimac stiće pravo neopterećenog zaloga, samo ako zalagodavac ima u posedu založenu stvar u vreme kada zaloga stvara dejstvo i zalogoprimac može da savesno pretpostavi da nad zalogom ne postoji nečije drugo pravo.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 969 E drejta e pengut në sendet e përziera të një lloji</p>	<p style="text-align: center;">Article 969 Pledge over the mixed assets</p>	<p style="text-align: center;">Član 969 Pravo zaloga na mešane stvari iste vrste</p>
<p>1. Në rastin e pengut pa posedim të sendeve të zëvendësueshme, nëse pengdhënësi i përzien ato pandashëm me sendet e zëvendësueshme të një lloji dhe të cilësisë së njëjtë, atëherë pengdhënësi në mënyrë të sigurtë e konstaton sasinë e gjendjes së tërësishme në kohën e marrëveshjes së pengut dhe ia kumton pengmarrësit pa vonesë.</p> <p>2. E drejta e pengut përbëhet nga një kuotë përkatëse e gjendjes së tërësishme, e cila me çfarëdo ndryshimi të sasisë së tërësishme ndryshon në mënyrë përkatëse.</p> <p>3. Pengdhënësi duhet të përkujdeset që të mbajë evidencë me shkrim mbi hyrjet dhe daljet për gjendjen e tërësishme dhe të ruajë dëshmitë për verifikimin e tyre.</p> <p>4. Rregullat e sipërshënuara vlejnë në mënyrë përkatëse tek një peng posedimor.</p>	<p>1. In the case of a non-possessory pledge over the assets, if the pledger mixes them inseparably with replaceable assets of the same kind and quality, the pledger shall assess the entire quantity at the time of the pledge and communicate this without undue delay to the pledge holder.</p> <p>2. The pledge shall consist of a quota in the entire quantity which changes respectively with every variation of the entire quantity.</p> <p>3. The pledgor is obliged to keep account in written of the additions to and reductions of the entire quantity, and keep the evidence for verification.</p> <p>4. The preceding rules apply <i>mutatis mutandis</i> to a possessory pledge.</p>	<p>1. U slučaju zaloge bez državine zamenjivih stvari, zalagodavac pomeša neodvojivo sa zamenjivim stvarima iste vrste i istog kvaliteta, onda zalagodavac treba da na siguran način utvrdi količinu celokupnog stanja u vremenu dogovora o zalogu i da bez odlaganja saopšti zalogoprincu.</p> <p>2. Pravo zaloge se sastoji od odgovarajuće kvote celokupnog stanja koja se prilikom bilo kakve izmene celokupne količine menja na odgovarajući način.</p> <p>3. Zalagodavac je dužan da u pisanom obliku vodi evidenciju o prihodima i rashodima celokupnog stanja i da sačuva podatke radi potvrđivanja istih.</p> <p>4. Gore navedena pravila se primenjuju na odgovarajući način na posedovni zalog.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 970 E drejta e pengut në vlera pasurore të ardhshme dhe në depo mallrash</p> <p>1. Një e drejtë pengu mund të krijohet edhe në vlerat pasurore apo sendet e përcaktuara në kontratën e pengut në të cilat pengdhënësi e fiton pronësinë ose autorizimin ligjor pas lidhjes së kontratës së pengut.</p> <p>2. Një e drejtë e pengut mund të krijohet në një depo mallrash me përmbajtje të ndryshueshme nëse vendndodhja dhe përmbajtja e depos janë të përshkruara mjaft qartë në kontratën e pengut. Çdo mall që shtohet në depo në të cilën është krijuar e drejta e pengut i nënshtrohet të drejtës së pengut prej momentit kur ai mall i shtohet depos.</p>	<p style="text-align: center;">Article 970 Pledge of future property and warehouse store</p> <p>1. A pledge can extend to such assets as identified in the pledge agreement which comes into the ownership or otherwise under the legal authority of the pledger after the conclusion of the pledge agreement.</p> <p>2. A pledge can be created over a warehouse store or fungible properties if the location and content of the warehouse store are sufficiently clear described in the pledge agreement. Each property added to the warehouse store over which a pledge is created becomes subject to the pledge from the time it is added to the warehouse store.</p>	<p style="text-align: center;">Član 970 Pravo zaloga na budućim svojinskim vrednostima i u skladištima robe</p> <p>1. Pravo zaloge se može stvoriti i na svojinske vrednosti ili stvari koje su utvrđene u ugovoru o zalozi nad kojima zalagodavac stiče svojinu ili pravnu nadležnost nakon sklapanja ugovora o zalogu.</p> <p>2. Zalog se može stvoriti nad skladištem robe sa promenljivim sadržajem ukoliko su mesto i sadržaj skladišta opisani dovoljno jasno u ugovoru o zalozi. Svaka roba koja se dodaje u skladištu nad kojim se steklo pravo zaloge podleže pravu o zalozi od trenutka kada se ta roba doda u skladištu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 971 Kërkesa e siguruar</p> <p>Një e drejtë e pengut është e vlefshme dhe e zbatueshme nëse kërkesa, i cili duhet të sigurohet përmes të drejtës së pengut, është i vlefshëm dhe i zbatueshëm.</p>	<p style="text-align: center;">Article 971 Secured claim</p> <p>A pledge right is only valid and enforceable if the claim that shall be to be secured by the pledge is valid and enforceable.</p>	<p style="text-align: center;">Član 971 Osigurano potraživanje</p> <p>Pravo zaloge je važeće i sprovodljivo samo ako je potraživanje, koje se treba osigurati pravom zaloge, važeće i sprovodljivo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 972 Fushëveprimi i kërkesës të siguruar</p> <p>1. Një e drejtë e pengut e siguron tërë shumën e kërkesës përfshirë kapitalin dhe kamatën e</p>	<p style="text-align: center;">Article 972 Scope of secured obligation</p> <p>1. A pledge secures the entire amount of an obligation, including any unpaid principal and</p>	<p style="text-align: center;">Član 972 Delokrug osiguranog potraživanja</p> <p>1. Založno pravo osigurava celokupan iznos potraživanja, uključujući neplaćeni kapital i</p>

<p>papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit, të mirëmbajtjes dhe shitjes së sendit të lënë peng.</p> <p>2. Nëse debitori personal nuk është pronari i sendit të lënë peng, përgjegjësia nuk zgjerohet me transaksion ligjor që kryhet nga debitori personal pas lënies peng.</p> <p>3. Kthimi i sendit të lënë peng me të cilin është siguruar kryerja e detyrimit nuk do të thotë që kreditori ka hequr dorë nga e drejta e kërimit të shlyerjes së atij detyrimi.</p>	<p>interest, penalties, the costs of enforcement, maintenance and sale of the pledged item.</p> <p>2. If a personal debtor is not the owner of the pledged property, the liability is not extended by a legal transaction entered into by the personal debtor after the pledging.</p> <p>3. The return of the pledged property with which the performance of an obligation was secured shall not mean that the creditor has waived the right to demand performance thereof.</p>	<p>kamatu, ugovorene kazne, troškove sprovođenja, održavanja i prodaje založene stvari.</p> <p>2. Ako lični dužnik nije sopstvenik založene imovine, obaveza se ne proširuje pravnom transakcijom koje se vrši od strane ličnog dužnika nakon založenja.</p> <p>3. Povraćaj založene stvari kojom je plaćanje obaveze osigurano ne znači da se poverilac odrekao prava potraživanja namirivanja te obaveze.</p>
<p>Neni 973 Mbrojtja e pengdhënësit</p>	<p>Article 973 Protection of the pledger</p>	<p>Član 973 Zaštita zalogodavca</p>
<p>1. Pengdhënësi mund të parashtrojë kundër pengmarësit mbrojtjen në dispozicion të një debitori personal ndaj një kërkesë. Nëse debitori personal vdes, atëherë pengmbajtësi nuk mund të bazohet tek fakti që trashëgimtari i tij apo saj ka përgjegjësi të kufizuar për atë detyrim.</p> <p>2. Nëse pengmarrësi nuk është debitor personal, ai nuk humb të drejtën e mbrojtjes për shkak të heqjes dorë nga debitori personal.</p>	<p>1. The pledger may assert against the pledgee the protection that is available to a personal debtor against the claim. If the personal debtor dies, then the pledger may not invoke the fact that his or her heir has only limited liability for the obligation.</p> <p>2. If the pledger is not the personal debtor, he does not forfeit protection right by the personal debtor waiving it.</p>	<p>1. Zalogodavac može podneti protiv zalogoprimca odbranu koja je na raspolaganju ličnom dužniku nad potraživanjem. Ako lični dužnik umre, onda se zalogodavac ne može pozivati na činjenicu da njegovi ili njeni naslednici imaju ograničenu odgovornost za obavezu.</p> <p>2. Ako zalogodavac nije lični dužnik on ne gubi pravo na odbranu zbog odricanja ličnog dužnika.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 974 Ndryshimet e objektit të pengut ose rritja e kërkesës të siguruar</p> <p>Pas krijimit të së drejtës së pengut, pengdhënësi dhe pengmarrësi mund të pajtohen që ta rrisin kërkesën e siguruar ose ta rrisin objektin e pengut. Për çdo rritje e cila nuk është e bashkëngjitur apo e lidhur me objektin e pengut, duhet të trajtohet si krijim i një të drejte të re të pengut.</p>	<p style="text-align: center;">Article 974 Change of pledged property or increase of the secured obligation</p> <p>Subsequent to the creation of a pledge, the pledger and the pledge holder may agree to increase the secured claim, or to add to the pledged property. Any addition that is not permanently attached or connected to the pledged property is to be treated as the creation of a new pledge.</p>	<p style="text-align: center;">Član 974 Promene predmeta zaloga ili povećanje osiguranog potraživanja</p> <p>Nakon stvaranja prava zaloge, zalagodavac i zalogoprimac mogu se složiti da povećaju osiguranu obavezu ili da povećaju predmet zaloge. Za svako povećanje koje nije priloženo ili povezano sa predmetom zaloge, treba se tretirati kao stvaranje novog prava zaloge.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 975 Siguria plotësuese</p> <p>1. Pengmbajtësi mund të kërkojë siguri plotësuese apo adekuate, nëse sendi i lënë peng nuk ofron siguri përkatëse për kërkesën e siguruar dhe nëse pengmarrësi nuk ka mundur ta dijë këtë në kohën kur është lidhur kontrata e pengut.</p> <p>2. Nëse pengdhënësi nuk jep siguri plotësuese apo adekuate, pengmbajtësi mund të kërkojë përmbushjen e menjëhershme të kërkesës së siguruar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 975 Additional security</p> <p>1. The pledge holder may demand additional or adequate security, if the pledged property does not offer a corresponding security for the related obligation and a pledge holder could not be aware of this at the time the pledge agreement was concluded.</p> <p>2. If the pledger does not grant additional or adequate security, the pledge holder may demand immediate fulfilment of the secured obligation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 975 Dopunsko osiguranje</p> <p>1. Zalogoprimac može tražiti dopunsko ili adekvatno osiguranje ukoliko založena stvar ne pruža odgovarajuće osiguranje za osigurano potraživanje i ukoliko zalogoprimac nije mogao to da zna za vreme kada je sklopljen ugovor o zalogu.</p> <p>2. Ukoliko zalagodavac ne daje dodatno ili adekvatno osiguranje, zalogoprimac može potražiti neposredno ispunjenje osiguranog potraživanja.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II - Të Drejtat dhe Detyrimet e Pengdhënësit dhe Pengmarrësit</p> <p style="text-align: center;">Neni 976 E drejta e kontrollimit</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Rights and Obligations of a Pledger and a Pledgee</p> <p style="text-align: center;">Article 976 Right to inspection</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Prava i obaveze Zalogodavca i Zalogoprimca</p> <p style="text-align: center;">Član 976 Pravo na kontrolu</p>

<p>Në rastin e pengut pa posedim, pengmarrësi ka të drejtë që, pas njoftimit të dhënë me kohë pengdhënësit, ta kontrollojë sendin e lënë peng. Në rastin e pengut posedimor, pengdhënësi ka të drejtë që, pas njoftimit të dhënë me kohë pengmbajtësit, ta kontrollojë sendin e lënë peng.</p> <p style="text-align: center;">Neni 977 Të drejtat dhe detyrimet e pengmarrësit</p> <p>1. Në rastin e pengut posedimor, pengmarrësi nuk e përdorë dhe e ruan me kujdesin më të madh sendin e lënë peng. Presumohet që pengmarrësi ka të drejtë në përfitime nga sendi i lënë peng, nëse palët nuk pajtohen ndryshe.</p> <p>2. Përveç në rastet kur palët pajtohen ndryshe, pengmarrësi mund ta lë peng sërish sendin e lënë peng nëse ai mund të sigurojë që sendi i lënë peng do t'i kthehet pengdhënësit, në përputhje me kushtet e kontratës së pengut. Pengmarrësi i përgjigjet pengdhënësit për ndonjë dëmtim, për humbjen ose për ndonjë vonesë në kthimin e sendit të lënë peng.</p>	<p>In the case of a non-possessory pledge the pledgee has the right upon reasonable notice to the pledger to inspect the pledged property. In the case of a possessory pledge the pledger has the right upon reasonable notice to the pledge holder to inspect the pledged property.</p> <p style="text-align: center;">Article 977 Rights and duties of a pledge holder</p> <p>1. In the case of a possessory pledge, the pledge holder shall not use and has to prudently maintain the pledged property. It is presumed that the pledge holder is entitled to the fruit of the pledged property if not agreed differently by the parties.</p> <p>2. Unless otherwise agreed between the parties, the pledge holder may re-pledge the pledged property if he can ensure that the pledged property will be returned to the pledger in accordance with the terms of the pledge agreement. The pledge holder is liable to the pledger for any damage to, the loss or a delay in the return of the pledged property.</p>	<p>U slučaju zaloge bez poseda, zalogoprimac ima pravo da, nakon blagovremenog obaveštenja zalagodavca, izvrši kontrolu založene stvari. U slučaju posednog zaloga, zalagodavac ima pravo da, nakon blagovremenog obaveštenja zalogoprimca, prekontroliše založenu stvar.</p> <p style="text-align: center;">Član 977 Prava i obaveze zalogoprimca</p> <p>1. Ukoliko u slučaju zaloge u posedu, zalogoprimac ne upotrebljava i ne čuva oprezno založenu stvar, pretpostavlja se da zalogoprimac ima pravo na plodove založene stvari, ukoliko se strane ne usaglase drugačije.</p> <p>2. Osim u slučajevima kada se strane drugačije usaglase, zalogoprimac može ponovo staviti u zalog založenu stvar ukoliko on može da osigura da će se založena stvar vratiti zalagodavcu u skladu sa uslovima ugovora o zalogu. Zalogoprimac odgovara zalagodavcu za svako oštećenje, gubitak ili zakašnjenje u povraćaju stvari stavljene u zalog.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 978 Të drejtat dhe detyrimet e pengdhënësit</p>	<p align="center">Article 978 Rights and obligations of the pledger</p>	<p align="center">Član 978 Prava i obaveze zalogodavca</p>
<p>1. Për pengun pa posedim, pengdhënësi ka për detyrë ta përdorë sendin e lënë peng në mënyrën e përputhshme me përdorimin e zakonshëm të atij sendi.</p> <p>2. Për pengun pa posedim që kanë efekt ndaj palëve të treta, pengdhënësi ruan të drejtën për:</p> <p>2.1. përdorur objektin e pengut në përputhje me qëllimin e tij. Nëse pengdhënësi dështon të shlyejë detyrimet e tij ndaj pengmbajtësit, ai humb atë të drejtë posedimi;</p> <p>2.2. qiradhënien e objektit të pengut dhe të hyjë në marrëveshje të tjera me të cilat objekti i pengut i bartet palës së tretë për përdorim dhe gëzim të përfitimeve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje;</p> <p>2.3. të vënë sërish peng objektin e pengut, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje; ose</p>	<p>1. For non-possessory pledges, the pledger has the duty to use the pledged property in a manner consistent with the ordinary use of such thing.</p> <p>2. For non-possessory pledges which are effective against third parties, the pledger shall retain the right to:</p> <p>2.1. use the object of pledge in accordance with its intended purpose. Should the pledger fail to settle his obligations to the pledge holder, he shall lose such a right of possession.</p> <p>2.2. lease the object of pledge and enter into other agreements whereby the object of pledge is transferred to third parties for use and reaping of fruits, unless otherwise stipulated by the agreement;</p> <p>2.3. re-pledge the object of pledge unless otherwise stipulated by the agreement; or</p>	<p>1. Za zalog bez poseda, zalogodavac ima obavezu da koristi založenu stvar na način koji je u skladu sa uobičajenom upotrebom takve stvari.</p> <p>2. Za zaloge bez državine, koje imaju dejstvo protiv trećih lica, zalogodavac zadržava pravo da:</p> <p>2.1. koristi predmet zaloge u skladu sa njegovom namenom. Ukoliko zalogodavac ne izmiri svoje obaveze prema zalogoprimcu, on gubi pravo državine.</p> <p>2.2. izdaje u zakup predmet zaloge i sklapa druge ugovore kojim bi se predmet zaloge preneo na treće lica radi korišćenja i uživanja koristi, osim ako nije drugačije određeno ugovorom;</p> <p>2.3. ponovo založi predmet zaloge osim ako nije drugačije određeno ugovorom, ili</p>

<p>2.4. të disponuar me objektin e pengut dhe bartur të drejtën e pronësisë tek një palë e tretë.</p> <p>3. Marrëveshja e pengut mund të tërheqë të drejtën e pengdhënësit për disponimin me objektin e pengut.</p> <p>4. Marrëveshja e pengut mund të kufizojë përdorimin e objektit të pengut dhe të përcaktojë mënyrën në të cilën pengdhënësi mund ta përdorë atë më tutje. Marrëveshja e pengut mund të ndalojë mënyra të caktuara të përdorimit të objektit të pengut.</p>	<p>2.4. dispose of the object of pledge and transfer the right of ownership to a third party.</p> <p>3. The pledge agreement may withdraw the right of the pledger to dispose of the object of pledge.</p> <p>4. The pledge agreement may limit the use of the object of pledge and stipulate the way in which the pledger may use it thereafter. The pledge agreement may prohibit particular ways of using the object of pledge.</p>	<p>2.4. raspolaže predmetom zaloge i prenosi pravo državine na treće lice.</p> <p>3. Ugovor o zalogu može da povuče pravo zalagodavca da raspolaže predmetom zaloge.</p> <p>4. Ugovor o zalogu može da ograniči korišćenje predmeta zaloge i da odredi način na koji zalagodavac može da je koristi nadalje. Ugovor o zalogu može da zabrani određene načine korišćenja predmeta zaloge.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 979 Disponimi me objektin e pengut pa posedim</p>	<p style="text-align: center;">Article 979 Disposal of the object of non-possessory pledge</p>	<p style="text-align: center;">Član 979 Raspologanje predmetom zaloga bez poseda</p>
<p>1. Pengdhënësi mund të disponojë me objektin e pengut dhe të bartë të drejtën e pronësisë tek pala e tretë.</p> <p>2. Pengdhënësi dhe pronari i ri i dërgojnë një pasqyrë njoftuese të bartësit tek regjistri i pengut, me shpenzime të pronarit të ri, si dhe pa vonesa të paarsyeshme.</p> <p>3. Pengdhënësi dhe pronari i ri i objektit të pengut janë bashkërisht përgjegjës ndaj</p>	<p>1. The pledger may dispose of the object of pledge and transfer the right of ownership to a third party unless if this right is limited by pledge agreement.</p> <p>2. The pledger and the new owner shall file a notification statement of the transfer at the Pledge Register at the new owner's expense and without unjustified delay.</p> <p>3. The pledger and the new owner of the object of pledge shall be jointly liable to the</p>	<p>1. Zalagodavac može da raspolaže predmetom zaloga i da prenese pravo državine na treće lice.</p> <p>2. Zalagodavac i novi sopstvenik podnose obaveštajni izveštaj o prenosu u registar zaloga, na trošak novog sopstvenika i bez neopravdanih kašnjenja.</p> <p>3. Zalagodavac i novi sopstvenik založenog predmeta, zajednički su odgovorni prema</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1148 Kujdestaria</p> <p>1. Martesa midis kujdestarit dhe personit nën kujdestari është e ndaluar gjatë kohës së kujdestarisë.</p> <p>2. Për shkaqe të arsyeshme, gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës midis personave nga paragrafi 1 i këtij neni, pasi të ketë marrë mendimin e Organit të Kujdestarisë.</p> <p>3. Kujdestaria pushon pas martesës midis këtyre personave, ndërsa martesa vazhdon të mbetet në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1148 Custodianship</p> <p>1. Marriage between the custodian and the person under custodianship is banned during the time of custodianship.</p> <p>2. Due to justifiable reasons, the competent court may allow marriage between persons as mentioned in paragraph 1 after seeking the opinion from the Custodian Body.</p> <p>3. Custodianship ceases upon marriage between these persons whereas marriage remains valid.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1148 Starateljstvo</p> <p>1. Brak između staratelja i lica pod starateljstvom zabranjen je tokom trajanja starateljstva.</p> <p>2. Iz opravdanih razloga, nadležni sud može da dozvoli sklapanje braka između lica navedenih u stavu 1. ovog člana, nakon što dobije mišljenje od Organa Starateljstva.</p> <p>3. Sklapanjem braka, prestaje starateljstvo između tih lica a brak ostaje punovažan.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV – Kërkesa për Lidhjen e Martesës dhe Procedura</p> <p style="text-align: center;">Neni 1149 Kërkesa për lidhjen e martesës</p> <p>1. Personat që dëshirojnë të lidhin martesë duhet të paraqesin kërkesë pranë ofiqarit të komunës.</p> <p>2. Certifikata e lindjes duhet t'i bashkëngjitet kërkesës dhe, kur është e nevojshme, duhet të provohen kërkesat për martesë të përcaktuara</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Marriage Application and Procedure</p> <p style="text-align: center;">Article 1149 Marriage application</p> <p>1. Persons willing to marry shall file a request with the Municipal registrar.</p> <p>2. A certificate of birth has to be attached to the request and, when necessary to prove the requirements for marriage set down in the</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV – Zahtev i Postupak za Sklapanje Braka</p> <p style="text-align: center;">Član 1149 Zahtev za Sklapanje Braka</p> <p>1. Lica koja žele da sklope brak moraju da podnesu zahtev pred opštinskim matičarem.</p> <p>2. Izvod rođenih mora biti priložen uz zahtev i, kada je potrebno, treba se utvrditi zahtevi za sklapanje braka predviđeni zakonom, druga</p>

<p>në ligj, dokumente tjera, siç është certifikata e divorcimit, certifikata për martesë - pranueshmëria e të huajve ose pasaporta.</p> <p>3. Për datën e lidhjes së martesës vendos ofiqari në marrëveshje me personat që dëshirojnë të lidhin martesën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1150 Informatë për regjimin pasuror bashkëshortor</p> <p>1. Ofiqari duhet të njoftoj çiftin se me martesë, ata hyjnë në regjimin pasuror-juridik martesor si pjesëmarrës të barabartë në fitimin e pronës, përveç nëse kanë lidhur kontratë për regjim të posaçëm pasuror.</p> <p>2. Ofiqari njofton bashkëshortët e ardhshëm se duhet ta lidhin një kontratë noteriale në qoftë se dëshirojnë ta ndryshojnë regjimin pasuror-juridik të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1151 Informimi i ndërsjellë për çështjet shëndetësore dhe çështje tjera</p> <p>Pas parashtrimit të kërkesës për lidhjen e martesës, ofiqari do t'u rekomandojë personave që dëshirojnë të lidhin martesë që</p>	<p>law, other documents, like a certificate of divorce, a certificate for marriage-eligibility for foreigners or a passport.</p> <p>3. The (official) registrar decides on the marriage date in agreement with the persons willing to marry.</p> <p style="text-align: center;">Article 1150 Information on matrimonial property regime</p> <p>1. The registrar informs the couple that by marriage, they enter the legal property regime of equal participation in acquisitions of the property, except if they have concluded a contract for special property regime.</p> <p>2. Registrar informs future spouses that they must conclude a notarial contract if they wish to change the legal matrimonial property regime as foreseen in paragraph 1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 1151 Reciprocal information on health and other issues</p> <p>Upon request for marriage, registrar shall recommend persons willing to marry to until the marriage date reciprocally be informed</p>	<p>dokumenta, kao što je potvrda o razvodu, izvod iz registra venčanih – prihvatanje stranaca ili pasoš.</p> <p>3. Za datum sklapanja braka, odlučuje matičar u dogovoru sa licima koja nameravaju da sklope brak.</p> <p style="text-align: center;">Član 1150 Informacije o supružničko imovinskim odnosima</p> <p>1. Matičar treba obavestiti par, da sa stupanjem u braku, oni stupaju u supružničko-imovinskim odnosima kao ravnopravni učesnici u sticanju imovine, osim ako su sklopili poseban ugovor o imovinskom odnosu.</p> <p>2. Matičar obaveštava buduće supružnike da moraju da zakluče jedan javno beležnički ugovor ako žele da promene supružničko imovinske odnose koji je predviđen u stavu 1. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 1151 Uzajamno obaveštavanje o zdravstvenim pitanjima i drugim pitanjima</p> <p>Posle podnošenja zahteva za sklapanje braka, matičar će preporučiti licima koji nameravaju da sklope brak da se do datuma sklapanja</p>
--	--	---

<p>deri në datën e lidhjes së martesës, që në mënyrë të ndërsjellët të informohen lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore, të vizitojnë konsulentin familjar për të siguruar mendimin profesional përkitazi me zhvillimin e marrëdhënieve harmonike martesore dhe familjare, të njihen me mundësitë dhe përparësitë e planifikimit të familjes, si dhe të pajtohen lidhur me mbiemrin e ardhshëm.</p>	<p>regarding their health conditions, to visit a family consultancy to be provided with a professional opinion regarding the development of harmonious marital and family relations and to get acquainted with the opportunities and advantages of family planning and to agree on the future surname.</p>	<p>braka, uzajamno obaveste o svom zdravstvenom stanju, da posete porodično savetovalište kako bi dobili stručno mišljenje u vezi sa izgradnjom skladnih bračnih i porodičnih odnosa, i kako bi se upoznali sa mogućnostima i prednostima porodičnog planiranja, i kako bi se složili o budućem bračnom prezimenu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1152 Vendi për lidhjen e martesës</p>	<p style="text-align: center;">Article 1152 Premises for marriage</p>	<p style="text-align: center;">Član 1152 Mesto sklapanja braka</p>
<p>1. Martesa bëhet në mënyrë solemne në lokalet zyrtare posaçërisht të caktuara për këtë qëllim.</p> <p>2. Lidhja e martesës përjashtimisht, me kërkesën e bashkëshortëve të ardhshëm, mund të bëhet edhe në ndonjë vend tjetër të përshtatshëm, me vendim të ofiqarit, me pagesë të veçantë për lidhje të martesës jashtë lokaleve zyrtare.</p>	<p>1. Marriage is solemnly entered into in official premises specifically designated for this purpose.</p> <p>2. Marriage is entered into within official premises, exceptionally in another convenient location based on the registrar's decision, with a special payment for entering into marriage outside official premises.</p>	<p>1. Brak se zaključuje na svečani način u službenim prostorijama koje su posebno određene za tu svrhu.</p> <p>2. Kao izuzetak sklapanje braka, na zahtev budućih supružnika se može izvršiti i na nekom drugom odgovarajućem mestu, sa odlukom matičara, uz posebno plaćanje za sklapanje braka van službenih prostorija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1153 Procedura para nëpunësit të gjendjes civile</p>	<p style="text-align: center;">Article 1153 Procedure with the registrar</p>	<p style="text-align: center;">Član 1153 Postupak pred matičarem</p>
<p>1. Për të lidhur martesë është e nevojshme që dy persona të sekseve të ndryshme, në prani të të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë</p>	<p>1. To enter into marriage, it is necessary that two persons of different sexes in the presence of another people freely declare their will and</p>	<p>1. Za sklapanje braka, neophodno je da dva lica razlicitih pola, u prisustvu jedno drugova, slobodno izjave svoju volju i saglasnost za sklapanje braka pred matičarem.</p>

<p>vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë përpara ofiqarit.</p> <p>2. Deklarata duhet të jetë pakushtëzuar dhe e menjëhershme.</p> <p>3. Palët pjesëmarrëse gjatë lidhjes së martesës janë bashkëshortët, dy dëshmitarë dhe ofiqari.</p> <p>4. Secili person me aftësi për të vepruar mund të jetë dëshmitar gjatë lidhjes së martesës.</p>	<p>full consent for marriage in front of the registrar.</p> <p>2. The statement shall be absolute and without dating.</p> <p>3. Participating parties during the marriage are the future spouses, two witnesses and the registrar.</p> <p>4. Any person with the capacity to act may serve as witness during the marriage.</p>	<p>2. Izjava mora biti безусловna i neposredna.</p> <p>3. Stranke koje učestvuju u postupku sklapanja braka su budući supružnici, dva svedoka i matičar.</p> <p>4. Bilo koje lice koje ima poslovnu sposobnost može da bude svedok prilikom sklapanja braka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1154 Bashkëpunimi i ofiqarit</p> <p>Ofiqari është i detyruar ta lejojë procedurën për lidhjen e martesës nëse nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa. Ofiqari është i detyruar ta refuzojë bashkëpunimin në procedurën e martesës nëse ekziston ndonjë pengesë apo ndalesë martesore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1154 Registrar's cooperation</p> <p>The registrar is obliged to allow the marriage procedure if there is no ban or prohibition. The registrar is obliged to refuse cooperation in the marriage procedure, if any prohibition or ban exists.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1154 Saradnja matičara</p> <p>Matičar je obavezan da dozvoli postupak sklapanja braka ako ne postojе bračne smetnje ili zabrane. Matičar je obavezan da odbije saradnju u postupku sklapanja braka, ako postoji bilo koja bračna smetnja ili zabrana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1155 Hyrja në martesë</p> <p>Lidhja e martesës fillon me raportin e paraqitur nga ofiqari, duke treguar praninë e bashkëshortëve të ardhshëm dhe mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave martesore të parapara me këtë libër. Kjo</p>	<p style="text-align: center;">Article 1155 Entering into marriage</p> <p>The marriage commences with the report presented by the registrar, stating the presence of the future spouses and the non-existence of marital bans and prohibitions provided for by law. This is concluded, based on the</p>	<p style="text-align: center;">Član 1155 Stupanje u braku</p> <p>Sklapanje braka počinje sa izveštajem koji dostavlja matičar, koji pokazuje prisustvo budućih supružnika i nepostojanje bračnih smetnji i bračnih zabrana predviđenih u ovoj Knjizi. To se utvrđuje na osnovu dostavljenih</p>

<p>konstatohet në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe deklaratave të dëshmitarëve.</p>	<p>documents and statements of future spouses and witnesses.</p>	<p>dokumenata i izjava budućih supružnika, kao i izjava svedoka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1156 Refuzimi i martesës</p>	<p style="text-align: center;">Article 1156 Marriage refusal</p>	<p style="text-align: center;">Član 1156 Odbijanje sklapanja braka</p>
<p>Në qoftë se ofiqari konstaton ekzistimin e çfarëdo pengese apo ndalesë martesore, ai i komunikon gojarisht parashtruesve të kërkesës se nuk mund të lidhin martesë dhe harton procesverbalin lidhur me këtë.</p>	<p>If the registrar concludes the existence of any marriage ban or prohibition, he verbally informs the applicants that they cannot marry and makes official record in the minutes therein.</p>	<p>Ako matičar zaključī da postoji bilo koja bračna smetnja ili bračna zabrana, on usmeno obaveštava podnosiocē zahteva da ne mogu da sklope brak i u vezi toga sastavlja zapisnik.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1157 Lidhja e martesës</p>	<p style="text-align: center;">Article 1157 Marriage</p>	<p style="text-align: center;">Član 1157 Sklapanja braka</p>
<p>1. Në rast se ofiqari konstaton mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave për lidhjen e martesës, ai i njofton bashkëshortët e ardhshëm me dispozitat e këtij libri përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e tyre edhe gjithashtu ua lexon këto dispozita.</p>	<p>1. In case the registrar concludes the non-existence of prohibition and bans, he then shall inform the future spouses about the provisions of this Book regarding their rights and obligations, and shall read these provisions to them.</p>	<p>1. U slučaju kad matičar utvrdi da ne postoje smetnje i zabrane za sklapanje braka, on ili ona obaveštava buduće supružnike o odredbama ove knjige, o njihovim pravima i obavezama i takođe im čita ove odredbe.</p>
<p>2. Ofiqari duhet t'i pyes bashkëshortët e ardhshëm veç e veç nëse pajtohen të martohen me njeri-tjetrin.</p>	<p>2. The registrar shall ask each future spouse separately, whether they agree to marry with one another.</p>	<p>2. Matičar mora da pita buduće supružnike odvojeno ako se slažu da sklope brak sa jedno-drugim.</p>
<p>3. Pasi t'i ketë siguruar deklaratat mbi pajtimin për hyrje në martesë, ofiqari e shpall martesën të lidhur.</p>	<p>3. After ensuring statements consenting for the marriage, the registrar shall announce the marriage bonded.</p>	<p>3. Nakon što je obezbedio izjave o saglasnosti za stupanje u braku, matičar proglašava sklopljeni brak.</p>

<p>4. Martesa konsiderohet e lidhur pas nënshkrimit në Regjistër nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe ofiçari.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1158 Procedura administrative</p> <p>1. Nëse personat që kanë paraqitur fletëparaqitjen për lidhjen e martesës nuk pajtohen me komunikimin verbal siç është përcaktuar në nenin 1156 të këtij libri, ata mund të kërkojnë nga ofiqari që të nxjerrë aktvendim për refuzimin e fletëparaqitjes për lidhjen e martesës.</p> <p>2. Paraqitja e ankesës kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet brenda tetë (8) ditëve nga dita e njoftimit mbi moslejimin për lidhjen e martesës nga organet kompetente.</p> <p>3. Sipas kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni, organi kompetent është i detyruar që në procedurën administrative të nxjerrë vendim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.</p>	<p>4. Marriage is considered to be bonded, after the spouses, witnesses and registrar sign in into the register.</p> <p style="text-align: center;">Article 1158 Administrative procedure</p> <p>1. If persons applying for marriage disagree with the verbal communication as provided for in Article 1156, of this book they may request the registrar to bring a ruling on the refusal of the marriage request.</p> <p>2. The ruling provided for in paragraph 1 may be appealed within eight (8) days upon notification by competent bodies regarding the disallowance of marriage.</p> <p>3. Based on the request provided for in paragraph 2 of this article, the competent body is obliged to issue a decision through administrative procedure within fifteen (15) days upon receipt of the request.</p>	<p>4. Brak se smatra sklopljenim nakon potpisivanja u Registar od strane supružnika, svedoka i matičara.</p> <p style="text-align: center;">Član 1158 Upravni postupak</p> <p>1. Ako lica koja su podnela pisani zahtev za sklapanje braka ne prihvataju usmeno saopštenje kao što je propisano u članu 1156. ove knjige, oni mogu da zatraže od matičara da donese rešenje o odbijanju pisanog zahteva za sklapanje braka.</p> <p>2. Podnošenje žalbe protiv rešenja propisanog u stavu 1. ovog člana, može da se podnese u roku od osam (8.) dana, od dana kad nadležni organ obavesti stranke da nije odobreno sklapanje braka.</p> <p>3. Na osnovu zahteva propisanog u stavu 2. ovog člana, nadležni organ je obavezan da donese odluku u upravnom postupku u roku od petnaest (15.) dana, od dana prijema zahteva.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 1159 Pjesëmarrja</p> <p>Në rast se në datën e lidhjes së martesës nusja, dhëndëri apo që të dy nuk paraqiten dhe mungesën e tyre nuk e arsyetojnë, kërkesa për lidhjen e martesës do të konsiderohet se është tërhequr.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1159 Attendance</p> <p>In case that on the decided date of marriage the bride, groom or both do not appear and their absence is not justified, the request for marriage shall be deemed to have been withdrawn.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1159 Prisustvo</p> <p>U slučaju da na zakazani dan sklapanja braka, mlada, mladoženja ili i jedno i drugo se ne pojave ispred matičara i svoje odsustvo ne opravdaju, time se smatra da je zahtev za sklapanje braka povučen.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1160 Libri amë i martesave</p> <p>1. Ofiqari e regjistron lidhjen e martesës në Librin amzë të martesave dhe i njëjti libër nënshkruhet nga bashkëshortët, dy dëshmitarët dhe ofiqari.</p> <p>2. Menjëherë pas lidhjes së martesës, bashkëshortëve u lëshohet certifikata nga Libri amzë i martesave.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1160 Marriage register (of married)</p> <p>1. The registrar records marriage in the marriage register, which is then signed by the spouses, two witnesses and the registrar.</p> <p>2. Immediately upon marriage, the spouses are provided with a certificate from the marriage register.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1160 Matična knjiga venčanih</p> <p>1. Matičar upisuje sklopljeni brak u matičnu knjigu venčanih, zatim ista knjiga se potpisuju od supružnika, dva svedoka i matičara.</p> <p>2. Odmah po sklapanju braka, supružnicima se izdaje izvod iz matične knjige venčanih.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1161 Çështjet paraprake</p> <p>Personat që dëshirojnë të lidhin martesë në pajtim me rregullat fetare (religjioze) nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, përderisa ata nuk e dëshmojnë lidhjen e martesës ligjore me certifikatë të lëshuar nga regjistri i ofiqarit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1161 Preliminary issues</p> <p>Persons marrying according to (religious) rules shall not perform the wedding, unless the spouses testify the legal entry into marriage through a certificate, issued by the marriage registrar.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1161 Prethodna pitanja</p> <p>Lica koja žele da sklope brak u skladu sa verskim (religioznim) propisima ne mogu to učiniti, dok supružnici ne dokažu zakonski sklopljeni brak putem izvoda izdatog iz registra matičara.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1162 Dokumentacioni</p> <p>1. Zyrtari nga bashkësia religjioze, përpara të cilit është lidhur martesë sipas rregullave fetare, i dërgon ofiqarit dokumentin e nënshkruar nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nga përfaqësuesi i bashkësisë fetare, duke e dokumentuar me këtë lidhjen e martesës religjioze, dhe kjo do të shënohet në rubrikën ku është regjistruar paraprakisht martesë ligjore.</p> <p>2. Dokumenti i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni do t'i dërgohet ofiqarit brenda afatit prej pesë ditësh nga dita e lidhjes së martesës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1162 Documentation</p> <p>1. The official from the religious union, in front of whom marriage was entered into in a religious way, shall provide the registrar with a document signed by the spouses, the witnesses and the representative of the religious union, proving the religious entry into marriage and this will be recorded on the place where legal marriage was previously recorded.</p> <p>2. The document foreseen in paragraph 1 shall be delivered to the registrar within five days from the date of entry into marriage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1162 Dokumentacija</p> <p>1. Službeno lice verske zajednice, pred kojim je bio sklopljen brak u skladu sa verskim propisima, dostavlja matičaru dokument potpisan od strane supružnika, svedoka i predstavnika verske zajednice, kojim se dokazuje sklapanje braka prema verskim propisima i to će se upisati u rubriku gde je prethodno registrovan zakonski sklopljeni brak.</p> <p>2. Predviđeni dokument iz stava 1. ovog člana će se dostaviti matičaru u roku od pet dana, od dana sklapanja braka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1163 Dokumentacioni për regjistrimin e martesës religjioze, pas martesës civile</p> <p>1. Ofiqari është i detyruar që të evidentojë martesën e lidhur në mënyrë religjioze brenda tri ditësh pas pranimit të dokumentit të paraparë në këtë libër, nëse ekziston paraprakisht lidhja e martesës ligjore.</p> <p>2. Menjëherë pas evidentimit të martesës religjioze në librin amë të martesave, ofiqari do të lëshojë akt juridik me të cilin palët do të</p>	<p style="text-align: center;">Article 1163 Documents for registration of religious marriage after civil marriage</p> <p>1. The registrar is obliged to record the marriage entered into in a religious way in the marriage register within three days upon receipt of the document provided by this book, if there is previous legal entry into marriage.</p> <p>2. Immediately upon recording religious marriage in the marriage register, the registrar shall issue legal act that will inform the parties</p>	<p style="text-align: center;">Član 1163 Dokumentacija za upis verskog braka nakon građanskog braka</p> <p>1. Matičar je obavezan da sklopljeni brak prema verskim propisima upiše u matičnu knjigu venčanih u roku od tri dana, od dana prijema dokumenta propisanim u ovoj knjizi, ako prethodno postoji zakonski sklopljeni brak.</p> <p>2. Odmah po upisu braka sklopljenog prema verskim propisima u matičnu knjigu venčanih, matičar izdaje pravni akt sa kojim se stranke</p>

<p>njoftohen se edhe martesë e tyre religjioze është evidentuar krahas martesës ligjore.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli V – Bashkëjetesa</p> <p style="text-align: center;">Neni 1164 Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje</p> <p>1. Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje është marrëdhënie faktike ndërmjet një burri madhor të pamartuar dhe një gruaje madhore të pamartuar, të cilët haptazi jetojnë bashkë, e karakterizuar me jetën dhe punën e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdimësie.</p> <p>2. Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje është e barabartë me statusin e bashkëshortëve martesorë nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare të ndërsjellë, dhe të drejtave pasurore ashtu siç është saktësuar në këtë Kod.</p> <p>3. Bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje nuk e jep efektin nga paragrafi 2 i këtij neni nëse në kohën e krijimit të saj kanë ekzistuar këto pengesa martesore: martesë ekzistuese, gjinia e gjakut në shkallën e ndaluar nga ky libër, gjinia adoptuese, paaftësia për të gjykuar dhe e veprimit, përveç nëse ndonjëra nga këto</p>	<p>that there religious is recorded along legal marriage.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter V – Cohabitation</p> <p style="text-align: center;">Article 1164 Cohabitation of man and woman</p> <p>1. Cohabitation of a man and a woman is the factual relationship between an unmarried adult man and an adult woman who openly live as a couple, characterized by a joint life and work that represents a character of stability and continuation.</p> <p>2. Cohabitation of a man and a woman is equal with the status of marital spouses on the aspect of rights and obligations for caretaking, reciprocal financial support, and property rights as specified in this Code.</p> <p>3. Cohabitation of a man and a woman does not produce effect of paragraph 2 if at the time of its creation the following marital obstacles existed: existing marriage, consanguinity at the level forbidden by law, the adopting gender, incapacity to act and judge, unless any of the obstacles ceased during the existence of cohabitation.</p>	<p>obaveštavaju da je i njihov verski sklopljeni brak upisan pokraj zakonskog sklopljenog braka.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje V – Suživot</p> <p style="text-align: center;">Član 1164 Suživot jednog muškarca i jedne žene</p> <p>1. Suživot jednog muškarca i jedne žene je faktički odnos između jednog neoženjenog odraslog muškarca i jedne neudate odrasle žene, koji otvoreno žive zajedno, koji se odlikuje zajedničkim životom i radom koji predstavlja karakter stabilnosti i kontinuiteta.</p> <p>2. Suživot jednog muškarca i jedne žene je ravnopravan statusom bračnih supružnika sa aspekta prava i obaveza za staranje, uzajamnom finansijskom podrškom i imovinskim pravima kako je navedeno u ovom Zakoniku.</p> <p>3. Suživot jednog muškarca i jedne žene ne proizvodi efekat iz stava 2. ovog člana ukoliko u vreme njegovog formiranja su postojale ove bračne smetnje: postojeći brak, krvna veza na zabranjenom stepenu po ovoj knjizi, veza usvojenja, nesposobnost rasuđivanja i poslovna nesposobnost, osim ukoliko je neka</p>
--	--	--

<p>pengesa ka pushuar gjatë ekzistimit të bashkëjetesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1165 Barra e provës</p> <p>Personi i cili dëshiron t'i realizojë të drejtat nga bashkëjetesa e një burri dhe një gruaje duhet ta provojë ekzistimin dhe kohëzgjatjen e saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1166 Përfitimet</p> <p>Bashkëjetuesit, deri sa bashkëjetojnë, kanë detyrim të ndërsjelltë për respekt të njëjtë, mirëkuptim të dyanshëm, dhe ndihmë sikur në bazë të martesës ligjore.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BASHKËSHORTËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1167 Bashkëshortët martesorë</p>	<p style="text-align: center;">Article 1165 Burden of proof</p> <p>A person who wants to derive rights from cohabitation of a man and a woman must prove its existence and duration.</p> <p style="text-align: center;">Article 1166 Benefits</p> <p>During their cohabitation, cohabitants have mutual obligation to each other for same respect, mutual understanding and support like under the legal marriage.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III - RIGHTS AND OBLIGATIONS OF SPOUSES</p> <p style="text-align: center;">Article 1167 Matrimonial Spouses</p>	<p>od ovih smetnji prestala da postoji tokom postojanja vanbračnog života.</p> <p style="text-align: center;">Član 1165 Teret dokazivanja</p> <p>Lice koja želi ostvariti prava iz suživotu jednog muškarca i jedne žene mora dokazati njegovo postojanje i trajanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 1166 Koristi</p> <p>Lica u suživotu, dok žive zajedno, imaju uzajamnu obavezu za iskazivanje istog poštovanja, uzajamnog razumevanja, i podrške kao i u zakonskom braku.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III – PRAVA I OBAVEZE SUPRUŽNIKA</p> <p style="text-align: center;">Član 1167 Bračni supružnici</p>
---	---	---

<p>1. Bashkëshortët në martesë janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore.</p> <p>2. Martesa lidhet me qëllim të përhershëm.</p> <p>3. Bashkëshortët janë të detyruar të jenë besnik ndaj njëri tjetrit dhe në mënyrë të ndërsjellë ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin financiarisht njëri tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë.</p> <p>4. Bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit të ndërsjellë, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre.</p>	<p>1. Spouses in marriage are equal, in all personal and property relations.</p> <p>2. The marriage is entered into for the permanent purpose.</p> <p>3. Spouses are obliged to be faithful to one another and reciprocally assist, respect and financially support one another, especially in case that the other is lacking a sufficient material basis for living.</p> <p>4. Spouses shall develop and live out the feeling of reciprocal solidarity, as well as solidarity towards their children.</p>	<p>1. Supružnici u braku su ravnopravni u svim ličnim i imovinskim odnosima.</p> <p>2. Brak se sklapa sa namerom da traje zauvek.</p> <p>3. Supružnici su dužni da budu verni jedno drugome i da se uzajamno pomažu, poštuju i finansijski podržavaju jedan drugog, naročito u slučaju kad jedan od supružnika nema dovoljnu materijalnu osnovu za život.</p> <p>4. Supružnici su dužni da izgrade i izraze osećanje uzajamne solidarnosti kao i osećanje solidarnosti prema svojoj deci.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1168 Mbiemri martesor</p>	<p style="text-align: center;">Article 1168 Matrimonial surname</p>	<p style="text-align: center;">Član 1168 Bračno prezime</p>
<p>1. Bashkëshortët me marrëveshje duhet të caktojnë mbiemrin e përbashkët të tyre, respektivisht mbiemrin të cilin do ta përdorin pas martesës.</p> <p>2. Me rastin e lidhjes së martesës, bashkëshortët me marrëveshje mund të vendosin:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. që secili ta mbajë mbiemrin e vet;</p>	<p>1. Spouses shall determine their common surname by agreement, respectively the surname that they are going to use after marriage.</p> <p>2. When entering into marriage, the spouses through agreement may decide:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. that each of them retains his surname;</p>	<p>1. Supružnici po dogovoru moraju da odrede svoje zajedničko prezime, odnosno prezime koje će koristiti nakon sklapanja braka.</p> <p>2. Prilikom sklapanja braka, supružnici dogovorom mogu da odluče:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. da svako od njih zadrži svoje prezime;</p>

<p>2.2. që i përbashkët të jetë mbiemri i njërit prej bashkëshortëve;</p> <p>2.3. që t'ia bashkëngjesin mbiemrin e vet mbiemrit të njërit prej bashkëshortëve.</p> <p>3. Kombinimi i mbiemrit nuk do të jetë i mundur, nëse mbiemrat e bashkëshortëve tanimë përbëhen nga mbiemri i dyfishtë. Në rast të tillë, vetëm njëri nga mbiemrat mund të kombinohet me emrin e bashkëshortit tjetër dhe të bëhet mbiemër martesor.</p> <p>4. Në rast se bashkëshortët nuk vendosin lidhur me mbiemrin martesor, secili prej tyre mban mbiemrin e vet.</p>	<p>2.2. that the common surname shall be the one of either spouse;</p> <p>2.3. to add the surname of the spouse to one surname.</p> <p>3. A surname combination shall not be possible, if the surnames of the spouses are already composed of a double surname. In this case only one of the surnames may be combined with the name of the other spouse to become the matrimonial surname.</p> <p>4. In case spouses do not decide on a matrimonial surname, each of them retains his own surname.</p>	<p>2.2. da kao zajedničko prezime uzmu prezime jednog od njih;</p> <p>2.3. da svom prezimenu dodaju prezime drugog supružnika.</p> <p>3. Kombinacija dva prezimena nije moguća ako su prezimena supružnika već sastavljena od dvostrukih prezimena. U tom slučaju samo jedno od prezimena može da bude pridodato prezimenu drugog supružnika i da postane bračno prezime.</p> <p>4. U slučaju da se supružnici ne odluče o bračnom prezimenu, svaki od njih će da zadrži svoje prezime.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1169 Vendbanimi, ekonomia familjare, profesioni</p>	<p style="text-align: center;">Article 1169 Residence, household and occupation</p>	<p style="text-align: center;">Član 1169 Prebivalište, domaćinstvo, zanimanje</p>
<p>1. Bashkëshortët martesorë, me marrëveshje, vendosin për vendbanimin e tyre.</p> <p>2. Bashkëshortët martesorë, me marrëveshje, vendosin për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare.</p> <p>3. Në rast se njëri nga bashkëshortët martesorë me marrëveshje midis tyre është përgjegjës</p>	<p>1. Matrimonial spouses decide on the place of residence through agreement.</p> <p>2. The spouses decide for maintaining common household through agreement.</p> <p>3. In case one of the matrimonial spouses is exclusively in charge with the maintenance of</p>	<p>1. Bračni supružnici, sa dogovorom, odlučuju o njihovom prebivalištu.</p> <p>2. Bračni supružnici, sa dogovorom, odlučuju o upravljanju zajedničkog domaćinstva.</p> <p>3. U slučaju da je jedan od bračnih supružnika, sa dogovorom između njih, odgovoran za održavanje poslova u kući, taj supružnik</p>

<p>për mirëmbajtjen e shtëpisë, ai/ajo udhëheq shtëpinë në përgjegjësinë vetanake.</p> <p>4. Bashkëshortët martesorë bashkërisht kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes në përpjestim me aftësitë e tyre individuale. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve konsiderohet si udhëheqja e ekonomisë familjare ashtu edhe fitimet tjera të nevojshme për jetën e familjes dhe prezumohet se ata janë pjesmarrës të barabartë me kontributet e tyre në shpenzimet familjare.</p> <p>5. Secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit.</p>	<p>household, that spouse manages the household on his own responsibility.</p> <p>4. Matrimonial spouses' both together contribute to the family maintenance in proportion to their individual capability. Mutual contribution of the spouses is considered to be household maintenance as well as other earnings that are necessary for family living and it is presumed that they are equal with their contribution in family expenditures.</p> <p>5. Each spouse is independent in selecting a job and vocation, but spouses shall previously to that find a mutual consent about this choice.</p>	<p>upravlja domaćinstvom na svoju sopstvenu odgovornost.</p> <p>4. Oba bračna supružnika su dužna da doprinosе na izdržavanju porodice u srazmeri sa svojim pojedinačnim sposobnostima. Zajednički doprinos supružnika smatra se upravljanjem domaćinstva i drugim neophodnim prihodima za porodični život i pretpostavlja se da su oni ravnopravni učesnici sa njihovim doprinosima za porodične troškove.</p> <p>5. Svaki od supružnika je samostalan u izboru svog posla i zanimanja.</p>
<p>KAPITULLI IV – MARRËDHËNIET PASURORE TË BASHKËSHORTËVE NË MARTESË DHE BASHKËJETESË</p> <p>Neni 1170 Regjimi pasuror në martesë</p> <p>1. Bashkëshortët martesorë gjatë jetës së tyre të përbashkët mund të kenë pasuri të veçantë,</p>	<p>CHAPTER IV – PROPERTY RELATIONS OF SPOUSES IN MARRIAGE AND COHABITATION</p> <p>Article 1170 Property regime in marriage and cohabitation</p> <p>1. Matrimonial spouses during their common life may have special individual property</p>	<p>POGLAVLJE IV – IMOVINSKI ODNOSI SUPRUŽNIKA U BRAKU I U SUŽIVOTU</p> <p>Član 1170 Imovinski odnos u braku</p> <p>1. Bračni supružnici tokom njihovog zajedničkog života mogu imati posebnu imovinu, stečenu pre sklapanje braka, i</p>

<p>të fituar para lidhjes së martesës, dhe pasurinë e përbashkët që krijohet me punën e tyre të përbashkët gjatë jetës bashkëshortore.</p> <p>2. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve, përveç asaj që ka qenë e fituar para lidhjes së martesës mund të krijohet edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës, me trashëgim, dhurim apo formë tjetër të përcaktuar me këtë kod ose ligj të veçantë.</p> <p>3. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve martesorë është pasuria e fituar me punën e tyre të përbashkët ose të ndarë, gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë nëse me kontratë paramartesore bashkëshortët martesorë nuk kanë përcaktuar regjimin pasuror të pasurisë së fituar gjatë martesës.</p> <p>4. Bashkëshortët martesorë me kontratë të veçantë në çdo kohë gjatë jetës së tyre të përbashkët martesore mund t'i rregullojnë çështjet pasurore dhe të vendosin për regjimin dhe administrimin e tyre pasuror.</p> <p>5. Pa një marrëveshje të tillë dhe për aq sa nuk ka marrëveshje të bërë sipas nenit 1183, atëherë zbatohen nenet vijuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1171 Pasuria e veçantë e bashkëshortëve</p>	<p>gained prior to the marriage bond, as well as the joint property that is created through their joint work during spousal life.</p> <p>2. The special (individual) property of spouses, other than the one that was made prior to the marriage bond, may also be created during the term of marriage, inheritance, donation or other form determined by this particular code or law.</p> <p>3. The joint property of married spouses is the property acquired through their joint or separate work during the continuation of marriage and the income derived from such property if the matrimonial spouses have not determined the property estate regime gained during marriage.</p> <p>4. Matrimonial spouses at any time during their joint matrimonial life may with a special contract regulate property issues and decide on their property regime and administration.</p> <p>5. Without such agreement and insofar as there is no agreement under Article 1183, then the following Articles shall apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 1171 Separate Property of Spouses</p>	<p>zajedničku imovinu koje se stvara njihovim zajedničkim radom tokom bračnog života.</p> <p>2. Posebna imovina supružnika, osim toga što je stečena pre sklapanja braka može se stvoriti i za vreme trajanja braka, putem nasleđivanja, poklona ili drugih oblika predviđenim ovim zakonikom ili posebnim zakonom.</p> <p>3. Zajednička imovina bračnih supružnika je imovina stečena njihovim zajedničkim ili odvojenim radom, za vreme trajanja braka, kao i dohodak ostvaren od te imovine, ako sa predbračnim ugovorom, bračni supružnici nisu odredili imovinski odnos te imovine koja je stečena tokom braka.</p> <p>4. Bračni supružnici sa posebnim ugovorom u bilo koje vreme tokom njihovog zajedničkog bračnog života mogu urediti imovinska pitanja i odlučiti o njihovom odnosu i upravljanju imovine.</p> <p>5. Bez jednog takvog sporazuma i sve dok nema sporazuma prema članu 1183, primenjuju se članovi koji slede.</p> <p style="text-align: center;">Član 1171 Posebna imovina supružnika</p>
--	---	---

<p>1. Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij edhe gjatë kohës së martesës.</p> <p>2. Pasuri e veçantë konsiderohet gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës me trashëgim, dhurim apo në ndonjë formë tjetër ligjore të fitimit të pronësisë.</p> <p>3. Pasuria e veçantë e investuar për rritjen e pronës së përbashkët mbetet pronësi e veçantë. Vlera e pasurisë së veçantë të investuar mbetet e pandryshuar pa marrë parasysh shtimin ose zvogëlimin e pasurisë së përbashkët, për të cilën është angazhuar pasuria e veçantë e njërit apo të dy bashkëshortëve.</p> <p>4. Pasuria që do t'i takojë bashkëshortit, me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët, bëhet pronësi e veçantë.</p> <p>5. Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale konsiderohet pasuri e veçantë e bashkëshortit që e ka krijuar, ndërsa fitimet nga ai produkt intelektual janë pasuri e përbashkët e bashkëshortëve;</p> <p>6. Pronësia e veçantë, gjatë kohëzgjatjes së martesës, administrohet dhe disponohet në</p>	<p>1. Property ownership belonging to the spouse at the time of entering into marriage remains his special property (ownership) even during the marriage.</p> <p>2. Special property ownership is also property acquired during marriage through inheritance, donation, or other legal form of property acquisition.</p> <p>3. Special property ownership invested in the increase of joint property remains a special property. The value of special property remains unchanged regardless of the addition or reduction of the joint property for which the special property of one or both spouses is engaged.</p> <p>4. The property ownership that will belong to the spouse, upon division of joint property, becomes a special property.</p> <p>5. The product of art, intellectual work or intellectual property is considered special property of the spouse who has created it, while the gains from that intellectual product are joint property of spouses;</p> <p>6. Each spouse independently administers and possesses his/her separate property during the course of the marriage</p>	<p>1. Imovina koja pripada jednom supružniku u vreme sklapanja braka ostaje njegova posebna imovina i tokom trajanja braka.</p> <p>2. Posebna imovina takođe je i imovina stečena tokom braka putem nasleđivanja, poklona ili drugih zakonskih oblika sticanja imovine.</p> <p>3. Posebna imovina uložena za povećanje zajedničke imovine ostaje posebna imovina. Vrednost posebne uložene imovine ostaje nepromenjena, bez obzira na porast ili smanjenje zajedničke imovine, za koju je angazovana posebna imovina jednog ili oba supružnika.</p> <p>4. Imovina koja će pripadati supružniku, u slučaju podele zajedničke imovine, postaje posebna imovina.</p> <p>5. Jedan umetnički proizvod, intelektualni rad ili intelektualna svojina smatra se posebnom imovinom supružnika koji ga je stvorio, dok su dobiti od tog intelektualnog proizvoda zajednička imovina supružnika;</p> <p>6. Posebna imovina, za vreme trajanja braka, se upravlja i raspolaže na nezavisen način od supružnika kome pripada.</p>
--	--	--

<p>mënyrë të pavarur nga bashkëshorti të cilit i takon.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1172 Pasuria e përbashkët</p> <p>1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë të përbashkët ose të ndarë gjatë kohëzgjatjes së martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga çfarëdo mënyre tjetër nga pasuria e përbashkët;</p> <p>2. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve (kërkesave);</p> <p>3. Pasuria e fituar me lojërat e fatit, nga dhuratat e përbashkëta, nga pronësia intelektuale, dhe format tjera të ngjashme , gjatë kohëzgjatjes së martesës konsiderohet pasuri e përbashkët.</p> <p>4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk kanë marrëveshje paramartesore apo martesore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1172 Joint property</p> <p>1. Joint property of spouses is the property acquired by joint or separate work during the course of the marriage as well as income deriving in any other manner from the joint property.</p> <p>2. Joint property may also include property rights and obligations rights (claims).</p> <p>3. Property acquired jointly through gambling games, from joint gifts, intellectual property and other similar forms, during the duration of marriage is considered as joint property.</p> <p>4. Spouses are joint owners of joint property in equal shares of joint property, if there is no matrimonial or pre matrimonial agreement.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1172 Zajednička imovina</p> <p>1. Zajednička imovina supružnika je stečena imovina zajedničkim ili odvojenim radom za vreme trajanja braka, kao i prihod koji proizilazi na bilo koji drugi način od zajedničke imovine;</p> <p>2. Zajednička imovina može takođe obuhvatiti i imovinska prava i obligaciona prava (zahteva);</p> <p>3. Imovina stečena igrama na sreću, od zajedničkih poklona, intelektualnom svojinom, i drugim sličnim oblicima, tokom trajanja braka smatra se zajedničkom imovinom.</p> <p>4. Supružnici su zajednički vlasnici u jednakim delovima zajedničke imovine ako nema pred-bračnog ili bračnog ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1173 Administrimi i pasurisë së përbashkët</p>	<p style="text-align: center;">Article 1173 Administration of joint property</p>	<p style="text-align: center;">Član 1173 Upravljanje zajedničkom imovinom</p>

<p>Pasurinë e përbashkët bashkëshortore, gjatë kohëzgjatjes së martesës, bashkëshortët e administrojnë dhe e posedojnë bashkërisht dhe me marrëveshje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1174 Regjistrimi i të drejtave në paluajtshmërinë e përbashkët</p> <p>1. Të drejtat në paluajtshmërinë e përbashkët të bashkëshortëve regjistrohen në Regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri në emër të të dy bashkëshortëve, si pronë e përbashkët në pjesë të papërcaktuara.</p> <p>2. Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është regjistruar si bartës i të drejtës së pronësisë ose të ndonjë të drejte tjetër në pronën e përbashkët të paluajtshme në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve. Paluajtshmëria e regjistruar në emrin e njërit nga bashkëshortët nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.</p> <p>3. Bashkëshorti i cili nuk është i regjistruar si bartës i së drejtës së pronësisë, në paluajtshmërinë që është pasuri e përbashkët, në çdo kohë mund të aplikojë që krahas emrit të bashkëshortit tjetër të shënohet edhe emri i</p>	<p>During the marriage, the spouses administrate and dispose of joint matrimonial property together and in agreement.</p> <p style="text-align: center;">Article 1174 Registration of rights on joint immovable property</p> <p>1. Rights on joint immovable property of spouses, are recorded in the immovable property rights register on behalf of both spouses as joint property in unspecified parts.</p> <p>2. When only one of the spouses is registered as property right holder or any other right of the joint property in the immovable property rights register, it shall be considered as if registration was carried out on behalf of both spouses. Immovable property that is registered on the name of one of the spouses cannot be alienated without the consent of both spouses.</p> <p>3. A spouse who is not registered as a holder of a right of ownership in an immovable property that is joint property can at any time apply to the name of his spouse other than his</p>	<p>Zajedničkom imovinom supružnika, tokom trajanja braka, supružnici zajedno i u dogovoru upravljaju.</p> <p style="text-align: center;">Član 1174 Upisivanje prava na zajedničkoj nepokretnosti</p> <p>1. Prava na zajedničku nepokretnost supružnika se upisuju u Registar prava na nepokretnostima u ime oba supružnika, kao zajednička imovina u neodređenim delovima.</p> <p>2. Kada se samo jedan od supružnika upisuje kao nosilac imovinskog prava ili bilo kojeg drugog pravo na zajedničku nepokretnost u registar prava na nepokretnostima, smatra se da je upis izvršen u ime oba supružnika. Nepokretnost registrovana na ime jednog od supružnika se ne može otuđiti bez saglasnosti oba supružnika.</p> <p>3. Supružnik koji nije registrovan kao nosilac imovinskog prava, na nepokretnost koja je zajednička imovina, može u bilo koje vreme podneti zahtev da pored ime supružnika, bude</p>
---	--	--

<p>tij si titullar i pronësisë në paluajtshmërinë që është pasuri e përbashkët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1175 Zbatimi i ligjeve në fuqi</p> <p>Ligjet në fuqi me të cilët rregullohen të drejtat dhe detyrimet në paluajtshmëri do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për pronën e paluajtshmërinë në pasuri të përbashkët, përveç rasteve kur me këtë Libër parashihet ndryshe.</p>	<p>name as a titular holder of joint immovable property.</p> <p style="text-align: center;">Article 1175 Enforcement of applicable laws</p> <p>Applicable laws regulating rights and obligations on immovable property shall also apply mutatis mutandis to immovable property in joint property, unless otherwise provided by this Code.</p>	<p>upisano i njegovo ime kao nosioc nepokretnosti koja je zajednička imovina.</p> <p style="text-align: center;">Član 1175 Primena važećih zakona</p> <p>Važeći zakoni koji uređuju prava i obaveze na nepokretnosti primenjuju se prikladno i na nepokretnost u zajedničkoj imovini, osim slučajeva kada se drugačije predviđa u ovoj Knjizi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1176 Detyrimet personale dhe të përbashkëta nga marrëdhëniet detyrimore</p> <p>1. Detyrimet e karakterit pasuror të bashkëshortëve janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. detyrimet e krijuara bashkërisht nga të dy bashkëshortët;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. detyrimet e krijuara nga njëri bashkëshort në mënyrë që të plotësojnë nevojat e duhura familjare;</p>	<p style="text-align: center;">Article 1176 Personal and joint obligations, obligations from obligational relationships</p> <p>1. The property character obligations of the spouses are:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. obligations incurred jointly by both spouses;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. obligations incurred by one spouse in order to meet the appropriate family needs;</p>	<p style="text-align: center;">Član 1176 Lične i zajedničke obaveze iz obligacionih odnosa</p> <p>1. Obaveze imovinskog karaktera supružnika su:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. obaveze koje su zajednički stvorili oba supružnika;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. obaveze koje je stvorio jedan od supružnika u nameri da zadovolji porodične potrebe;</p>

<p>1.3. detyrimet e bëra për përdorimin apo administrimin e pasurisë së përbashkët, ose në interes të pasurisë së përbashkët;</p> <p>1.4. detyrimet që lidhen me aktivitetet profesionale të bashkëshortit.</p> <p>2. Detyrimet e përbashkëta mund të mbulohen nga pasuria e përbashkët dhe nga pasuria e veçantë e bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët janë bashkërisht përgjegjës, detyrimet mund të mbulohen edhe nga pasuria e veçantë e cilitdo bashkëshort.</p> <p>3. Detyrimet personale që lidhen me marrëdhëniet detyimore ose nga krimi gjithashtu mund të mbulohen nga gjysma e vlerës neto të pasurisë së përbashkët, kur pasuria private e bashkëshortit debitor, të ardhurat dhe fitimet janë të pamjaftueshme për shlyerje.</p> <p>4. Çdo detyrim që nuk është pjesë e detyrimeve të përbashkëta sipas këtij neni konsiderohet detyrim i veçantë.</p> <p>5. Bashkëshorti, i cili nga pasuria e tij e veçantë e ka përmbushur detyrimin solidar, ka të drejtë të kërkojë që bashkëshorti tjetër t'ia shpërblejë pjesën e detyrimit që e ka përmbushur.</p>	<p>1.3. obligations incurred for the use or administration of joint property or in the interest of the joint property;</p> <p>1.4. obligations related to a spouse's professional activities.</p> <p>2. Joint obligations can be recovered from the joint property and from the separate property of the spouse. If the spouses are jointly liable, the obligations may also be recovered from the separate property of either spouse.</p> <p>3. Personal obligations related to obligational relationship or crime can also be recovered from half of the net value of the joint property where the special property of a debtor spouse, income and gains are insufficient for recovery.</p> <p>4. Any obligation not forming part of the joint obligation under this Article shall be considered as separate obligation.</p> <p>5. The spouse, who has fulfilled the solidarity obligation from his special property, has the right to demand that the other spouse reimburse the part of the obligation that he has fulfilled.</p>	<p>1.3. obaveze za korišćenje ili upravljanje zajedničkom imovinom, ili u interesu zajedničke imovine;</p> <p>1.4. obaveze koje se odnose na stručne aktivnosti supružnika.</p> <p>2. Zajedničke obaveze mogu biti pokrивene zajedničkom imovinom i posebnom imovinom supružnika. Ako su supružnici zajednički odgovorni, obaveze mogu biti pokrивene i posebnom imovinom bilo kojeg od supružnika.</p> <p>3. Lične obaveze koje su vezane sa obligacionim odnosima ili sa kriminalom mogu takođe biti pokrивene polovinom neto vrednosti zajedničke imovine, kada privatna imovina dužničkog supružnika, prihodi i zarade nisu dovoljne za izmirenje.</p> <p>4. Svaka obaveza koja nije deo zajedničkih obaveza iz ovog člana smatra se posebnom obavezom.</p> <p>5. Supružnik, koji je ispunio solidarnu obavezu iz svoje posebne imovine, ima pravo da zatraži od drugog supružnika da nadoknadi deo obaveze koju je ispunio.</p>
---	---	--

<p>6. Detyrimet e krijuara nga bashkëshortët, nëse nuk mund të provohet se janë detyrime të veçanta, konsiderohen se janë detyrime të përbashkëta.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1177 Marrëveshjet kontraktuese për posedim dhe administrim të pasurisë së përbashkët</p> <p>1. Bashkëshortët mund të kontraktojnë që administrimi dhe posedimi i pasurisë së përbashkët, në tërësi ose pjesë të saj, të bëhet nga njëri prej bashkëshortëve.</p> <p>2. Kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim ose vetëm posedim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të rregullta.</p> <p>3. Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të privojë në mënyrë arbitrare bashkëshortin tjetër nga pasuria e përbashkët.</p>	<p>6. Obligations created by spouses, if cannot be proved to be separate obligations, are considered to be joint obligations.</p> <p style="text-align: center;">Article 1177 Contractual arrangements on possession and administration of joint property</p> <p>1. Spouses may contract that administration and possession of joint property in a whole or in parts shall be carried out by one of the spouses.</p> <p>2. The contract may be limited only to the administration or possession. Unless otherwise contracted, administration also includes possession within regular activity.</p> <p>3. Neither of the spouses can arbitrarily deprive the other spouse of joint property.</p>	<p>6. Obaveze koje stvaraju supružnici, ako se ne mogu dokazati kao posebne obaveze, smatraju se zajedničkim obavezama.</p> <p style="text-align: center;">Član 1177 Ugovorni sporazumi za državinu i upravljanje zajedničkom imovinom</p> <p>1. Supružnici mogu da urede ugovorom da upravljanje i državinu zajedničkom imovinom, u celosti ili u delovima, vrši jedan od supružnika.</p> <p>2. Ugovor može da bude ograničen samo na upravljanje ili samo državinu. Osim ukoliko je drugačije ugovoreno, upravljanje obuhvata i državinu u okvirima redovnih aktivnosti.</p> <p>3. Nijedan od supružnika ne može na arbitraran način da liši drugog supružnika zajedničke imovine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1178 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët me marrëveshje</p> <p>1. Bashkëshortët, në çdo kohë, mund ta pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje me shkrim dhe të vërtetuar te noteri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1178 Apportioning (division of joint property) by agreement</p> <p>1. Spouses, at any time may divide their joint property by written agreement, certified with the notary.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1178 Deoba zajedničke imovine po dogovoru</p> <p>1. Supružnici mogu u bilo kom trenutku podeliti svoju zajedničku imovinu dogovorom sa pismenim i potvrđenim sporazumom kod javnog beležnika.</p>

<p>2. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet edhe në procedurë gjyqësore nga një gjykatë kompetente kur bashkëshortët nuk mund të arrijnë marrëveshje dhe kërkojnë që pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët të caktohen si pjesë të veçanta për të regjistruar të drejtën e pronësisë mbi pjesët e tyre.</p> <p>3. Këto pjesë të veçanta janë bashkëpronësi dhe shprehen në përqindje ose me thysa deri sa të bëhet ndarja fizike, nëse pasuria mund të ndahet fizikisht.</p> <p>4. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët nga ana e bashkëshortëve nuk mund t'u shkaktojë dëme personave të tretë.</p>	<p>2. Division of joint property may also be made in court proceedings by a court of competent jurisdiction where the spouses cannot reach an agreement and require that their shares in the joint property be designated as separate s to register the right of ownership over their shares.</p> <p>3. These separate parts are joint ownership and are expressed in percentages or whites until physical separation occurs, if property can be physically divided.</p> <p>4. Division the joint property by spouses cannot cause harm to third parties</p>	<p>2. Deoba zajedničke imovine može se vršiti i u sudskom postupku pred nadležnim sudom, kad supružnici ne mogu da postignu dogovor i zahtevaju da se njihovi delovi na zajedničkoj imovini odrede kao posebni delovi za upisivanje prava vlasništva nad njihovim delovima.</p> <p>3. Ovi posebni delovi su zajedničko vlasništvo i izraženi su u procenat ili razlomak sve dok ne dođe do fizičkog razdvajanja, ako se imovina može fizički podeliti.</p> <p>4. Deoba zajedničke imovine od strane supružnika, ne može naneti štetu trećim licima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1179 Përcaktimi i pjesëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 1179 Determination of shares</p>	<p style="text-align: center;">Član 1179 Određivanje udela</p>
<p>1. Pjesa e pasurisë nga pronësia e përbashkët e bashkëshortëve është e barabartë, nese nuk është paraparë ndryshe me kontratë martesore.</p> <p>2. Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat e tjera në pasurinë e përbashkët, dhe</p>	<p>1. The share of property of joint ownership of spouses is equal, unless foreseen otherwise under the marriage contract.</p> <p>2. The largest share of the spouse in a determined object or determined right, may be determined by court only if that object or right is economically independent compared to other objects and rights of the joint property and the spouse, for obtaining such object or</p>	<p>1. Udeo imovine u zajedničkom vlasništvu supružnika je jednak, ako ugovorom o braku nije drugačije određeno.</p> <p>2. Najveći udeo jednog supružnika u pojedinoj stvari, odnosno na određeno pravo, može da bude određena od strane suda samo ako je ta stvar, odnosno pravo, ekonomsko samostalno u odnosu na ostale stvari i prava u zajedničkoj imovini, i supružnik je u sticanju te stvari,</p>

<p>bashkëshorti për fitimin e atij sendi apo të drejte ka marrë pjesë me të hyrat nga pasuria e tij e veçantë.</p> <p>3. Bashkëshorti, i cili pas pushimit të bashkësisë martesore, përmes investimit, rrit vlerën e sendeve të pasurisë së përbashkët, ka të drejtën të kërkojë nga bashkëshorti tjetër kompensimin nëse investimet kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme. Kompensimi do të jetë në proporcion me pjesën e tij në atë send.</p> <p>4. Bashkëshorti tjetër mund të lirohet nga detyrimi i tillë nëse pranon pjesën më të madhe së pjesës të atij sendi në proporcion me investimet e bëra.</p>	<p>right, has largely participated with income from his separate property.</p> <p>3. The spouse, who after the cease of the marital union increases the value of objects from the joint property by investment, has the right to claim remuneration from the other spouse, if investments were necessary and useful. Remuneration shall be in proportion with his share in the object.</p> <p>4. The other spouse may be released from such obligation, if he accepts to receive the largest share of that object in proportion with the investments made.</p>	<p>odnosno prava učestvovao prihodima od svoje posebne imovine.</p> <p>3. Supružnik koji ulaganjem izvršenim posle prestanka bračne zajednice, uveća vrednost stvari iz zajedničke imovine, ima pravo da zahteva naknadu od drugog supružnika, ako je ulaganje bilo nužno i korisno. Naknada mora da bude u srazmeri sa delom supružnika u toj stvari.</p> <p>4. Drugi supružnik može da bude oslobođen te obaveze ako prizna veći udeo u toj stvari srazmerno sa izvršenim ulaganjima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1180 Koha dhe subjektet që mund të kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët</p> <p>1. Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohej gjatë martesës, me rastin e zgjidhjes së martesës dhe pas zgjidhjes së saj.</p> <p>2. Të drejtën që të kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët e kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 1180 Time limits and subjects that can demand division of joint property</p> <p>1. Division of joint spousal property may be requested during marriage, upon dissolution of marriage and at its dissolution.</p> <p>2. Persons eligible to demand division of joint property are: spouses, heirs of a dead spouse of a spouse that is announced dead, creditors of one of the spouses, if the claims of the creditor cannot be realized from the separate</p>	<p style="text-align: center;">Član 1180 Vreme i lica koji mogu zahtevati podelu zajedničke imovine</p> <p>1. Podela zajedničke imovine supružnika može da bude zatražena za vreme braka, u toku raskida braka i posle njegovog prestanka.</p> <p>2. Pravo da traže podelu zajedničke imovine imaju: supružnici, naslednici umrlog supružnika ili supružnika koji je proglašen za umrlog, kao i poverilac jednog od supružnika ukoliko svoje potraživanje ne može da ostvari</p>

<p>kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga prona e veçantë e atij bashkëshorti. Kreditorët nuk mund të kërkojnë pjesëtimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve nëse kërkesa e tyre është e parashkruar.</p>	<p>property of that spouse who is the debtor. Creditors cannot demand division of joint property of matrimonial spouse if their claim is prescript.</p>	<p>iz posebne imovine tog supružnika. Poverilac ne može zahtevati podelu zajedničke imovine supružnika ako je njihov zahtev zastareo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1181 Shuarja e pasurisë së përbashkët</p>	<p style="text-align: center;">Article 1181 Extinction of joint property</p>	<p style="text-align: center;">Član 1181 Prestanak zajedničke imovine</p>
<p>1. Shuarja e regjimit juridik të pronës së fituar gjatë bashkësisë martesore ndodh:</p>	<p>1. Extinction of the legal regime of spouse's property acquired during the marriage occurs:</p>	<p>1. Prestanak pravnog odnosa imovine stečene tokom bračne zajednice nastaje:</p>
<p>1.1. në ditën e vdekjes së njërit bashkëshort ose në datën e shpalljes së njërit bashkëshort për të vdekur;</p>	<p>1.1. on the day the death of a spouse or at the day of announcement of one spouse dead;</p>	<p>1.1. na dan smrti jednog od supružnika ili na dan objavljivanja supružnika koji je proglašen za umrlog;</p>
<p>1.2. në rast të anulimit të martesës, nga dita kur është bërë kërkesa për anulim të martesës.</p>	<p>1.2. on the day of annulment of the marriage, from the day when the request for annulment of the marriage was submitted;</p>	<p>1.2. u slučaju poništenja braka, od dana podnošenja zahteva za poništenje braka.</p>
<p>1.3. në rast të shkurorëzimit, nga data e paraqitjes së kërkesës për shkurorëzim;</p>	<p>1.3. in case of divorce, from the date of application for divorce;</p>	<p>1.3. u slučaju razvoda, od dana podnošenja zahteva za razvod braka;</p>
<p>1.4. me ndërprerjen e jetës së përbashkët bashkëshortore, nga data e ndarjes së tyre;</p>	<p>1.4. by termination of their joint matrimonial live, from the day of their separation;</p>	<p>1.4. prestankom zajedničkog supružničkog života, od dana njihovog razdvajanja;</p>
<p>1.5. me marrëveshje për ndarje të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.</p>	<p>1.5 with an agreement for division of joint spousal property.</p>	<p>1.5. sporazumom supružnika o podeli zajedničke imovine.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1182 Pasuria e fituar në bashkëjetesë</p> <p>1. Pasuria e fituar me punën e përbashkët gjatë kohëzgjatjes së bashkëjetesës konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkëjetuesve.</p> <p>2. Dispozitat e këtij Kodi, në lidhje me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve martesorë, vlejnë përshtatshmërisht, edhe për pasurinë e përbashkët të burrit dhe gruas në bashkëjetesë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1182 Property acquired during cohabitation</p> <p>1. Property acquired by joint work during cohabitation is considered joint property of cohabitants.</p> <p>2. Provisions of this code relating to evaluation and division of joint property of matrimonial spouses applied analogically for joint property of man and woman in cohabitation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1182 Stečena imovina u vanbračnom životu</p> <p>1. Imovina stečena zajedničkim radom za vreme trajanja vanbračnog života, smatra se zajedničkom imovinom partnera vanbračnog života.</p> <p>2. Odredbe ovog Zakonika, koje se odnose na zajedničku imovinu bračnih supružnika, se prikladno primenjuju i na zajedničku imovinu muškarca i žene u zajedničkom životu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1183 Marrëveshja paramartesore ose martesore lidhur me pasurinë e fituar gjatë martesës</p> <p>1. Para lidhjes së martesës ose gjatë martesës, në çdo kohë, mund të lidhet një marrëveshje martesore për çështjet për pasurinë e fituar gjatë martesës.</p> <p>2. Marrëveshja paramartesore hyn në fuqi në ditën e regjistrimit të martesës, ndërsa kontrata e lidhur nga bashkëshortët gjatë martesës hyn në fuqi në momentin e noterizimit të saj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1183 Premarital or marital agreement related to property acquired during marriage</p> <p>1. A marital agreement related to the property acquired during the marriage may be concluded at any time before entering into marriage or during marriage.</p> <p>2. Premarital agreement shall come into effect on the day of the registration of the marriage, while the contract concluded by spouses during the marriage enters into force at the moment of its notarisation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1183 Predbračni ili bračni sporazum koji se odnosi na imovinu stečenu tokom braka</p> <p>1. Pre sklapanja braka ili tokom braka, u bilo koje vreme, može se zaključiti jedan bračni sporazum o pitanjima vezanim za imovinu stečenu tokom braka.</p> <p>2. Predbračni sporazum stupa na snagu dana upisivanja braka, a ugovor zaključen od strane supružnika tokom braka stupa na snagu u trenutku njegove overe od javnog beležnika.</p>

<p>3. Me marrëveshje martesore, të fejuarit apo bashkëshortët përcaktojnë marrëdhëniet e tyre pronësore për të ardhmen në përputhje me dispozitat e këtij kodi dhe ligjeve tjera në fuqi.</p> <p>4. Marrëveshja paramartesore ose martesore nuk mund të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe duhet të respektojë ligjin e aplikueshëm të vendit ku lidhet martesa.</p> <p>5. Një person, i cili është ligjërisht i paaftë, nuk mund të hyjë në marrëveshje martesore.</p>	<p>3. By a marital agreement, the fiancées or spouses define their property relations for the future in accordance to the provisions of this code and applicable laws.</p> <p>4. The marital or premarital agreement cannot be contrary to the legal provisions and should respect applicable laws of the country where the marriage is entered to.</p> <p>5. A person, who is legally incapable, cannot enter into a marital agreement.</p>	<p>3. Sa bračnim sporazumom, verenici ili supružnici određuju svoje buduće imovinske odnose u skladu sa odredbama ovog zakonika i drugih važećih zakona.</p> <p>4. Predbračni ili bračni sporazum ne sme biti u suprotnosti sa zakonskim odredbama i mora poštovati zakon na snagu onog mesta gde se sklapa brak.</p> <p>5. Lice koje je pravno nesposobno, ne može sklopiti bračni sporazum.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1184 Marrëveshjet midis personave në bashkëjetesë</p>	<p style="text-align: center;">Article 1184 Agreements between persons in cohabitation</p>	<p style="text-align: center;">Član 1184 Sporazumi između lica u vanbračnom životu</p>
<p>Personat që jetojnë në bashkëjetesë mund të lidhin një marrëveshje me shkrim dhe të vërtetuar te noteri lidhur me pasurinë që do ta fitojnë gjatë bashkëjetesës, me punën e tyre të përbashkët. Bashkëjetuesit një marrëveshje të tillë mund ta lidhin edhe gjatë kohës së bashkëjetesës.</p>	<p>1. People living in cohabitation may conclude a written agreement authenticated by a notary regarding the property that they will acquire during cohabitation by their joint work. Cohabitants may conclude such agreement during cohabitation period.</p>	<p>1. Lica koje žive u vanbračnom životu mogu zaključiti pismeni i overeni sporazum kod javnog beležnika vezano za imovinu koju će steći tokom vanbračnog života, sa zajedničkim radom. Lica koja žive u vanbračnom životu mogu zaključiti takav sporazum i tokom vremena vanbračnog života.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1185 Forma dhe vërtetimi noterial i marrëveshjes</p> <p>1. Marrëveshjet për çështjet pronësore janë të vlefshme vetëm nëse janë lidhur para noterit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1185 Notarial form and certification of agreement</p> <p>1. Agreements related to property issues are only valid if entered into before the notary.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1185 Javnobeležnička potvrda i oblik sporazuma</p> <p>1. Sporazumi o pitanjima imovine važe samo ako su zaključeni pred javnim beležnikom.</p>

<p>2. Noteri e lexon marrëveshjen (kontratën) me zë dhe u shpjegon palëve pasojat e marrëveshjes (kontratës). Noteri siguron se bashkëshorti që humb të drejtat përmes marrëveshjes, e kupton këtë fakt dhe vendos lirshëm për ta nënshkruar marrëveshjen.</p> <p>3. Kontrata përpilohet me shkrim dhe nënshkruhet pranë noterit pas sqarimit të nevojshëm të dhënë palëve, dhe e njëjta vërtetohet nga noteri.</p> <p>PJESA E TRETË</p> <p>KAPITULLI I – PËRFUNDIMI I MARTESËS</p> <p>Nënkapitulli I - Rregullat e Përgjithshme</p> <p>Neni 1186 Zgjidhja e martesës</p> <p>1. Gjykata dhe çdo person i interesuar për zgjidhje të martesës do t'i ketë parasysh parimet e mëposhtme të përgjithshme:</p> <p>1.1. institucioni i martesës duhet të ruhet;</p>	<p>2. The notary will read out the agreement (contract) and explain to the parties consequences of the agreement (contract). Notary ensures that the spouse who loses rights through the agreement understands this fact and that he freely decides to sign the agreement.</p> <p>3. The contract shall be made in writing, signed in front of the notary after the enlightenment of the parties and will be certified by the notary.</p> <p>PART THREE</p> <p>CHAPTER I – DISSOLUTION OF MARRIAGE</p> <p>Sub-chapter I – General Principles</p> <p>Article 1186 Dissolution of marriage</p> <p>1. The court and any person concerned with a dissolution of marriage shall have regard to the following general principles:</p> <p>1.1. Institution of marriage shall be preserved;</p>	<p>2. Javni beležnik glasno čita sporazum (ugovor) i objašnjava strankama posledice sporazuma (ugovora). Javni beležnik osigurava da supružnik koji gubi prava preko sporazuma, shvata tu činjenicu i slobodno odlučuje da potpiše sporazum.</p> <p>3. Ugovor se sastavlja u pisanom obliku i potpisuje pred javnim beležnikom nakon što je strankama dato potrebno pojašnjenje, a isti je overen od strane javnog beležnika.</p> <p>DEO TREĆI</p> <p>POGLAVLJE I – PRESTANAK BRAKA</p> <p>Potpoglavlje I – Opšta Pravila</p> <p>Član 1186 Rešavanje braka</p> <p>1. Sud i bilo koje lice koje ima pravni interes za rešavanje braka, dužni su da uzmu u obzir dole navedena opšta načela:</p> <p>1.1. institucija braka treba da se čuva.</p>
---	--	---

<p>1.2. bashkëshortët në martesë e cila mund të jetë shkëputur, duhet të inkurajohen t'i marrin të gjitha hapat e zbatueshëm përmes këshillimit për martesë, procedurave të pajtimit të parashikuara në këtë kod, ndërmjetësimit ose mënyrave tjera për ta ruajtur martesën;</p> <p>1.3. martesë e cila në mënyrë të pakthyeshme është shkëputur duhet të zgjidhet:</p> <p>1.3.1. me minimum të shqetësimit për palët dhe fëmijët e prekur;</p> <p>1.3.2. të zgjidhet në atë mënyrë që të promovojnë sa më mirë marrëdhënie të vazhdueshme mes palëve dhe fëmijëve të prekur sa është e mundur në rrethanat; dhe</p> <p>1.3.3. pa shpenzime të paarsyeshme të përfshira në lidhje me procedurat që duhet ndjekur në sjelljen e martesës në një përfundim;</p> <p>1.4. çdo rrezik për të keqe ose dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve duhet të shmangët dhe të mbrohen nga dhuna.</p>	<p>1.2. spouses to a marriage which may have dissolved are to be encouraged to take all practicable steps, whether by marriage counselling, reconciliation procedures foreseen by this code, mediation or other methods, to save the marriage;</p> <p>1.3. a marriage which has irretrievably broken down should be dissolved;</p> <p>1.3.1. with minimum distress to the parties and to the children affected;</p> <p>1.3.2. dealt with in a manner designed to promote as good a continuing relationship between the parties and any children affected as possible in the circumstances; and</p> <p>1.3.3. without costs being unreasonably incurred in connection with the procedures to be followed in bringing the marriage to an end.</p> <p>1.4. any risk of harm or violence to spouses and to children should be avoided and to get protected from violence.</p>	<p>1.2. supružnici u braku koji se možda ukinuo, trebaju se ohrabriti da preuzmu sve primenjive korake putem bračnih savetovanja, postupka pomirenja predviđenim ovim zakonikom, posredovanjem, ili na drugi način, kako bi sačuvali svoj brak;</p> <p>1.3. brak koji je nepovratno ukinut treba biti rešen:</p> <p>1.3.1. uz najmanje uznemirenje za pogođene stranke i decu;</p> <p>1.3.2. uz rešavanje svih pitanja na taj način da promovise na što bolji mogući način odnose između pogođenih stranaka i dece shodno okolnostima; i</p> <p>1.3.3. bez stvaranja nerazumnih obuhvaćenih troškova u vezi postupaka koje se trebaju pratiti na okončanje jednog braka;</p> <p>1.4. treba se izbegavati bilo kakva opasnost od povrede ili nasilja prema supružnicima i deci, i trebaju se zaštititi od nasilja</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1187 Mënyrat e përfundimit të martesës</p> <p>1. Martesa përfundon me vdekjen e bashkëshortit, shpalljen e bashkëshortit të zhdukur të vdekur, anulimit dhe shkurorëzimit.</p> <p>2. Martesa zgjidhet vetëm pas parashtrimit të padisë, respektivisht të propozimit për shkurorëzim, dhe me vendim të gjykatës, përmes anulimit ose shkurorëzimit.</p> <p>3. Anulimi ose shkurorëzimi prodhojnë efekte juridike kur aktgjykimi i gjykatës për anulimin ose shkurorëzimin e martesës marrin formën e prerë.</p> <p>4. Kur bashkëshorti i zhdukur shpallet i vdekur, martesa përfundon në ditën kur vdekja e bashkëshortit të zhdukur përcaktohet me aktvendimin e formës së prerë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1187 Ways of dissolution of marriage</p> <p>1. Marriage is dissolved upon death of the spouse, announcement of the missing spouse dead, annulment or divorce.</p> <p>2. Marriage is dissolved only upon submission of claim or proposal for divorce, and by court order through annulment or divorce.</p> <p>3. Annulment or divorce produce legal effects when the judgments of the court annulling or divorcing marriage becomes final.</p> <p>4. When a missing spouse is announced dead, marriage is dissolved the day when the death of the missing spouse is concluded by final judgment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1187 Načini prestanka braka</p> <p>1. Brak prestaje smrću jednog od supružnika, proglašenjem nestalog supružnika umrlim, poništenjem ili razvodom.</p> <p>2. Brak je rešen samo posle podnošenja tužbe, odnosno predloga za razvod, i putem sudske odluke putem poništenja i razvoda braka.</p> <p>3. Poništenje ili razvod postaju pravosnažni kad presuda kojom je sud poništio ili razveo brak postane konačna.</p> <p>4. Kad je nestali supružnik proglašen mrtvim, brak prestaje danom kad nestali supružnik bude proglašen za umrlog, konačnom presudom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1188 Zgjidhja e bashkëjetesës</p> <p>Për ta zgjidhur një bashkëjetesë nuk kërkohet veprim ligjor zyrtar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1188 Dissolution of cohabitation</p> <p>No legal action shall be required to dissolve cohabitation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1188 Rešavanje vanbračnog života</p> <p>Ne zahteva se nikakva pravna radnja da bi se rešio jedan vanbračni život.</p>

<p align="center">Nënkapitulli II – Anulimi i Martesës</p> <p align="center">Neni 1189 Kolizioni i martesës</p> <p>1. Martesa e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët është nule.</p> <p>2. Martesa e re e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët nuk do të anulohet, nëse martesa e mëparshme është zgjidhur ndërkohë.</p> <p>3. Kur të dy martesat zgjidhen njëkohësisht për shkak të vdekjes së bashkëshortit i cili ka hyrë në martesë të re duke qenë i martuar me person tjetër, martesa e re do të anulohet, përveç në rastet kur martesa e re ka zgjatur së paku për tri vite, dhe kur bashkëshorti nga martesa e mëparshme nuk ka ndërmarrë veprime për të rithemeluar bashkësi martesore dhe bashkëjetesë.</p> <p align="center">Neni 1190 Dhuna dhe kërcënimi</p> <p>Martesa do të anulohet nëse bashkëshorti e ka dhënë pëlqimin për lidhjen e martesës me anë të dhunës ose kërcënimit serioz.</p>	<p align="center">Sub-chapter II – Marriage Annulment</p> <p align="center">Article 1189 Collision of marriages</p> <p>1. Marriage entered into at the time of existence of previous marriage of one of the spouses is void.</p> <p>2. New marriage entered into at the time of the existence of the previous marriage of one of the spouses shall not be annulled, if previous marriage was dissolved in the meantime.</p> <p>3. When both marriages are dissolved simultaneously due to the death of the spouse who entered into a new marriage, while still being legally married to another person, new marriage shall be annulled, except when the new marriage has lasted for several years and the spouse from the previous marriage has not undertaken actions to re-establish marital relationship and cohabitation.</p> <p align="center">Article 1190 Violence and threat</p> <p>Marriage shall be annulled if the spouse has given consent to marry while under violence or serious threat.</p>	<p align="center">Potpoglavlje II – Poništenje Braka</p> <p align="center">Član 1189 Kolizija braka</p> <p>1. Brak sklopljen u vreme postojanja jednog braka jednog od supružnika je ništav.</p> <p>2. Novi brak sklopljen u vreme postojanja jednog braka jednog od supružnika neće se poništiti, ukoliko prethodni brak se u međuvremenu rešio.</p> <p>3. Kad oba braka budu istovremeno rešena usled smrti supružnika koji je sklopio novi brak u vreme postojanja ranijeg braka, novi sklopljeni brak će biti poništen, osim u slučaju da je novi brak trajao najmanje tri godine, i kad supružnik iz ranijeg braka nije preduzimao nikakve radnje u cilju ponovnog uspostavljanja bračne zajednice ili vanbračnog života.</p> <p align="center">Član 1190 Prinuda i pretnja</p> <p>Biće poništen brak ako je supružnik dao svoj pristanak za sklapanje braka pod prinudom ili ozbiljnom pretnjom.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 1191 Mangësitë formale që shkaktojnë anulimin e martesës</p> <p>1. Martesa mund të anulohet edhe për shkak të mosplotësisimit të kërkesave formale për martesë, të parapara në nenet 1138-1149 dhe 1152 të këtij libri. Respektivisht nëse:</p> <p>1.1. bashkëshorti nuk ka aftësi të plotë për të vepruar për shkak të paaftësisë për të gjykuarke, ose</p> <p>1.2. martesë është e lidhur në mes të personave në gjini gjaku, në gjini të adoptimit apo në gjini të krushqisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1191 Formal deficiencies that cause annulment of marriage</p> <p>1. Marriage may be annulled if the formal requirements for marriage foreseen in Articles 1138-1149 and Article 1152 of this Book are not met. Namely if:</p> <p>1.1. the spouse doesn't have full capacity to act because of incapacity to judge; or</p> <p>1.2. marriage was entered into between persons in consanguinity or persons of the same kin based on adoption or affinity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1191 Formalni nedostaci koji uzrokuju poništenje braka</p> <p>1. Brak se takođe može poništiti ako nisu ispunjeni formalni zahtevi za brak, predviđeni u članovima 1138.-1149. i 1152. u ovoj Knjizi. Odnosno, ako:</p> <p>1.1. supružnik nema potpunu sposobnost da postupa zbog nesposobnosti rasuđivanja, ili</p> <p>1.2. brak je sklopljen između lica u krvnom srodstvu, u srodstvu na osnovu usvojenja ili u srodstvu po tazbini.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1192 Lajthimi dhe mashtrimi</p> <p>1. Martesa mund të anulohet nëse është lidhur në lajthim për sa i përket identitetit të bashkëshortit.</p> <p>2. Martesa e lidhur me mashtrim të paramenduar për faktet të cilat po të njiheshin me kohë do ta ndalonin bashkëshortin tjetër ta lidhte këtë martesë dhe që tani e bëjnë jetën e përbashkët të padurueshme do të anulohet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1192 Error and deceit</p> <p>1. Marriage may be annulled if entered into by error regarding the identity of the spouse.</p> <p>2. Marriage entered into because of willful deceit regarding facts, which, if known in time would have stopped the spouse from entering into such marriage, and which now make common life unbearable shall be annulled.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1192 Zabluda i prevara</p> <p>1. Brak može da bude poništen ako je bio sklopljen u zabludi u odnosu na ličnost supružnika.</p> <p>2. Brak koji je bio sklopljen usled namerne prevare u odnosu na činjenice koje bi, da su na vreme bile poznate, zaustavile drugog supružnika od sklapanja tog braka, i koje sada čine nepodnošljivi zajednički život, biće poništen.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1193 Mungesa e qëllimit</p> <p>1. Martesa e lidhur pa qëllim të jetës së përbashkët në mes bashkëshortëve është nule.</p> <p>2. Martesa është e pavlefshme kur bashkëshortët me anë të martesës në të vërtetë nuk kanë qenë të interesuar të krijojnë bashkëjetesë (jetë të përbashkët), por të fshehin disa veprime juridike ose fillimisht dëshirojnë të arrijnë qëllime tjera (siç janë trashëgimi ligjor, pensioni familjar, ikja nga përgjegjësia penale, dhe keqpërdorimi i çfarëdo të drejte tjetër).</p> <p>3. Martesa e tillë nuk do të anulohet nëse më vonë vendoset të krijohet bashkëjetesa.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1193 Lack of intent</p> <p>1. Marriage entered into without the aim of co-existence of the spouses is null.</p> <p>2. Marriage is void when the spouses through marriage were in fact not interested to establish cohabitation (joint life) but want to hide some other legal action or primarily want to achieve another goal (i.e. legal succession, family pension, escape from criminal liability or misuse of any other rights).</p> <p>3. Such marriage shall not be annulled, if it is later decided to establish cohabitation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1193 Nedostatak namere</p> <p>1. Brak koji je sklopljen bez namere za zajednički život između supružnika je nevažeći.</p> <p>2. Brak je nevažeći kad supružnici nisu stvarno želeli da brakom uspostave zajednicu života (zajednički život) već da sklapanjem braka prikriju neke druge pravne radnje ili prvenstveno žele da ostvare druge ciljeve (kao što su zakonsko nasleđivanje, porodičnu penziju, izbegavanje krivičnog gonjenja, i zloupotrebu bilo kog drugog prava).</p> <p>3. Ovakav brak neće biti poništen ako supružnici naknadno odluče da uspostave zajednicu života.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1194 E drejta për të parashtruar padi</p> <p>1. Personat që kanë të drejtë të parashtrojnë padi për anulimin e martesës për shkaqet e parapara në këtë Libër janë bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat tjerë të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë juridik për anulimin e martesës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1194 Right to file claim</p> <p>1. Persons eligible in filing a claim for the annulment of marriage due to reasons provided for in this Book are the spouses, public prosecutor and all other persons who have a direct legal interest in the annulment of marriage.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1194 Pravo na podnošenje tužbe</p> <p>1. Lica koja imaju pravo na podnošenje tužbe za poništenje braka iz razloga propisanih u ovoj Knjizi su supružnici, javni tužilac i sva druga lica koja imaju neposredni pravni interes da brak bude poništen.</p>

<p>2. Kur shkaqet e parapara në këtë Libër shuhen, e drejta për të parashtruar padi për anulimin e martesës i takon vetëm bashkëshortit i cili ka pësuar nga lajthimi ose paaftësia ligjore. Padia duhet të parashtrohet brenda një viti nga data kur shkaqet e lartpërmendura shuhen.</p>	<p>2. When reasons provided for in this Book cease, the right to file a claim for the annulment of marriage belongs only to the spouse who has suffered from the error or legal incapacity. The claim may be filed within one year from the date, the aforementioned reasons ceased to exist.</p>	<p>2. Kada razlozi propisani u ovoj Knjizi prestanu, pravo na tužbu za poništenje braka pripada samo supružniku koji je pretrpeo zabludu ili pravnu nesposobnost. Tužba može biti podneta u roku od jedne godine od dana prestanka navedenih razloga.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli III – Shkurorëzimi</p> <p style="text-align: center;">Neni 1195 Shkurorëzimi</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter III – Divorce</p> <p style="text-align: center;">Article 1195 Divorce</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje III – Razvod</p> <p style="text-align: center;">Član 1195 Razvod</p>
<p>1. Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, me padi ose propozim, të njërit bashkëshort ose të të dy bashkëshortëve.</p>	<p>1. Marriage may be dissolved by divorce only upon decision of a court upon claim or proposal of one spouse or both spouses.</p>	<p>1. Brak se može rešiti razvodom samo na osnovu odluke suda, tužbom ili predlogom, jednog supružnika ili oba supružnika.</p>
<p>2. Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar propozim në gjykatën kompetente.</p>	<p>2. One spouse or both may by mutual agreement request a divorce by filing a proposal with the competent court.</p>	<p>2. Jedan ili oba supružnika mogu uz zajednički sporazum da zatraže razvod braka podnošenjem predloga pred nadležnim sudom.</p>
<p>3. Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë</p>	<p>3. If one of the spouses files a claim for divorce and the other spouse the latest until the conclusion of the main court session expressly declares not to reject the soundness of the requests in the complaint, it shall be considered, that the spouses have submitted a proposal for divorce by agreement.</p>	<p>3. Ako jedan supružnik podnese tužbu za razvod, a drugi supružnik najkasnije do zaključenja glavne rasprave, izričito izjavi da ne osporava osnovanost tužbenog zahteva, smatraće se da su supružnici podneli sporazumni predlog za razvod.</p>

<p>paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1196 Shkaqet për shkurorëzim</p> <p>Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet e tyre martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, si dhe kur për shkaqe të tjera martesë është shkëputur në mënyrë të pashmueshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1196 Causes for divorce</p> <p>The spouse may request divorce when their marital relations have seriously and continuously become disordered and when due to other causes the marriage has irretrievably broken down.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1196 Razlozi za razvod</p> <p>Supružnik može da zatraži razvod ako su braćni odnosi ozbiljno ili trajno poremećeni ili kad se iz drugih razloga brak nepovratno prekine.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli IV – Mbrojtja e Fëmijëve dhe Bashkëshortëve</p> <p style="text-align: center;">Neni 1197 Parimet e mbrojtjes</p> <p>Së bashku me kërkesën për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrajnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter IV – Protection of Children and Spouses</p> <p style="text-align: center;">Article 1197 Principles of protection</p> <p>Together with the claim for divorce by mutual agreement, spouses are obliged to submit a written agreement of custody, education and feeding of their joint children, as well as a written proposal on how personal contacts between the child and both of the parents shall be guaranteed in the future.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje IV – Zaštita Dece i Supružnika</p> <p style="text-align: center;">Član 1197 Naćela zaštite</p> <p>Uz zahtev za sporazumni razvod supružnici su dužni da podnesu pisani sporazum o staranju, vaspitavanju i izdržavanju svoje zajednićke dece, kao i pisani predlog o naćinu na koji će ubuduće da garantuju izdržavanje lićnih kontakata između deteta i oba roditelja.</p>

<p align="center">Neni 1198 Mbajtja e domosdoshme e bashkëshortit</p>	<p align="center">Article 1198 Necessary livelihood of spouse</p>	<p align="center">Član 1198 Neophodno izdržavanje supružnika</p>
<p>1. Gjatë procedurave të kontesteve martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin.</p> <p>2. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e ndal ekzekutimin e vendimit.</p> <p>3. Nëse rrethanat e bëjnë të nevojshme, një bashkëshort mund të kërkojë që tjetri t'ia lejojë përdorimin e vetëm të shtëpisë bashkëshortore ose të një pjese të shtëpisë bashkëshortore për aq sa zgjatë kontesti martesor gjyqësor. Gjykata nxjerr vendimin duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht interesat më të mira të fëmijëve që jetojnë në familje, dhunën e përdorur nga njëri bashkëshort ndaj tjetrit, ose ndaj fëmijëve, dhe të drejtat financiare dhe interesat e të dy bashkëshortëve.</p>	<p>1. During court procedures of marriage disputes, based on claim, court may determine by decision about temporary measures to provide financial livelihood for the spouse.</p> <p>2. Appeal against the ruling provided for in paragraph 1 of this Article does not stop the execution of the ruling.</p> <p>3. If the circumstances make it necessary, one spouse may demand that the other permit him the sole use of the matrimonial home or of part of the matrimonial home for the time of the marriage court disputes. Court will render the decision considering all the circumstances of the case, in particular the best interests of children living in the household, any violence used by a spouse towards the other or the children, and financial rights and interests of both spouses</p>	<p>1. Tokom postupka bračnih sporova, odlukom zasnovanom na tužbi, sud može odrediti privremene mere za obezbeđivanje finansijskog izdržavanja supružnika.</p> <p>2. Žalba protiv odluke iz stava 1. ovog člana ne zaustavlja izvršenje odluke.</p> <p>3. Ako okolnosti čine potrebnim, jedan supružnik može zahtevati od drugog da dozvoli korišćenje samo kuće supružnika ili jednog dela kuće supružnika dok traje sudski bračni spor. Sud donosi odluku uzimajući u obzir sve okolnosti slučaja, posebno najbolje interese dece koja žive u porodici, korišćeno nasilje jednog supružnika nad drugim ili nad decom, i finansijska prava i interese oba supružnika.</p>

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli V – Procedura në Kontestet Martesore</p> <p style="text-align: center;">Neni 1199 Kompetenca</p> <p>Në kontestet martesore kompetencën territoriale përveç gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale e ka edhe gjykata në territorin e të cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1200 E drejta e kujdestarit</p> <p>Kujdestari mund të parashtrojë padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit i cili vuan nga sëmundjet psikike të diagnostifikuara, ose në emër të personit të paaftë për të vepruar vetëm me pëlqimin e mëparshëm të Organit të Kujdestarisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1201 Përfjashtimi i publikut</p> <p>Publiku përjashtohet nga procedurat e kontestit martesor.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter V – Procedure on Matrimonial Disputes</p> <p style="text-align: center;">Article 1199 Competence</p> <p>In marital disputes, apart from the court with overall territorial jurisdiction, the court in the territory of which the spouses had their last joint residence, shall have jurisdiction</p> <p style="text-align: center;">Article 1200 Right of the Custodian</p> <p>The custodian, may file a claim for divorce on behalf of the spouse suffering from diagnosed mental illness or the person suffering incapacity to act only with previous consent of the Custodian Body.</p> <p style="text-align: center;">Article 1201 Exclusion of Public</p> <p>Public is excluded from the procedures of marital disputes.</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje V – Postupak u Bračnim Sporovima</p> <p style="text-align: center;">Član 1199 Nadležnost</p> <p>Pored suda sa opštom teritorijalnom nadležnošću, u bračnim sporovima nadležan je sud na čijoj su teritoriji supružnici imali svoje poslednje zajedničko prebivalište.</p> <p style="text-align: center;">Član 1200 Pravo staratelja</p> <p>Staratelj može da podnese tužbu za razvod braka, u ime supružnika koji boluje od dijagnostificirane psihičke bolesti ili u ime lica koje nema pravnu sposobnost samo uz prethodno dobijenu saglasnost organa starateljstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1201 Isključenje javnosti</p> <p>Javnost je isključena iz postupka u bračnim sporovima.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 1202 Parimet</p> <p>1. Aktgjykimi për shkurorezim duhet të merret pas një periudhe të përpjekjeve për pajtim të zhvilluara nga gjykata në seanca të veçanta përveç kur:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. një nga bashkëshortët është i paaftë për të vepruar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. kur një apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.</p> <p>2. Periudha e pajtimit do t'u mundësojë bashkëshortëve një periudhë për të shqyrtuar dhe vlerësuar vendimin e tyre duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe pasojat.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1202 Principles</p> <p>1. Court decision on divorce shall be taken after a period of efforts of reconciliation guided by the court in special court sessions except when:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. One of the spouses is incapacity to act;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. When one or both spouses live abroad;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. When place of residence of one of the spouses is not known.</p> <p>2. The reconciliation period shall allow spouses a period for reflection and consideration of their decision and to consider all circumstances and consequences.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1202 Načela</p> <p>1. Sudska presuda o razvodu braka se mora doneti nakon perioda napora pomirenja kojima upravlja sud na posebnim sednicama, osim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kad jedan od supružnika nema pravnu sposobnost;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. kad jedan ili oba supružnika žive u inostranstvu;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. kad prebivalište jednog od supružnika nije poznato.</p> <p>2. Period pomirenja omogućava supružnicima period za razmatranje i preispitivanje njihove odluke uzimajući u obzir sve okolnosti i posledice.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1203 Procedurat e pajtimit</p> <p>1. Në kontestin e shkurorezimit gjykata është e detyruar të tentojë të arrijë pajtimin formal.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1203 Reconciliation procedures</p> <p>1. In divorce disputes, court is obliged to try to achieve formal reconciliation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1203 Postupak pomirenja</p> <p>1. U sporovima o razvodu braka, sud je obavezan da pokuša da postigne formalno pomirenje.</p>

<p>2. Aktgjykimi për shkurorëzim u dërgohet palëve vetëm pas përfundimit të procedurës dhe vetëm nëse pajtimi nuk ka pasur sukses.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1204 Seanca e pajtimit</p> <p>Kur gjykata udhëheq procedurën e pajtimit të bashkëshortëve, ajo do të caktojë seanca të veçanta në përpjekje për të arritur pajtimin përderisa konstaton se gjasat për arritjen e pajtimit akoma ekzistojnë.</p>	<p>2. Decision on divorce is sent to the parties only after concluding the procedures and only if reconciliation was not successful.</p> <p style="text-align: center;">Article 1204 Reconciliation sessions</p> <p>When court is conducting reconciliation procedure of the spouses, it shall assign special sessions in efforts to reach reconciliation, as far as it concludes that chances to achieve reconciliation still exist.</p>	<p>2. Konačna odluka o razvodu biće poslata strankama samo nakon zaključenja postupka i samo ako se pomirenje nije postiglo.</p> <p style="text-align: center;">Član 1204 Ročišta pomirenja</p> <p>Kad sud sprovodi postupak pomirenja supružnika, zakazaće posebna ročišta u naporima da se postigne pomirenje, sve dok smatra da još uvek postoje šanse za postizanje pomirenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1205 Pjesmarrja në seancat e pajtimit</p> <p>1. Në seancën për përpjekjen që të arrihet pajtimi ftohen të dy bashkëshortët për të marrë pjesë personalisht;</p> <p>2. Nëse njëri ose që të dy bashkëshortët edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt, mungojnë nga seanca për përpjekjen që të arrihet pajtimi, dhe asnjëri prej tyre nuk e arsyetojnë mungesën gjykata, do të çmojë se a do të caktojë seancën e re për përpjekjen e arritjes së pajtimit ose do të konsiderojë se pajtimi ka dështuar;</p> <p>3. Kur njëri apo të dy bashkëshortët të cilët me propozimin e përbashkët kanë filluar procedurën për shkurorëzim me marrëveshje</p>	<p style="text-align: center;">Article 1205 Participation in reconciliation sessions</p> <p>1. Both spouses are summoned to personally participate in the session in efforts to achieve reconciliation.</p> <p>2. When one or both spouses duly summoned do not justify the absence at the session in efforts to reach reconciliation, the court shall assess whether to assign a new session or to conclude that reconciliation has failed.</p> <p>3. When one or both spouses who through a joint proposal have initiated the procedures for divorce by mutual agreement do not</p>	<p style="text-align: center;">Član 1205 Prisutnost na ročišta pomirenja</p> <p>1. Na ročištu u naporu da se postigne pomirenje pozivaju se oba supružnika da lično prisustvuju.</p> <p>2. Kad jedan ili oba supružnika, iako su na redovan način pozvani, odsutni su na ročištu u naporima da se postigne pomirenje, i ni jedan od njih ne opravda svoju odsutnost, sud će proceniti da li da zakazaže još jedno ročište ili da zaključi da se pomirenje nije postiglo;</p> <p>3. Kad se jedan ili oba supružnika koji su sa zajedničkim predlogom pokrenuli postupak za sporazumni razvod, ne pojave na ročištu</p>

<p>nuk paraqiten në seancën për përpjekje që të arrihet pajtimi, dhe mungesa e tyre nuk arsyetohet, do të konsiderohet se e kanë tërhequr propozimin për shkëputje me marrëveshje.</p>	<p>appear in the session in efforts to reach reconciliation and their absence is not justified, it shall be considered, that they have waived the proposal for divorce by mutual agreement.</p>	<p>zakazanom u pokušaju ostvarenja pomirenja, i njihovo odsustvo nije opravdano, smatraće se da su povukli predlog za sporazumni razvod braka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1206 Kompetenca lëndore e organit të kujdestarisë në procedurën e pajtimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 1206 Subject matter jurisdiction of Custodian body in reconciliation procedure</p>	<p style="text-align: center;">Član 1206 Predmetna nadležnost organa starateljstva u postupku pomirenja</p>
<p>1. Nëse bashkëshortët kanë një apo më shumë fëmijë të përbashkët të mitur, procedura e pajtimit zhvillohet para Organit të Kujdestarisë duke zbatuar metodat e punës sociale, metodat tjera profesionale dhe duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimores për martesë dhe familje si dhe institucioneve tjera profesionale.</p>	<p>1. If the spouses have one or more joint minor children, the reconciliation procedure is conducted in front of Custodian Body by applying social work and other professional methods, by utilizing services of marriage and family councils as well as other professional institutions.</p>	<p>1. Ako supružnici imaju jedno ili više zajedničke maloletne dece, postupak pomirenja supružnika vodi organ starateljstva kroz primenu metoda socijalnog rada, i drugih stručnih metoda, uz korišćenje usluge bračnog i porodičnog savetovališta, kao i drugih stručnih institucija.</p>
<p>2. Procedurat duhet të mbështeten nga parimet e vullnetit të mirë dhe bashkëveprimit.</p>	<p>2. Procedures shall be supported by the principle of free will and co-operation.</p>	<p>2. Postupci se trebaju podržati načelima dobre volje i saradnje.</p>
<p>3. Në raste të tjera, procedurën e pajtimit të bashkëshortëve e zbaton gjykata nëse kryetari i kolegjit gjyqësor nuk e çmon se do të ishte e arsyeshme që procedura e pajtimit t'i kalojë Organit të Kujdestarisë.</p>	<p>3. In other cases, court conducts reconciliation procedure of spouses, when the president of court panel doesn't consider that the reconciliation procedure shall be transferred to the Custodian Body.</p>	<p>3. U drugim slučajevima, sud vodi postupak pomirenja supružnika, kad predsedavajući sudskog veća smatra da nema razloga da postupak pomirenja bude prosleđen kod organa starateljstva.</p>
<p>4. Në shkresën me të cilën procedura e pajtimit i kalon organit të kujdestarisë do të shënohen emrat dhe adresat e bashkëshortëve, data e fillimit të procedurës për shkëputje si dhe</p>	<p>4. In the written record transferring reconciliation to the Custodian Body, names and addresses of spouses shall be included, as well as the date of divorce procedures and the</p>	<p>4. U spisi s kojom postupak pomirenja je prosleđen organu starateljstva biće upisana imena i adrese supružnika, datum početka postupka za razvod kao i glavni razlozi zbog</p>

<p>shkaqet kryesore për të cilat kërkohet shkurrëzimi. Nëse në martesë ka fëmijë të mitur do të shënohen edhe të dhënat për fëmijët.</p>	<p>main reasons for requesting divorce. If the spouses have minor children, all data referring to them shall also be provided.</p>	<p>kojih se zahteva razvod. Ako u braku ima maloletne dece, biće uneti i svi podaci koji se odnose na njih.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1207 Kompetenca territoriale ligjore</p>	<p style="text-align: center;">Article 1207 Territorial legal jurisdiction</p>	<p style="text-align: center;">Član 1207 Mesna nadležnost suda</p>
<p>1. Për procedurën e pajtimit, përveç Organit të Kujdestarisë në territorin e të cilit ndodhet vendbanimi ose vendqëndrimi i të paditurit, është kompetent edhe Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët;</p>	<p>1. Jurisdiction for reconciliation procedure, lies not only with the Custodian Body in the territory of which is the transient or dwelling place of the defendant, but also with the Custodian Body in the territory of which the spouses had their last joint residence.</p>	<p>1. U postupku pomirenja supružnika, osim organ starateljstva, na području na kome tužena strana ima svoje boravište ili privremeno prebivalište, nadležan je i organ starateljstva, na području na kojem su supružnici imali svoje poslednje zajedničko prebivalište.</p>
<p>2. Kur procedura fillon me propozimin për shkurrëzim me marrëveshje të dyanshme, kompetent për procedurën e pajtimit të bashkëshortëve është Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit e ka vendbanimin ose vendqëndrimin njëri prej bashkëshortëve si dhe Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.</p>	<p>2. When procedures commence with the claim for divorce by mutual agreement, the Custodian Body in the territory of which one of the spouses has his transient residence or dwelling place shall be competent for the reconciliation procedure of spouses, as well as the Custodian Body in the territory of which the spouses lastly resided jointly.</p>	<p>2. Kad postupak počinje s obostranim predlogom za sporazumni razvod braka, organ starateljstva na čijem području jedan od supružnika ima svoje boravište ili privremeno prebivalište nadležan je za postupak pomirenja supružnika, kao i organ starateljstva na čijem području supružnici su imali svoje poslednje zajedničko prebivalište.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1208 Mbrojtja e fëmijëve në procedurën e pajtimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 1208 Protection of children in reconciliation procedure</p>	<p style="text-align: center;">Član 1208 Zaštita dece u postupku pomirenja</p>
<p>Në procedurën e pajtimit, Organi i Kujdestarisë konstaton se në çfarë kushte për</p>	<p>During reconciliation procedures, Custodian Body concludes under what living and</p>	<p>Tokom postupka pomirenja supružnika, organ starateljstva utvrđuje pod kojim su se uslovima</p>

<p>jetë dhe zhvillim ndodhen fëmijët e përbashkët të bashkëshortëve dhe ndërmer të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë edukimin, sigurinë dhe mbajtjen financiare, duke u përpjekur që të arrijë marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve në mënyrë që të mbrojnë interesat e fëmijëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1209 Afati në procedurën e pajtimit pranë organit të kujdestarisë</p> <p>1. Procedura e pajtimit pranë Organit të Kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet, nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë pas përfundimit të këtij afati.</p> <p>2. Organi i Kujdestarisë është i detyruar pa vonesë të dërgojë në gjykatë raportin më shkrim lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit.</p>	<p>developing conditions joint children of the spouses are found in and undertakes all necessary measures to ensure education, security and financial livelihood, by making efforts to achieve agreement between the spouses in order to protect children's interests.</p> <p style="text-align: center;">Article 1209 Deadline for reconciliation procedure by Custodian Body</p> <p>1. Reconciliation procedure in front of the Custodian Body may not last longer than three months but can be extended, if the spouses agree to continue such procedure after the expiry of the this deadline.</p> <p>2. Custodian Body is obliged that without any delay submit to the court a written report on the results of the reconciliation procedure.</p>	<p>za život i razvoj nalazila zajednička deca supružnika i preduzima neophodne mere da osigura njihovo obrazovanje, bezbednost i finansijsko izdržavanje, na taj način što će se potruditi da postigne dogovor među supružnicima u cilju zaštite interesa dece.</p> <p style="text-align: center;">Član 1209 Rokovi u postupku pomirenja pred organom starateljstva</p> <p>1. Postupak pomirenja supružnika koji se vodi pred organom starateljstva ne može da traje duže od tri meseca, ali se može nastaviti, ako se supružnici saglase da nastave ovaj postupak nakon isteka datog roka.</p> <p>2. Organ starateljstva obavezan je da bez odlaganja sudu podnese pisani izveštaj o ishodu postupka pomirenja supružnika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1210 Veprimet e gjykatës gjatë shkurorëzimit me marrëveshje</p> <p>1. Kur procedura ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me anë të marrëveshjes, faktet në të cilat është</p>	<p style="text-align: center;">Article 1210 Actions of the court during divorce by mutual agreement</p> <p>1. When procedure by the proposal of the spouses for divorce by mutual agreement have commenced, facts supporting the proposal are</p>	<p style="text-align: center;">Član 1210 Sudske radnje tokom sporazumnog razvoda</p> <p>1. Kad je postupak započet podnošenjem predloga supružnika za sporazumni razvod braka, činjenice koje podržavaju predlog neće</p>

<p>mbështetur propozimi nuk hetohen, sidoqoftë gjykata mund të vendosë që të zhvillohet procedura e provave, sikurse sipas padisë për shkurrëzim, nëse në procedurën e pajtimit çmon se për arsye fundamentale fëmijët e përbashkët të mitur kërkojnë që të ruhet martesë.</p> <p>2. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët gjykata mund t'i hetojë faktet dhe ta zbatojë procedurën e provave rreth pjesës së propozimit të bashkëshortëve që ka të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen financiare të fëmijëve, nëse bindet se propozimi i prindërve lidhur me këto çështje nuk ofron garanci të nevojshme se interesat e fëmijëve të tyre të mitur ose të paafte me këtë marrëveshje do të mbrohen në masë të duhur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1211 Përcaktimi i fakteve në të cilat mbështetet kërkesa</p> <p>1. Faktet në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore gjykata mund t'i konsiderojë si të kontestueshme edhe atëherë kur ato fakte janë të pa kontestueshme ndërmjet palëve.</p>	<p>not investigated, however, the court may decide to conduct evidentiary proceedings, same as for the procedures in divorce by claim, if during the reconciliation proceedings considers that joint minor children due to justifiable reasons require preservation of marriage.</p> <p>2. When spouses have joint children, court may investigate the facts and conduct evidentiary proceedings relating to that part of the proposal of spouses dealing with keeping, education and provision of financial livelihood for children, if convinced that the proposal of parents regarding these issues doesn't provide necessary guarantee that the interests of their minor or disabled children shall be properly protected through such agreement.</p> <p style="text-align: center;">Article 1211 Determination of Facts on which the request is based</p> <p>1. Facts based on which the party bases its request in marital disputes, may be considered disputable by the court, even when such facts are no longer disputable between parties.</p>	<p>se istražiti, međutim, sud može odlučiti da se sprovede dokazni postupak, isto kao kod tužbe za razvod braka, ako tokom postupka pomirenja supružnika proceni da iz osnovnih razloga zajednička maloletna deca zahtevaju očuvanje braka.</p> <p>2. Ako supružnici imaju zajedničku decu, sud može da ispita činjenice i da sprovede dokazni postupak u vezi sa delom predloga supružnika koji se odnosi na čuvanje, obrazovanje i pružanje finansijskog izdržavanja za decu, ako se ubedi da predlog roditelja vezano za ova pitanja ne pružaju neophodne garancije, da će interesi njihove maloletne dece ili nesposobne dece biti pravilno zaštićeni tim sporazumom.</p> <p style="text-align: center;">Član 1211 Utvrđivanje činjenica na koje se zasniva zahtev</p> <p>1. Činjenice na osnovu kojih je jedna strana zasnovala svoj zahtev u bračnim sporovima, sud može da smatra spornim čak i u slučaju da te činjenice više nisu sporne među strankama.</p>
--	--	---

<p>2. Në kontestet martesore nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës ose aktgjykimit në bazë të pranimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1212 Tërheqja e padisë</p> <p>1. Në kontestet për shkurorëzim paditësi mund ta tërheqë padinë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit, kurse me pajtimin e të paditurit derisa procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë.</p> <p>2. Propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje bashkëshortët mund ta tërheqin derisa aktgjykimi mbi shkurorëzimin të marrë formën e prerë. Do të konsiderohet se është tërhequr propozimi edhe kur nga propozimi heq dorë njëri bashkëshort.</p>	<p>2. No judgment may be issued for marital disputes due to absence or judgment by concession.</p> <p style="text-align: center;">Article 1212 Withdrawal of a claim</p> <p>1. In divorce disputes, the plaintiff may withdraw the claim until the conclusion of the main court session without the consent of the respondent, whereas with the consent of the respondent until the procedure becomes final.</p> <p>2. Spouses can withdraw joint proposal for divorce by mutual agreement may be undertaken until the judgment for divorce becomes final. The proposal shall be considered to have been withdrawn even when one of the spouses withdraws from the proposal.</p>	<p>2. U bračnim sporovima ne može se doneti presuda zbog odsustva ili presuda na osnovu priznanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 1212 Povlačenje tužbe</p> <p>1. U sporovima za razvod braka, tuženik može da povuče svoju tužbu do zaključka glavnog ročišta bez pristanka tužene strane, i uz saglasnost tuženog dok postupak nije zaključen u konačnoj formi.</p> <p>2. Zajednički podneti predlog supružnika za sporazumni razvod braka može se povući dok presuda za razvod braka ne bude konačna. Smatraće se da je predlog povučen čak i u slučaju da se samo jedan od supružnika povuče od predloga.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1213 Kufizimi i ankesës</p> <p>1. Aktgjykimi me të cilin zgjidhet martesa sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje të përbashkët mund të goditet vetëm për shkak:</p>	<p style="text-align: center;">Article 1213 Limitation of Appeal</p> <p>1. Judgment dissolving marriage according to the joint proposal of the spouses for divorce by mutual agreement may be appealed only because of:</p>	<p style="text-align: center;">Član 1213 Ograničenje žalbe</p> <p>1. Protiv presude kojom je brak rešen na osnovu zajedničkog predloga supružnika za sporazumni razvod braka, može da bude uložena žalba samo zbog:</p>

<p>1.1 Të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose</p> <p>1.2 Për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtrëngimit, ose të mashtrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1214 Moslejimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike</p> <p>Nëse martesë është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurrezimin, përkatësisht për anulimin e martesës nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1215 Pjesëtimi i pronës së përbashkët</p> <p>1. Në datën e zgjidhjes së martesës, prona e fituar me punën e përbashkët gjatë kohëzgjatjes së martesës duhet të përcaktohet, të vlerësohet dhe të pjesëtohet në pajtim me dispozitat e këtij libri.</p> <p>2. Pjesëtimi i pronës së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet gjatë martesës dhe me rastin e shkurrezimit.</p>	<p>1.1. Essential violations of provisions of the contentious procedure,</p> <p>1.2. Due to the fact that the proposal was submitted by mistake or under coercion or deceit.</p> <p style="text-align: center;">Article 1214 Prohibition of extraordinary remedies</p> <p>If marriage has been dissolved or annulled by final judgment, a decision for divorce, respectively for annulment of the marriage may not be attacked with extraordinary legal remedies.</p> <p style="text-align: center;">Article 1215 Division of joint property</p> <p>1. At the date of the dissolution of the marriage, property that is acquired by joint work during marriage must be determined, evaluated and divided as provided for in provisions of this Book.</p> <p>2. Division of joint property of spouses can be deemed during the marriage and at the time of divorce.</p>	<p>1.1 Osnovnog kršenja odredaba parničnog postupka, ili</p> <p>1.2 Zbog činjenice da je predlog bio podnet u zabludi, ili pod uticajem prisile ili prevare.</p> <p style="text-align: center;">Član 1214 Ne dozvoljavanje vanrednih pravnih lekova</p> <p>Ako je brak rešen ili je bio poništen konačnom sudsom presudom, protiv sudske odluke kojom je brak razveden, odnosno kojom je brak poništen ne može se uložiti vanredni pravni lek.</p> <p style="text-align: center;">Član 1215 Deoba zajedničke imovine</p> <p>1. Na dan rešenja braka, imovina stečena zajedničkim radom za vreme trajanja braka mora se utvrditi, proceniti i podeliti u skladu sa odredbama ove knjige.</p> <p>2. Deoba zajedničke imovine supružnika može da bude zatražena za vreme trajanja braka ili u slučaju razvoda.</p>
--	--	---

<p>3. E drejta për pjesëtimin e pronës së përbashkët nuk parashkruhet, por nuk ndikon në rregullat mbi parashkrimin fitues dhe parashkrimin e kërkesave.</p>	<p>3. Right for division of property is not prescriptive, but does not affect rules on statutory prescriptions and prescriptions of claims.</p>	<p>3. Pravo na deobu zajedničke imovine ne zastareva, ali ne utiče na pravila o zastarevanju potraživanja i zastarelost zahteva.</p>
<p>Neni 1216 Udhëzime të pjesëtimit</p>	<p>Article 1216 Division guidelines</p>	<p>Član 1216 Smernice deobe</p>
<p>1. Me rastin e pjesëtimit të pronës së përbashkët, borxhi i pronës së përbashkët do të llogaritet në pjesën e secilit bashkëshort.</p>	<p>1. When dividing joint property, the debt of the joint property shall be calculated in the shares of each spouse.</p>	<p>1. Prilikom deobe zajedničke imovine, dug zajedničke imovine biće uračunat na deo svakog supružnika.</p>
<p>2. Nëse prona e përbashkët nuk është e mjaftueshme për të mbuluar detyrimet ekzistuese ndaj pronës së përbashkët, të gjitha detyrimet e përbashkëta të mbetura pas pjesëtimit mund të mbulohen nga pasuria e veçantë e bashkëshortëve. Bashkëshorti i cili ka paguar detyrimet e përbashkëta para ose pas zgjidhjes së martesës ka të drejtën e regresit ndaj bashkëshortit tjetër për gjysmën e pagesës.</p>	<p>2. If joint property is not sufficient to cover the existing obligations to the joint property, all joint liabilities remaining after the division may be covered by separate property of the spouses. A spouse who has paid joint obligations before or after termination of marriage has the right to regress the other spouse for half of the payment.</p>	<p>2. Ako zajednička imovina nije dovoljna da pokrije postojeće obaveze prema zajedničkoj imovini, sve zajedničke obaveze koje ostaju nakon podele mogu biti pokriveno iz posebne imovine supružnika. Supružnik koji je platio zajedničke i obaveze pre ili posle okončanja braka ima pravo na povratak pola isplate od drugog supružnika.</p>
<p>3. Kur bëhet pjesëtimi i pronës me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve të një martese ligjërisht të regjistruar, duhet kushtuar vëmendje për të siguruar që pjesa e tij/saj përfshin ato sende të pronës së përbashkët, të cilët i shërbejnë zejës apo profesionit të tij/saj.</p>	<p>3. When dividing the property takes place upon request of one of the spouses of a legally registered marriage, consideration should be given to ensure that his/her share includes those objects of the joint property which serve his/her craft or vocation.</p>	<p>3. Kada se deli imovina na zahtev jednog od supružnika jednog zakonskog registrovanog braka, treba se obratiti posebna pažnja kako bi se obezbedilo da njegov/njen deo obuhvati stvari zajedničke imovine koje služe njegovom ili njenom zanatu ili zanimanju.</p>
<p>4. Nëse vlera e sendeve nga paragrafi 3 i këtij neni është jo proporcionalisht e madhe në</p>	<p>4. If value of objects provided for in paragraph 3 of this Article is disproportional high,</p>	<p>4. Ako vrednost stvari propisanih u stavu 3. ovog člana je nesrazmerno velika u odnosu na</p>

<p>krahasim me vlerën e pronës së përgjithshme të përbashkët, do të bëhet pjesëtimi edhe i atyre sendeve, përveç nëse bashkëshorti të cilit këto pjesë duhet t'i takojnë nuk ia siguron bashkëshortit tjetër pagimin përkatës në para apo vlerën përkatëse ose të përafërt ose nuk ia cedon bashkëshortit tjetër sipas pëlqimit të tij sendet e tjera me vlerë përkatëse ose të përafërt. Për këto kompensime qëllimi kërkohet të miratohet nga të dy bashkëshortët.</p> <p>5. Kur pjesëtimi fillohet me kërkesën e njërit bashkëshort, atij do t'i dorëzohen ato sende të pronës së përbashkët që i shërbejnë ekskluzivisht përdorimit të tij personal.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1217 Pagimi në para</p> <p>Në rast se pjesa e njërit bashkëshort në pasurinë e përbashkët është jo proporcionalisht më e vogël se pjesa e bashkëshortit tjetër, gjykata, me kërkesën e njërit nga bashkëshortët, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe vlerën e pasurisë së tij, atij bashkëshorti mund t'ia caktojë shpërblimin në të holla sipas vlerës së pjesës së tij.</p>	<p>compared to the value of general joint property, those objects shall also be divided, except in cases when the spouse to whom such shares should belong to does not ensure pecuniary compensation of the relevant or approximate value to the other spouse, respectively does not transfer another object or share with relevant or approximate value to the other spouse. For these compensation purposes consent of both spouses is required.</p> <p>5. When division is initiated upon request of one spouse, he shall be provided with those objects of the joint property which exclusively serve for personal use.</p> <p style="text-align: center;">Article 1217 Pecuniary Compensation</p> <p>When the share of one spouse from the joint property is disproportional smaller than the share of the other spouse, the court, upon request of one of the spouses, considering all the circumstances and the values of his share may determine pecuniary compensation for the spouse.</p>	<p>vrednost celokupne zajedničke imovine, biće izvršena deoba i tih stvari, osim u slučaju da supružnik kome te stvari treba da pripadaju, drugom supružniku obezbedi isplatu odgovarajuće vrednosti ili drugom supružniku ustupi, uz njegov pristanak, druge stvari odgovarajuće ili približne vrednosti. Za potrebe ovakve naknade potreban je pristanak oba supružnika.</p> <p>5. Kad je deoba pokrenuta na zahtev jednog od supružnika, tom supružniku biće dati oni predmeti iz zajedničke imovine koji isključivo služe za njegovu ličnu upotrebu.</p> <p style="text-align: center;">Član 1217 Novčana naknada</p> <p>U slučaju kad je udeo jednog supružnika u zajedničkoj imovini nesrazmerno manji od udela drugog supružnika, sud može na zahtev jednog supružnika, uzimajući u obzir sve okolnosti i vrednost njegovog udela tom supružniku da odredi naknadu u novcu prema vrednosti njegovog udela.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 1218 Sendet e luajtshme</p> <p>1. Secili prej bashkëshortëve mund të kërkojë që sendet e luajtshme në pronën e përbashkët t'i ndahen në emër të pjesës në pronën e përbashkët bashkëshortit tjetër i cili ato sende i ka ndalur pas ndërprerjes së bashkësisë së jetës dhe ka qenë në posedim të tyre të qetë të pandërprerë së paku (3) vjet, ose i ka blerë ato për përdorim vetanak pa miratimin e bashkëshortit tjetër.</p> <p>2. Në zbatim të paragrafit 1 i këtij neni bashkëshorti tjetër mund të kërkojë t'i ofrohet pjesa përkatëse nga sendet tjera të luajtshme dhe nëse vlera e këtyre sendeve nuk është e mjaftueshme ka të drejtë që dallimi t'i paguhet në të holla.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1218 Movable items</p> <p>1. Each of the spouses may request movable items from the joint property to be divided to the other spouse on behalf of the share in the joint property of the spouse who has kept those items upon termination of their coexistence and has silently possessed them for at least (3) years or has only bought them for his own use without approval of the other spouse.</p> <p>2. On application of paragraph 1 of this article, other spouse may request to be provided with the relevant share from other movable items and if the values of such items are not sufficient, he is eligible to pecuniary compensation for the difference.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1218 Pokretne stvari</p> <p>1. Svaki od supružnika može da zahteva da se pokretne stvari koje predstavljaju zajedničku imovinu dodele na ime udela u zajedničkoj imovini onom supružniku koji je te stvari zadržao posle prekida zajednice života i bile su u neprekidnoj neometanoj državini najmanje tri (3) godine, ili ih je kupio za sopstvenu upotrebu bez saglasnosti drugog supružnika.</p> <p>2. U primeni stava 1. ovog člana, drugi supružnik može zahtevati da mu se u ostalim pokretnim stvarima odredi odgovarajući udeo, i ako vrednost tih stvari nije dovoljna, ima pravo da razlika bude isplaćena u novčanoj vrednosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1219 Përcaktimi i pronës së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes</p> <p>Nëse nuk arrihet marrëveshja në lidhje me atë se cila pjesë e bashkëshortëve i takon pronës së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1219 Determination of joint property in case of non-agreement</p> <p>When there is no agreement about which part of the joint property belongs to which spouse, this shall be decided by the court.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1219 Utvrđivanje zajedničke imovine u slučaju nesporazuma</p> <p>Ako se ne postigne sporazum o tome koji deo imovine supružnika pripada zajedničkoj imovini, o tome mora odlučiti sud.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1220 Sendet për përdorim të fëmijëve</p> <p>Bashkëshortit që i besohen fëmijët e përbashkët për ruajtje dhe edukim përveç pjesës së tij, i jepen edhe sendet që i shërbejnë vetëm fëmijëve ose që janë të destinuara vetëm për përdorimin e tyre të drejtpërdrejtë, përveç nëse vlera e tyre është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pronës së përgjithshme të përbashkët. Në këtë rast, ndryshimi do të kompensohet në para nga bashkëshorti të cilit i janë besuar fëmijët.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1220 Items for children's use</p> <p>The spouse to whom the joint children have been entrusted to for protection and education, besides his share, is provided with items serving only the children or which are designated only for their direct use, except when the value of these items is unproportionally high compared to the value of the general joint property. In this case difference shall be pecuniary compensated by spouse to whom children are entrusted.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1220 Stvari za dečiju upotrebu</p> <p>Supružniku kome su poverena zajednička deca na čuvanje i vaspitavanje, osim njegovog dela, biće dodeljene i stvari koje služe samo deci ili su namenjene za njihovu neposrednu upotrebu, osim ako je vrednost tih predmeta nesrazmerno velika u odnosu na vrednost celokupne zajedničke imovine. U ovom slučaju, razlika će biti nadoknađena u novčanoj vrednosti od strane supružnika kome su deca poverena.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1221 Vendimi i gjykatës për banesën martesore</p> <p>1. Nëse bashkëshorti në procedurën e shkurorëzimit nuk pajtohet mbi atë se kujt duhet t'i jepet e drejta që të jetojë në të ardhmen në banesën nga martesa ose për ndarjen e pajisjeve të shfrytëzuara bashkërisht dhe gjërave të tjera që i takojnë shtëpisë, vendimi duhet të nxjerrët nga gjykata në kërkesë të njërës apo të dy bashkëshortëve.</p> <p>2. Gjykata do të vendosë duke pasur parasysh çdo rast individual, e në veçanti rastet kur</p>	<p style="text-align: center;">Article 1221 Court decision on matrimonial domicile</p> <p>1. If spouse in the divorce procedures does not agree upon who shall be entitled to live in the matrimonial domicile in the future or about the distribution of commonly used furniture and other household belongings, decision shall be taken by the court, on request of one or both of the spouses.</p> <p>2. Court shall decide with close regard to each individual case, especially when the decision</p>	<p style="text-align: center;">Član 1221 Sudska odluka o bračnom mestu stanovanja</p> <p>1. Ako se u postupku razvoda braka supružnici ne saglase o tome kome će biti dodeljeno pravo da ubuduće živi u bračnom mestu stanovanja ili za dodelu opreme zajednički korišćene kao i ostalim stvarima koje pripadaju mestu stanovanja, odluka će biti doneta od strane suda po zahtevu jednog ili oba supružnika.</p> <p>2. Sud će doneti odluku uzimajući u obzir svaki pojedinačni slučaj, naročito kada se</p>

<p>vendimi prek mirëqenien e fëmijëve dhe pozitën sociale të bashkëshortëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1222 E drejta e parablerjes</p> <p>Kur pjesa e bashkëshortit nga prona e përbashkët përcaktohet në formë të prerë, bashkëshorti tjetër ka të drejtën e parablerjes së asaj pjese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1223 Mbiemri i bashkëshortit të shkurorëzuar</p> <p>1. Bashkëshorti i cili në rastin e lidhjes së martesës e ka ndryshuar mbiemrin, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm.</p> <p>2. Deklarata për marrjen e mbiemrit të mëparshëm duhet të jepet brenda afatit prej gjashtë muajve pas zgjidhjes së martesës.</p> <p>3. Deklarata i paraqitet ofiqarit i cili mban regjistrin amë të të martuarve për vendin në të cilin është lidhur martesa sipas vendbanimit të deklaratë dhënësit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1224 Kufizimet e përgjegjësisë</p>	<p>touches the welfare of children and the social position of the spouses.</p> <p style="text-align: center;">Article 1222 Right on pre-emption</p> <p>When share of the spouse from the joint property is finally determined, other spouse has the right on pre-emption of that share.</p> <p style="text-align: center;">Article 1223 Surname of spouse after divorce</p> <p>1. Spouse, who at the time of entering into marriage has changed surname, after dissolution of marriage, may acquire its previous surname.</p> <p>2. Statement for acquiring previous surname shall be submitted within six months from the dissolution of marriage.</p> <p>3. Statement shall be submitted to the registrar who maintains register of marriages where marriage was entered into based on the place of residence of the person providing the statement.</p> <p style="text-align: center;">Article 1224 Limitation of liability</p>	<p>odluka tiče blagostanja dece i socijalnog položaja supružnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 1222 Pravo preče kupovine</p> <p>Kad je udeo supružnika u zajedničkoj imovini konačno određen, drugi supružnik ima pravo preče kupovine tog dela.</p> <p style="text-align: center;">Član 1223 Prezime razvedenog supružnika</p> <p>1. Supružnik koji je prilikom sklapanja braka promenio svoje prezime, nakon prestanka braka može da uzme prethodno prezime.</p> <p>2. Izjava o uzimanju prethodnog prezimena mora da bude podneta u roku od šest meseci od rešenja braka.</p> <p>3. Izjava se dostavlja matičaru zaduženom za vođenje matične knjige venčanih za mesto u kojem je sklopljen brak prema mestu prebivališta lica koje dostavlja svoju izjavu.</p> <p style="text-align: center;">Član 1224 Ograničenje odgovornosti</p>
--	--	---

<p>Bashkëshorti tjetër nuk është përgjegjës për detyrimet që njëri nga bashkëshortët i ka pasur para lidhjes së martesës, si dhe për detyrimet personale që i pranon gjatë martesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1225 Trashëgimi</p> <p>Pushimi i të drejtës së trashëgimisë së bashkëshortit në rast të shkurorëzimit ose anulimit përfundon sipas kushteve të parapara në Librin 5 të këtij Kodi.</p> <p>PJESA E KATËRT</p> <p>KAPITULLI I – MARRËDHËNIET NDËRMJET PRINDËRVE DHE FËMIJËVE</p> <p style="text-align: center;">Nënkpaitulli I - Atësia</p> <p style="text-align: center;">Neni 1226 Prezumimi i atësisë</p> <p>1. At i fëmijës së lindur në martesë do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit së martesës.</p>	<p>Other spouse is not responsible for the obligations that one of the spouses had before entering into marriage, as well as for personal obligations, that he accepts during the marriage.</p> <p style="text-align: center;">Article 1225 Inheritance</p> <p>The right of inheritance of the spouse in case of divorce or annulment ends under the conditions foreseen in the Book 5 of this Code.</p> <p>PART FOUR</p> <p>CHAPTER I –RELATIONS BETWEEN PARENTS AND CHILDREN</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter I – Paternity</p> <p style="text-align: center;">Article 1226 Presumption of paternity</p> <p>1. If a child is born during the marriage or within 300 days after breach of marriage then husband of the child’s mother shall be considered as child`s father.</p>	<p>Drugi supružnik nije obavezan za obaveze koje jedan od supružnika je imao pred sklapanja braka, kao i za lične obaveze koje prihvata tokom braka.</p> <p style="text-align: center;">Član 1225 Nasleđivanje</p> <p>Prestanak prava nasleđivanja supružnika u slučaju razvoda ili poništenja se zaključuje pod uslovima predviđenim u Knjizi 5 ovog Zakonika.</p> <p>DEO ČETVRTI</p> <p>POGLAVLJE I – ODNOSI IZMEĐU RODITELJA I DECE</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje I – Očinstvo</p> <p style="text-align: center;">Član 1226 Pretpostavka očinstva</p> <p>1. Otac rođenog deteta u braku smatraće se muž majke deteta ako je dete rođeno tokom braka ili unutar roka od trista (300.) dana nakon prestanka braka.</p>
--	--	--

2. Nëse fëmija është lindur në martesën e mëvonshme të nënës së vet pas kalimit të afatit prej (270) ditësh e deri në afatin prej (300) ditësh pas zgjidhjes së martesës së saj të mëparshme, at do të konsiderohet burri i nënës nga martesa e mëparshme, përveç nëse burri i nënës nga martesa e mëvonshme me pëlqimin e saj e pranon fëmijën për të vetin.

Neni 1227
Fëmijët e lindur në martesë

1. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës.

2. Nëse prindërit e fëmijës të lindur jashtë martesës kanë pasur qëllimin që ta lidhin martesën dhe në këtë gjë kanë qenë të penguar me vdekjen e njërit prej tyre ose me ndonjë pengesë martesore që ka lindur pas zënies së fëmijës, në bazë të kërkesës së njërit prind të fëmijës, gjykata në procedurë jashtëkontestimore do të shpallë se fëmija ka lindur në martesë.

3. Nëse asnjëri prej prindërve nuk është i gjallë ose prindit të gjallë i është hequr aftësia për të vepruar apo i është hequr e drejta prindore, procedurën pranë gjykatës për shpalljen se

2. When the child was born during the later marriage of his mother after the period of (270) days up to (300) days after dissolution of her previous marriage, husband of mother from previous marriage will be considered as father of a child except when the husband of the mother from the later marriage with her consent accepts the child as his own.

Article 1227
Children born in marriage

1. A child shall be considered to have been born in marriage when his parents are married at the time of the child birth.

2. If the parents of extra marital child intended to enter into marriage but were impeded due to death of one spouse or due to a marriage ban, which arose after conception, upon request of one parent or the child, court shall in an extra contentious procedure announce that the child was born in marriage.

3. When none of the parents is alive, or the parent alive has been deprived from capacity to act or from parental custody, procedure to announce minor child to have been born in

2. Kad je dete rođeno u docnijem braku svoje majke, posle isteka roka od dvesta sedamdeset (270.) dana do roka od trista (300.) dana od prestanka njenog prethodnog braka, smatraće se da je otac deteta muž majke iz prethodnog braka, osim kad muž majke iz docnijeg braka, sa njenim pristankom, prizna dete za svoje.

Član 1227
Deca rođena u braku

1. Smatraće se da je dete rođeno u braku kad su njegovu roditelji bili u braku u vreme njegovog rođenja.

2. Kad su roditelji deteta rođenog van braka, imali nameru da sklope brak, pa su u tome bili sprečeni smrću jednog od njih ili nekom drugom bračnom smetnjom koja je nastala posle začeća deteta, sud će u vanparničnom postupku, na zahtev jednog od roditelja deteta, proglasiti da je dete rođeno u braku.

3. Ako nijedan od roditelja nije živ ili je živi roditelj lišen pravne sposobnosti ili je lišen roditeljskog prava, postupak kod suda radi proglašenja da je maloletno dete rođeno u braku može da pokrene organ starateljstva.

<p>fëmija i mitur ka lindur në martesë mund ta inicojë Organi i Kujdestarisë.</p> <p>4. Nën kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni kërkesa për shpalljen e fëmijës martesor mund të parashtrohet gjithashtu edhe në kontestin për vërtetimin e atësisë, nëse atësia nuk është vërtetuar më parë me pranimin ose me vendimin e gjykatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1228 Fëmijët e lindur jashtë martesës</p> <p>I ati i fëmijës, i cili nuk ka lindur në martesë, as brenda afatit prej (300) ditësh pas zgjidhjes së martesës, konsiderohet burri i cili e pranon për të vetin ose atësia e të cilit është vërtetuar me vendimin e gjykatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1229 E drejta për njohjen e atësisë</p> <p>Atësia mund t'i njihet mashkullit i cili ka aftësi të veprimit dhe i cili ka arritur moshën (16) vjeçare, si dhe personit i cili pjesërisht ka qenë i zhveshur nga aftësia për të vepruar, nëse është në gjendje të kuptojë përmbajtjen e deklaratës për njohjen e atësisë.</p>	<p>marriage, shall be initiated by the Custodian Body</p> <p>4. Under the conditions of Paragraph (2) of this Article, request to announce the marital child may also be submitted in the dispute for the verification of paternity, if paternity has not been previously verified by acceptance or by court decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 1228 Children born out of marriage</p> <p>Father of the child who was not born in marriage or during the period of (300) days after the dissolution of marriage, shall be considered the husband who accepts the child as his own or the person, the paternity of whom has been verified by court decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 1229 Eligibility for recognition of Paternity</p> <p>Paternity may be recognized to a male who is capable to act and who has reached the age of (16), as well as to a person who has partially been deprived from his capacity to act but is capable to understand content of the statement for recognition of paternity.</p>	<p>4. Pod uslovima iz stava (2.) ovog člana, zahtev za proglašenje da je dete rođeno u braku može da bude podnet i u sporu radi utvrđivanja očinstva, ako očinstvo nije ranije utvrđeno priznanjem ili odlukom suda.</p> <p style="text-align: center;">Član 1228 Deca rođena van braka.</p> <p>Otac deteta, koje nije rođeno u braku, ni u roku od trista (300.) dana po rešenju braka, smatra se muškarac koji ga prizna za svoje, ili muškarac čije očinstvo je utvrđeno odlukom suda.</p> <p style="text-align: center;">Član 1229 Pravo za priznavanje očinstva</p> <p>Očinstvo se može priznati muškarcu koji ima poslovnu sposobnost i koji je postigao šesnaest (16.) godina starosti, kao i licu koji je delimično bio lišen poslovne sposobnosti, ukoliko je u stanju da razume sadržaj izjave za priznavanje očinstva.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 1230 Parimet mbi njohjen e atësisë</p> <p>1. Personi i cili e konsideron vetën at të fëmijut mund të pranojë atësinë në procesverbal para ofiqarit.</p> <p>2. Atësia mund të njihet para Organit të Kujdestarisë, gjykatës apo organit tjetër të autorizuar me ligj. Këto organe janë të detyruara që pa vonesë të dërgojnë procesverbalin e vërtetuar tek ofiqari kompetent, i cili duhet të regjistrojë fëmijun në regjistrin e të lindurve.</p> <p>3. Atësia gjithashtu mund të njihet edhe me testament.</p> <p>4. Deklarata për njohjen e atësisë nuk mund të jepet përmes përfaqësuesit me prokurë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1230 Principles on recognition of paternity</p> <p>1. The person considering himself father of the child may accept paternity in minutes in front of the registrar.</p> <p>2. Paternity may also be recognized before the Custodian Body, before the court or another duly authorized body. These bodies are obliged, without delay to submit verified minutes to the competent registrar who shall then register child in the register of births.</p> <p>3. Paternity may also be recognized by will.</p> <p>4. The statement for recognition of paternity cannot be provided by a proxy representative.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1230 Načela priznavanja očinstva</p> <p>1. Lice koje sebe smatra ocem deteta može da prizna očinstvo i da upiše tu činjenicu u zapisnik u prisustvu matičara.</p> <p>2. Očinstvo takođe se može priznati pred organom starateljstva, pred sudom ili pred drugim zakonski ovlašćenim organom. Ti organi su obavezni da bez odlaganja dostave overeni zapisnik nadležnom matičaru koji će izvršiti upis deteta u matičnu knjigu rođenih.</p> <p>3. Očinstvo takođe može da bude priznato testamentom.</p> <p>4. Izjava o priznavanju očinstva ne može da bude data od strane zastupnika sa prokurom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1231 Procedura për njohjen e atësisë para ofiqarit të gjendjes civile</p> <p>1. Nëna e fëmijës së lindur jashtë martesës, në paraqitjen e lindjes së fëmijës mund ta shënojë personin të cilin e konsideron atë të fëmijës së vet. Ajo mund të ofrojë deklaratë me gojë që do të shënohet në procesverbal te ofiqari ose te organi i autorizuar për përpilimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 1231 Procedure for recognition of paternity in front of official- registrar of civil status</p> <p>1. When mother of the extra marital child, announces birth of her child she may present the person she considers father of her child. She may provide verbal statement to be recorded in the minutes of registrar or before</p>	<p style="text-align: center;">Član 1231 Postupak za priznavanje očinstva pred matičarem civilnog stanja</p> <p>1. Majka deteta rođenog van braka, u prijavi rođenja svog deteta može da navede osobu koju ona smatra ocem njenog deteta. Ona može pružiti usmenu izjavu za zapisnik u prisustvu matičara ili pred organom</p>

<p>dokumenteve publike, në dokumentin e vërtetuar ose në testament.</p> <p>2. Nëse nëna në paraqitjen e lindjes së fëmijës nuk e ka shënuar personin që e konsideron atë të fëmijës, ofiqari do ta udhëzojë për të drejtën e saj që ta bëjë këtë gjë.</p> <p>3. Kur e merr deklaratën e nënës për identitetin e atit të fëmijës së saj, ofiqari do ta ftojë personin e shënuar të deklarohej për atësinë e vet drejtpërdrejt para ofiqarit ose të ofrojë dokumentin e vërtetuar brenda afatit prej (30) ditësh. Letërthirrja për një person të këtillë medoemos i dorëzohet personalisht dhe sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia.</p> <p>4. Për veprimet që i ndërmerr dhe për deklaratat me gojë të nënës së fëmijës dhe të personit për të cilin nëna pohon se është atë i fëmijës, ofiqari do të përpilojë procesverbalin.</p> <p>5. Nëse personi i ftuar deklaron se nuk është atë i fëmijës ose brenda afatit prej 30 ditësh nuk deklarohej për atësinë e fëmijës, ofiqari lidhur me këtë gjë do ta informojë nënën e fëmijës.</p> <p>6. Nëse personi i ftuar deklaron në procesverbal para ofiqarit se konsideron veten atë të fëmijës, dhe kjo është e regjistruar në</p>	<p>the body, authorized to prepare public documents, in a verified document or a will.</p> <p>2. When the mother has not provided written record about the person she considers to be the father of her child, the registrar shall give advice regarding her rights to do so.</p> <p>3. After taking mother's statement regarding identity of her child's father, he shall ask the mentioned person to declare about his paternity directly before the registrar or to provide a certified document within a time limit of (30) days. Invitation of such individual must be submitted in person and based on the methods providing confidentiality.</p> <p>4. The registrar shall draft minutes regarding undertaken actions and verbal statements of the child's mother and the person whom the mother alleges to be the father of the child.</p> <p>5. If the invited person declares not to be the father of the child or within 30 days does not express himself regarding the paternity of the child, the registrar shall inform mother of the child thereupon.</p> <p>6. When invited person declares before the registrar, to consider himself to be the father of the child, and this is recorded in the minutes</p>	<p>ovlašćenim za pripremu javnih isprava, u overenoj ispravi ili u testamentu.</p> <p>2. Kad majka u prijavi rođenja deteta nije označila lice koje smatra ocem svog deteta, matičar je dužan da je uputi o njenom pravu da to učini.</p> <p>3. Kad primi izjavu majke o identitetu oca njenog deteta, matičar će pozvati navedeno lice da se u roku od trideset (30.) dana neposredno pred matičarem ili u overenoj ispravi proglasi o svom očinstvu. Pozivnica takvom licu neophodno se treba lično dostaviti i na način kojim se obezbeđuje tajnost.</p> <p>4. O radnjama koje preduzima i o usmenim izjavama majke deteta i lica za koje majka tvrdi da je otac deteta, matičar sastavlja zapisnik.</p> <p>5. Kad pozvano lice izjavi da nije otac deteta ili ako se u roku od trideset (30.) dana ne izjasni o očinstvu deteta, matičar će o tome obavesti majku deteta.</p> <p>6. Kad pozvano lice izjavi u zapisniku pred matičarem da sebe smatra ocem deteta, i ovo je upisano u zapisniku ili u overenoj ispravi,</p>
---	--	---

<p>procesverbal ose në dokumentin e verifikuar, ofiqari zyrtarisht do ta regjistrojë si atë të fëmijës, në regjistrin amë të të lindurve dhe për regjistrimin duhet të informojë nënën e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1232 Njohja e atësisë para lindjes dhe pas vdekjes së fëmijës</p> <p>1. Deklarata për njohjen e atësisë mund të jepet edhe para lindjes së fëmijës. Deklarata e tillë prodhon efektin juridik me kusht që fëmija të lindet i gjallë.</p> <p>2. Pas vdekjes së fëmijës atësia mund të vërtetohet vetëm me vendimin e gjykatës me kërkesën e personave të autorizuar, nëse për këtë gjë kanë interes juridik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1233 Pëlqimi i nënës</p> <p>1. Njohja e atësisë prodhon efekt juridik dhe regjistrohet në librin amë të të lindurve vetëm nëse me njohjen pajtohet nëna e fëmijës.</p>	<p>or in the verified document, the registrar shall officially register him as father of the child in the register of births and shall inform child's mother regarding this registration.</p> <p style="text-align: center;">Article 1232 Recognition of paternity before birth and after death of a child</p> <p>1. Statement for recognition of paternity may also be provided before the child's birth. Such statement produces legal effect, provided that the child is born alive.</p> <p>2. After death of a child, paternity may be verified only by court decision upon request of authorized persons and if they have a legal interest for this.</p> <p style="text-align: center;">Article 1233 Consent of the mother</p> <p>1. Recognition of paternity produces legal effect and is registered in the register of births only if mother of child agrees with such recognition.</p>	<p>matičar će zvanično upisati istog kao oca deteta, u matičnoj knjizi rođenih, i o tom upisu treba obavesti majku deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1232 Priznanje očinstva pre rođenja deteta i nakon smrti deteta</p> <p>1. Izjava o priznanju očinstva može da bude data i pre rođenja deteta. Ta izjava proizvodi pravno dejstvo pod uslovom da se dete rodi živo.</p> <p>2. Posle smrti deteta očinstvo se može utvrditi samo na osnovu odluke suda, na zahtev ovlašćenih lica, ako za to imaju pravni interes.</p> <p style="text-align: center;">Član 1233 Pristanak majke</p> <p>1. Priznanje očinstva proizvodi pravno dejstvo i biće upisano u matičnu knjigu rođenih samo ako se sa priznanjem saglasi majka deteta.</p>
--	--	--

<p>2. Deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë mund ta japë nëna sipas rregullave të përcaktuara me nenin 1230 të këtij Libri.</p> <p>3. Ofiqari ka për detyrë ta ftojë nënën e fëmijës që brenda afatit prej (30) ditësh të deklarohet për njohjen e atësisë nëse ajo nuk e ka paraqitur më parë personin e njëjtë si at të fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1234 Pëlqimi i fëmijës</p>	<p>2. Statement on consent for recognition of paternity may be given by mother according to the regulations provided for in Article 1230 of this Book.</p> <p>3. If she has not presented the same person as father of the child, registrar is obliged to summon the child's mother for her statement within thirty (30) days from the recognition of paternity.</p> <p style="text-align: center;">Article 1234 Consent of the child</p>	<p>2. Izjavu o saglasnosti sa priznanjem očinstva majka može dati na način propisan u članu 1230. ove Knjige.</p> <p>3. Matičar je dužan da pozove majku deteta da se u roku od trideset (30.) dana izjasni o priznanju očinstva, ako ona već ranije nije označila isto lice kao oca deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1234 Pristanak deteta</p>
<p>1. Nëse fëmija është më i vjetër se (16) vjeç është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij për njohjen e atësisë. Ky pëlqim jepet sipas mënyrës së rregulluar me nenin 1236 të këtij Libri.</p> <p>2. Nëse fëmija pavarësisht nga kjo moshë, është i paaftë për të gjykuar në mënyrë të vazhdueshme, ose nëna nuk është më e gjallë, apo ka vendqëndrimin e panjohur ose është shpallur e vdekur apo plotësisht i është hequr aftësia për të vepruar, deklaratën mbi pëlqimin për njohjen e atësisë e jep kujdestari i fëmijës me lejen e Organit të Kujdestarisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1235 Procedura gjyqësore për mospajtimin</p>	<p>1. If child is older than (16) years, consent of the child shall also be required for recognition of paternity. Such consent shall be provided as foreseen in Article 1236. When child is legally incapable consent is given by his legal representative.</p> <p>2. When the child regardless of his age is in continuous incapacity to act or mother is no longer alive or with unknown residence or has been announced dead or has been completely deprived from her capacity to act, statement regarding consent for recognition of paternity shall be provided by custodian of the child with the permission of the Custodian Body.</p> <p style="text-align: center;">Article 1235 Court procedure for disagreement</p>	<p>1. Kad je dete starije od šesnaest (16.) godina, potrebna je i njegova saglasnost sa priznanjem očinstva. Ova saglasnost se daje na način propisan u članu 1236. u ovoj Knjizi.</p> <p>2. Ako dete nezavisno od ovog uzrasta neprekidno nije u stanju da rasuđuje, ili ukoliko majka nije više živa, ili je njeno boravište nepoznato, ili je proglašena mrtvom, ili je potpuno lišena pravne sposobnosti, izjavu o saglasnosti za priznanje očinstva daje staralac deteta, uz saglasnost organa starateljstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1235 Sudski postupak za nesaglasnost</p>

<p>1. Nëse nëna e fëmijës ose fëmija që është më i vjetër se (16) vjeç, ose kujdestari i fëmijës kur nevojitet pëlqimi i tij, nuk pajtohen për njohjen e atësisë, ose nuk deklarohen lidhur me këtë gjë brenda afatit prej (30) ditësh, pasi të marrin në dijeni njohjen, personi i cili e ka njohur fëmijën për të vetin mund t'ia paraqesë padinë gjykatës për vërtetim se ai është at i fëmijës.</p> <p>2. Padia mund të paraqitet brenda afatit prej tri vjetësh pas marrjes së njoftimit për mospajtimin e nënës, përkatësisht të fëmijës. Nëse në ndërkohë është vërtetuar atësia e personit tjetër, padia nuk mund të paraqitet pas kalimit të afatit për kundërshtimin e atësisë atij personi.</p>	<p>1. If mother of a child or child older than (16) years of age, or the custodian of a child does not agree with the recognition of paternity, or when they do not declare themselves concerning this issue within (30) days after being informed of recognition, person who has recognized a child as his own may submit a claim to the court, in order to verify that he is child's father.</p> <p>2. Claim may be submitted within a period of three years after being informed about disagreement of the child's mother. If in the meantime paternity of another person has been verified, claim shall not be submitted after expired date for rejecting paternity of such person.</p>	<p>1. Kad se majka deteta, ili dete koje je starije od šesnaest (16.) godina, ili staralac deteta, kada je njegovja saglasnost potreba, nisu saglasni za priznanje očinstva, ili se ne izjasne vezano za isto u roku od trideset (30.) dana po prijemu obaveštenja o priznanju očinstva, lice koje je priznalo dete za svoje, može da podnese tužbu sudu radi utvrđenja da je otac deteta.</p> <p>2. Tužba se može podneti u roku od tri godine po prijemu obaveštenja o nesaglasnosti majke, odnosno deteta. Ako se u međuvremenu utvrdi očinstvo od strane drugog lica, tužba se ne može podneti nakon isteka roka za osporavanje očinstva tog lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1236 Efekt i juridik i deklaratës së njohjes</p>	<p style="text-align: center;">Article 1236 Legal effect of the statement of recognition</p>	<p style="text-align: center;">Član 1236 Pravno dejstvo izjave o priznanju</p>
<p>1. Deklarata për njohjen e atësisë, si dhe deklaratat e nënës dhe të fëmijës, si dhe pëlqimi për njohjen e atësisë, nuk mund të revokohen.</p> <p>2. Personi i cili ka dhënë deklaratën për njohjen e atësisë, mund të kërkojë anulimin e deklaratës nëse ajo është dhënë me shtrëngim, për shkak të mashtrimit ose në lajthim.</p>	<p>1. Statement for recognition of paternity, statements of the mother and child and consent for recognition of paternity shall not be revoked.</p> <p>2. Person giving a statement for recognition of paternity may request annulment of such statement, if it was given under coercion, deceit or mistake.</p>	<p>1. Izjava o priznanju očinstva, kao i izjava majke i deteta, kao i saglasnost o priznanju očinstva ne mogu se opozvati.</p> <p>2. Lice koje je dala izjavu o priznanju očinstva, može zahtevati poništenje izjave ukoliko je ista data pod prinudom, usled prevare ili zablude.</p>

<p>3. Padia për anulimin e deklaratës mund të paraqitet në gjykatë brenda afatit prej gjashtë muajsh nga data kur shtrëngimi është bërë i ditur, apo gabimi është vërejtur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1237 Fëmijët jashtëmartesor</p> <p>1. Padinë për vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesës, përveç personit i cili e konsideron vetën at të fëmijës mund ta paraqesin fëmija dhe nëna e fëmijës.</p> <p>2. Fëmija i lindur jashtë martesës mund të paraqet padinë për vërtetimin e atësisë në çdo kohë.</p> <p>3. Nëse fëmija është i mitur ose nuk e ka aftësinë për të vepruar, padinë në emër të tij mund të paraqet nëna. Nëse nëna nuk është e gjallë ose i është hequr aftësia për të vepruar, përkatësisht nga kujdesi prindëror dhe kur nëna ka vendqëndrimin e panjohur, padinë mund të paraqet kujdestari me lejen e Organit të Kujdestarisë.</p> <p>4. Nëna mund të paraqet padinë për vërtetimin e atësisë derisa të ketë të drejtën të ushtrojë të drejtën prindërore.</p>	<p>3. Claim for annulment of a statement may be submitted to the court within a period of six months from the date, coercion ceased to exist or the moment mistake is noticed.</p> <p style="text-align: center;">Article 1237 Extra Marital Children</p> <p>1. Apart of a person considering himself father of the child, the child and the child's mother may also submit a claim for paternity verification.</p> <p>2. Extra marital child may submit a claim for paternity verification at any time.</p> <p>3. If child is minor or is legally incapable to act, mother may on his behalf submit a claim. If mother is not alive, or has been deprived from parental responsibility or mother's place of residence is unknown, claim may be submitted by custodian with the permission of Custodian Body.</p> <p>4. Mother may submit a claim for the verification of paternity as long as she has parental right for the child.</p>	<p>3. Tužba za poništenje izjave može se podneti sudu u roku od šest meseci od dana kad je prinuda obelodanjena, ili od dana kad je greška uočena.</p> <p style="text-align: center;">Član 1237 Vanbračna deca</p> <p>1. Pored lica koje sebe smatra ocem deteta, tužbu za utvrđivanje očinstva deteta rođenog van braka mogu podneti i dete i majka deteta.</p> <p>2. Dete rođeno van braka može uvek podneti tužbu za utvrđivanje očinstva.</p> <p>3. Ako je dete maloletno ili je poslovno nesposobno, tužbu u njegovo ime može da podnese majka. Ako majka nije živa, ili je lišena poslovne sposobnosti, odnosno ako je lišena roditeljskog prava, kao i kad je njeno boravište nepoznato, tužbu može da podnese staralac uz saglasnost Organa Starateljstva.</p> <p>4. Majka može podneti zahtev za dokazivanje očinstva sve dok ima pravo da vrši roditeljska prava.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 1238 Veprimi sipas detyrës zyrtare</p> <p>1. Nëse nëna ka shënuar personin e caktuar si at të fëmijës së vet, kurse brenda një viti nga dita e lindjes së fëmijës nuk e fillon procedurën për vërtetimin e atësisë, organi i kujdestarisë sipas detyrës zyrtare mund të fillojë procedurën në emër të fëmijës. Me atë rast fëmijës i caktohet kujdestari i posaçëm për zhvillimin e procedurës.</p> <p>2. Organi i kujdestarisë nuk do të fillojë procedurën për vërtetimin e atësisë sipas detyrës zyrtare nëse nëna për shkaqe të arsyeshme kundërshton këtë gjë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1238 Ex officio action</p> <p>1. When the mother has recorded specific person to be father of her child and within a period of one year from the child's birth does not initiate paternity verification procedure, Custodian Body may <i>ex officio</i> initiate such procedure on behalf of a child. In this case the child is assigned a special custodian to conduct the procedures.</p> <p>2. Custodian Body shall not initiate the procedure of <i>ex officio</i> verification of paternity, if mother objects to this action due to justifiable reasons.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1238 Postupak po službenoj dužnosti</p> <p>1. Kad je majka označila određeno lice kao oca svog deteta, a u roku od godinu dana od dana rođenja deteta ne pokrene postupak za utvrđivanje očinstva, organ starateljstva može po službenoj dužnosti pokrenuti taj postupak u ime deteta. U tom slučaju detetu će biti dodeljen poseban staralac za vođenje postupka.</p> <p>2. Organ starateljstva neće po službenoj dužnosti pokrenuti postupak za utvrđivanje očinstva, ako se majka iz opravdanih razloga protivi tome.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II - Amësia</p> <p style="text-align: center;">Neni 1239 Vërtetimi i amësisë</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Maternity</p> <p style="text-align: center;">Article 1239 Verification of maternity</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Materinstvo</p> <p style="text-align: center;">Član 1239 Utvrđivanje materinstva</p>
<p>Dispozitat e këtij libri për vërtetimin e atësisë gjithashtu zbatohen edhe me rastin e vërtetimit të amësisë.</p>	<p>Provisions of this Law regarding verification of paternity shall also apply for verification of maternity</p>	<p>Odredbe ove knjige o utvrđivanju očinstva biće jednako primenjene i na utvrđivanje materinstva.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli III – Kundërshtimi i Atësisë dhe Amësisë</p> <p style="text-align: center;">Neni 1240 Kundërshtimi i atësisë nga burri</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter III – Rejection of Paternity and Maternity</p> <p style="text-align: center;">Article 1240 Rejection of paternity by husband</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje III – Oспорavanje Očinstva i Materinstva</p> <p style="text-align: center;">Član 1240 Oспорavanje očinstva od strane muža</p>

<p>1. Burri mund të kundërshtojë atësinë e fëmijës të cilin e ka lindur gruaja e tij gjatë martesës ose para kalimit të (300) ditëve nga zgjidhja e martesës, nëse konsideron se nuk është at i fëmijës.</p> <p>2. Padia për kundërshtimin e atësisë mund të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita e marrjes në dijeni të faktit që vë në dyshim atësinë e tij. Kërkesa nuk mund të dërgohet më vonë se afati prej (10) vjetësh nga lindja e fëmijës.</p> <p>3. Nëse burrit të nënës së fëmijës i është hequr plotësisht aftësia për të vepruar, padinë për kundërshtimin e atësisë së tij mund ta ngritë kujdestari i tij me lejen e Organit të Kujdestarisë.</p>	<p>1. Husband may reject paternity of the child born by his wife during marriage, or before expiry of (300) days from dissolution of marriage, if he does not consider himself being the father of the child.</p> <p>2. Claim on rejection of paternity may be submitted within six months from the time of acknowledgement of the fact that gave reason for the assumption of paternity. Claim shall not be submitted later than a period of (10) years after the child's birth.</p> <p>3. If husband of the child's mother has been completely deprived from his capacity to act, claim rejecting his paternity may be submitted by his custodian with the permission of the Custodian Body.</p>	<p>1. Muž može da ospori očinstvo deteta koje je rodila njegova žena za vreme trajanja braka ili pre isteka perioda od trista (300.) dana od prestanka braka, ako smatra da on nije otac deteta.</p> <p>2. Tužba u cilju osporavanja očinstva može da se podnese u roku od šest meseci od dana saznanja za činjenicu koja dovodi u sumnju pretpostavku njegovog očinstva. Tužba ne može biti podneta kasnije od deset (10.) godina od rođenja deteta.</p> <p>3. Ako je muž majke deteta bio potpuno lišen poslovne sposobnosti, tužbu radi osporavanja njegovog očinstva može da podnese njegov staralac uz odobrenje organa starateljstva.</p>
<p>Neni 1241 Kundërshtimi i atësisë nga nëna</p>	<p>Article 1241 Rejection of paternity by mother</p>	<p>Član 1241 Osporavanje očinstva od strane majke</p>
<p>1. Nëna mund të kundërshtojë se është at i fëmijës së saj personi i cili, sipas paragrafit 1. të nenit 1226 të këtij Libri, konsiderohet at i fëmijës.</p> <p>2. Padia për kundërshtimin e atësisë nga nëna duhet të paraqitet brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga lindja e fëmijës.</p>	<p>1. Mother may reject a father of the child to be the person, who according to Paragraph 1 of the Article 1226 is considered to be father of a child.</p> <p>2. Claim rejecting paternity by the mother shall be submitted within six (6) months from the child's birth.</p>	<p>1. Majka može da ospori da je otac njenog deteta lice koje se na osnovu stava 1., člana 1226. ove Knjige, smatra njegovim ocem.</p> <p>2. Tužbu radi osporavanja očinstva od strane majke treba se podneti u roku od šest (6.) meseci od dana rođenja deteta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1242 Kundërshtimi i atësisë me iniciativën e fëmijës</p> <p>1. Fëmija mund të kundërshtojë atësinë e personit i cili me këtë libër konsiderohet si at i tij.</p> <p>2. Fëmija mund të paraqesë padinë për kundërshtimin e atësisë. Nëse fëmija është i mitur ose nuk ka aftësi për të vepruar, padinë në emër të tij mund ta paraqet nëna, e nëse nëna nuk është e gjallë ose ka vendqëndrimin e panjohur, apo i është hequr aftësia për të vepruar ose i është hequr e drejta prindore, padinë mund ta paraqet kujdestari me lejen e organit të kujdestarisë.</p> <p>3. E drejta e padisë së fëmijës për kundërshtimin e atësisë nuk parashkruhet.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1242 Rejection of paternity on child`s initiative</p> <p>1. Child may reject paternity of a person, who according to this Book is considered to be his father.</p> <p>2. Child may submit a claim rejecting paternity. When child is minor or legally incapable, claim on his behalf may be submitted by mother and, if the mother is no longer alive or her place of residence is unknown or she has not legal capacity, or she has been deprived from parental right, claim may be submitted by custodian with the permission of Custodian Body.</p> <p>3. Child`s right to claim rejection of paternity is not prescriptive.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1242 Osporavanje oćinstva sa inicijativom deteta</p> <p>1. Dete mođe da ospori oćinstvo osobe koja se prema ovoj knjizi smatra njegovim ocem.</p> <p>2. Dete mođe da podnese tuđubu radi osporavanja oćinstva. Kad je dete maloletno ili je poslovno nesposobno, tuđubu u njegovo ime mođe da podnese majka, a ako majka nije živa, ili je njeno boravište nepoznato, ili je lišena poslovne sposobnosti, ili je lišena roditeljskog prava, tuđubu mođe da podnese staralac uz odobrenje organa starateljstva.</p> <p>3. Pravo deteta na podnošenje tuđube za osporavanja oćinstva ne zastareva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1243 Kundërshtimi i atësisë nga personi i tretë për fëmijën jashtëmartesor</p> <p>1. Personi që e konsideron veten at i fëmijës së lindur jashtë martesës, mund të kërkojë pavlefshmërinë e atësisë së personit tjetër i cili atë fëmijë e ka pranuar si të vetin, me kusht që me po atë padë të kërkojë që të vërtetohet atësia e tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1243 Rejection of paternity by third person for an extra marital child</p> <p>1. Person considering himself to be the father of an extra-marital child may claim invalidity of the paternity of the other person who accepted a child as his own, provided that with the same claim he requests verification of his own paternity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1243 Osporavanje oćinstva od trećeg lica za vanbraćno dete</p> <p>1. Lice koje sebe smatra ocem deteta rođenog van braka, mođe da ospori oćinstvo drugog lica koje je to dete priznalo za svoje, pod uslovom da istom tuđuбом traži da bude utvrđeno njegovo oćinstvo.</p>

<p>2. Padia mund të paraqitet brenda afatit prej një viti nga regjistrimi i atësisë së kundërshtuar në regjistrin amë të të lindurve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1244 Kundërshtimi i atësisë nga personi i tretë për fëmijën e lindur në martesë</p> <p>1. Personi që e konsideron vetën at i fëmijës të lindur në martesë mund t'ia kundërshtojë atësinë personit i cili, sipas këtij libri, konsiderohet at i fëmijës.</p> <p>2. Kjo vlen vetëm në rastet kur personi ka jetuar në bashkësi me nënën e fëmijës në kohën e zënies së fëmijës, me kusht që me po atë padi të kërkojë që të vërtetohet atësia e tij.</p> <p>3. Padia për kundërshtimin e atësisë në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paraqitet brenda afatit prej një viti nga lindja e fëmijës.</p>	<p>2. Claim may be submitted within a period of one year from the date of registration of the rejected paternity in the register of births.</p> <p style="text-align: center;">Article 1244 Rejection of Paternity of a third Person for a Marital Child</p> <p>1. Person considering himself father of a marital child, may reject paternity of a third person who according to this Book is considered to be father of the child.</p> <p>2. This applies only in case that the person has lived in cohabitation with the mother of the child at the time of the conception and that with the same claim he requests verification of his own paternity.</p> <p>3. Claim rejecting paternity provided for in Paragraph (1) of this Article shall be submitted within a period of one year from the child's birth.</p>	<p>2. Tužba može da bude podneta u roku od jedne godine od dana upisa osporavanog očinstva u matičnu knjigu rođenih.</p> <p style="text-align: center;">Član 1244 Osporavanje očinstva od trećeg lica za dete rođeno u braku</p> <p>1. Lice koje sebe smatra ocem deteta rođenog u braku, može da ospori očinstvo lica koje se prema ovoj knjizi smatra ocem deteta.</p> <p>2. Ovo važi samo u slučaju da je to lice živelo u zajednici sa majkom deteta u vreme začeća deteta, pod uslovom da istom tužbom zahteva da se utvrdi njegovo očinstvo.</p> <p>3. Tužba radi osporavanja očinstva u slučaju iz stava 1. ovog člana može da bude podneta u roku od jedne godine od dana rođenja deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1245 Kundërshtimi i amësisë</p> <p>1. Gruaja, e cila është regjistruar në regjistrin amë të të lindurve si nënë e fëmijës, mund ta kundërshtojë amësinë e vet nëse konsideron se nuk është nënë e fëmijës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1245 Rejection of Maternity</p> <p>1. Woman registered in the register of births as mother of a child, may reject her maternity, if she considers not to be child's mother.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1245 Osporavanje materinstva</p> <p>1. Žena koja je upisana u matičnu knjigu rođenih kao majka deteta može osporiti svoje materinstvo ako smatra da nije majka deteta.</p>

<p>2. Padia për kundërshtimin e amësisë mund të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga marrja në dijeni e faktit se nuk është nënë e fëmijës, e më së voni brenda afatit prej (7) vjetësh nga lindja e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1246 Kundërshtimi i amësisë nga personi i tretë</p> <p>1. Gruaja e cila e konsideron vetën nënë e fëmijës mund t'ia kundërshtojë amësinë gruas tjetër e cila në regjistrin amë të të lindurve është regjistruar si nënë e atij fëmije, me kusht që me po atë padi të kërkojë që të vërtetohet amësia e saj.</p> <p>2. Padia e këtillë do të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga marrja në dijeni se ajo është nënë e atij fëmije, e më së voni brenda afatit prej (7) vjetësh nga lindja e fëmijës.</p>	<p>2. Claim rejecting maternity may be submitted within a period of six months from the date of learning not to be child`s mother and at the latest within the period of (7) years from the child`s birth.</p> <p style="text-align: center;">Article 1246 Rejection of maternity of a third Person</p> <p>1. Woman that considers herself being mother of a child may reject maternity of the other woman, which has been registered as mother of that child in the register of births, provided that with the same claim she requests verification of her own maternity.</p> <p>2. Such claim shall be submitted within a period of six months from the date of learning that she is mother of that child and at the latest within the period of (7) years from the child`s birth.</p>	<p>2. Tužbu radi osporavanja materinstva može da bude podneta u roku od šest meseci od dana saznanja za činjenicu da nije majka deteta, a najkasnije u roku od sedam (7) godina od rođenja deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1246 Osporavanje materinstva od trećeg lica</p> <p>1. Žena koja sebe smatra majkom deteta može da ospori materinstvo druge žene, koja je upisana u matičnu knjigu rođenih kao majka deteta pod uslovom da istom tužbom zahteva da se utvrdi njeno materinstvo.</p> <p>2. Takva tužba može da bude podneta u roku od šest meseci od dana saznanja za činjenicu da je majka deteta, a najkasnije u roku od sedam (7.) godina od rođenja deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1247 Kundërshtimi i amësisë me iniciativën e fëmijës</p> <p>1. Fëmija mund t'a kundërshtojë amësinë e gruas e cila është regjistruar në regjistrin amë të të lindurve si nënë e tij.</p> <p>2. Deri në moshën madhore të fëmijës, si dhe në rastin kur fëmijës i është hequr aftësia për</p>	<p style="text-align: center;">Article 1247 Rejection of Maternity on child`s initiative</p> <p>1. Child may reject maternity of the woman registered in the register of births to be his mother.</p> <p>2. Until the age of adulthood of the child and in cases, when the child has been deprived</p>	<p style="text-align: center;">Član 1247 Osporavanje materinstva sa inicijativom deteta</p> <p>1. Dete može da ospori materinstvo žene koja je upisana u matičnu knjigu rođenih kao njegovja majka.</p> <p>2. Do sticanja punoletstva deteta, i u slučajevima kad je dete lišeno poslovne</p>

<p>të vepruar, Organi i Kujdestarisë apo kujdestari në emër të Organit të Kujdestarisë mund të paraqet këtë padi në emër të tij.</p> <p>3. E drejta e padisë së fëmijës për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1248 Trashëgimi i të drejtave</p> <p>1. E drejta për padi për kundërshtimin e atësisë, si dhe e drejta për padi për kundërshtimin e amësisë nuk kalon në trashëgimtarët e personave të autorizuar, sidoqoftë trashëgimtarët mund të vazhdojnë procedurën e filluar nëse për këtë gjë kanë interes juridik.</p> <p>2. Përfundimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, trashëgimtarët e personit që, sipas këtij libri, konsiderohet at i fëmijës mund të paraqesin padinë për kundërshtimin e atësisë nëse ai person nuk ka qenë i njoftuar as për zënien e nënës as për lindjen e fëmijës, e as në kohën e zënies së fëmijës nuk ka jetuar në bashkësi me nënën e fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1249 Përfundimisht</p>	<p>from his capacity to act, Custodian Body or custodian, with the permission of the Custodian Body may submit such claim on the child's behalf.</p> <p>3. Child's right to claim rejection of maternity is not prescriptive.</p> <p style="text-align: center;">Article 1248 Succession of rights</p> <p>1. Right to claim rejection of paternity as well as the right to claim rejection of maternity is not transferred to successors of authorized persons; however, successors may continue commenced procedure, if they have a legal interest in this issue.</p> <p>2. Exceptionally from provisions of Paragraph 1 of this Article, successors of the person, who according to this Law is considered being father of the child, may submit a claim rejecting paternity, if such person was not informed, neither of the conception of mother, nor of the birth of a child, nor has he lived together with the mother of the child.</p> <p style="text-align: center;">Article 1249 Exception</p>	<p>sposobnosti, tužbu u ime deteta može da podnese organ starateljstva ili staralac u ime organa starateljstva.</p> <p>3. Pravo deteta na podnošenje tužbe za osporavanja materinstva ne zastareva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1248 Nasleđivanje prava</p> <p>1. Pravo na tužbu u cilju osporavanja očinstva, kao i pravo na tužbu radi osporavanja materinstva, ne prelazi na naslednike ovlašćenih lica, međutim naslednici mogu da nastave započeti postupak ako za to imaju pravni interes.</p> <p>2. Izuzetno od odredbe stava 1. ovog člana, naslednici lica koji, prema ovoj Knjizi se smatra ocem deteta, mogu podneti tužbu radi osporavanja očinstva, ako to lice nije saznalo ni za začeće majke, ni za rođenje deteta, niti je u vreme začeća deteta bio u vanbračnom životu sa majkom deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1249 Izuzetak</p>
--	--	---

<p>Pas vdekjes së fëmijës nuk lejohet kundërshtimi i atësisë dhe i amësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1250 Përcaktimi ose kundërshtimi i atësisë ose amësisë i fëmijës të zënë me asistencë mjekësore</p> <p>Nuk lejohet përcaktimi ose kundërshtimi i atësisë ose amësisë i fëmijës i cili është zënë me asistencë mjekësore dhe me pëlqimin e donatorit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1251 Përjashtimet në përcaktimin ose kundërshtimin e atësisë ose amësisë të fëmijëve të zënë me asistencë mjekësore</p> <p>1. Përjashtimisht, burri i nënës mund të kundërshtojë atësinë e fëmijës së lindur në kohën e martesës ose pas (300) ditëve nga mbarimi i martesës, nëse fëmija është zënë me mbarsim artificial me farën e personit të tretë pa pëlqimin me shkrim të bashkeshortit.</p> <p>2. Gruaja, e cila ka lindur fëmijën e zënë me qelizën vezore të një gruaje tjetër, ka të drejtë të kundërshtojë amësinë nëse mbarsja është bërë me asistencë mjekësore dhe pa pëlqim me shkrim të saj.</p>	<p>Rejection of paternity or maternity is not permitted after child's death.</p> <p style="text-align: center;">Article 1250 Determination or rejection of maternity or paternity of children conceived by medical assistance</p> <p>Determination or rejection of maternity or paternity of a child which is conceived by medical assistance and the consent of the donor it is not allowed.</p> <p style="text-align: center;">Article 1251 Exceptions in determination or rejection of maternity or paternity of children conceived by medical assistance</p> <p>1. Exceptionally, husband of the mother may reject paternity of the child born at the time of marriage or after (300) days from termination of marriage, if the child was conceived artificially with the sperm of a third person and without written consent of the spouse.</p> <p>2. Woman, which gave birth to a child conceived by an ovule cell of another woman, has the right to reject maternity, if conception was carried out by medical assistance and with no written consent of hers.</p>	<p>Nakon smrti deteta ne dozvoljava se osporavanje očinstva ili materinstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1250 Utvrđivanje ili osporavanje očinstva ili materinstva deteta koje je začeto uz medicinsku pomoć</p> <p>Nije dopušteno utvrđivati niti osporavati materinstvo ili očinstvo deteta koje je začeto uz medicinsku pomoć i uz pristanak donatora.</p> <p style="text-align: center;">Član 1251 Izuzeci u utvrđivanju ili osporavanju očinstva ili materinstva deteta koje je začeto uz medicinsku pomoć</p> <p>1. Izuzetno, muž majke može da ospori očinstvo deteta rođenog za vreme trajanja braka ili u roku od trista (300.) dana nakon završetka braka, ako je dete bilo začeto veštačkom oplodnjom uz korišćenje semena trećeg lica bez pisane saglasnosti muža.</p> <p>2. Žena, koja je rodila dete začeto uz pomoć jajne ćelije neke druge žene, ima pravo da ospori materinstvo, ako je začete bilo izvršeno uz korišćenje medicinske pomoći ali bez njene pisane saglasnosti.</p>
--	--	---

<p>3. Gruaja, me qelizën vezë të të cilës është zënë fëmija pa pëlqimin me shkrim të saj, ka të drejtë të kundërshtojë amësinë e gruas e cila e ka lindur fëmijën, nëse në të njëjtën kohë kërkon verifikimin e amësisë së saj.</p> <p>4. Padia për kundërshtimin e atësisë ose amësisë mund të parashtrohet brenda gjashtë muajve nga data kur është informuar lidhur me zënien nga Paragrafi 1, 2, dhe 3 të këtij neni. Kjo nuk do të bëhet pasi që fëmija ka arritur moshën shtatë vjeç.</p> <p>5. Nëse personat nga Paragrafi 1, 2, dhe 3 të këtij neni, mësojnë për zënien para lindjes së fëmijës, do të parashtrorjnë padi për kundërshtimin e atësisë ose amësisë brenda gjashtë muajve nga lindja e fëmijës.</p>	<p>3. Woman with the ovule cell of whom the child has been conceived without written consent of hers, has the right to reject maternity of the woman who gave birth of a child, if at the same time she claims verification of her own maternity.</p> <p>4. Claim rejecting maternity or paternity may be submitted within six months from the date of being informed about the conception as provided for in Paragraphs 1, 2 and 3 of this Article. This shall not be submitted after the child reached age of seven.</p> <p>5. If persons mentioned in Paragraph 1, 2 and 3 of this Article learn about conception before time of birth of the child, they shall submit a claim rejecting maternity or paternity within six months from the child's birth.</p>	<p>3. Žena, pomoću čije jajne ćelije je bilo začeto dete bez njene pisane saglasnosti, ima pravo da ospori materinstvo ženi koja je rodila dete, ukoliko istovremeno tužbom zahteva utvrđivanje svog materinstva.</p> <p>4. Tužba kojom je osporeno materinstvo ili očinstvo može se podneti u roku od šest meseci od dana saznanja za začecje propisano u stavovima 1., 2., i 3. ovog člana. Ovo se ne može izvršiti nakon što dete napuni sedam godina.</p> <p>5. Ako lica navedena u stavovima 1., 2., i 3. ovog člana, saznaju o tom začecju pre nego što dete bude rođeno, oni mogu da podnesu tužbu kojom osporavaju materinstvo ili očinstvo u roku od šest meseci od dana rođenja deteta.</p>
<p>KAPITULLI II – MBROJTJA E FËMIJËVE DHE PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE</p>	<p>CHAPTER II – CHILD PROTECTION AND PARENTAL RESPONSIBILITY</p>	<p>POGLAVLJE II – ZAŠTITA DECE I RODITELJSKA ODGOVORNOST</p>
<p>Nënkpaitulli I – Mbrojtja e Fëmijëve</p>	<p>Sub-chapter I – Child Protection</p>	<p>Potpoglavlje I – Zaštita dece</p>
<p>Neni 1252 Parimet për mbrojtjen e fëmijëve</p>	<p>Article 1252 Principles of child protection</p>	<p>Član 1252 Načela zaštite dece</p>
<p>1. Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.</p>	<p>1. Every child enjoys the undeniable right for life.</p>	<p>1. Svako dete uživa neosporno pravo na život.</p>

<p>2. Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë;</p> <p>3. Fëmijët me paaftësi për të gjykuar të diagnostifikuar ose paaftësi fizike kanë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore.</p> <p>4. Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillore falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme si dhe për shkollat që ekzistojnë.</p> <p>5. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimit të fëmijëve, trafikimit dhe eksploatimit seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre.</p> <p>6. Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual.</p> <p>7. Fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të</p>	<p>2. Children have the right to grow up in a family with parents. Children not living together with both parents, have the right to regularly meet the parent they are not living together with.</p> <p>3. Children with diagnosed incapacity to judge and physical disability are eligible to special care, suitable conditions of life which guarantee their dignity and facilitate active participation in social life.</p> <p>4. Children are eligible to free of charge primary education and access to information regarding different professions and existing schools.</p> <p>5. Children enjoy the right for protection from economic utilization, child exploitation trafficking and sexual exploitation and from conduction of any activity which could be harmful or hazardous to their education or health.</p> <p>6. Children shall be protected from maltreatment and sexual violations.</p> <p>7. Children shall be protected from illegal usage of narcotic drugs and psychotropic substances and it shall not be permitted to use</p>	<p>2. Deca imaju pravo da odrastaju u porodici sa roditeljima. Deca koja ne žive zajedno sa oba svoja roditelja, imaju pravo da se redovno susreću sa njima.</p> <p>3. Deca koja su dijagnostifikovana nesposobnošću rasuđivanja ili fizičkim nesposobnostima, imaju pravo na posebnu negu, na prikladan život prema okolnostima, na životne uslove koje garantuju njihovo dostojanstvo i olakšavaju aktivno učešće u društvenom životu.</p> <p>4. Deca imaju pravo na besplatno školovanje u osnovnoj školi, i na pristup informacijama u vezi sa različitim zanimanjima kao i za škole koje postoje.</p> <p>5. Deca uživaju pravo na zaštitu od ekonomskog iskorišćavanja, eksploatacije dečjeg rada, trgovine ljudima i seksualnog iskorišćavanja kao i od obavljanja bilo kog posla koji je štetan ili rizičan po njihovo obrazovanje ili zdravlje.</p> <p>6. Deca moraju biti zaštićena od seksualnog zlostavljanja i silovanja.</p> <p>7. Deca moraju biti zaštićena od nezakonitog korišćenja narkotičkih droga i psihotropnih supstanci i ne treba se dozvoliti iskorišćavanje</p>
--	--	--

<p>përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve.</p> <p>8. Mendimi i fëmijës, i cili ka mbushur moshën (6) vjeçare duhet të merret parasysh nga gjykata në çdo rast kur vendoset për interesin e fëmijës. Për fëmijën nën moshën (6) vjeçare gjykata e merr mendimin e tij me metoda të përshtatshme në seancë ose jashtë seance sa herë që e konsideron të nevojshme.</p>	<p>children for illegal production and trafficking of such substances.</p> <p>8. The opinion of the child who has reached the age of six (6) should be taken into account by the court in any case when deciding on child's interest. For the child under the age of six (6), the court takes child's opinion with appropriate methods in the session or outside the session, whenever it deems it necessary.</p>	<p>dece u nezakonitoj proizvodnji i trgovini ovih supstanci.</p> <p>8. Mišljenje deteta, koje je navršilo (6) godina treba da bude uzeto u obzir od strane suda u svakom slučaju kada se odlučuje o interesu deteta. Za dete mlađe od (6) godina sud uzima njegovo mišljenje sa prikladnim metodama na ročištu ili van ročišta koliko god puta smatra to potrebnim.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1253 Banimi i përbashkët dhe i ndarë</p> <p>1. Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre.</p> <p>2. Fëmijët e mitur mund të jetojnë ndaras nga prindërit e tyre vetëm kur këtë gjë e kërkojnë interesat e përbashkëta të fëmijëve dhe të prindërve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1253 Cohabitation and separate living</p> <p>1. Minor children have the right to live with their parents.</p> <p>2. Minor children may live separately from their parents only if common interests of children and parents require so.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1253 Zajedničko i odvojeno stanovanje</p> <p>1. Maloletna deca imaju pravo da žive sa svojim roditeljima.</p> <p>2. Maloletna deca mogu da žive odvojeno od svojih roditelja samo ako tako zahtevaju zajednički interesi dece i roditelja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1254 Kthimi i fëmijës në banim të përbashkët me prindërit</p> <p>Prindërit mund të kërkojnë kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur fëmija nuk jeton me ata ose mbahet pa të drejtë nga persona tjerë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1254 Return of a child in cohabitation with parents</p> <p>Parents shall request return of their minor child, when a child is not living with them or is unjustly kept by other persons.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1254 Povratak deteta u zajedničkom stanovanju sa roditeljima</p> <p>Roditelji mogu zahtevati povratak njihovog maloletnog deteta, kada dete ne živi sa njima ili kad se nepravedno drži od drugih lica.</p>

Nënkpaitulli II – Përgjegjësia Prindërore	Sub-chapter II – Parental Responsibility	Potpoglavlje II – Roditeljska odgovornost
<p data-bbox="353 272 651 341" style="text-align: center;">Neni 1255 Përgjegjësia prindore</p> <ol data-bbox="203 421 801 1267" style="list-style-type: none"> 1. Përgjegjësia prindërore rezulton fillimisht nga e drejta për kujdes prindëror. 2. Fëmija është nën përgjegjësi prindërore deri në moshën madhore. 3. Prindërit janë të detyruar të sigurojnë në çdo kohë që parimet e përcaktuara në nenin 1252 të këtij Libri përdoren për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të mitur. 4. Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë. 5. Duke i zbatuar këto parime, prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre. 	<p data-bbox="965 272 1279 379" style="text-align: center;">Article 1255 Parental responsibility Principles</p> <ol data-bbox="824 421 1413 1267" style="list-style-type: none"> 1. Parental responsibility primarily results from the right for parental care. 2. A child is under parental responsibility until it reaches majority age. 3. Parents are obliged to ensure at any times that the principles laid out in Article 1252 of this Book are utilized for protection of their minor children. 4. Parental responsibility includes rights and obligations, aiming to ensure emotional, social and material welfare of the child, by looking after the child, preserving personal relations with a child, providing proper growth, education, vocational training, legal representation and administration of property. 5. By applying these principles parents shall consider skills, expectations and desires of their children. 	<p data-bbox="1563 268 1906 341" style="text-align: center;">Član 1255 Roditeljska odgovornost</p> <ol data-bbox="1435 421 2033 1267" style="list-style-type: none"> 1. Roditeljska odgovornost prvenstveno proističe iz prava na roditeljsko staranje. 2. Dete je pod roditeljskom odgovornošću do svog punoletstva. 3. Roditelji su obavezni da obezbede da su načela propisana u članu 1252. ove Knjige u svakom trenutku upotrebljena za zaštitu njihove maloletne dece. 4. Roditeljska odgovornost obuhvata prava i obaveze koje imaju za cilj da obezbede emocionalno, socijalno i materijalno blagostanje deteta, na taj način što se staraju o istom, uz održavanje ličnog odnosa sa njime, uz obezbeđivanje zdravog odgoja, vaspitanja, obrazovanja, zakonsko zastupanje i upravljanje imovinom deteta. 5. Primenom ovih načela, roditelji trebaju uzeti u obzir sposobnosti, sklonosti i želje svoje dece.

<p style="text-align: center;">Neni 1256 Kontributi personal dhe shfrytëzimi i shërbimeve publike</p> <p>Për të realizuar kujdesin prindëror dhe për të zbatuar parimet e nenit 1255 të këtij Kodi prindërit janë të detyruar personalisht të japin kontributin e tyre si dhe të shfrytëzojnë shërbimet e institucioneve shoqërore nëse është e nevojshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1256 Personal contribution and usage of public services</p> <p>To ensure parental care and applt principles of Article 1255 of this Code, parents are obliged to personally give out their contributions and to make use of services of social institutions when necessaary.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1256 Lični doprinos i korišćenje javnih usluga</p> <p>Za ostvarivanje roditeljskog prava i primene člana 1255. ovog Zakonika, roditelji su obavezni da daju svoj lični doprinos kao i da koriste usluge javnih institucija ako je potrebno.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1257 Përcaktimi i mbiemrit të fëmijës</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fëmijës ia caktojnë mbiemrin prindërit me marrëveshje. 2. Fëmija e merr mbiemrin sipas mbiemrit të njërit ose të të dy prindërve. 3. Fëmijëve të përbashkët prindërit nuk mund t'ua caktojnë mbiemra të ndryshëm. 4. Kur prindërit nuk mund të arrijnë marrëveshjen për mbiemrin e fëmijës, mbiemri përcaktohet nga Organi i Kujdestarisë, në pajtim me dispozitat e 	<p style="text-align: center;">Article 1257 Determination of child's surname</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parents in agreement determine surname of a child. 2. Child obtains the surname of one or of both parents. 3. Parents shall not determine different surnames to joint children. 4. When parents cannot reach an agreement regarding the surname of a child, surname is determined by Custodian Body after hearing both parents. 	<p style="text-align: center;">Član 1257 Određivanje prezimena deteta</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Roditelji sa sporazumom određuju prezime deteta. 2. Dete dobija prezime jednog roditelja ili prezimena oba roditelja. 3. Roditelji ne mogu dati različita prezimena svojoj zajedničkoj deci. 4 Kad roditelji ne mogu postići dogovor u vezi sa prezimenom deteta, nakon saslušanja oba roditelja prezime određuje organ starateljstva u saglasnosti sa odredbama stava 2. ovog člana.

<p>paragrafit 2 të këtij neni, pasi t'i dëgjojë të dy prindërit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1258 Përjashtimet</p> <p>1. Nëse njëri prind nuk është i gjallë, ose nuk ka mundësi që t'i ushtrojë të drejtat dhe detyrat prindërore, ose është i panjohur, mbiemrin e fëmijës e cakton prindi tjetër.</p> <p>2. Nëse prindërit e fëmijës nuk janë të gjallë ose nuk janë të aftë që të ushtrojnë kujdesin prindëror ose janë të panjohur, mbiemrin e fëmijës e cakton organi i kujdestarisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1258 Exceptions</p> <p>1. If one of the parents is not alive, or has no possibly to exercise parental rights and responsibilities, or he is unknown, other parent determines surname of the child.</p> <p>2. If both parents of the child are not alive, or have been deprived from parental responsibility or they are unknown, Custodian Body determines surname of the child.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1258 Izuzeci</p> <p>1. Ako jedan od roditelja nije živi, ili je nesposoban da vrši roditeljska prava i obaveze, ili je nepoznat, prezime deteta određuje drugi roditelj.</p> <p>2. Ako roditelji deteta nisu živi ili su nesposobni da vrše roditeljsko pravo ili su nepoznati, prezime deteta određuje organ starateljstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1259 Mbiemri i fëmijës pas ndryshimit në statusin e familjes</p> <p>1. Fëmijës së mitur të cilit i është caktuar mbiemri pas ndërrimit të statusit familjar me njohjen e atësisë, me lidhjen e martesës ndërmjet prindërve, me vërtetimin e atësisë ose të amësisë, përkatësisht me kundërshtimin e atësisë ose të amësisë, mund t'i caktohet mbiemri i ri, brenda afatit prej dy muajsh pas ndërrimit të statusit të familjes.</p> <p>2. Nëse mbiemri i ri i caktohet fëmijës me të vjetër se dhjetë vjeç, është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1259 Child's surname after change in family status</p> <p>1. A minor child who has been given a surname after changes in his family status by recognition of paternity, by marriage of the parents, by verification of paternity or by the rejection of paternity, may be determined a new surname within a period of two months after the change of family status.</p> <p>2. When a new surname is determined for a child who is older than ten years, child's consent is necessary.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1259 Prezime deteta posle promene porodičnog statusa</p> <p>1. Maloletnom detetu kome je određeno prezime nakon promene njegovog porodičnog statusa, s priznanjem očinstva, zbog sklapanja braka njegovih roditelja, usled utvrđivanja ili očinstva materinstva, odnosno osporavanja materinstva ili očinstva, može da dobije novo prezime u roku od dva meseca nakon promene porodičnog statusa.</p> <p>2. Ako se novo prezime odredi detetu starijem od deset godina, potreban je i pristanak deteta.</p>

<p>3. Deklarata për caktimin e mbiemrit i paraqitet ofiqarit i cili mban regjistrin amë të të lindurve për fëmijën, ose ofiqarit sipas vendbanimit të deklaratë dhënësit.</p>	<p>3. Statement for determination of a new surname shall be submitted to the registrar who keeps the register of births for the child, or to the registrar, based on the residence of the person providing statement.</p>	<p>3. Izjava o određivanju prezimena, dostavlja se matičaru koji vodi matičnu knjigu rođenih za dete, ili matičaru nadležnom prema mestu prebivališta lica koja daje tu izjavu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1260 Përfaqësimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 1260 Representation</p>	<p style="text-align: center;">Član 1260 Zastupanje</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1322 Shuarja e adoptimit dhe pasojat</p>	<p style="text-align: center;">Article 1322 Termination of adoption and consequences</p>	<p style="text-align: center;">Član 1322 Prestanak usvojenja i posledice</p>

<p>Marrëdhënia e adoptimit mundet të shuhet vetëm në bazë të rregullave të neneve të mëposhtëm 1323 deri 1327.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1323 Anulimi i adoptimit</p> <p>1. Gjykata mundet të anulojë marrëdhënien e adoptimit në bazë të kërkesës, nëse kjo ka qenë e themeluar pa kërkesë të adoptuesit, pa pëlqimin e fëmijës ose prindit.</p> <p>2. Kërkesa të cilës i mungon pëlqimi i nevojshëm është e pavlefshme vetëm nëse deklaruesi:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. në kohën e deklarimit ka qenë në gjendje të pavetëdijshme ose të çmendurisë së përkohshme, nëse kërkuesi ka qenë juridikisht jo kompetent për të kryer punë juridike, ose nëse fëmija më i ri se (14) vjet ose i paaftë për të vepruar e ka dhënë personalisht pëlqimin e tij dhe të vendimit të bërë për këtë arsye;</p>	<p>Adoptive relationship may only be terminated under the provisions of following Articles 1323 to 1327.</p> <p style="text-align: center;">Article 1323 Annulment of adoption</p> <p>1. Court may annul adoptive relationship on request, if it was established without a request of adopter or without consent of a child or consent of a parent.</p> <p>2. Request lacking necessary consent is ineffective only when the declarer:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. at the time of making statement was in a state of unconsciousness or temporary insanity, if applicant was legally incompetent to enter into a legal transaction or if the incompetent or less than (14) year old child personally gave his consent and decision was made thereupon,</p>	<p>Usvojenički odnos može da bude prekinut samo na osnovu odredaba narednih članova 1323. do 1327.</p> <p style="text-align: center;">Član 1323 Poništenje usvojenja</p> <p>1. Sud može da poništi usvojenički odnos na osnovu podnetog zahteva, ako je takav odnos bio zasnovan bez zahteva usvojioca ili bez saglasnosti deteta ili bez saglasnosti roditelja.</p> <p>2. Zahtev kome nedostaje neophodna saglasnost nevažeći je samo u slučajevima kad davalac:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. U vreme davanja izjave nije bio u svesnom stanju ili je bio u stanju privremene nesposobnosti rasuđivanja, ako podnosilac zahteva nije imao pravnu sposobnost za zaključenje pravnih poslova, ili ako je pravno nesposobno dete odnosno dete mlađe od (14) godina lično dalo svoju saglasnost a odluka o usvojenju je bila doneta na osnovu te saglasnosti;</p>
---	--	---

<p>2.2. ka dështuar të kuptojë procedurat e adoptimit ose edhe pse ai ka qenë në dijeni për këtë, nuk ka pasur për qëllim të kërkojë adoptim ose të shpreh pëlqimin e tij për procedurat e adoptimit;</p> <p>2.3. ka bërë gabim lidhur me identitetin e fëmijës ose fëmija që adoptohet ka bërë gabim lidhur me identitetin e adoptuesit;</p> <p>2.4. është shtyrë të bëjë deklaratë në mashtrim lidhur me rrethanat materiale;</p> <p>2.5. padrejtësisht me kërcënim është shtyrë të bëjë deklaratë.</p> <p>3. Anulimi mund të mos bëhet nëse deklaruesi e ka ratifikuar kërkesën ose pëlqimin pas shuarjes së metave të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>4. Padia për anulim mund të paraqitet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita kur është marrë në dijeni shkaku i anulimit e më së voni brenda prej një viti nga data e themelimit të adoptimit.</p>	<p>2.2. failed to understand adoption procedures or although he was aware thereof, he did not intend to request an adoption or to express his consent for adoption procedures,</p> <p>2.3. made a mistake concerning identity of a child or adoptive child made a mistake concerning identity of the adopter,</p> <p>2.4. was induced to make the statement by fraud, concerning material circumstances or</p> <p>2.5. was unlawfully induced to make statement under threats.</p> <p>3. Annulment may not be made, if the declarer has ratified request or consent after cessation of deficiencies mentioned under paragraph 2.</p> <p>4. Claim for annulment of adoption may be submitted within six months from the day when it was learnt about the reason for annulment and no later than within one year from the day of establishment of adoption.</p>	<p>2.2. nije mogao da razume postupak usvojenja, ili čak i ako je bio svestan toga, nije zaista nameravao da zatraži usvojenje niti da izjavi svoju saglasnost u postupku usvojenja;</p> <p>2.3. bio je u zabludi u vezi sa ličnošću deteta, ili kad usvojeno dete je bilo u zabludi u vezi sa ličnošću usvojioca;</p> <p>2.4. bio je prinuđen na davanje izjave putem prevare, koja se odnosi na materijalne okolnosti;</p> <p>2.5. nepravedno je bio prinuđen putem pretnje da se izjavi.</p> <p>3. Do prestanka usvojeničkog odnosa ne može da dođe ako je davalac izjave ratifikovao svoj zahtev ili saglasnost nakon prestanka manjkavosti pomenutih u stavu 2. ovog člana.</p> <p>4. Tužba za poništenje usvojeničkog odnosa može se podneti u roku od šest meseci od dana saznanja za razloge za poništenje a najkasnije u roku od godinu dana od dana usvojenja.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1324 Nuk ka shuarje për shkak të mungesës së pëlqimit</p> <p>Marrëdhënia e adoptimit nuk mund të shuhet, nëse mirëqenia e fëmijës do të dëmtohej qenësisht, përveç nëse interesat predominante të adoptuesit e kërkojnë shuarjen e adoptimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1324 No termination due to lack of consent</p> <p>Adoptive relationship may not be terminated, if welfare of the child would be substantially jeopardized thereby, unless the predominant interests of adopter necessitate termination.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1324 Nema prestanka zbog nedostatka saglasnosti</p> <p>Usvojenički odnos ne može se prekinuti, ako bi time bilo suštinski ugroženo blagostanja deteta, osim ukoliko preovlađujući interesi usvojioca čine zahtevaju prestanak tog odnosa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1325 Shuarja sipas detyrës zyrtare</p> <p>1. Gjatë moshës së miturisë së fëmijës, Gjykata kompetente mund të shuajë marrëdhënien e adoptimit me procedurë të vetën, nëse për çfarëdo arsye kjo bëhet e nevojshme për mirëqenien e fëmijës.</p> <p>2. Nëse fëmija është adoptuar nga çifti i martuar, marrëdhënia e adoptimit mes fëmijës dhe vetëm njërit nga bashkëshortët po ashtu mund të shuhet.</p> <p>3. Marrëdhënia e adoptimit mund të shuhet vetëm nëse:</p> <p>3.1. nëse në rastin nën paragrafin 2. bashkëshorti tjetër ose prindi biologjik është i pajtimit të marrë përsipër kujdesin dhe rritjen e fëmijës dhe nëse ushtrimi i</p>	<p style="text-align: center;">Article 1325 Ex officio termination</p> <p>1. During child`s minor age, competent Court may terminate adoptive relationship on its own procedure, if for any reasons this becomes necessary for the welfare of the child.</p> <p>2. If a child was adopted by a married couple, adoptive relationship between a child and only one of the spouses may also be ceased.</p> <p>3. Adoptive relationship may only be terminated:</p> <p>3.1. if in a case under paragraph 2 other spouse or a biological parent is willing to take over care and upbringing of a child and if exercise of the parental care by him</p>	<p style="text-align: center;">Član 1325 Prestanak po službenoj dužnosti</p> <p>1. Za vreme dok je dete maloletno, nadležni Sud može u sopstvenom postupku rešiti usvojenički odnos, ako iz bilo kojeg razloga to postane neophodno za blagostanje deteta.</p> <p>2. Ako je dete usvojio par koji je u braku, može takođe da bude rešen usvojenički odnos između deteta i samo jednog od supružnika.</p> <p>3. Usvojenički odnos može da bude rešen samo:</p> <p>3.1. ako je u slučaju iz stave 2. ovog člana, drugi supružnik ili pravi roditelj spreman da preuzme staranje deteta i njegov odgoj i ako</p>

<p>kujdesit prindëror nga ai nuk do të ishte në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës ose</p> <p>3.2. nëse shuarja do të lejonte adoptim të ri të fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1326 Pasojat e shuarjes</p> <p>1. Shuarja ka efekt vetëm për të ardhmen. Nëse Gjykata e shuan marrëdhënien e adoptimit me aplikimin e adoptuesit pas vdekjes së tij ose me aplikimin e fëmijës pas vdekjes, kjo ka efekt të njëjtë si shuarje e marrëdhënies së adoptimit para vdekjes.</p> <p>2. Me shuarjen e adoptimit, marrëdhënia e fëmijës dhe pasardhësve të tij me kushërinjtë e mëparshëm bazuar në adoptim ndërprehet së bashku me të drejtat dhe detyrat e krijuara.</p> <p>3. Në të njëjtën kohë marrëdhënia mes fëmijës dhe pasardhësve të tij dhe kushërinjtë natyral së bashku me të drejtat dhe detyrat që dalin nga kjo ripërtërihen me përjashtim të autoritetit prindëror i cili varet vetëm nga e drejta për kujdes;</p> <p>4. Gjykata do t'ia kthejë kujdesin prindëror prindërve biologjik, nëse dhe përderisa kjo</p>	<p>would not be in contrary to the child`s welfare, or</p> <p>3.2. if termination would facilitate new adoption of a child.</p> <p style="text-align: center;">Article 1326 Effects of termination</p> <p>1. Termination effects only future. If competent Court terminates adoptive relationship on the application of adopter after his death or on application of a child after death, it has the same consequence as an adoptive relationship terminated before death.</p> <p>2. Upon termination of adoption, child`s relationship and his descendants and to the relatives based on the adoption is terminated, together with the rights and obligations created thereby.</p> <p>3. At the same time relationship between a child and his descendants and natural relatives together with rights and obligations arising there from is revived, with the exception of parental care that depends only on the right for care.</p> <p>4. Court shall return parental care to natural parents, if and as far as it is not in contrary to</p>	<p>vršenje roditeljskog prava od strane tog lica ne bi bilo suprotno blagostanju deteta, ili</p> <p>3.2. ako bi rešenje usvojeničkog odnosa dozvolilo novo usvojenje deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1326 Posledice prestanka</p> <p>1. Prestanak usvojeničkog odnosa ima posledice samo za ubuduće. Ako Sud reši usvojenički odnos na zahtev usvojioca, nakon njegove smrti ili na zahtev deteta nakon smrti ovog drugog, to proizvodi iste posledice kao i prestanak usvojeničkog odnosa pre slučaja smrti.</p> <p>2. Nakon prestanka usvojenja, odnos između deteta i njegovih potomaka i njegovih rođaka stečenih po osnovu usvojenja biva prekinuta, zajedno sa pravima i obavezama stvorenim takvim odnosom.</p> <p>3. U isto vreme, odnos između deteta i njegovih potomaka i njegovih bioloških rođaka, zajedno sa pravima i obavezama koji proističu iz takvog odnosa biva obnovljena, sa izuzetkom roditeljskog prava koji u potpunosti zavisi samo od prava na staranje deteta.</p> <p>4. Sud će vratiti roditeljsko pravo biološkim roditeljima, ukoliko i dok to nije u suprotnosti</p>
---	---	--

<p>nuk është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës; në të kundërtën do të emërojë një kujdestar.</p> <p>5. Nëse prindërit adoptues janë bashkëshortë martesorë dhe shuarja prek vetëm të drejtat e njërit bashkëshort, efektet e cekura në paragrafin 2. rezultojnë vetëm në mes fëmijës dhe pasardhësve të tij në njërën anë dhe bashkëshortit të këtij të fundit dhe kushërinjve të tij në anën tjetër; efektet nën paragrafin 3. nuk rezultojnë.</p>	<p>the welfare of a child; otherwise it shall appoint a custodian.</p> <p>5. If adoptive parents are matrimonial spouses and termination affects only rights of one spouse, effects mentioned in paragraph 2 ensue only between child and his descendants on the one hand and latter spouse and his relatives on the other; effects under paragraph 3 do not ensue.</p>	<p>sa blagostanjem deteta; u suprotno imenuje se jedan staratelj za dete.</p> <p>5. Ako roditelji usvojioci su par koji je u braku a prestanak usvojenja ima dejstvo na prava samo jednog od supružnika, pravna dejstva navedena u stavu 2. nastaju samo između deteta i njegovih potomaka, s jedne strane, i onog drugog supružnika i njegovih rođaka, s druge strane; pravna dejstva iz stava 3. ne nastaju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1327 Pasojat në mbiemër</p>	<p style="text-align: center;">Article 1327 Effects on the surname</p>	<p style="text-align: center;">Član 1327 Posledice na prezime</p>
<p>1. Me shuarjen e adoptimit, fëmija humb të drejtën të bartë mbiemrin e adoptuesit si mbiemër të tij.</p> <p>2. Gjykata kompetente mundet me kërkesë të fëmijës, të vendosë që fëmija të mbajë mbiemrin që e ka fituar përmes adoptimit, nëse fëmija ka interes të arsyetuar që ta bartë këtë mbiemër.</p>	<p>1. Upon termination of adoption, child loses right to bear adopter`s surname as his surname.</p> <p>2. Competent Court may upon request of a child decide that the child retains the surname he acquired by means of adoption, if a child has justifiable interest in bearing this surname.</p>	<p>1. Posle prestanka usvojenja, dete gubi pravo da nosi prezime usvojioca kao svoje prezime.</p> <p>2. Nadležni Sud može na zahtev deteta, da odluči da dete zadrži prezime koje je steklo činom usvojenja, ako dete ima opravdani interes da nosi to prezime.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1328 Krijimi dhe përfundimi i marrëdhënieve familjare</p> <p>1. Me adoptim krijohen marrëdhënie familjare ndërmjet adoptuesit dhe personave në gjini në</p>	<p style="text-align: center;">Article 1328 Creation and Termination of Family Relations</p> <p>1. Upon adoption, family relations between adopting party and persons in his family on</p>	<p style="text-align: center;">Član 1328 Stvaranje i prestanak porodičnih odnosa</p> <p>1. Samim usvojenjem, nastaju porodični odnosi između usvojioca i rođaka iz njegove</p>

<p>njërën anë, dhe ndërmjet të adoptuarit dhe pasardhësve të tij në anën tjetër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.</p> <p>2. Me themelimin e adoptimit shuhen të drejtat dhe detyrimet e të adoptuarit ndaj prindërve të tij dhe personave në gjini të tjerë në familje si dhe të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe familjes ndaj tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1329 Moslejimi i vërtetimit të amësisë dhe të atësisë pas adoptimit</p> <p>Pas adoptimit nuk lejohet vërtetimi i amësisë ose atësisë së fëmijës së adoptuar.</p>	<p>one hand, and adoptee and his descendants on the other are created, along with all rights and obligations thereby.</p> <p>2. Upon on establishment of adoption rights and obligations of adoptee towards his parents and other persons in the family, as well as the rights and obligations of the parents and family towards him are terminated.</p> <p style="text-align: center;">Article 1329 Prohibition of maternity and paternity confirmation after adoption</p> <p>After adoption, it is not permissible to ask for confirmation of maternity and paternity of an adopted child.</p>	<p>porodice, s jedne strane, i usvojenika i njegovih potomaka, s druge strane, sa svim pravima i obavezama.</p> <p>2. Uspostavljanjem usvojenja, prestaju prava i obaveze usvojenika prema njegovim pravim roditeljima i drugim rođacima u porodici, kao i prava i obaveze pravih roditelja i porodice prema njemu.</p> <p style="text-align: center;">Član 1329 Ne dozvoljavanje utvrđivanja materinstva i očinstva posle usvojenja</p> <p>Nakon zaključenja usvojenja, ne dozvoljava se utvrđivanje materinstva i očinstva usvojenog deteta.</p>
<p>KAPITULLI III – VENDOSJA NË STREHIM FAMILJAR</p> <p style="text-align: center;">Neni 1330 Parimet e vendosjes së fëmijës në familjen tjetër</p> <p>1. Vendosja e fëmijës në familje është formë e organizuar shoqërore e përkujdesjes së fëmijëve në familjen tjetër.</p> <p>2. Fëmijët pa prindër ose pa kujdesin prindëror dhe fëmijët zhvillimi i të cilëve është penguar nga rrethanat në familjen e tyre, vendosen në</p>	<p>CHAPTER III – PLACEMENT OF A CHILD IN FOSTER CARE</p> <p style="text-align: center;">Article 1330 Principles of child placement in another family</p> <p>1. The placement of a child in a family is an organized social form of children’s care within another family.</p> <p>2. Children without parents or without parental care and children whose development has been impeded by circumstances in their</p>	<p>POGLAVLJE III – STAVLJANJE HRANITELJSTVO</p> <p style="text-align: center;">Član 1330 Načela stavljanja deteta u drugoj porodici</p> <p>1. Stavljanje dece u porodicu je društveno organizovani oblik njihovog zbrinjavanja u drugoj porodici.</p> <p>2. Deca bez roditelja ili bez roditeljskog staranja i deca čiji je razvoj bio ometene okolnostima u sopstvenoj porodici, biće</p>

<p>familjen tjetër për t'ua siguruar kushtet e domosdoshme për zhvillimin, edukimin dhe aftësimin e tyre për jetë dhe për punë të pavarur.</p> <p>3. Në familjen tjetër mund të vendosën fëmijët e lënë pasdore në edukimin, si dhe fëmijët me zhvillim të penguar.</p> <p>4. Gjendja materiale e prindërve nuk mund të jetë arsye për vendosje në familjen tjetër. Familja, fillimisht do të përkrahet me të gjitha mjetet e ndihmës sociale.</p> <p>5. Të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe kujdestarit të fëmijës në përputhje të dispozitave të kësaj pjese të ligjit, kufizohen për kohëzgjatjen e vendosjes në familje.</p>	<p>family, are placed in another family to ensure necessary conditions for development, education and their preparation for an independent work and life.</p> <p>3. Educationally neglected children as well as children, whose development has been impeded, may be placed in another family.</p> <p>4. The financial situation of parents shall not be a reason for a placement in another family. The family shall firstly be supported by all means of social welfare.</p> <p>5. Rights and obligations of parents and child's custodian in accordance to the provisions of this part of the Law, are limited for the duration of placement in a family.</p>	<p>smeštena u neku drugu porodicu radi obezbeđivanja neophodnih uslova za njihov razvoj, obrazovanje i osposobljavanje za samostalan život i rad.</p> <p>3. U drugu porodicu mogu da budu smeštena vaspitno-obrazovna zapostavljena deca, kao i deca čiji je razvoj bio ometen.</p> <p>4. Materijalno stanje roditelja ne može da bude jedan od razloga za smeštaj u neku drugu porodicu. Pre toga, porodica treba da dobije podršku svih vidova socijalne pomoći.</p> <p>5. Prava i dužnosti roditelja i staraoca prema detetu, u saglasnosti s odredbama ovog dela zakona, bivaju ograničeni za vreme trajanja smeštaja u porodici.</p>
<p>Neni 1331 Vendosja</p>	<p>Article 1331 Placement</p>	<p>Član 1331 Smeštaj</p>
<p>1. Fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdesin prindëror u garantohet vendosja në familje deri sa të aftësohen për jetë dhe punë të pavarur.</p> <p>2. Vendosja e fëmijës është e mundshme në familjen që i ka të dy prindërit ose njërin prind.</p> <p>3. Vendosja është e përcaktuar me pëlqim paraprak të prindërve biologjik të fëmijës dhe</p>	<p>1. Children without parents or without parental care are guaranteed placement in a family until they are considered as being able for an independent life and work.</p> <p>2. Placement of a child is possible within a family with two parents or one parent.</p> <p>3. Placement is determined upon preliminary consent of biological parents of the child and,</p>	<p>1. Deci bez roditelja ili deci bez roditeljskog staranja biće garantovan smeštaj u porodici sve dok ta deca ne budu sposobna za samostalni život i rad.</p> <p>2. Smeštaj dece je moguć u porodicu sa oba roditelja kao i sa jednim roditeljom.</p> <p>3. Smeštaj je određen uz prethodnu saglasnost bioloških roditelja deteta, i prema pravilu, taj</p>

<p>si rregull vendosja do të zgjasë për aq sa do të vazhdonin rrethanat të cilat e kanë shkaktuar atë.</p> <p>4. Pas vendosjes së fëmijës në familjen tjetër, Organi i Kujdestarisë ndërmerr menjëherë të gjitha masat e domosdoshme që të adresojë dhe në të ardhmen të mënjanojë të gjitha rrethanat të cilat e kanë bërë të domosdoshme vendosjen në familje përkujdesëse.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1332 Përgjegjësitë për përkujdesje</p> <p>1. Vendosja e fëmijës në familje bëhet në familjen e cila mund t'i përmbushë me sukses detyrimet prindërore, posaçërisht në pikëpamje të kujdesit, të edukimit, të arsimimit dhe të aftësimin të drejtë të fëmijës për jetë të pavarur.</p> <p>2. Vendosja e fëmijës në familje do të bëhet vetëm në familjen në të cilën prindi ose prindërit të cilit i besohet fëmija i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara me këtë libër për fëmijë dhe përgjegjësinë prindore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1333</p>	<p>as a rule, placement lasts for duration of circumstances which gave rise to the placement.</p> <p>4. After the placement of the child with another family, the Custodian Body undertakes immediately all necessary means to address and in future to avoid all circumstances which made placement with a foster family necessary.</p> <p style="text-align: center;">Article 1332 Responsibilities for care</p> <p>1. Placement of a child in a family, which can successfully fulfil parental obligations, in particular with regard to care, education, teaching and provision of a child with skills for an independent life.</p> <p>2. Placement of a child in a family shall be made only with a family in which parent or parents to whom child is entrusted to, fulfil all the conditions provided for by law on behalf of children and parental responsibility.</p> <p style="text-align: center;">Article 1333</p>	<p>smeštaj traje sve dok traju okolnosti koje su bile uzrok za dati smeštaj.</p> <p>4. Nakon smeštaja deteta u drugu porodicu, Organ starateljstva bez odlaganja preuzima sve potrebne mere u cilju rešavanja i ukloniti ubuduće sve okolnosti koje su učinile neophodnim stavljanje dece u hraniteljskoj porodici.</p> <p style="text-align: center;">Član 1332 Odgovornosti za staranje</p> <p>1. Smeštaj deteta u porodici biva obezbeđen u porodici koja uspešno može da ispuni roditeljske dužnosti, naročito u pogledu pravilnog zbrinjavanja, vaspitanja, obrazovanja i osposobljavanja deteta za samostalni život.</p> <p>2. Smeštaj deteta u porodici može da bude određen samo u porodici u kojoj roditelji ili roditelj kome se dete poverava, ispunjava sve uslove za dete predviđene ovom knjigom i vrši roditeljsku dužnost.</p> <p style="text-align: center;">Član 1333</p>
---	---	--

<p>Vendosja e fëmijëve me nevoja te veçanta, të lënë pas dore dhe atyre me aftësi të kufizuar</p> <p>Zgjedhja e familjes në të cilën vendoset fëmija me nevoja të veçanta, të lënë pasdore, apo fëmija me aftësi të kufizuar, bëhet me propozim të grupit profesional të caktuar nga Organi i Kujdestarisë, i cili duhet të përbëhet nga punëtorët social, pedagogët, psikologët dhe mjekët si dhe nga ekspertët tjerë, të zgjedhur varësisht nga shkaqet që kërkojnë vendosjen e fëmijës në familje.</p> <p>Neni 1334 Kompetenca ligjore dhe dokumentimi</p> <p>1. Organi i Kujdestarisë i komunës në territorin e së cilës fëmija ka vendbanimin apo vendqëndrimin, merr vendim për vendosjen e fëmijës në familje.</p> <p>2. Para marrjes së vendimit për vendosjen në familje, organi i kujdestarisë nga paragrafi 1 i këtij neni siguron dokumentacionin e plotë mbi të gjitha të dhënat me rëndësi për marrjen e vendimit për vendosjen e fëmijës në familje, si dhe për familjen në të cilën vendoset fëmija.</p>	<p>Placement of children with special needs, neglected children and children with disabilities</p> <p>A family where a child with special needs, neglected child or a child with disabilities is placed, is chosen upon the proposal of a group of professionals, assigned by Custodian Body, which shall be comprised of social workers, teachers, psychologists and doctors as well as other experts, chosen with regard to the reasons that deem placement of a child in the family.</p> <p>Article 1334 Legal competence; Documentation</p> <p>1. Custodian Body of municipality, in which territory child resides or is domiciled decides on placement of a child in a family.</p> <p>2. Before making a decision upon a placement, Custodian Body mentioned in paragraph 1 of this article provides full documentation on all data which is important for making a decision on the child's placement in a family, as well as on the family where the child will be placed.</p>	<p>Smeštaj dece sa posebnim potrebama, zapuštene dece i dece sa ograničenim sposobnostima</p> <p>Izbor porodice u koju treba da bude smešteno dete sa posebnim potrebama, zapuštено dete, odnosno dete sa ograničenim sposobnostima, biće učinjen na predlog stručne grupe, određene od strane organ starateljstva, koji treba da se sastoji od socijalnih radnika, pedagoga, psihologa, lekara kao i od drugih stručnjaka, koji su izabrani u zavisnosti od prirode uzroka koji su zahtevali smeštaj deteta u neku drugu porodicu.</p> <p>Član 1334 Zakonska nadležnost i dokumentacija</p> <p>1. Organ starateljstva opštine na čijoj teritoriji dete ima prebivalište ili boravište, donosi odluku o stavljanju deteta u porodicu.</p> <p>2. Pre donošenja odluke o stavljanju deteta u porodicu, organ starateljstva iz stava 1. ovog člana, pribavlja potpunu dokumentaciju o svim podacima koji su od značaja za odlučivanje o stavljanju deteta u porodicu, kao i o porodicu u kojoj će dete biti smešteno.</p>
---	---	---

<p>3. Përjashtimisht në rast se prindërit refuzojnë të japin pëlqimin për këtë vendos gjykata.</p> <p>4. Përjashtimisht në rast se prindërit refuzojnë të japin pëlqimin për vendosje, vendos organi i kujdestarisë por që duhet ta njoftoj gjykatën menjëherë, e më së voni brenda (72) orëve. Gjykata vendos mbi arsyeshmërinë e vendosjes me procedurë të shpejtuar.</p>	<p>3. Exceptionally if parents refuse to give their consent, regarding this shall decide the court.</p> <p>4. Exceptionally, if parents refuse to give their consent for placement, the custodian body shall decide, but has to notify the court immediately, at the latest within (72) hours. The court decides on the reasonableness of the decision with a speeded procedure.</p>	<p>3. Izuzetno, ako roditelji odbijaju da daju saglasnost, o tome odlučuje sud.</p> <p>4. Izuzetno, ako roditelji odbijaju da daju svoju saglasnost za stavljanje, odlučuje organ starateljstva, ali mora o tome odmah obavestiti sud, najkasnije u roku od sedamdeset i dva (72.) sata. Sud odlučuje o razumnosti odluke po hitnom postupku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1335 Kontrata me shkrim, e drejta në vizitë dhe shpërblimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 1335 Written Contract; Right of Visitation; Payment</p>	<p style="text-align: center;">Član 1335 Pisani ugovor, pravo posete i isplata naknade</p>
<p>1. Në bazë të vendimit për vendosjen e fëmijës në familje, Organi i Kujdestarisë lidhë kontratën me shkrim me njërin prej prindërve të familjes në të cilën do të vendoset fëmija.</p> <p>2. Familja në të cilën është vendosur fëmija ka për detyrë që t'i bëjë të mundur vizitat e prindërve të fëmijës, përveç kur Organi i Kujdestarisë cakton ndryshe për interes dhe mirëqenie të fëmijës.</p> <p>3. Familja në të cilën fëmija është vendosur ka të drejtë në shpërblim.</p>	<p>1. On the basis of the decision for placement of a child in the family, Custodian Body concludes written contract with one of the parents of the family in which child shall be placed.</p> <p>2. The family where the child is placed is obliged to facilitate visits of the child's parents, unless Custodian Body decides otherwise in interest of child's welfare.</p> <p>3. Family where a child is placed has a right to payment.</p>	<p>1. Na osnovu odluke o određivanju stavljanja deteta kod porodice, Organ starateljstva zaključuje pisani ugovor sa jednim od roditelja iz porodice u kojoj će dete biti smešteno.</p> <p>2. Porodica u kojoj je dete smešteno, dužna je da omogući posete roditelja deteta, osim kad nadležni Organ starateljstva drugačije odredi u interesu i dobrobiti deteta.</p> <p>3. Porodica u kojoj je dete smešteno ima pravo na isplatu naknade za smeštaj.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1336 Përfundimi i vendosjes</p>	<p style="text-align: center;">Article 1336 Termination of placement</p>	<p style="text-align: center;">Član 1336 Prestanak stavljanja</p>
<p>1. Vendosja në familje pushon:</p> <p>1.1. Me marrëveshjen e palëve kontraktuese;</p> <p>1.2. Me heqjen dore nga kontrata;</p> <p>1.3. Me arritjen e moshës madhore të fëmijës, përkatësisht me aftësimin e tij për jetë të pavarur ose kur fëmija martohet para kësaj moshe;</p> <p>1.4. Me adoptimin e fëmijës;</p> <p>1.5. Me vdekjen e fëmijës ose me vdekjen e anëtarit të familjes i cili ka lidhur kontratën për vendosjen në familje.</p> <p>2. Në rast të vdekjes së njërit nga prindërit e familjes nga paragrafi 1 i këtij neni, kontrata për vendosjen në familje mbetet në fuqi nëse prindi tjetër, brenda afatit prej një muaji e njofton Organin kompetent të Kujdestarisë për vazhdimin e vendosjes së fëmijës në familje dhe nëse disponon me garancionin se familja në të ardhmen do t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me këtë libër.</p>	<p>1. Placement within a family terminates:</p> <p>1.1. By agreement of the contracting parties;</p> <p>1.2. By withdrawal from the contract;</p> <p>1.3. By the time a child reaches majority age, respectively thereafter when the child is able to conduct an independent life or if child marries before that age;</p> <p>1.4. By the adoption of a child; or</p> <p>1.5. Upon death of the child or death of a family member, who has concluded contract for the placement in the family.</p> <p>2. In case of death of one of the parents of family from paragraph 1 of this Article, contract for placement with a family remains in force, if other parent, within one month, informs competent Custodian Body of the continuation of child's placement in the family and provided that he has guarantee that the family in future fulfils the conditions determined by this Book.</p>	<p>1. Stavljanje u porodici prestaje:</p> <p>1.1. sporazumom ugovornih stranaka,</p> <p>1.2. odricanjem od ugovora,</p> <p>1.3. Navršenjem punoletnosti deteta, odnosno osposobljavanjem istog za samostalni život ili kad dete stupi u brak pre punoletstva;</p> <p>1.4. usvojenjem deteta,</p> <p>1.5. smrću deteta ili smrću onog člana porodice koji je bio stranka ugovora o smeštaju deteta u tu porodicu.</p> <p>2. U slučaju smrti jednog od roditelja u porodici iz stava 1. ovog člana, ugovor o porodičnom smeštaju deteta u datu porodicu ostaje na snazi ako drugi roditelj, u roku od mesec dana, obavesti nadležni organ starateljstva da će nastaviti da drži dete u porodičnom smeštaju i pod uslovom da bude utvrđeno da porodica i dalje ispunjava uslove propisane ovom knjigom.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1337 Ndërprerja e kontratës</p> <p>1. Familja në të cilën është vendosur fëmija mund të heqë dorë nga kontrata brenda afatit të parashikuar në kontratë, me paralajmërim paraprak.</p> <p>2. Organi i Kujdestarisë mund ta ndërpres kontratën për vendosje në familje vetëm në rastin kur rrethanat e ndryshuara në familjen e fëmijës tregojnë se nuk ka nevojë të mëtutjeshme për të vazhduar vendosjen, ose fëmija vendoset në një formë tjetër alternative të mbrojtjes më të përshtatshme për nevoja të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1337 Termination of contract</p> <p>1. Family where the child has been placed may withdraw from the contract within the terms provided for in the contract, with the preliminary notice.</p> <p>2. Custodian Body may terminate contract for placement in a family only if changed circumstances in the child's family indicate, that there is no further need to continue placement, or the child is placed in another alternative form of protection that is more appropriate for his needs</p>	<p style="text-align: center;">Član 1337 Raskid ugovora</p> <p>1. Porodica u kojoj je smešteno dete, može se odreći ugovora u vremenskom roku predviđenom u ugovoru uz prethodno obaveštenje.</p> <p>2. Organ starateljstva može da raskine ugovor o porodičnom smeštaju samo u slučaju ako usled izmenjenih okolnosti u porodici deteta prestane potreba za njegovim daljim smeštajem, ili se dete smesti u neku drugi alternativni oblik zaštite koji je pristupačniji za njegove potrebe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1338 Heqja dorë nga kontrata</p> <p>1. Nëse familja në të cilën është vendosur fëmija pushon të plotësojë ndonjërin prej kushteve nga neni 1332 i këtij Libri, përkatësisht nëse nuk është realizuar qëllimi i vendosjes, Organi i Kujdestarisë mund të vendosë për heqjen dorë nga kontrata për vendosjen në familje.</p> <p>2. Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet dita e pushimit të vendosjes së fëmijës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1338 Rescission from the contract</p> <p>1. If family where a child has been placed ceases to fulfil any of the conditions of Article 1332 of this Book, respectively if the purpose of the placement has not been achieved, Custodian Body may decide to revoke contract for placement in a family.</p> <p>2. Decision of paragraph 1 of this Article determines the day of rescission of a child's placement.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1338 Odricanje od ugovora</p> <p>1. Ako porodica u kojoj je dete smešteno prestane da ispunjava bilo koji od uslova iz člana 1332. ove Knjige, odnosno ako svrha smeštaja ne bude ostvarena, Organ starateljstva donosi odluku o odricanju od ugovora o porodičnom smeštaju deteta u datoj porodici.</p> <p>2. Odlukom iz stava 1. ovog člana, biće određen dan prestanka porodičnog smeštaja deteta.</p>

<p>3. Organi i Kujdestarisë i cili ka marrë vendimin për zgjidhjen e kontratës për vendosjen në familje e siguron ruajtjen, kujdesin dhe shkollimin e mëtejshëm të fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1339 Mbikëqyrja</p> <p>1. Organi i Kujdestarisë mbikëqyr zhvillimin e fëmijës, siguron se mbrojtja, kujdesi dhe edukimi i fëmijës bëhet në përputhje me dispozitat e këtij libri si dhe me dispozitat e kontratës për vendosjen e fëmijës.</p> <p>2. Organi kompetent i Kujdestarisë i kushton vëmendje të posaçme zhvillimit të fëmijës lidhur me qëllimet të cilat kanë shkaktuar vendosjen e fëmijës në familje.</p> <p>3. Organi i Kujdestarisë ka obligim që ti ofron familjes strehuese informata thelbësore dhe të domosdoshme për shkaqet që kanë shkaktuar vendosjen e fëmijës në strehim familjar. Organi i Kujdestarisë duhet të planifikon dhe të jap propozime për mënjanimin e shkaqeve në të ardhmen, të marrë masa adekuate dhe me kohë të cilat janë të parashikuar në këtë libër.</p>	<p>3. Custodian Body, which has decided on the rescission of the contract for placement, shall ensure further protection, care and education of the child.</p> <p style="text-align: center;">Article 1339 Supervision</p> <p>1. Custodian Body supervises child's development, ensures that protection, care and education of a child is conducted in conformity with the provisions of this Book and with the provisions of the contract for placement of the child.</p> <p>2. Competent Custodian Body pays special attention to the development of a child regarding the purposes, which led to the placement of a child.</p> <p>3. Custodian Body is obliged to provide a foster family where the child is placed with the substantial and necessary information's about the that caused child`s placement in foster care. Custodian body shall plan and make proposals on their future avoidance and timely undertake all necessary regular social measures, foreseen under this Book.</p>	<p>3. Organ starateljstva koji je doneo rešenje o rešenju ugovora o porodičnom smeštaju, obezbeđuje dalje čuvanje, zbrinjavanje i vaspitavanje deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 1339 Nadzor</p> <p>1. Organ starateljstva vrši nadzor detetovog razvoja i obezbeđuje da se čuvanje deteta i obrazovanje vrši u skladu sa odredbama ove knjige i u skladu sa odredbama ugovora o smeštaju deteta.</p> <p>2. Nadležni organ starateljstva posebno prati razvoj deteta u pogledu razloga koji su doveli do stavljanja deteta u drugoj porodici.</p> <p>3. Organ starateljstva je dužan je da hraniteljskoj porodici dostavi značajne i obavezne informacije u vezi sa uzrocima koji su doveli so smeštanja deteta u hraniteljstvo. Organ starateljstva treba da planira i da daje predloge za izbegavanje uzroka u budućnosti, da preduzme adekvatne i blagovremene mere koje su propisane u ovoj knjizi.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1340 Detyrimet e familjes përkujdesëse për të informuar</p> <p>Familja përkujdesëse ka për detyrë ta njoftojë organin kompetent të mbikëqyrjes për çështjet që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore, edukimin si dhe të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e fëmijës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1340 Obligations of the foster family to inform</p> <p>Foster family is obliged to inform Custodian Body about issues related of health, education and all other relevant conditions of child's development.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1340 Obaveza hraniteljske porodice da obaveštava</p> <p>Hraniteljska porodica ima obavezu da nadležnom nadzornom organu daje obaveštenja koja su vezana o zdravstvenom stanju, vaspitavanju i školovanju deteta, kao i o svim okolnostima koje su od značaja za razvoj deteta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1341 Informatat reciproke të organeve kompetente</p> <p>1. Nëse vendosjen në familje e ka caktuar një organ, kurse mbikëqyrjen e ushtron organi tjetër, organi i cili e ushtron mbikëqyrjen ka për detyrë që për zhvillimin e fëmijës ta informojë organin që ka caktuar vendosjen në familje.</p> <p>2. Nëse organi mbikëqyrës nga paragrafi 1 i këtij neni nxjerr përfundim se është paraqitur ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenet 1336-1338 për zgjidhjen e kontratës, lidhur me këtë gjë pa vonesë e njofton organin që ka caktuar vendosjen në familje.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1341 Reciprocal information of responsible bodies</p> <p>1. If placement in a family has been decided by one body, whereas supervision is exercised by another body, supervisory body is obliged to inform body of placement of the child's development.</p> <p>2. If supervisory body from paragraph 1 of this Article concludes that one of the conditions mentioned in Articles 1336-1338 or dissolution of the contract have occurred, body that is responsible for placement shall without any delay be informed about this fact.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1341 Uzajamno obaveštavanje nadležnih organa</p> <p>1. Ako je odluku o porodičnom smeštaju doneo jedan organ, dok nadzor vrši drugi organ, organ koji vrši nadzor dužan je da o razvoju deteta obaveštava organ koji je doneo odluku o porodičnom smeštaju.</p> <p>2. Ako nadzorni organ iz stava 1. ovog člana, utvrdi da se pojavio bilo koji od uslova za rešenje ugovora iz članova 1336.-1338., obavestiće bez odlaganja o tome organ koji je doneo odluku o porodičnom smeštaju.</p>

<p>PJESA E GJASHTË</p> <p>KAPITULLI I – KUJDESTARIA</p> <p>Nënkapitulli I – Vendosja dhe Qëllimi i Kujdestarisë</p> <p>Neni 1342 Parimet e kujdestarisë për të miturit dhe të rriturit</p> <p>1. Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike:</p> <p>1.1. kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar kujdesjen prindërore;</p> <p>1.2. për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur të zhdukur, u është hequr kujdesi prindëror ose kanë humbur aftësinë për të vepruar;</p>	<p>PART SIX</p> <p>CHAPTER I – CUSTODIANSHIP</p> <p>Sub-chapter I – Placement and Purpose of Custodianship</p> <p>Article 1342 Principles of custodianship for minors and adults</p> <p>1. Minor children are placed under custodianship and enjoy special protection by public institutions:</p> <p>1.1. when their parents are not able to exercise parental care;</p> <p>1.2. because both parents are deceased or not known, have been announced to be missing, or have been deprived of parental care or have lost capacity to act; or</p>	<p>DEO ŠESTI</p> <p>POGLAVLJE I STARATELJSTVO</p> <p>Potpoglavlje I – Stavljanje pod starateljstvom i svrha</p> <p>Član 1342 Načela starateljstva za maloletnike i odrasle</p> <p>1. Maloletna deca biće stavljena pod starateljstvo i uživae posebnu zaštitu javnih institucija:</p> <p>1.1. kad njihovi roditelji su u nemogućnosti da vrše roditeljsko staranje</p> <p>1.2. zbog toga što su oba roditelja umrla ili su nepoznati, kad su proglašeni umrlim ili kad su lišeni roditeljskog staranja ili su lišeni poslovne sposobnosti.</p>
--	--	---

<p>1.3. apo për çdo shkak tjetër i cili me vendim të gjykatës jep arsye për vendosje në të mirë të mirëqenies së fëmijës.</p> <p>2. Qëllimi i kujdestarisë ndaj personave të moshës madhore është mbrojtja e personalitetit të tyre dhe do të manifestohet në radhë të parë me kujdesin personal, aftësim për jetë të pavarur dhe me mjekim.</p> <p>3. Kujdestaria ka për qëllim gjithashtu sigurimin e të drejtave pasurore dhe të të drejtave të tjera dhe interesave të personave nën kujdesje.</p>	<p>1.3. for any other reason that by court decision provides reason for decision in interest fo a child`s wellbeing.</p> <p>2. Purpose of custodianship towards adults is to protect their personality and shall be manifested firstly through personal care, preparation for an independent life and medical care.</p> <p>3. Custodianship also aims to ensure property rights and other rights and interests and of person under custodianship.</p>	<p>1.3. ili iz bilo kog drugog razloga koji na osnovu sudske odluke pruža razlog za smeštaj deteta radi detetovog blagostanja.</p> <p>2. Svrha starateljstva nad punoletnim licima je zaštita njihove ličnosti, koja se prvenstveno ostvaruje njihovim zabrinjavanjem, osposobljavanjem za samostalan život i lečenjem.</p> <p>3. Starateljstvo ima za svrhu i obezbeđivanje imovinskih i drugih prava i interesa lica pod starateljstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Kujdestaria ndaj të Miturve</p> <p style="text-align: center;">Neni 1343</p> <p style="text-align: center;">Kompetencat dhe qëllimet e kujdestarisë për të miturit</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Custodianship of minors</p> <p style="text-align: center;">Article 1343</p> <p style="text-align: center;">Competences and aims of custodianship for minors</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II – Starateljstvo nad maloletnim licima</p> <p style="text-align: center;">Član 1343</p> <p style="text-align: center;">Nadležnost i svrhe starateljstva nad maloletnim licima</p>
<p>1. Organi i kujdestarisë e vë nën kujdestari personin e mitur i cili nuk është nën kujdesin prindëror.</p> <p>2. Kujdestari i personit të mitur ka për detyrë që të kujdeset me mirëbesim për personalitetin e të miturit, posaçërisht për shëndetin e të</p>	<p>1. Custodian Body places under custodianship a minor child who is without parental care.</p> <p>2. Custodian of a minor child is obliged to take care in good faith for the child`s personality, in particular for the child`s health, education,</p>	<p>1. Organ starateljstva stavlja pod starateljstvo maloletno lice koje nije pod roditeljskim staranjem.</p> <p>2. Staratelj maloletnog lica, obavezan je da savesno vodi računa o ličnosti maloletnika, naročito o zdravlju, obrazovanju i vaspitavanju</p>

<p>miturit, edukimin e arsimimin e tij dhe për zhvillimin e aftësisë për të bërë jetë të pavarur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1344 Aftësia për të vepruar dhe përdorimi i të ardhurave</p> <p>1. I mituri nën kujdestari që nuk ka mbushur (14) vjet, nuk mund të ushtrojë vetë punët juridike, me përjashtim të veprimeve më rëndësi të vogël. Për veprimet të cilat nuk mund t'i ushtroj vetë është e nevojshme leja e kujdestarit të tij për ti bërë këto veprime të vlefshme, kurse për veprimet të cilat kujdestari nuk mund t'i ndërmarr vet është e nevojshme leja e Organit të Kujdestarisë.</p> <p>2. I mituri nën kujdestari që e themelon marrëdhënien e punës, mund t'i disponojë vetë të ardhurat e tij personale dhe pasurinë që e ka fituar me punën e tij. Përveç kësaj ai ka për detyrë që të kontribuojë për ushqimin e tij, edukimin dhe arsimimin në nivel të arsyeshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1345 E drejta e ankesës</p>	<p>upbringing and development of the ability to undertake an independent life.</p> <p style="text-align: center;">Article 1344 Capacity to act and use of income</p> <p>1. Minor child that under custodianship, who has reached (14) years yet, cannot exercise legal transactions By itself, except for some matters of low importance. For the actions which cannot be exercised by himself/herself it is necessary to have permission of his custodian in order to make these actions valid, while for actions that cannot be carried by custodian it is necessary to have permission of Custodian Body.</p> <p>2. Minor child under custodianship, who enters into an employment relation, may dispose of his personal income and revenues earned through his work. Besides this, he is obliged to contribute for his own food, education and upbringing to a reasonable extent.</p> <p style="text-align: center;">Article 1345 Right for appeal</p>	<p>maloletnog lica i razvoju njegovih sposobnosti za dalji samostalni život.</p> <p style="text-align: center;">Član 1344 Poslovna sposobnost i korišćenje prihoda</p> <p>1. Maloletno lice koje se nalazi pod starateljstvom i još nije navršilo (14) godina života ne može sam da obavlja pravne poslove, izuzev radnje od malog značaja. Za svoje radnje koje ne može da obavlja sam, potrebna je dozvola njegovog staratelja da bi se obavili ti važni poslovi, dok o radnjama koje staratelj sam ne može da preduzme, potrebna je dozvola Organa starateljstva.</p> <p>2. Maloletno lice koje se nalazi pod starateljstvom i koje stupi u radni odnos može da raspolaže svojim ličnim prihodom i primanjima zarađenim svojim radom. Pored toga, maloletno lice ima obavezu da učestvuje u troškovima za svoju ishranu, obrazovanje i podizanje u razumnoj meri.</p> <p style="text-align: center;">Član 1345 Pravo na žalbu</p>
--	--	--

<p>I mituri që ka mbushur (14) vjet ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër vendimit të Kujdestarit, të Organit të Kujdestarisë dhe kundër organeve të tjera të cilat mohojnë lejen e nevojshme për plotfuqishmërinë e cilitdo veprim juridik nga ana e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1346 Kompetenca e kujdestarit</p> <p>1. Kujdestari mund të ndërmarrë veprimet e poshtëshënuara vetëm me lejen paraprake të Organit të Kujdestarisë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 t'ia besojë të miturin shtëpisë për përkujdesje ose ndonjë organizate tjetër për fëmijë dhe të mitur për ruajtje, edukim dhe arsimim, t'ia besojë të miturin ndonjë personi për edukim, mirërritje dhe kujdes ose që ta vendosë të miturin për një kohë të gjatë për mjekim në institucionin shëndetësor;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. të iniciojë ndërrimin e shkollës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. të vendosë për zgjedhjen e profesionit ose ushtrimin e profesionit të të miturit;</p>	<p>Minor child who has reached fourteen (14) years of age has right to submit appeal against the decision of Custodian, Custodian Body or against other bodies which deny approval required for validity of any of his legal transactions.</p> <p style="text-align: center;">Article 1346 Competence of custodian</p> <p>1. Custodian can undertake following actions only with prior approval of Custodian Body:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. to entrust child to home care or another organization of children and adults for protection, education and upbringing, to entrust minor child to another person for education, upbringing and care or to place a child under medical treatment for a long period at a health institution;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. to initiate change of school;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. to decide on the selection of a profession or exercise of the minor child's profession;</p>	<p>Maloletno lice koje je navršilo četrnaest (14.) godina života ima pravo da podnese žalbu protiv odluka svog Staratelja, Organa starateljstva ili bilo kog drugog organa koji mu uskrati odobrenje potrebno za punovažnost bilo koje od njegovih pravnih radnji.</p> <p style="text-align: center;">Član 1346 Nadležnosti staratelja</p> <p>1. Staratelj može da preduzima sledeće radnje samo uz prethodnu saglasnost Organa starateljstva:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 da maloletno lice poveri kući za staranje ili nekoj drugoj organizaciji koja radi sa decom i maloletnicima na njihovo čuvanje, obrazovanje i vaspitavanje, da poveri maloletno lice nekom drugom licu na obrazovanje, vaspitavanje i zbrinjavanje, ili da maloletno lice podvrgne medicinskom tretmanu na duži period u nekoj od zdravstvenih institucija;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. da inicira promenu škole;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. da odlučuje o izboru zanimanja ili o upražnjavanju zanimanja maloletnog lica;</p>
--	--	--

<p>1.4. të marrë edhe masat e tjera të rëndësishme, lidhur me personalitetin dhe interesat e të miturit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1347 Informacionet nga organi i kujdestarisë</p> <p>1. Ofruesi i shërbimeve së cilës i është besuar i mituri ose institucioni në të cilin është dërguar, si dhe personi të cilit i është besuar për ruajtje dhe edukim apo institucioni shëndetësor në të cilin është vendosur për mjekim, kanë për detyrë ta informojnë kujdestarin dhe Organin e Kujdestarisë për të gjitha çështjet e rëndësishme për jetën, shëndetin, edukimin dhe arsimimin të të kujdesurit, si dhe lëshimin e mundshëm nga institucionet dhe të vendqëndrimit të tij të ri.</p> <p>2. Personat dhe institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni kanë për detyrë që para lëshimit të të kujdesurit të mitur ta informojnë me kohë lidhur me këtë gjë Organin e Kujdestarisë, në mënyrë që të mund t'i ndërmarrë me kohë masat për mbajtjen dhe sigurimin e të miturit.</p>	<p>1.4. to undertake other important measures which could harm minor child's personality and interest.</p> <p style="text-align: center;">Article 1347 Information's from Custodian Body</p> <p>1. Service provider to whom the child is entrusted to or the institution where he has been sent as well as the person to whom is entrusted for protection and education or medical institution where he is placed for medical care, are obliged to inform custodian and Custodian Body of all important issues regarding life, health, education and upbringing of a person under custodianship, as well as of a possible discharge from the institution and his new place of residence.</p> <p>2. Persons and institutions mentioned in paragraph 1 of this Article are obliged to timely inform the Custodian Body before discharging minor child under custodianship in order to ensure timely measures for taking care and security of minor child.</p>	<p>1.4. da preduzme druge važne mere u vezi sa ličnošću i interesima maloletnog lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 1347 Informacije od organa starateljstva</p> <p>1. Pružaocu usluga kome je bilo povereno maloletno lice, odnosno institucija u koju je bio poslat, kao i lice kome je maloletnik bio poveren na čuvanje i obrazovanje, ili zdravstvena institucija u koju je bio smešten radi pružanja medicinske nege, imaju obavezu da dostave informacije staratelju i Organu starateljstva o svim važnim problemima u vezi sa životom, zdravljem, obrazovanjem i vaspitavanjem lica stavljenog pod starateljstvo, kao i o mogućem otpuštanju tog lica iz datih organizacija i njegovom novom prebivalištu.</p> <p>2. Lica i institucije navedene u stavu 1. ovog člana imaju obavezu da blagovremeno obaveste Organ starateljstva pre trenutka otpuštanja maloletnika iz svog starateljstva, kako bi bile obezbeđene blagovremene mere za izdržavanje i bezbednost maloletnog lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1348 Përfundimi i kujdestarisë</p>	<p style="text-align: center;">Article 1348 Termination of custodianship</p>	<p style="text-align: center;">Član 1348 Prestanak starateljstva</p>

<p>1. Kujdestaria ndaj të miturit pushon:</p> <p>1.1. Me arritjen e moshës madhore të tyre;</p> <p>1.2. Me lidhjen e martesës para mbushjes së moshës madhore;</p> <p>1.3. Me adoptim;</p> <p>1.4. Me kthimin e kujdesit prindëror te prindërit e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1349 Pasuria e kujdestarit dhe raportet</p> <p>1. Në rast të pushimit të kujdestarisë, Organi i Kujdestarisë kërkon nga kujdestari që brenda afatit të caktuar të përgatisë raportin për punën e vet dhe të shpërndaj pasurinë e të kujdesurit dhe t’ia dorëzojë personit në kujdestari për administrim, respektivisht te prindit ose adoptuesi.</p> <p>2. Dorëzimi i pasurisë bëhet në praninë e kujdestarit, personit nën kujdestari, përkatësisht të prindit ose adoptuesit dhe të përfaqësuesit të Organit të Kujdestarisë.</p>	<p>1. Custodianship towards minor child terminates:</p> <p>1.1. Upon reaching majority age;</p> <p>1.2. Upon marriage before reaching majority age;</p> <p>1.3. Upon adoption; or</p> <p>1.4. Upon return of parental rights to his own parents.</p> <p style="text-align: center;">Article 1349 Property of custodian and reports</p> <p>1. In case of termination of custodianship, Custodian Body requests from custodian to prepare a work report within a given term, to hand over the assets of child under custody and to deliver child to the administration respectively to the parents or the adopting party.</p> <p>2. Delivery of properties is performed in the presence of the custodian, child under custody, respectively parent or adopting party and representative of Custodian Body.</p>	<p>1. Starateljstvo nad maloletnim licem prestaje:</p> <p>1.1. Kad maloletnik postane punoletan;</p> <p>1.2. Kad maloletnik stupi u brak pre svog punoletstva;</p> <p>1.3. Usvojenjem maloletnika;</p> <p>1.4. Kad roditelji maloletnog lica ponovo steknu pravo roditeljskog staranja.</p> <p style="text-align: center;">Član 1349 Imovina staratelja i podnošenje izveštaja</p> <p>1. U slučaju prestanka starateljstva, Organ starateljstva traži od staratelja da pripremi izveštaj o svom radu u određenom roku i da izvrši dostavljanje imovine štićenika i istu dostavi licu staratelju na upravljanju, odnosno roditeljima ili usvojiocima.</p> <p>2. Predaja imovine vrši se u prisustvu staratelja, štićenikom, odnosno roditelja ili usvojioca kao i predstavnika Organa starateljstva.</p>
--	--	---

<p align="center">Nënkapitulli III – Kujdestaria ndaj Personave të Cilëve u është Hequr Aftësia për të Vepruar ose të cilët Nuk e Kanë Aftësinë e Plotë për të Vepruar</p> <p align="center">Neni 1350 Heqja e plotë apo e pjesshme e aftësisë së veprimit</p> <p>1. Personit të moshës madhore që nuk është i aftë për të gjykuar normalisht dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të kujdeset vetë për të drejtat dhe interesat e tij, duhet t'i hiqet aftësia për të vepruar.</p> <p>2. Personit të moshës madhore që me veprimet e veta ashpërsisht i rrezikon të drejtat dhe interesat e tij ose të drejtat dhe interesat e personave të tjerë për shkak të sëmundjes së diagnostifikuar me paaftësisë për të gjykuar, të ngecjes në zhvillimin psikik apo keqpërdorimit të alkoolit ose të mjeteve narkotike, të paaftësisë nga pleqëria duhet pjesërisht ti hiqet aftësia për të vepruar.</p> <p>3. Vendimin mbi heqjen e aftësisë për të vepruar ose për të kufizuar aftësinë juridike e merr gjykata kompetente në procedurën jashtëkontestimore.</p>	<p align="center">Sub-chapter III – Custodianship of Persons with Deprived Capacity to Act or who do not have the Full Capacity to Act</p> <p align="center">Article 1350 Full or partial deprivation of capacity to act</p> <p>1. An adult person who is not capable of normal judgment and due to this reason is unable to take care of his rights and interests shall be deprived of his capacity to act.</p> <p>2. An adult person who by his actions gravely endangers his rights and interests or the rights or interests of other persons because of diagnosed illness with incapacity to judge, mental retardation or severe abuse of alcohol or narcotics or due to infirmity of old age, shall be partially deprived of his capacity to act.</p> <p>3. Decision to deprive someone from his capacity to act or to limit his capacity to act is made by competent court in a non-contest dispute.</p>	<p align="center">Potpoglavlje III – Starateljstvo nad licima lišenim poslovne sposobnosti ili koji imaju delimičnu poslovnu sposobnost</p> <p align="center">Član 1350 Potpuno ili delimično lišenje poslovne sposobnosti</p> <p>1. Punoletno lice koje nije sposobno za normalno rasuđivanje (kod koga je dijagnostikivana psihička bolest, psihička zaostalost ili sličan uzrok) te zbog toga nije u stanju samo da se brine o svojim pravima i interesima, biva potpuno lišeno poslovne sposobnosti.</p> <p>2. Punoletnom licu koje svojim postupcima ozbiljno ugrožava svoja prava i interese ili prava i interese drugih lica zbog dijagnostikovane nesposobnosti rasuđivanja, zaostajanja u umnom razvoju, ili ozbiljne zloupotrebe alkohola ili opojnih sredstava, ili zbog utvrđene staračke iznemoglosti, biće delimično lišeno poslovne sposobnosti.</p> <p>3. Odluka o lišenju nekog lica poslovne sposobnosti ili ograničenju poslovne sposobnosti donosi nadležni sud u vanparničnom postupku.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 1351 Procedurat</p> <p>1. Personat të cilëve me vendimin e gjykatës pjesërisht ose plotësisht u është hequr aftësia e tyre për të vepruar, vëhen nën kujdestari të Organit të Kujdestarisë.</p> <p>2. Gjykata brenda afatit dhjetë ditor duhet të përcjellë vendimin tek Organi kompetent i kujdestarisë i cili brenda (30) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit duhet të sigurojë kujdestarinë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1351 Procedures</p> <p>1. Persons who by court order are partially or fully deprived of their capacity to act are placed under custodianship, exercised by Custodian Body.</p> <p>2. Court has to forward decision within a ten-day period to the competent Custodian Body which, within (30) days from the day of the decision, has to provide custodianship.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1351 Postupci</p> <p>1. Lica koja odlukom suda su delimično ili potpuno lišena svoje poslovne sposobnosti, staviće se pod starateljstvo Organ starateljstva.</p> <p>2. Sud je dužan da dostavi odluku u roku od deset dana nadležnom Organu starateljstva koji će, u roku od trideset (30.) dana od dana prijema iste, staviti lice lišeno poslovne sposobnosti pod starateljstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1352 Detyrimet e Kujdestarit</p> <p>1. Kujdestari i personit të cilit i është hequr aftësia për të vepruar ka për detyrë të kujdeset për personalitetin e tij, dhe në veçanti për kushtet e vendosjes së tij.</p> <p>2. Kujdestari posaçërisht do të kujdeset për gjendjen e veçantë të personit nën kujdesjen e tij me shqyrtim të veçantë të shkaqeve për të cilat personit i janë hequr ose kufizuar të drejtat. Kujdestari do t'i mundësojë personit nën kujdesin e tij të jetojë jetë të pavarur dhe me dinjitet për aq sa është e mundur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1352 Obligations of Custodian</p> <p>1. Custodian of the person who was deprived of his capacity to act is obliged to take care of the person's the personality and in particular the conditions of his placement.</p> <p>2. Custodian shall in particular take care of the special situation of a person in his custodianship with close examination of the causes that brought to the deprivation or limitation of person's rights. Custodian shall enable person under his custodianship to live independent life in dignity for as far as possible.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1352 Obaveze staratelja</p> <p>1. Staratelj lica koje je lišeno poslovne sposobnosti dužan je naročito da se stara o ličnosti tog lica, vodeći posebno računa o uslovima njegovog smeštaja.</p> <p>2. Staratelj je naročito dužan da vodi računa o posebnoj situaciji u kojoj se nalazi lice pod njegovim starateljstvom, uz pažljivo proučavanje uzroka koji su doveli do lišavanja ili ograničenja poslovne sposobnosti i prava lica pod starateljstvom. Staratelj je dužan da omogući licu pod svojim starateljstvom da živi što je više moguće samostalniji život u dostojanstvu.</p>

<p>3. Nëse kujdestari konkludon se rrethanat tregojnë nevojën për të rikthyer aftësinë për të vepruar përkatësisht në rast të nevojës, ndryshimin e vendimit të mëparshëm, ai ka për detyrë të informojë Organin e Kujdestarisë pa vonesë.</p>	<p>3. If custodian concludes that circumstances indicate the need to regain capacity to act, respectively in case of a need of a revocation of previous decision, he is obliged to inform Custodian Body without any delay.</p>	<p>3. Ako staratelj zaključí da okolnosti pokazuju potrebu povratka poslovne sposobnosti, u slučaju potrebe, izmenu ranije donete odluke, dužan je da bez odlaganja o tome obavesti organ starateljstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1353 Analogji me rregullat për kujdesin për të miturit</p>	<p style="text-align: center;">Article 1353 Analogy to Regulations for custodianship of minors</p>	<p style="text-align: center;">Član 1353 Analogija sa propisima o starateljstvu nad maloletnim licima</p>
<p>1. Kujdestari i personit që i është hequr plotësisht aftësia për të vepruar ka detyrat dhe të drejtat e kujdestarit të personit të mitur që nuk ka mbushur (14) vjet.</p>	<p>1. Custodian of a person who is fully deprived of his capacity to act has the rights and obligations of custodian of a minor person that has not reached (14) years of age.</p>	<p>1. Staratelj lica koje je potpuno lišeno poslovne sposobnosti ima dužnosti i prava staratelja maloletnog lica koje još nije navršilo četrnaest (14.) godina.</p>
<p>2. Kujdestari i personit të cilit pjesërisht i është hequr aftësia për të vepruar (kufizime të aftësisë juridike) ka detyrat e kujdestarit personit të mitur që ka mbushur 14 vjet. Nën rrethana të caktuara Organi i Kujdestarisë do të lejojë të gjitha punët juridike të cilat mund të ndërmerren nga personi me aftësi të plotë për të vepruar.</p>	<p>2. Custodian of a person who is partially deprived of his capacity to act (limitations of legal capacity) has obligations of a custodian of minor person who has reached age of 14. Under certain circumstances Custodian Body shall allow all legal transactions, which can be undertaken of a person with full capacity to act</p>	<p>2. Staratelj lica koje je delimično lišeno poslovne sposobnosti (ograničene su pravne sposobnosti) ima dužnosti i prava staratelja maloletnog lica koje je navršilo četrnaest (14.) godina. Pod izvesnim uslovima, Organ starateljstva može da dopusti vršenje svih pravnih radnji, koje može da preduzima lice sa punom poslovnom sposobnošću.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1354 Masat e përkohshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 1354 Temporary measures</p>	<p style="text-align: center;">Član 1354 Privremene mere</p>
<p>1. Gjykata pranë së cilës ka filluar procedura për heqjen e aftësisë për të vepruar ka për detyrë që lidhur me këtë gjë ta informojë</p>	<p>1. The court where the procedure for deprivation of the capacity to act has begun is obliged to immediately inform Custodian</p>	<p>1. Sud pored kojeg je pokrenut postupak za lišenje poslovne sposobnosti, dužan je da o tome odmah obavesti nadležni Organ</p>

<p>menjëherë Organin e Kujdestarisë, i cili, kur është e nevojshme, atij personi do t'ia caktojë kujdestarin e përkohshëm.</p> <p>2. Ndaj të drejtave dhe detyrave të kujdestarit të përkohshëm nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen dispozitat për kujdestarinë ndaj të miturve që kanë mbushur (14) vjet, por organi i kujdestarisë, kur është e nevojshme një gjë e tillë, ndaj tij mund ta zgjerojë zbatimin e dispozitave për kujdestarinë ndaj të miturve që nuk kanë mbushur (14) vjet.</p> <p>3. Detyrat e kujdestarit të përkohshëm pushojnë kur caktohet kujdestari i përhershëm ose me vendimin e gjykatës me të cilin mohohet privimi i aftësisë për të vepruar.</p>	<p>Body which, if required, shall assign a temporary custodian to that person.</p> <p>2. Provisions on custodianship of minors who have reached (14) years of age apply to the rights and obligations of temporary custodian from Paragraph (1) of this Article, but Custodian Body, when something like that is deemed necessary, may apply to this person the provisions of custody over minors who have not yet reached 14 years of age.</p> <p>3. Obligations of a temporary custodian are terminated when either a permanent custodian is appointed or upon a court order denying custodianship in the specific case.</p>	<p>starateljstva, koji će, ako bude potrebno, tom licu da postavi privremenog staratelja.</p> <p>2. U vezi prava i dužnosti privremenog staratelja iz stava (1.) ovog člana, biće primenjene odredbe o starateljstvu nad maloletnim licima koja su navršila četrnaest (14.) godina, ali organ starateljstva može, ako je to potrebno, da proširi na njega primenu odredbi o starateljstvu nad maloletnicima koji još nisu navršili četrnaest (14.) godina.</p> <p>3. Dužnosti privremenog staratelja prestaju kada se postavi stalni staratelj ili ako bude doneta odluka suda da nema mesta lišenju poslovne sposobnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1355 Mbikëqyrja</p>	<p style="text-align: center;">Article 1355 Supervision</p>	<p style="text-align: center;">Član 1355 Nadzor</p>
<p>1. Organi i Kujdestarisë ka për detyrë të bëjë mbikëqyrje të përhershme të kushteve të jetës të personit të privuar nga aftësia për të vepruar, kushtet e tij mjekësore dhe në veçanti kushtet që shkaktojnë humbjen ose kufizimin e aftësisë së tij për të vepruar. Organi i Kujdestarisë merr raporte të rregullta nga kujdestari ose nga institucioni ku është vendosur personi, respektivisht institucioni shëndetësor ku personi nën kujdestari trajtohet ose është vendosur për trajtim.</p>	<p>1. Custodian Body is obliged to conduct permanent supervision of living conditions of a person deprived form his capacity to act, of his medical condition and, if given, of the conditions that caused a respective loss or limitation of his capacity to act. The Custodian Body shall receive regular reports from custodian or from the institution where the person has been placed, respectively health institution where a person under</p>	<p>1. Organ starateljstva dužan je da vrši stalan nadzor uslova pod kojima živi lice lišeno poslovne sposobnosti, njegove zdravstvene uslove, i posebno na uzroke zbog kojih je to lice bilo lišeno poslovne sposobnosti. Organ starateljstva redovno pribavlja izveštaje od staratelja ili institucije u kojoj je to lice smešteno, odnosno od zdravstvene institucije gde se to lice leči ili je u nju smešteno radi lečenja.</p>

<p>2. Në përputhje me detyrën e tij zyrtare, Organi i Kujdestarisë fillon të gjitha procedimet e nevojshme gjyqësore për t'ia rikthyer aftësinë për të vepruar personit nën kujdestari, nëse nxjerr përfundim se ndryshimi i kushteve e kërkon këtë.</p> <p>Nënkapitulli IV – Kujdestarët për Raste të Vecanta</p> <p>Neni 1356 Kujdestaria për shkak të pasurisë së paqartë</p> <p>1. Organi i Kujdestarisë ka të drejtë të emërojë kujdestar për raste të veçanta (kujdestari special) në emër të pasurisë së supozuar të personit në rastet kur pronari i pasurisë është i panjohur dhe kur personi i tillë nuk ka përfaqësues statutor dhe kur kujdestaria është e paevitueshme për të mbrojtur interesat ligjore të pronarit.</p> <p>2. Kujdestari mund të caktohet ndaj personit të cekur në paragrafin 1 të këtij neni nga gjykata nën kushtet e cekura me ligj. Gjykata dhe kujdestari kanë për detyrë të njoftojnë Organin kompetent të Kujdestarisë për këtë çështje pa vonesë.</p>	<p>custodianship is treated or placed for treatment.</p> <p>2. According to its official obligation, Custodian Body initiates all necessary court proceedings for restitution of capacity act to the person under custodianship, if it concludes that a change in conditions require so.</p> <p>Sub-chapter IV – Custodians in Special Cases</p> <p>Article 1356 Custodianship for unclear property</p> <p>1. Custodian Body is entitled to appoint a custodian for special cases (special custodian) on behalf of a person's assumed property in situations where the owner of the property is unknown and where such a person has no legal representative and custodianship is inevitable to protect legal interests of the owner.</p> <p>2. A custodian may be appointed to the persons mentioned in Paragraph 1 of this Article by the court under the conditions provided by Law. Court and custodian are obliged to inform competent Custodian Body on this issue without delay.</p>	<p>2. Na osnovu svoje službene dužnosti, organ starateljstva pokreće propisan postupak kod nadležnog suda, za vraćanje poslovne sposobnosti lica pod starateljstvom, ako utvrdi da postoje uslovi za to.</p> <p>Potpoglavlje IV – Staratelji u posebnim slučajevima</p> <p>Član 1356 Starateljstvo zbog nejasne imovine</p> <p>1. Organ starateljstva ima pravo da imenuje staratelja za posebne slučajeve (posebni staratelj) u ime pretpostavljenog sopstvenika nekog lica u situacijama u kojima sopstvenik neke imovine nije poznat i kad takvo lice nema svog zakonskog zastupnika a starateljstvo je neophodno radi zaštite pravnih interesa sopstvenika.</p> <p>2. Starateljstvo se može odrediti nad licima navedenim u stavu 1. ovog člana, od strane suda pod uslovima određenim zakonom. Sud i staratelj obavezni su da o tome bez odlaganja izveste nadležni Organ starateljstva.</p>
--	---	--

<p>3. Organi i Kujdestarisë mund t'i ushtrojë të drejtat e cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> <p>4. Kjo e drejtë pushon në çastin kur personi në emër të të cilit është themeluar kujdestaria e veçantë, kërkon dhe dëshmon të drejtat dhe identitetin e tij pranë Organit të Kujdestarisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1357 Kujdestaria e veçantë për vlerësimin e kontesteve</p> <p>1. Kujdestari për raste të veçanta do të emërohet për fëmijën në rastet kur edhe pse prindërit e ushtrojnë kujdesin prindëror, mes tyre dhe fëmijës ekziston kontest, pra për punë juridike të dukshme që kanë të bëjnë me pasurinë e fëmijës.</p> <p>2. Personit nën kujdestari mund t'i caktohet përkohësisht kujdestari special për kontestet e rënda mes tij dhe kujdestarit.</p> <p>3. Prindërit, palët adoptuese, kujdestarët, kushërinjtë dhe fqinjët janë të detyruar të njoftojnë Organin e Kujdestarisë kur të vihen në dijeni për çështjet ose rastet e cekura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.</p>	<p>3. Custodian Body may directly exercise rights mentioned in Paragraphs 1 and 2 of this Article.</p> <p>4. This Right ceases at the moment a person on whose behalf special custodianship was established claims and proofs his own rights and identity with the Custodian Body.</p> <p style="text-align: center;">Article 1357 Special custodianship for dispute assessment</p> <p>1. Special cases custodian shall be appointed for a child where even though the parents exercise parental care, there is a dispute between child and his parents, namely where significant legal transactions involving the child's property are concerned.</p> <p>2. Person under custodianship may be temporarily appointed a special custodian for a severe and legally grave dispute between him and custodian.</p> <p>3. Parents, adopting parties, custodians, relatives and neighbors are obliged to notify Custodian Body when they become aware of events or instances mentioned in paragraphs 1 and 2 of this Article.</p>	<p>3. Organ starateljstva može neposredno da vrši prava navedena u stavovima 1. i 2. ovog člana.</p> <p>4. Ovo pravo prestaje u trenutku kad lice, u čije ime je osnovano starateljstvo u posebnim slučajevima, podnese zahtev za stupanje u posed svojih prava i dokaže svoj identitet organu starateljstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1357 Posebno starateljstvo za procenu spora</p> <p>1. Posebni staratelj biće imenovan za dete u slučaju kad, čak i ako roditelji vrše roditeljsko pravo, postoji znatan spor između deteta i njegovih roditelja, to jest za vidljive pravne radnje koje se tiču imovine/svojstvom deteta.</p> <p>2. Licu pod starateljstvom, može se odrediti privremeni posebni staratelj za vođenje teškog i pravno veoma ozbiljnog spora između njega i staratelja.</p> <p>3. Roditelji, stranke usvojioci, staratelji, srodnici i susedi imaju obavezu da obaveste Organ starateljstva kad saznaju za slučajeve i događaje navedene u stavovima 1. i 2. ovog člana.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 1358 Dispozitat e përgjithshme</p> <p>1. Me rastin e emërimit të kujdestarit për rastet e veçanta, Organi i Kujdestarisë do të caktojë vëllimin, detyrimet dhe të drejtat e kujdestarit të veçantë, duke pasur parasysh rrethanat e secilit rast individual.</p> <p>2. Dispozitat mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e kujdestarit të cekura në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 1342 zbatohen me analogji edhe ndaj kujdestarit të veçantë.</p> <p>3. Kujdestari i veçantë ka për detyrë t'i paraqet raporte të rregullta për punën vet Organit të Kujdestarisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1358 General provisions</p> <p>1. On the occasion of appointing a custodian for special cases, Custodian Body shall define scope, obligations and rights of special custodian, taking into consideration circumstances of each individual case.</p> <p>2. Provisions on rights, obligations and responsibilities of custodian mentioned in paragraphs 2 and 3 of Article 1342 apply by analogy to the special custodian.</p> <p>3. The special custodian is obligated to present regular reports on his work to the Custodian Body.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1358 Opšte odredbe</p> <p>1. Prilikom imenovanja staratelja za posebne slućajeve, Organ starateljstva određiće obim, dućnosti i prava posebnog staratelja imajući u vidu okolnosti svakog pojedinaćnog slućaja.</p> <p>2. Odredbe o pravima, dućnostima i odgovornostima staratelja navedena u stavu 2. i 3., člana 1342. primenjuju se analogijom i na staratelja za poseban slućaj.</p> <p>3. Posebni staratelj ima obavezu da podnosi redovne izveštaje o radu organa starateljstva.</p>
<p style="text-align: center;">Nėnkapitulli V – Kompetenca Ligjore nė Punėt e Kujdestarisė</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter V – Legal Competence in Matters of Custodianship</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje V – Zakonska nadlećnost u pitanjima starateljstva</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1359 Kompetenca</p> <p>Punėt e kujdestarisė tė pėrcaktuara me kėtė Libėr i kryen dhe i realizon Organi i Kujdestarisė.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1359 Competence</p> <p>1. Custodianship matters provided for in this Law are conducted and fulfilled by Custodian Body.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1359 Nadlećnost</p> <p>Pitanja u vezi starateljstva propisana ovom Knjigom sprovodi i ispunjava Organ starateljstva.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1360 Praktikat më të mira</p> <p>1. Për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari, Organi i Kujdestarisë i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të realizuar qëllimin e kujdestarisë në mënyrën më të mirë.</p> <p>2. Organi i Kujdestarisë gjatë përgatitjes, realizimit dhe zbatimit të vendimeve dhe masave të veta, do t'i shfrytëzojë të gjitha format e përshtatshme të mbrojtjes speciale, metodat e punës sociale dhe punëve tjera profesionale që do të thotë shërbimet e organizatave sociale si dhe institucioneve shëndetësore dhe edukative.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1360 Best Practices</p> <p>1. To protect rights and interests of a person under custodianship, Custodian Body undertakes all necessary measures to achieve purpose of custodianship in the best way.</p> <p>2. Custodian Body during preparation, realization and enforcement of its decisions and measures, shall make use of all relevant forms of social protection, methods of social work and other professional work, namely of services of social organizations as well as of health and educational institutions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1360 Najbolja praksa</p> <p>1. U cilju zaštite prava i interesa lica koje je pod starateljstvom, Organ starateljstva preduzima sve neophodne mere za ostvarivanje svrhe starateljstva na najbolji način.</p> <p>2. Organ starateljstva tokom pripremanja, donošenja i sprovođenja svojih odluka i mera, koristi sve relevantne oblike posebne zaštite, metode socijalnog rada i drugog stručnog rada, odnosno, koristi usluge organizacija za socijalni rad kao i usluge zdravstvenih i obrazovnih institucija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1361 Përgjegjësia e organit të kujdestarisë</p> <p>1. Organi i Kujdestarisë siguron se të gjitha të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari janë të garantuara në përputhje me dispozitat e këtij libri.</p> <p>2. Organi i Kujdestarisë siguron gjithashtu format tjera të mbrojtjes të siguruara me ligj për të ndihmuar të miturit dhe personat e moshës madhore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1361 Responsibility of Custodian Body</p> <p>1. Custodian Body ensures, that all rights and interests of the person under custodianship are guaranteed according to the provisions of this Law.</p> <p>2. Custodian Body ensures also other forms of protection provided by Law to help minors and adult persons.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1361 Odgovornosti organa starateljstva</p> <p>1. Organ starateljstva obezbeđuje da sva prava i interesi lica pod starateljstvom budu garantovana u skladu sa odredbama ove knjige.</p> <p>2. Organ starateljstva takođe obezbeđuje i druge vidove zaštite koje propisuje zakon za pružanje pomoći maloletnim i punoletnim licima.</p>

<p>3. Organi i Kujdestarisë zbaton masat edukative dhe masat tjera të përcaktuara nga gjykata. Ky organ i ndërmerr dhe i mbikëqyr të gjitha aktivitetet nën kompetencën e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1362 Kujdestari</p> <p>Kujdestarit si një person i caktuar posaçërisht, i besohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e domosdoshme për të realizuar këtë qëllim.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli VI – Kujdestari dhe Kujdestaria</p> <p style="text-align: center;">Neni 1363 Kujdestari</p> <p>1. Personit nën kujdesje Organi i Kujdestarisë ia cakton kujdestarin.</p> <p>2. Si kujdestar mund të jetë çdo person i cili i ka cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të kujdestarit dhe i cili më parë jep pëlqimin që të bëhet kujdestar.</p> <p>3. Kujdestari në radhë të parë caktohet nga mesi i personave në familjen e personit nën kujdestari. Organi i Kujdestarisë do të vendosë nëse kjo gjë është në interes të të kujdesurit.</p>	<p>3. Custodian Body applies educational measures and other measures defined by the court. This body conducts and supervises all activities under its responsibility.</p> <p style="text-align: center;">Article 1362 Custodian</p> <p>Custodian as a specially appointed person, is entrusted with all necessary rights and obligations to achieve this aim.</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter VI – Custodian and Custodianship</p> <p style="text-align: center;">Article 1363 Custodianship</p> <p>1. Custodian Body appoints custodian to the person under custodianship.</p> <p>2. As a custodian can be appointed any person who has personal capacity and necessary ability to fulfil obligations of a custodian and who prior to that gives his consent to become a custodian.</p> <p>3. Custodian shall in the first place be appointed from among persons in the family of the person under custodianship. Custodian Body shall decide whether this is in the interest of the person under custodianship.</p>	<p>3. Organ starateljstva primenjuje vaspitne i druge mere koje su predviđene od suda. Organ starateljstva preuzima i vrši nadzor svih radnji koje su pod njenu nadležnost.</p> <p style="text-align: center;">Član 1362 Staratelj</p> <p>Staratelju, kao posebno imenovanom licu, poverena su sva prava i neophodne obaveze za ostvarivanje tog cilja.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje VI – Staratelj i Starateljstvo</p> <p style="text-align: center;">Član 1363 Staratelj</p> <p>1. Organ starateljstva postavlja staratelja licu pod starateljstvom.</p> <p>2. Za staratelja može da bude postavljeno lice koje ima lična svojstva i sposobnosti koji su potrebni za vršenje dužnosti staratelja i koje prethodno da pristanak da bude staratelj.</p> <p>3. Za staratelja treba prvenstveno da bude postavljeno lice iz porodice lica koje treba da bude stavljeno pod starateljstvo. Organ starateljstva odlučuje da li je takva odluka u interesu lica pod starateljstvom.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1364 Përfshirjet nga e drejta për kujdestari</p> <p>1. Nuk mund të jetë kujdestar:</p> <p>1.1. Personi i cili paraprakisht ka humbur të drejtën ligjore ose prindore të kujdestarisë me vendim të gjykatës;</p> <p>1.2. Personi i cili pjesërisht apo plotësisht ka humbur aftësinë për të vepruar;</p> <p>1.3. Interesat e të cilit janë në konflikt të dukshëm me interesat e personit që do të vendoset nën kujdestari;</p> <p>1.4. Personi, veçoritë personale ose interesat materiale të të cilit mund të jenë në konflikt me interesat e kujdestarit dhe kur dyshohet se marrëdhënia me personin nën kujdestari ose me prindërit natyral mund të shkaktojë konflikt.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1364 Exclusions from the right of custodianship</p> <p>1. Following persons cannot be custodian:</p> <p>1.1. Person that previously lost legal parental care of custodianship due to a court decision;</p> <p>1.2. Person that is fully or partially deprived of his capacity to act;</p> <p>1.3. Person whose personal interests are in obvious conflict with the interests of the person to be placed under custodianship;</p> <p>1.4. Person whose personal characteristics and pecuniary interests may be in conflict with the interests of a custodian and where it is suspected that the relationship with the person under custodianship or the parents of a child under custodianship may cause conflicts.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1364 Izuzeci od prava za starateljstvo</p> <p>1. Staratelj ne može da bude:</p> <p>1.1. Lice koje je lišeno prava na zakonsko ili roditeljsko staranje na osnovu sudskog rešenja;</p> <p>1.2. Lice koje je u potpunosti ili delimično lišeno poslovne sposobnosti;</p> <p>1.3. Lice čiji su interesi u očiglednom sukobu sa interesima lica koje treba da bude stavljen pod starateljstvo;</p> <p>1.4. Lice čije lične osobine ili materijalni interesi mogu da budu u sukobu sa interesima staratelja kao i lice za koje postoji sumnja da bi veza sa licem koje je pod starateljstvom ili sa pravim roditeljima tog lica mogla da dovede do sukoba.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1365 Detyrimi për të pranuar kujdestarinë dhe përfshirjet</p> <p>1. Personat në gjini të gjakut me personin që do të vendoset nën kujdestari në vijë të drejtë dhe pasardhësit në vijë të drejtë, vëllezërit dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 1365 Obligation to accept custodianship and exceptions</p> <p>1. Persons related by blood to the person to be placed under custodianship in direct linear ascendancy and direct linear decedency and</p>	<p style="text-align: center;">Član 1365 Obaveza za prihvatanje starateljstva i izuzeci</p> <p>1. Lica koja su u pravoj liniji krvnog srodstva sa licem koje treba da bude stavljen pod starateljstvo, ili potomci u pravnoj liniji, braća</p>

<p>motrat e babait apo nënës të personit nën kujdestari, janë të detyruar me ligj që të pranojnë detyrën e kujdestarit nëse ata pajtohen me nevojat për kujdestari në bazë të dispozitave të këtij Libri.</p> <p>2. Personat në gjini gjaku nuk janë të detyruar të pranojnë detyrën e kujdestarit nëse:</p> <p>2.1. nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;</p> <p>2.2 nëse për shkak të sëmundjes, të metave trupore ose për shkak të natyrës së profesionit ose të shërbimit ata nuk janë mjaft të aftë për të përmbushur këtë detyrë;</p> <p>2.3. nëse ata tashmë kanë detyrën e kujdestarit ose nëse ata tashmë kujdesen për dy ose më shumë fëmijë të huaj;</p> <p>2.4. nëna e cila konsiderohet për këtë detyrë ka fëmijën më të ri se shtatë vjeç dhe për këtë arsye refuzon detyrën;</p> <p>2.5. personi i cili tashmë kujdeset për tre ose më shumë fëmijë të tij të mitur.</p>	<p>brothers and sisters of the father or mother of the person under custodianship, are under the legal obligation to accept the task of a custodian if they comply with legal requirements for a custodianship under the provisions of this Law.</p> <p>2. Persons in blood relationship are not obliged to accept the task of a custodian if:</p> <p>2.1. they are under eighteen (18) years of age;</p> <p>2.2. due to illness, body disabilities or type of profession or service they are not adequately capable to fulfil this task;</p> <p>2.3 they already took on the task of a custodian or if they already take care of two or more other children;</p> <p>2.4 mother who is considered for this task has a child under the age of seven and therefore rejects the task.</p> <p>2.5 a person already takes care of three or more minor children of his own.</p>	<p>i sestre oca ili majke lica pod starateljstvom imaju zakonsku obavezu da prihvate obavezu staratelja ako ispunjavaju uslove da budu staratelji u skladu sa odredbama ove Knjige.</p> <p>2. Lica koja su u krvnom srodstvu nemaju obavezu da se prihvate dužnosti staratelja ukoliko su:</p> <p>2.1. nisu uzrasta od osamnaest (18.) godina;</p> <p>2.2. zbog bolesti, telesnih nedostataka ili zbog prirode svog zanimanja ili zbog svoje službe nisu na odgovarajući način u stanju da ispunjavaju ovu dužnost;</p> <p>2.3. već su preuzeli obavljanje dužnosti staratelja ili ako se inače staraju o dvoje ili više druge dece;</p> <p>2.4. majka koja se uzima u obzir kao mogući staratelj, ima dete mlađe od sedam (7.) godina te zbog toga odbije ovu dužnost;</p> <p>2.5. lice se već brine o troje ili više svoje maloletne dece.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1366 Shqyrtimi i kërkesës</p> <p>Me rastin e caktimit të kujdestarisë, Organi i Kujdestarisë do të merr parasysh kërkesën e personit nën kujdestari, nëse ai është në gjendje të shpreh interesin e tij. Dëshirat e të afërmeve do të merren gjithashtu parasysh nëse kjo është në interes të personit i cili do të vendoset nën kujdestari.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1366 Request review</p> <p>On the occasion of appointing a custodianship, Custodian Body shall take into account request of the person who is placed under custodianship if he is able to express his interest. Wishes of the relatives shall be also considered if this is in the interest of the person to be placed under custodianship.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1366 Razmatranje zahteva</p> <p>Prilikom postavljenja staratelja, Organ starateljstva dužan je da uzme u obzir zahtev lica koje se nalazi pod starateljstvom, ako je to lice u stanju da izrazi svoj interes. Želje bliže rodbine takođe treba da budu uzete u obzir, ako je to u interesu lica koje treba da bude stavljeno pod starateljstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1367 Kujdesi i ushtruar drejtpërdrejt nga organi i kujdestarisë</p> <p>1. Nëse kjo është në interes të personit i cili do të vëhet nën kujdestari, Organi i Kujdestarisë mund të vendosë që të mos caktojë kujdestar, por që detyrat e kujdestarit t'i përmbushë drejtpërdrejt. Me aktvendimin mbi ushtrimin e drejtpërdrejtë të punëve të kujdestarit përfaqësuesi i Organit të Kujdestarisë është i caktuar që të drejtojë detyrat në emër të kujdestarit.</p> <p>2. Detyrat e kujdestarit të cilat kërkojnë autorizimin nga Organi i Kujdestarisë apo pjesëmarrja e organit në cilëndo mënyrë tjetër, në mënyrë që të vërtetohet vendimi, mund të drejtohet nga përfaqësuesi i Organit të Kujdestarisë vetëm nëse ky person e ka autorizimin administrativ të Organit të</p>	<p style="text-align: center;">Article 1367 Custodianship directly exercised by Custodian Body</p> <p>1. If this in the interest of the person to be placed under custody, the Custodian Body may decide not to appoint a custodian, but to fulfil the obligations of the custodian directly. Upon a decision to directly exercise the matters of custody a representative of the Custodian Body is appointed to conduct the tasks of a custodian on its behalf.</p> <p>2. Custodian`s tasks, which require the permission of the Custodian Body or participation of the body in any other way, in order to validate a decision, can be conducted by a representative of the Custodian Body only, if this person is holder of the administrative authorization of the Custodian</p>	<p style="text-align: center;">Član 1367 Neposredno starateljstvo vršeno od organa starateljstva</p> <p>1. Ako je to u interesu lica koje treba da bude stavljeno pod starateljstvo, Organ starateljstva može da odluči da ne postavlja staratelja, već da neposredno sam vrši poslove staratelja. Posle donošenja odluke o neposrednom vršenju poslova starateljstva, biće postavljen jedan predstavnik Organa starateljstva za vršenje dužnosti staratelja u ime tog organa.</p> <p>2. Obaveze staratelja za koje se zahteva ovlašćenje od strane organa starateljstva ili učešće organa na bilo koji drugi način, kako bi se utvrdila odluka, mogu se vršiti od strane predstavnika organa starateljstva samo ukoliko to lice ima upravno ovlašćenje organa starateljstva. Isti će delovati u skladu sa bilo</p>

<p>Kujdestarisë. Ai do të veprojë në përputhje me çfarëdo urdhërese nga ana e Organit të Kujdestarisë dhe të veproj në përputhje me dispozitat e këtij Libri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1368 Kujdesi i më shumë se një personi</p> <p>Personi i njëjtë me anë të marrëveshjes mund të emërohet si kujdestar i më shumë se një personi, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e personave nën kujdestari.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1369 Delegimi i detyrimeve</p> <p>Nëse Organi i Kujdestarisë përgjithësisht e merr rolin e kujdestarit ose kryen detyrat speciale të kujdestarit drejtpërdrejt, është i autorizuar t'ia besojë detyrat e caktuara profesionistëve tjerë të cilët mund të veprojë në emër të tij dhe nën mbikëqyrje të tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1370 Besimi</p> <p>1. Organi i Kujdestarisë i cili vendos për emërimin e kujdestarit i definon detyrat e kujdestarit dhe fushën e veprimit.</p>	<p>Body. He shall abide by any directions of the Custodian Body and act in accordance with the provisions of this Book.</p> <p style="text-align: center;">Article 1368 Custodianship of more than one person</p> <p>The same person upon agreement may be appointed as a custodian for more than one person, if this is not in contrary to the interests of a persons under custodianship.</p> <p style="text-align: center;">Article 1369 Delegation of obligations</p> <p>If Custodian Body generally takes the role of a custodian or carries out special tasks of the custodian directly, it is authorized to entrust certain tasks to other professionals who can act on its behalf and under its supervision.</p> <p style="text-align: center;">Article 1370 Entrustment</p> <p>1. Custodian Body who decides on appointing the custodian defines custodian`s obligations and scope of authority.</p>	<p>kojom narednom od strane organa starateljstva i delovaće u skladu sa odredbama ove knjige.</p> <p style="text-align: center;">Član 1368 Starateljstvo nad više od jednog lica</p> <p>Isto lice na osnovu sporazuma može se imenovati kao staratelj više od jednog lica, ukoliko ovo nije u suprotnosti s interesima šticeinika.</p> <p style="text-align: center;">Član 1369 Delegiranje dužnosti</p> <p>Ako Organ starateljstva u načelu preuzme ulogu staratelja ili ako neposredno vrši posebne dužnosti staratelja onda je ovlašćen da izvesne dužnosti poveri drugim stručnim licima koja onda mogu da deluju u ime organa starateljstva i pod nadzorom tog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 1370 Poveravanje dužnosti</p> <p>1. Organ starateljstva koji odlučuje o imenovanju staratelja, definiše obaveze staratelja i obim delovanja.</p>
--	---	--

<p>2. Para marrjes së vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Organi i Kujdestarisë e informon kujdestarin për rëndësinë e kujdestarisë, të drejtat dhe detyrimet dhe siguron të gjitha informatat tjera të rëndësishme të nevojshme për kryerjen e detyrave të kujdestarit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1371 Detyrat e kujdestarit</p> <p>1. Kujdestari posaçërisht është i detyruar që të kujdeset me mirëbesim për personalitetin, dhe të drejtat dhe interesat e të kujdesurit, dhe ta administrojë pasurinë e tij me kujdes si dhe ta informojë Organin e Kujdestarisë për drejtimin e kujdestarisë.</p> <p>2. Kujdestari posaçërisht është i detyruar, me ndihmën e Organit të Kujdestarisë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e domosdoshme të ndihmës sociale me qëllim që të sigurohen të gjitha kërkesat materiale të nevojshme për zbatimin e masave të caktuara të kujdestarisë.</p>	<p>2. Before making a decision from Paragraph (1) of this Article, Custodian Body informs the custodian of the importance of custodianship, about rights and obligations and provides all other important information required for carrying out the task of a custodian.</p> <p style="text-align: center;">Article 1371 Obligations of custodian</p> <p>1. Custodian is especially obliged to take care in good faith of the personality and the rights and interests of the person under custodianship and to administer his property with care, as well as to inform Custodian Body of the course of custodianship.</p> <p>2. Custodian is especially obliged, with the assistance of Custodian Body, to make use of all necessary means of social welfare in order to ensure material requirements needed for enforcement of custodianship measures.</p>	<p>2. Pre donošenja odluke iz stava (1.) ovog člana, Organ starateljstva informiše staratelja o značajem starateljstva, o njegovim pravima i obavezama kao i obezbeđuje sve ostale bitne informacije koje su neophodne za obavljanje poslova staratelja.</p> <p style="text-align: center;">Član 1371 Dužnosti staratelja</p> <p>1. Staratelj je naročito dužan da se savesno stara i vodi računa o ličnosti, pravima i interesima štićenika i da upravlja imovinom tog lica uz dužnu pažnju, te da obaveštava organ starateljstva o toku svog rada.</p> <p>2. Staratelj je naročito dužan da uz pomoć organa starateljstva, iskoristi sva potrebna sredstva socijalnog staranja kako bi obezbedio materijalna sredstva koja su potrebna za sprovođenje mera za staranje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1372 Inventari i pasurisë</p> <p>1. Nëse i kujdesuri ka pasuri bazë, Organi i Kujdestarisë është i obliguar t’ia bashkangjesë raportit të tij të punës një inventar dhe raportin</p>	<p style="text-align: center;">Article 1372 Inventory of property</p> <p>1. If a person under custodianship owns substantial property, Custodian Body is obliged to attach an inventory- and</p>	<p style="text-align: center;">Član 1372 Spisak imovine</p> <p>1. Ako štićenik ima osnovnu imovinu, Organ starateljstva obavezan je da priloži spisak te imovine i izveštaj o proceni te imovine uz svoj</p>

<p>e vlerësimit për këtë pasuri. E njëjta vlen edhe për personin i cili i kryen detyrat e kujdestarisë në emër të Organit të Kujdestarisë.</p> <p>2. Inventari i pasurisë duhet të ofrojë të dhënat e mëposhtme:</p> <p>2.1. Të dhënat për personin nën kujdestari</p> <p>2.2. Të dhënat për kujdestarin, respektivisht personin i cili vepron si kujdestar në emër të Organit të Kujdestarisë për të administruar pasurinë e personit nën kujdestari</p> <p>2.3. Të dhënat për personin i cili i mban sendet e pasurisë në emër të të kujdesurit.</p> <p>3. Nëse Organi i Kujdestarisë kur kjo është juridikisht e lejuar, ka filluar procedurën e kujdestarisë, mund të bëjë inventarin dhe vlerësimin e pasurisë së personit nën kujdestari dhe të ndërmerr masat e nevojshme që të mbrohet pasuria edhe para marrjes së vendimit përfundimtar mbi vënien nën kujdesje.</p>	<p>evaluation-report of this property to his work report. This also applies to the person who performs tasks of a custodian on behalf of Custodian Body.</p> <p>2. The following data shall be provided with the inventory or property:</p> <p>2.1. Data of the person under custodianship</p> <p>2.2. Data about the custodian respectively a person who acts as a custodian on behalf of Custodian Body to administer property of the person under custodianship</p> <p>2.3. Data on the person who holds property things on behalf of the person under custodianship.</p> <p>3. If Custodian Body, where it is legally permissible, has initiated custodianship procedure, it can conduct the inventory and evaluation of property of a person under custodianship and undertake all necessary measures to protect this property, even before making the final decision for placement under custodianship.</p>	<p>izveštaj o radu. Ovo isto važi i za lice koje obavlja dužnost staratelja u ime Organa starateljstva.</p> <p>2. Spisak imovine treba pružiti sledeće podatke:</p> <p>2.1. Podaci o licu koje je pod starateljstvom;</p> <p>2.2. Podaci o staratelju, odnosno o licu koje deluje kao staratelj u ime Organa starateljstva za upravljanje imovinom štićenika</p> <p>2.3. Podaci o licu držaocu stvari ili imovine, u ime lica štićenika.</p> <p>3. Ako je Organ starateljstva, kad je to zakonski izričito dopušteno, pokrenuo postupak da se neko lice stavi pod starateljstvo, onda Organ starateljstva može da vršiti inventarizaciju i procenu imovine lica pod starateljstvom i da preduzme potrebne mere da se imovina zaštiti i pre donošenja konačne odluke o stavljanju pod starateljstvo.</p>
--	---	---

<p>trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja e trungut tjetër, sikurse është caktuar në nenin 18 të këtij Libri.</p> <p>Nënkapitulli IV – Trashëgimia nga Ana e Autoriteteve Publike</p> <p>Neni 1498 Komuna si trashëgimtar ligjor i radhës së fundit</p> <p>1. Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë, ligjor dhe me testament, thirret në trashëgim Komuna, ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e tij të fundit.</p> <p>2. Për përpaluajtshmeri, trashëgon komuna në teritorin ku ndodhet paluajtshmeria.</p> <p>3. Nëse vendbanimi ose vendqëndrim i tij ka qënë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, atëherë pasuria trashëgimore i takon Komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanim ose vendqëndrim e tij të fundit në vend . Në rastet kur trashëgimlënësi nuk ka banuar apo qëndruar asnjëherë në Republikën e Kosovës, pasuria trashëgimore i takon shtetit.</p>	<p>inherited by the grandparents of the other lineage, as per article 18 of this Book.</p> <p>Sub-chapter IV – Inheritance by Public Authorities</p> <p>Article 1498 The municipality as legal heir of last resort</p> <p>1. If the decedent does not leave any legal heir or with testament, the succession shall be assumed by the municipality where the decedent had his last residence or abode.</p> <p>2. Regarding immovable property, municipality inherits in the territory where the immovable property is located.</p> <p>3. If his or her place of residence has been outside the territory of the Republic of Kosovo then the hereditary wealth belongs to the municipality where the decedent has had his or her last residence or place of residence in the country. In cases where the decedent has never resided or stayed in the Republic of Kosovo, the hereditary wealth belongs to the state.</p>	<p>kako je propisano u članu 18. ove knjige.</p> <p>Potpoglavlje IV - Nasleđivanje od strane javnih vlasti</p> <p>Član 1498 Opština kao krajni zakonski naslednik</p> <p>1. Ako ostavilac nije ostavio naslednika, pravnog ili sa testamentom, opština u kojoj je ostavilac imao svoje poslednje prebivalište ili boravište je pozvana da nasledi.</p> <p>2. Nepokretnu imovinu, nasleđuje opština na teritoriji na kojoj se nalazi nepokretna imovina.</p> <p>3. Ako je njegovo prebivalište ili boravište bilo van teritorije Republike Kosovo, onda zaostavština pripada opštini u kojoj je ostavilac imao svoje poslednje prebivalište ili boravište u zemlji. U slučajevima kada ostavilac nikada nije imao prebivalište ili boravište u Republici Kosovo, zaostavština pripada državi.</p>
---	---	---

<p>KAPITULLI IV - DISPOZITAT E VEÇANTA PËR DISA TRASHËGIMTARË</p> <p>Nënkapitulli I - Fëmijët</p> <p>Neni 1499 Trajtimi i barabartë i fëmijëve të trashëgimtarit</p> <p>Fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martesë kur atësia është njohur ose vërtetuar sipas Librit për familjen, si dhe të adoptuarit dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta në trashëgimi</p> <p>Neni 1500 Barazia e të adoptuarve në trashëgimi</p> <p>I adoptuari dhe pasardhësit e tij kanë të drejta të njëjta trashëgimore ndaj adoptuesit, sikurse fëmijët e adoptuesit dhe pasardhësit e tjerë të tij.</p> <p>Neni 1501 Pasojat e kërkesës për pushimin e adoptimit</p> <p>I adoptuari dhe pasardhësit e tij nuk e trashëgojnë adoptuesin, nëse adoptuesi ka paraqitur kërkesë për pushimin e adoptimit,</p>	<p>CHAPTER IV – SPECIAL PROVISIONS FOR SOME HEIRS</p> <p>Sub-chapter I – Children</p> <p>Article 1499 Equal treatment of the decedent’s children</p> <p>Children born in marriage and outside marriage when paternity has been recognized or certified according to the Book for the Family, as well as those adopted, and their descendants, shall have equal rights to inheritance.</p> <p>Article 1500 Equality in inheritance of adoptees</p> <p>The adoptee and his descendants shall have the same rights towards the adopter as to adopter’s children and their descendants.</p> <p>Article 1501 Consequences of a request to nullify an adoption</p> <p>An adoptee and his successors shall not inherit the adopter, if the adopter has submitted a request for ceasing the adoption, and after his</p>	<p>POGLAVLJE IV - POSEBNE ODREDBE ZA IZVESNE NASLEDNIKE</p> <p>Potpoglavlje I - Deca</p> <p>Član 1499 Ravnopravni tretman dece ostavioca</p> <p>Deca rođena u braku i van braka kada je očinstvo priznato ili overeno prema knjizi za porodicu, kao i usvojena deca i njihovi potomci imaju jednaka prava na nasleđivanje.</p> <p>Član 1500 Jednakost usvojenih u nasleđivanju</p> <p>Usvojenik i njegovi potomci imaju ista nasledna prava prema usvojeniku, kao i deca usvojenika i drugi njegovi potomci.</p> <p>Član 1501 Posledice zahteva za prestanak usvojenja</p> <p>Usvojenik i njegovi potomci ne mogu da naslede usvojenika, ako je usvojlac podneo zahtev za prestanak usvojenja, i ako je njegov</p>
---	---	--

<p>dhe nëse kërkesa e tij vërtetohet pas vdekjes se ka qenë e bazuar.</p> <p>Nënkapitulli II – Të Drejtat mbi Sendet e Shtëpisë dhe të Drejtat e Bashkëshortit</p> <p>Neni 1502 Trashëgimi i sendeve shtëpiake</p> <p>1. Sendet shtëpiake që janë përdorur për plotësimin e nevojave të përditshme të bashkëshortit pasjetues apo trashëgimtarëve të tjerë, të cilët kanë jetuar në të njëjtën shtëpi, të tilla si mobilet, pajisjet, dhe të ngjashme, do të trashëgohen nga bashkëshorti pasjetues dhe pasardhësit e trashëgimlënësit, me përjashtim të rasteve kur këto sende janë me vlerë të konsiderueshme.</p> <p>2. Personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, fitojnë bashkëpronësinë në pjesë të barabarta mbi sendet shtëpiake të veçuara.</p>	<p>death it is verified that the request was justified.</p> <p>Sub-chapter – Rights over Household Items and Spouse’s Rights</p> <p>Article 1502 Inheritance of household items</p> <p>1. The household items that are used for fulfilling the daily needs of the surviving spouse or other heirs, who have lived in the same house, such as furniture, equipment and similar, shall be inherited by the surviving spouse and decedent’s descendants, unless these items are of substantial value.</p> <p>2. The persons listed in paragraph 1 of this article shall obtain the co-ownership in equal shares of the household items so deducted.</p>	<p>zahtev potvrđen nakon smrti da je bio osnovan.</p> <p>Potpoglavlje II - Prava nad stvarima domaćinstva i prava supružnika</p> <p>Član 1502 Nasleđivanje predmeta domaćinstva</p> <p>1. Predmeti domaćinstva koji su služili svakodnevnim potrebama nadživelog supružnika ili drugih potomaka koji su živeli u istom domaćinstvu, kao što su nameštaj, oprema i slično, će biti nasleđena od strane nadživelog supružnika i ostaviočevih potomaka, osim kada ovi predmeti imaju značajnu vrednost.</p> <p>2. Lica određena u stavu 1. ovog člana stiču zajedničko vlasništvo u jednakim delovima nad zasebnim predmetima domaćinstva.</p>
<p>Neni 1503 E drejta e banimit të bashkëshortit</p> <p>1. Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë për të jetuar në shtëpinë bashkëshortore të martesës derisa të vdes ose ri-martohet, pa cënuar të drejtën e tij për të trashëguar. Nese objekti i banimit shitet apo në ndonjë formë tjetër</p>	<p>Article 1503 Residential right of the spouse</p> <p>1. The surviving spouse has the right to live at the marriage spouse's home for a period of one year after the death of the decedent, without prejudice to his right to inherit.</p>	<p>Član 1503 Pravo stanovanja supružnika</p> <p>1. Nadživeli supružnik ima pravo da živi u bračnom domu dok ne umre ili ponovo stupi u brak, ne dovodeći u pitanje njegovo pravo na nasleđivanje. Ako se stambeni objekat prodaje ili u nekom drugom obliku otuđuje,</p>

<p>tjetërsohet, bashkëshortit pasjetues i sigurohet objekti i domosdoshëm i banimit.</p> <p>2. Nëse shtëpia bashkëshortore është marrë nga bashkëshorti pa pajtimin e tij, ai mund ta kërkojë kthimin nga personi, në posedim të cilit ndodhet shtëpia.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1504 Statusi i pasurisë bashkëshortore</p>	<p>The surviving spouse is entitled to live in the marital home until death or re-marry, without jeopardizing the right to inherit. If the housing facility is sold or in some other form is alienated, to the surviving spouse is provided indispensable housing facility.</p> <p>2. If the matrimonial home has been taken away from the spouse without his consensus, he can reclaim it from the person who is in its possession.</p> <p style="text-align: center;">Article 1504 Matrimonial property status</p>	<p>nadživelom supružniku se obezbeđuje neophodan objekat za stanovanje.</p> <p>2. Ako bračna kuća je uzeta od supružnika bez njegovog pristanka, on može zatražiti povratak od lica u čijoj državini se nalazi kuća.</p> <p style="text-align: center;">Član 1504 Imovinski status supružnika</p>
<p>1. Bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën e tij në pasurinë e përbashkët martesore. Kjo pjesë e pasurisë së bashkëshortit veçohet dhe nuk llogaritet në pjesën e pasurisë trashëgimore, në të cilën bashkëshorti po ashtu e ka të drejtë e trashëgimisë ligjore sipas këtij Kodi ose sipas testamentit të trashëgimlënësit.</p> <p>2. Nëse trashëgimlënësi dhe bashkëshorti i tij kanë pasur pasuri të përbashkët në përputhje me regjimin e pasurisë së përbashkët, vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit pas pjestimit së pasurisë së përbashkët bëhet objekt i trashëgimisë.</p>	<p>1. The surviving spouse of the decedent has the right to claim his share from the joint property. This share will not count towards the share in the inheritance that the spouse is entitled to according to this Book or to the will of the decedent.</p> <p>2. If the decedent and his spouse had joint property under their matrimonial property regime, only the share that pertains to the decedent after distribution of the joint property shall fall in the scope of the inheritance.</p>	<p>1. Nadživeli supružnik ostavioca ima pravo da traži svoj udeo u zajedničku bračnu imovinu. Ovaj deo imovine supružnika je odvojen i ne ubraja se u zaostavštinu u kojoj supružnik takođe ima pravo na zakonsko nasleđe prema ovom zakoniku ili prema testamentu ostavioca.</p> <p>2. Ako su ostavilac i njegov supružnik imali zajedničku imovinu u skladu sa režimom zajedničke imovine, samo onaj deo koji se bude odnosio na ostavioca nakon podele zajedničke imovine postaje predmet nasleđivanja.</p>

<p>3. Nuk mund të interpretohet në frymën e kufizimit të së drejtës së bashkëshortit pasjetues asnje dispozite e ketij libri mbi të drejtat e fituara sipas dispozitave të Librit të Familjes, lidhur me mbarimin e regjimit të pasurisë së përbashkët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1505 Kur bashkëshorti nuk ka të drejtë për të trashëguar</p> <p>1. E drejta e trashëgimit midis bashkëshortëve pushon me shkurorizimin ose me anulimin e martesës.</p> <p>2. Bashkëshorti nuk ka të drejtë të trashëgojë:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. nëse në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit janë përmbushur kushtet për shuarjen e martesës me shkurorëzim dhe trashëgimlënësi ka paraqitur kërkesë ose ka dhënë pëlqimin për shkurorëzim;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. nëse trashëgimlënësi ka pasur të drejtë të paraqesë kërkesë për anulimin e martesës dhe e ka paraqitur një të tillë.</p> <p>Nënkapitulli III – Personat që Përfitojnë nga Detyrimi për Ushqim ose Mbajtje</p>	<p>3. Nothing in this Book shall be construed to limit the surviving spouse’s right to whatever he is entitled to under the Family Law provisions regarding the winding-up of a matrimonial property regime.</p> <p style="text-align: center;">Article 1505 When a spouse is not eligible to inheritance</p> <p>1. The right to inheritance between spouses ceases to exist upon divorce or annulment of the marriage.</p> <p>2. A spouse shall not be eligible to inherit in the following cases:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 if at the time of the death of the decedent the requirements for the dissolution by divorce of the marriage were satisfied and the decedent had filed for or consented to the divorce</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. if the decedent was entitled to file for the annulment of the marriage and had filed for it.</p> <p>Sub-chapter III – Persons benefiting from the obligation for Alimony or Maintenance</p>	<p>3. Nijedna odredba ove knjige o pravima stečenim po odredbama knjige porodice ne može se tumačiti u duhu ograničenja prava nadživelog supružnika o prestanku režima zajedničke svojine.</p> <p style="text-align: center;">Član 1505 Kada supružnik nema pravo nasleđivanja</p> <p>1. Pravo na nasleđivanje između supružnika prestaje razvodom ili poništenjem braka.</p> <p>2. Supružnik nema pravo nasleđivanja:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ako su u vreme smrti ostavioca ispunjeni uslovi za prestanak braka sa razvodom braka, a ostavilac je podneo zahtev ili je dao saglasnost za razvod;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. ako je ostavilac imao pravo da podnese zahtev za poništenje braka i predao takav zahtev.</p> <p>Potpoglavlje III -Lica koja dobijaju alimentaciju ili izdržavanje</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 1506 Mbi të drejtat e personave ndaj të cilëve trashëgimlënësi ka paguar detyrimin për ushqim ose mbajtjen</p> <p>1. Çdo detyrim i trashëgimlënësit për të siguruar ushqim dhe mbajtje transferohet tek trashëgimia si detyrim, nëse personi që përfiton nga detyrimi për ushqim ose mbajtja nuk i ka mjetet e nevojshme për jetesë.</p> <p>2. Trashëgimtarët ose legatarët janë përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi në përputhje me dispozitat mbi përgjegjësinë e kreditorëve të trashëgimlënësit.</p> <p>KAPITULLI V – TRASHËGIMTARËT E DOMOSDOSHËM</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli I – Parimet</p> <p style="text-align: center;">Neni 1507</p>	<p style="text-align: center;">Article 1506 The rights of persons whom the decedent paid alimonies or maintenance to</p> <p>1. Any obligations of the decedent to provide maintenance or alimonies shall be transferred to the inheritance as a debt if the person who benefits from the alimony or maintenance would otherwise not have the necessary means for living.</p> <p>2. The heirs and legatees are liable for the payment of this debt according to the provisions on the liability vis-à-vis creditors of the decedent in general.</p> <p>CHAPTER V – COMPULSORY HEIRS</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub-chapter I – Principles</u></p> <p style="text-align: center;">Article 1507 Compulsory heirs in general</p>	<p style="text-align: center;">Član 1506 Prava lica kojima je ostavilac plaćao alimentaciju ili izdržavanje</p> <p>1. Bilo kakve obaveze ostavioca da obezbeđuje alimentaciju ili izdržavanje se prenose nasledstvom kao obaveza, ako lice koje dobija od alimentacije ili izdržavanja nema neophodna sredstva za život.</p> <p>2. Naslednici ili legati su odgovorni za ispunjenje ove obaveze u skladu sa odredbama o odgovornostima poverilaca ostavioca.</p> <p>POGLAVLJE V - OBAVEZNI NASLEDNICI</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje I - Načela</p> <p style="text-align: center;">Član 1507 O nužnim naslednicima uopšte</p>
--	---	--

<p>Mbi trashëgimtarët e domosdoshëm në përgjithësi</p> <p>1. Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti/ja i tij.</p> <p>2. Gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit janë trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm nëse janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë.</p> <p>3. Personat e cekur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni janë trashëgimtarë të domosdoshëm nëse janë thirrur për trashëgim sipas neneve 1489-1497 të këtij Libri.</p>	<p>1. Compulsory heirs are: the decedent's descendants, adoptees, their descendants, his/her parents, and spouse.</p> <p>2. Decedent's grandparents, and siblings, are compulsory heirs only if they suffer from permanent and total disability to work and lack the means for living.</p> <p>3. The persons mentioned under paragraphs 1 and 2 of this article are compulsory heirs when they are called for inheritance according to Articles 1489-1497 of this Book.</p>	<p>1. Nužni naslednici su: potomci ostavioca, njegova usvojena deca i njihovi potomci, njegovi roditelji i supružnik.</p> <p>2. Dede i babe ostavioca, braća i sestre ostavioca biće nužni naslednici samo ako su potpuno nesposobni za rad i nemaju sredstva za život.</p> <p>3. Lica navedena u stavu 1. i 2. ovog člana su nužni naslednici ako su pozvani na nasleđe prema članovima 1489-1497 ove knjige.</p>
<p>Neni 1508 Statusi i personave në bashkëjetesë</p> <p>Personat në bashkëjetesë nuk janë trashëgimtarë të domosdoshëm. Përfundimisht nëse plotësohen kushtet sipas nenit 1489 të këtij libri, konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm.</p>	<p>Article 1508 The status of persons in cohabitation</p> <p>Persons in extramarital cohabitation are not compulsory heirs. Exceptionally, if conditions under Article 1489 of this Book are met, they are considered as indispensable inheritors.</p>	<p>Član 1508 Status lica u zajednici života</p> <p>Lica u zajednici života nisu obavezni naslednici. Izuzetno, ako su ispunjeni uslovi prema članu 1489. ove knjige, oni se smatraju obaveznim naslednicima.</p>
<p>Neni 1509 Pjesa e domosdoshme dhe e disponueshme pasurisë trashëgimore</p>	<p>Article 1509 The compulsory and the available part (share) of the hereditary property</p>	<p>Član 1509 Nužni i raspoloživi deo zaostavštine</p>

<p>1. Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë mbi pasurinë trashëgimore, të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë, e cila quhet pjesë e domosdoshme.</p> <p>2. Pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi trashëgiminë sipas neneve 1490-1497 të këtij libri, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e saj.</p>	<p>1. The compulsory heirs have the right to such part hereditary property over which the decedent cannot dispose, and which is called the compulsory share.</p> <p>2. The compulsory share of the descendants and of the spouse is half, and the compulsory share of other compulsory heirs is one-third, of the share the compulsory heir would have obtained as heir at law according to the provisions on inheritance under Articles 1490-1497 of this Book, while the compulsory share of other heirs receives the third of it.</p>	<p>1. Nužni naslednici imaju pravo na onaj deo zaostavštine kojim ostavilac ne može da raspolaze a koji se naziva obaveznim naslednim delom.</p> <p>2. Nužni deo nasledstva potomaka i supružnika čini jednu polovinu dela koji bi pripadao svakome kao pravni naslednik u skladu sa odredbama o nasleđivanju prema članovima 1490-1497 ove knjige, dok nužni deo drugih naslednika čini njenu trećinu.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Llogaritja e Pjesës së Domosdoshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 1510 Përcaktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Calculating the Compulsory Share</p> <p style="text-align: center;">Article 1510 Determining the value of the hereditary property</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Izračunavanje nužnog dela</p> <p style="text-align: center;">Član 1510 Utvrđivanje vrednosti zaostavštine</p>
<p>1. Vlera e pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet pjesa e domosdoshme llogaritet në këtë mënyrë:</p> <p>2. Së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në</p>	<p>1. The value of the hereditary property, which is used as the basis for calculating the compulsory share, shall be calculated as follows:</p> <p>2. First, all the assets the decedent had at the moment of his death shall be inventoried and</p>	<p>1. Vrednost zaostavštine, koja treba da se koristi kao osnova za izračunavanje nužnog dela, biće izračunata na sledeći način:</p> <p>2. Kao prvo, sva imovina koju je ostavilac posedovao u trenutku njegove smrti biće</p>

<p>çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato të drejta që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha detyrimet e të tretëve borxhet që ia kanë të tjerët, si edhe ato që i detyrohet a ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të detyrimeve të cilat qartazi nuk mund të përmbushen prej debitoreve të tij.</p> <p>3. Nga vlera e përcaktur e pasurisë që ka pasur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes, zbritet shuma e detyrimeve të tij, shuma e shpenzimeve të inventarizimit e vlerësimit të pasurisë trashëgimore, si edhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit.</p> <p>4. Pjesës që mbetet i zbritet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj mënyre ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor brenda dhjetë viteve të fundit para vdekjes, duke përfshirë edhe dhurimet e bëra trashëgimtarëve që kanë hequr dorë nga trashëgimia, ose dhurimeve, të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore.</p> <p>5. Kësaj shume i zbritet edhe vlera e dhurimeve që trashëgimtari në vitin e fundit të jetës së tij u ka bërë personave të tjerë që nuk janë trashëgimtarë ligjorë, me përjashtim të dhurimeve të rëndomta.</p>	<p>evaluated, including all testamentary dispositions, and all debts owed to the decedent, even those owed by one of the heirs, except those debts obviously irrecoverable.</p> <p>3. The decedent's liabilities, the cost of inventorying and evaluating the inheritance, and the expenses for the decedent's funeral, shall then be subtracted from the value of the decedent's assets so determined.</p> <p>4. To the remainder so determined shall be added the value of all gifts made by the decedent in any manner to an heir at law within the last ten years before his death, including gifts made to heirs who have renounced to their inheritance, and those gifts that the decedent ordered not to count towards the heir's inheritance share.</p> <p>5. To this sum shall be added the value of gifts that the decedent made to persons who are not heirs at law during the last year of his life, with the exception of ordinary gifts.</p>	<p>popisana i procenjena, uključujući sva prava koja je raspolagao testamentom, kao i sve obaveze trećih lica, sve dugove koji su dugovani umrlom licu, čak i onaj dug koji duguje neki od njegovih nasljednika, sa izuzetkom onih dugova koji su očigledno nenaplativi.</p> <p>3. Od utvrđene vrednosti imovine koju je ostavilac imao u trenutku svoje smrti, biće odbijen iznos njegovih obaveza, iznos troškova za popis imovine i procenu vrednosti nasledstva, kao i troškovi sahrane ostavioca.</p> <p>4. Preostalom delu se oduzima vrednost svih poklona koje je ostavilac na bilo koji način dao bilo kom zakonitom nasledniku u poslednjih deset godina pre njegove smrti, uključujući poklone naslednicima koji su se odrekli nasledstva ili poklona za koje je ostavilac naredio da se ne računaju na naslednika u njegovom naslednom delu.</p> <p>5. Ovom iznosu se oduzima i vrednost poklona koje je ostavilac u poslednjoj godini njegovog života dao drugim licima koja nisu zakonski naslednici, osim manjih uobičajenih poklona.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 1511 Çfarë konsiderohet dhurim</p> <p>Për qëllime të këtij Libri, dhurim konsiderohet çdo heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit ose detyrimit tjetër, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, me qëllim themelimin apo zgjerimin e familjes, ushtrimin e një mjeshtrie, apo çdo disponim tjetër pa shpërblim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1511 What is considered a gift</p> <p>For the purposes of this Book, a gift is considered any renunciation of a right, forgiveness of debt or other obligation, any transfer of property in the interest of an heir on behalf of the hereditary part with the purpose of establishing or expanding the family, practicing a mastery, or any other activity without reward.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1511 Šta se smatra poklonom</p> <p>U smislu ove knjige, poklonom se smatra bilo koje odricanje od prava, oproštaj bilo kog duga ili druge obaveze, bilo koji prenos imovine izvršen u korist naslednika u ime naslednog dela, u cilju osnivanja ili za proširenje domaćinstva, za obavljanje zanimanja, kao i svako drugo raspolaganje bez naknade.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1512 Caktimi i vlerës së dhurimit</p> <p>Vlera e dhurimit përcaktohet në bazë të vlerës së saj në momentin e dhurimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1512 Determination of the value of the gift</p> <p>The value of a gift shall be evaluated based on its value at the moment of the donation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1512 Određivanje vrednosti poklona</p> <p>Vrednost poklona određuje se na osnovu njene vrednosti u trenutku davanja poklona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1513 Dhurimi në formë të sigurimit</p> <p>Kur dhurimi përbëhet nga sigurimi në dobi të dhuratëmarrësit, si vlerë e dhurimit merret shuma e primeve që ka paguar trashëgimlënësi, nëse kjo shumë është e barabartë ose më e vogël se shuma e siguruar. Në rastet kur shuma e primeve është më e madhe se shuma e siguruar, si vlerë e dhurimit merret shuma e siguruar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1513 Gifts consisting of insurance</p> <p>If the gift consists of an insurance contracted for the benefit of the donee, its value shall be equal to the amount of premium paid by the decedent, if such amount is equal to or smaller than the amount insured; and if such amount exceeds the amount insured, the value of the gift shall be equal to the amount insured.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1513 Poklon u obliku osiguranja</p> <p>Kad se poklon sastoji od osiguranja u korist poklonoprimca, kao vrednost poklona uzeće se iznos premije koje je uplatio ostavilac, ako je taj iznos jednak ili manji od osigurane sume. U slučajevima kada je iznos premije veći od osigurane sume, kao vrednost poklona uzeće se iznos osigurane sume.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1514 Veçimi i sendeve shtëpiake</p>	<p style="text-align: center;">Article 1514 Deduction of household items</p>	<p style="text-align: center;">Član 1514 Izdvajanje predmeta domaćinstva</p>

<p>Sendet shtëpiake që një trashëgimtar ose bashkëshorti trashëgon sipas dispozitave të këtij Libri nuk llogariten në pjesën e domosdoshme apo në pjesën trashëgimore të një trashëgimtari.</p> <p>Nënkapitulli III – Zvogëlimi i Disponimit me Testament dhe Kthimi për Shkak të Cenimit të Pjesës së Domosdoshme</p> <p>Neni 1515 Cënimi i pjesës së domosdoshme</p> <p>1. Nëse pjesa e domosdoshme është cenuar, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet për plotësimin e pjesës së domosdoshme.</p> <p>2. Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën e disponueshme.. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament, të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij. Kjo nuk do të përfshijë dhuratat, të cilat janë bërë më shumë se dhjetë vjet para vdekjes së trashëgimlënësit.</p>	<p>Household items that one heir or the spouse inherits will not be calculated towards the compulsory share, nor shall they be counted towards the hereditary share of an heir.</p> <p>Sub-chapter III – Decreasing Testamentary Dispositions and Returning of Gifts due to Infringement of the Compulsory Share</p> <p>Article 1515 Infringement of the compulsory share</p> <p>1. If the compulsory share is infringed, testamentary dispositions shall be decreased, and gifts shall be returned, to the extent required to restore the compulsory share.</p> <p>2. The compulsory share is infringed if the combined value of testamentary dispositions and gifts exceeds the available share. This combined value shall comprise gifts and testamentary dispositions that have been ordered by the decedent not to count towards the share of a compulsory heir. It shall not comprise gifts that were been made more than ten years before the death of the decedent.</p>	<p>Predmeti domaćinstva koje naslednik ili supružnik nasledi prema odredbama ove knjige ne računaju se u nužni deo ili nasledni deo jednog naslednika.</p> <p>Potpoglavlje III – Smanjenje raspolaganja testamentom i vraćanje zbog povrede nužnog dela</p> <p>Član 1515 Povreda nužnog dela</p> <p>1. Ako je povređen nužni deo, raspolaganje testamentom biće smanjeno, a pokloni će biti vraćeni u meri koja bude potrebna da bi se namirio nužni deo.</p> <p>2. Nužni deo je povređen kad ukupna vrednost raspolaganja testamentom i poklona premašuje raspoloživi deo. Ova vrednost uključuje poklone i raspolaganja testamentom za koje je ostavilac naredio da se ne uračunavaju nužnom nasledniku u nasledni deo. To neće uključivati poklone koji su napravljeni više od deset godina pre smrti ostavioca.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 1516 Radha e zvogëlimit dhe e kthimit</p> <p>1. Nëse pjesa e domosdoshme është cenuar, zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë dhurimet kthehen.</p> <p>2. Nëse dhurata nuk mund të kthehet si send, dhuratëmarrësi duhet të kthejë vlerën e saj sipas dispozitave mbi kthimin e pasurimit të pa bazë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1516 The rank of decrease and return</p> <p>1. If the compulsory share is infringed, the testamentary dispositions shall be decreased, and if that is insufficient, the gifts shall be returned.</p> <p>2. If the gift cannot be returned <i>in rem</i>, the person who received the gift shall return its value according to the provisions on the return of an unjust enrichment</p>	<p style="text-align: center;">Član 1516 Red smanjenja i vraćanja</p> <p>1. Ako je povređen nužni deo, smanjuju se raspolaganja testamentom, i kao se neophodni deo ne ispuni na ovaj način, onda se vraćaju pokloni.</p> <p>2. Ako poklon ne može da bude vraćen kao predmet, poklonoprimalac vratiće vrednost poklona u skladu sa odredbama o povraćaju neosnovanog obogaćenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1517 Zvogëlimi proporcional i trashëgimisë sipas testamentit</p> <p>Disponimet me testament zvogëlohen në të njëjtën masë, pa marrë parasysh natyrën dhe vëllimin e tyre, apo pa marrë parasysh nëse gjenden në një ose më shumë testamente, me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me testament.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1517 Proportional decrease of testamentary inheritance</p> <p>Testamentary dispositions are decreased proportionally, irrespective of their nature and volume, and irrespective of whether they result from one or several wills, unless otherwise provided for in the will.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1517 Srazmerno smanjenje nasleđivanja prema testamentu</p> <p>Raspolaganja testamentom smanjuju se istom merom, bez obzira na njihovu prirodu i obim, i bez obzira na to da li su proistekli iz jednog ili iz više testamenta, osim ako je drukčije određeno testamentom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1518 Legu i privilegjuar</p> <p>Nëse trashëgimlënësi ka lënë disa legë dhe ka urdhëruar që ndonjë leg të paguhet para të tjerëve, ky leg do të zvogëlohet vetëm nëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 1518 Privileged legacy</p> <p>If the decedent has left a legacy and ordered for some legacies to be paid prior to others, these legacies shall only be decreased if the</p>	<p style="text-align: center;">Član 1518 Privilegovan legat</p> <p>Ako je ostavilac ostavio više legata i naredio da se neki legat isplati pre ostalih, taj će se legat smanjiti samo ukoliko vrednost ostalih</p>

<p>vlera e legëve të tjerë nuk mjafton për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1519 Zvogëlimi proporcional i legëve</p> <p>1. Trashëgimtari me testament, pjesa trashëgimore e të cilit duhet të zvogëlohet për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme, mund të kërkojë zvogëlimin proporcional të legëve që ai duhet t'i paguajë, nëse në testament nuk parashihet diçka tjetër.</p> <p>2. Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni vlen edhe për legatarin, të cilin trashëgimlënësi e ka urdhëruar të paguajë diçka nga legu i vet.</p>	<p>value of the other legacies is not sufficient to restore the compulsory share.</p> <p style="text-align: center;">Article 1519 Proportional decrease of legacies</p> <p>1. A testamentary heir, whose share is reduced in order to restore the compulsory share, may request a proportional reduction of legacies to be paid by him/her, unless otherwise provided for in the will.</p> <p>2. Paragraph 1 of this article shall also apply to a legatee who was ordered by the decedent to make a payment from his/her own legacy.</p>	<p>legata ne bude dovoljna da se namiri nužni deo.</p> <p style="text-align: center;">Član 1519 Srazmerno smanjenje legata</p> <p>1. Testamentarni nasljednik čiji je nasledni deo trebao da bude smanjen da bi se namirio nužni deo, može da zatraži srazmerno smanjenje legata koje on treba da isplati, osim ukoliko testamentom ne predviđa nešto drugo.</p> <p>2. Odredba iz stava 1. ovog člana takođe važi i za legatora kome je ostavilac naložio da iz svog legata nešto isplati.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1520 Radha e kthimit të dhurimeve</p> <p>1. Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdone radhë deri tek dhurimet më të hershme, mbrapa në kohë.</p> <p>2. Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1520 The rank of returning gifts</p> <p>1. Returning of gifts shall start with the last gift made, and shall then continue in reverse temporal order.</p> <p>2. Gifts made at the same time shall be returned in proportion to the value of the gifts.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1520 Red vraćanja poklona</p> <p>1. Vraćanje poklona vrši se počev od poslednjeg datog poklona i nastavlja se obrnutom redu kojim su pokloni bili dati, nazad u vreme.</p> <p>2. Pokloni dati u isto vreme vraćaju se srazmerno vrednosti poklona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1521 Pozita e dhuratëmarrësit që kthen dhurimin</p>	<p style="text-align: center;">Article 1521 The position of the person returning the gift</p>	<p style="text-align: center;">Član 1521 Položaj poklonoprirnca koji vraća poklon</p>

<p>Sa i përket sendit të dhuruar që është i detyruar ta kthejë, dhuratëmarrësi konsiderohet si posedues në mirëbesim (<i>bona fide</i>) deri në ditën që ka marrë dijëni për kërkesën që të kthejë dhurimin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1522 E drejta e kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve</p> <p>1. Vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm mund ta kërkojnë zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve, të cilat çënojnë pjesësn e domosdoshme.</p> <p>2. Kjo e drejtë nuk mund të çënohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm.</p>	<p>As regards the obligations of a person who has to return the gift, he is considered a <i>bona fide</i> possessor up to the day he was informed about the request to return the gift.</p> <p style="text-align: center;">Article 1522 The right to request reduction of testamentary possession and returning gifts</p> <p>1. Only compulsory heirs shall have the right to request the reduction of testamentary dispositions and the return of gifts if the compulsory share is infringed.</p> <p>2. Such right cannot be seized by the creditors of the compulsory heir.</p>	<p>U pogledu poklonjenih stvari koje je obavezan da vrati poklon, poklonoprimalac se smatra držaoцем u dobroj veri (<i>bona fide</i>) do dana kada sazna za zahtev za vraćanje poklona.</p> <p style="text-align: center;">Član 1522 Pravo potraživanja za smanjenje raspolaganja testamentom i vraćanje poklona</p> <p>1. Smanjenje raspolaganja testamentom i vraćanje poklona ako je time bio povređen nužni deo, mogu da traže samo nužni naslednici.</p> <p>2. Ovo pravo ne može biti narušeno od poverioca obaveznog naslednika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1523 Parashkrimi i kërkesës</p> <p>Zvogëlimi i disponimeve me testament mund të kërkohet brenda tre viteve nga shpallja e testamenti, ndërsa kthimi i dhurimeve brenda tre viteve nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1523 Prescription of the request</p> <p>The reduction of testamentary dispositions may be requested within three years from the announcement of the testament, and the returning of gifts within three years from the decedent's death, respectively from the day the decision on the declaration of death or the decision confirming his suspected death became final and absolute.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1523 Zastarelost zahteva</p> <p>Smanjenje raspolaganja testamentom može da se zatraži u roku od tri godine od proglašenja testamenta, a vraćanje poklona u roku od tri godine od smrti ostavioca, odnosno od dana kada je rešenje o njegovom proglašenju za umrlóg, odnosno rešenje kojim se utvrđuje njegova smrt, postalo pravosnažno i konačno.</p>

<p>KAPITULLI VI – LLOGARITJA E DHURIMEVE DHE E LEGËVE NË PJESËN TRASHËGIMORE</p> <p>Neni 1524 Llogaritja e dhurimeve të trashëgimtarit ligjor</p> <p>1. Çdo trashëgimtari ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi në çfarëdo lloj mënyre.</p> <p>2. Nëse dhurimi është bërë prej më shumë se dhjetë vjet para vdekjes së trashëgimlënësit, ai nuk merret parasysh.</p> <p>3. Fitimet nga dhurimi të bëra deri në vdekjen e trashëgimlënësit nuk merren parasysh.</p> <p>4. Dhurimi nuk llogaritet, nëse trashëgimlënësi ka deklaruar në kohën e dhurimit, më vonë ose në testament, se dhurimi nuk do të llogaritet në pjesën trashëgimore ose nga rrethanat mund të konkludohet se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit.</p>	<p>CHAPTER VI – TAKING INTO ACCOUNT OF GIFTS AND LEGACIES FOR THE HEREDITARY SHARE</p> <p>Article 1524 Taking into account of gifts to an heir</p> <p>1. Everything an heir has received as a gift from the decedent in whatsoever manner shall be taken into account for the calculation of the hereditary share.</p> <p>2. If the gift was made more than ten years before the death of the decedent, it is not taken into account.</p> <p>3. Profits or proceeds from made from the gift until the decedent’s death shall not be taken into account.</p> <p>4. Gifts shall not be taken into account if the decedent has declared at the time of donation or later, or in a will, that the gift should not be counted towards the hereditary share, or if it results from the circumstances that this was the decedent’s intention.</p>	<p>POGLAVLJE VI – IZRAČUNAVANJE POKLONA I LEGATA U NASLEDNI DEO</p> <p>Član 1524 Izračunavanje poklona zakonskom nasledniku</p> <p>1. Svakom zakonskom nasledniku izračunava se u nasledni deo sve što je na dobio na poklon od ostavioca na bilo koji način.</p> <p>2. Ako je poklon predat više od deset godina prije smrti ostavioca, on se ne uzima u obzir.</p> <p>3. Dobici od poklona do smrti ostavioca ne uzimaju se u obzir.</p> <p>4. Poklon se ne uračunava ako je ostavilac izjavio, u vreme davanja poklona ili docnije ili u testamentu, da se poklon neće uračunati u nasledni deo, ili se iz okolnosti može zaključiti da je to bila volja ostavioca.</p>
--	---	---

<p>5. Ky nen nuk cënon dispozitat për pjesën e domosdoshme</p> <p style="text-align: center;">Neni 1525 Llogaritja e legut trashëgimtarëve ligjor</p> <p>Legu që i është lënë trashëgimtarit ligjor llogaritet në pjesën trashëgimore të tij, përveç rasteve kur nga testamenti del se trashëgimlënësi ka dashur që trashëgimtari të marrë legun përpos pjesës së tij trashëgimore.</p>	<p>5. Nothing in this article shall affect the provisions on the compulsory share.</p> <p style="text-align: center;">Article 1525 Taking into account legacies for heirs at law</p> <p>A legacy that is left to an heir at law shall be counted towards his hereditary share, unless it results from the will that the decedent wanted such heir to receive the legacy in addition to his hereditary share.</p>	<p>5. Ovaj član ne dovodi u pitanje odredbe o nužnom delu.</p> <p style="text-align: center;">Član 1525 Izračunavanje legata zakonskim naslednicima</p> <p>Legat ostavljen zakonskom nasledniku izračunava se u njegov nasledni deo, osim ukoliko iz testamenta proizilazi da je ostavilac hteo da naslednik dobije legat pored njegovog dela nasledstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1526 Llogaritja e dhurimeve dhe e legëve</p> <p>1. Dhurimet dhe legët llogariten në atë mënyrë që trashëgimtarët e tjerë marrin nga pasuria trashëgimore vlerën përkatëse dhe pastaj ajo që mbetet nga pasuria trashëgimore ndahet midis të gjithë trashëgimtarëve.</p> <p>2. Nëse sendet dhe të drejtat që ka pasur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk mjaftojnë që trashëgimtarët e tjerë të marrin vlerën përkatëse, trashëgimtari në dobi të të cilit bëhet llogaritja nuk është i detyruar t'u kthejë diçka nga ajo që ka marrë.</p> <p>3. Ky nen nuk cënon dispozitat për pjesën e domosdoshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1526 Taking into account gifts and legacies</p> <p>1. Donations and legacies shall be taken into account by distributing to the other heirs, from the hereditary property, the respective value, and by dividing only the remainder among all heirs.</p> <p>2. If things and rights that the decedent owned of his death are not sufficient for the other heirs to receive the respective value, the heir towards whose share the gifts or legacies are counted shall not be obliged to return anything he had received.</p> <p>3. Nothing in this article shall affect the provisions on the compulsory share.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1526 Izračunavanje poklona i legata</p> <p>1. Izračunavanje poklona i legata vrši se na taj način što ostali naslednici dobijaju iz zaostavštine odgovarajuću vrednost, pa se tek posle toga ostatak zaostavštine deli među svim naslednicima.</p> <p>2. Ako predmeti i prava koja je ostavilac imao u trenutku njegove smrti nisu dovoljna da ostali naslednici dobiju odgovarajuću vrednost, naslednik kome se vrši izračunavanje nije dužan da vrati bilo šta od onog što je on dobio.</p> <p>3. Ovaj član ne dovodi u pitanje odredbe o nužnom delu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1527 E drejta e trashëgimitarit të cilit nuk i llogaritet dhurimi ose legu</p> <p>1. Në rastet kur sipas vullnetit të trashëgimlënësit, dhurimi ose legu nuk duhet t'i llogaritet trashëgimitarit në pjesën trashëgimore të tij, ky i fundit mban dhurimin respektivisht legun dhe merr pjesë me trashëgimtarët e tjerë në ndarjen e pasurisë trashëgimore sikur të mos kishte marrë fare dhurim ose leg.</p> <p>2. Kur ka trashëgimtarë të domosdoshëm dhe sipas vullnetit të trashëgimlënësit dhurimi ose legu nuk duhet t'i llogaritet ndonjë trashëgimtarit në pjesën trashëgimore të tij, ky trashëgimtar do të mund të mbajë dhurimin përkatësisht legun brenda kufijëve të pjesës së domosdoshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1527 The right of an heir who will not have gifts or legacies taken into account</p> <p>1. If according to the decedent's will, the gift or legacy should not be counted towards the heir's hereditary share, such heir shall retain the gift or legacy, and shall take part in the division of the inheritance, with the other heirs, as if he had not received the gift or legacy.</p> <p>2. If there are compulsory heirs, and according to the decedent's will the donation or legacy should not be counted towards the heir's hereditary share. The heir may retain the gift or legacy only within the limits of the available share.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1527 Pravo naslednika kojem se poklon ili legat ne izračunava</p> <p>1. U slučajevima kad na osnovu volje ostavioca poklon ili legat ne treba da se izračunava nasledniku u njegov nasledni deo, takav naslednik zadržava poklon odnosno legat i učestvuje sa ostalim naslednicima u podeli zaostavštine kao da on nije ni dobio poklon odnosno legat.</p> <p>2. Kad ima nužnih naslednika, a na osnovu volje ostavioca poklon ili legat ne treba da se izračunava nekom nasledniku u njegov nasledni deo, taj naslednik će moći da zadrži poklon odnosno legat u granicama nužnog dela.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1528 E drejta e trashëgimitarit që ka hequr dorë nga trashëgimi</p> <p>Trashëgimtarit që ka hequr dorë nga trashëgimi e mban dhurimin brenda kufijëve të pjesës së domosdoshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1528 The right of an heir who has renounced to the inheritance</p> <p>An heir who has renounced to the inheritance shall retain the gift within the limits of the available share.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1528 Pravo naslednika koji se odrekao svog nasledstva</p> <p>Naslednik koji se odrekao nasleđa zadržava poklon u granicama nužnog dela.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1529</p>	<p style="text-align: center;">Article 1529</p>	<p style="text-align: center;">Član 1529</p>

<p style="text-align: center;">E drejta e kthimit të dhurimit</p> <p>1. Trashëgimtari ka të drejtë të kthejë në pasurinë trashëgimore sendin që i është dhuruar.</p> <p>2. Në këtë rast vlera e tij nuk do t'i llogaritet në pjesën trashëgimore dhe përsa i përket shpenzimeve që ka bërë për sendin dhe dëmtimeve që ka pësuar sendi, ai do të konsiderohet posedues me mirëbesim, derisa të provohet e kundërta.</p>	<p style="text-align: center;">The right to return gifts</p> <p>1. An heir has the right to return to the inheritance property what had been donated to him.</p> <p>2. In this case, its value shall not be counted towards the hereditary share, and as regards the expenses and damages caused to the gift, he will be considered to have been a <i>bona fide</i> possessor, unless the contrary is proved.</p>	<p style="text-align: center;">Pravo na vraćanje poklona</p> <p>1. Naslednik ima pravo da predmet koji je poklonjen njemu vrati u zaostavštinu.</p> <p>2. U tom slučaju, vrednost tog predmeta neće biti izračunata u njegov nasledni deo, a u pogledu troškova koje je učinio za predmet i u pogledu oštećenja koje je on pretrpeo on će se smatrati savesnim držaoцем, osim ukoliko se ne dokaže suprotno.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1530 Shpenzimet e mbajtjes së trashëgimtarit</p> <p>1. Ajo që është shpenzuar për mbajtjen e trashëgimtarit dhe për shkollimin e detyrueshëm të tij nuk do të llogaritet në pjesën trashëgimore të tij.</p> <p>2. Gjykata do të vendosë sipas rrethanave nëse shpenzimet që ka bërë trashëgimlënësi për shkollimin e mëtejshëm të trashëgimtarëve do të llogariten në pjesën trashëgimore të tyre dhe në ç' masë, duke marrë parasysh sidomos vlerën e pasurisë trashëgimore dhe shpenzimet e shkollimit si dhe aftësinë e trashëgimtarëve të tjerë për të mbajtur veten.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1530 Expenses caused by maintaining the heirs</p> <p>1. What is spent for the maintenance of an heir, or for his compulsory education, shall not be counted towards his or her hereditary share.</p> <p>2. The court shall decide whether expenses incurred for further education of an heir are counted towards such heir's hereditary share, taking into account the circumstances of the case, and namely the value of the inheritance, the amount of expenses incurred for such further education, and the ability of the other heirs to maintain themselves.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1530 Troškovi izdržavanja naslednika</p> <p>1. Ono što je bilo potrošeno za izdržavanje naslednika ili za njegovu obavezno školovanje neće se izračunati u njegov nasledni deo.</p> <p>2. Da li će se izdaci koje je ostavilac učinio za dalje školovanje naslednika izračunati u njegov nasledni deo i u kojoj meri, na zahtev naslednika, odlučiće sud prema okolnostima, uzimajući u obzir naročito vrednost zaostavštine i troškove školovanja, kao i sposobnost ostalih naslednika da se sami izdržavaju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1531</p>	<p style="text-align: center;">Article 1531</p>	<p style="text-align: center;">Član 1531</p>

Dhurimet e rëndomta	Customary gifts	Uobičajeni pokloni
<p style="text-align: center;">Neni 1565 Shuarja e legut në përgjithësi</p> <p>Legu shuhet nëse legatari vdes para testatorit, heq dorë nga legu ose është i padenjë. Në këto raste objekti i legut i mbetet personit që ka qenë i detyruar ta ekzekutojë, po qe se nga vetë testamenti nuk rezulton ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1565 Lapse of legacy in general</p> <p>The legacy shall lapse if the legatee dies before the testator, or renounces to the legacy, or is unworthy. In these cases, the object of legacy remains with the person who was obliged to execute the legacy, unless it results otherwise from the will.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1565 Prestanak legata uopšte</p> <p>Legat prestaje da važi ako legator umre pre zaveštaoca, odrekne se legata ili je nedostojan. U tim slučajevima, predmet legata ostaje kod lica koje je bilo obavezno da izvrši legat, osim ukoliko iz samog testamenta ne proizlazi nešto drugo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1566 Shurja në lidhje me objektin e legut</p> <p>Legu shuhet edhe kur testatori ka shpenzuar objektin e legut, ose ky objekt vetëvetiu ka pushuar së ekzistuari derisa ka qenë gjallë trashëgimlënësitestatori, ose rastësisht është asgjesuar pas vdekjes së tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1566 Lapse related to the object of the legacy</p> <p>The legacy shall also lapse when the testator has spent the object of legacy, or this object is lost while the testator was still alive, or is accidentally lost after his death.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1566 Prestanak u vezi predmeta legata</p> <p>Legat prestaje da važi kad je zaveštalc potrošio predmet legata, ili taj predmet sam po sebi prestaje da postoji dok je još za života ostavilac zaveštaoca, ili je slučajno uništen posle njegove smrti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1567 Parashkrimi i legut</p> <p>E drejta për të kërkuar ekzekutimin e legut parashkruhet brenda 1 viti nga dita kur legatari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe ka qenë i autorizuar të kërkojë ekzekutimin e legut, e</p>	<p style="text-align: center;">Article 1567 Prescription of legacy</p> <p>The right to request discharge of the legacy shall be prescribed within one year from the day the legatee was notified about his right, and was authorized to request discharge of the</p>	<p style="text-align: center;">Član 1567 Zastarevanje legata</p> <p>Pravo da zahteva izvršenja legata zastareva u roku od godinu dana od dana kad je legator bio obavesten o njegovom pravu i bio ovlašćen da traži izvršenje legata, a najkasnije tri godine od</p>

<p>më se voni prej 3 vjetëve nga dita kur ka pasur mundësi të kërkojë ekzekutimin e legut.</p> <p>KAPITULLI IX – EKZEKUTUESIT</p> <p>Neni 1568 Caktimi i ekzekutuesit</p> <p>1. Testatori mund të caktojë me testament një ose më shumë persona si ekzekutues.</p> <p>2. Ekzekutues i testamentit mund të jetë çdo person që ka aftësi për të vepruar.</p> <p>3. Personi që është caktuar të jetë ekzekutues i testamentit nuk është detyruar të marrë përsipër këtë detyrë.</p> <p>Neni 1569 Detyrat e ekzekutuesit</p> <p>1. Pëveç rasteve kur testatori nuk ka caktuar ndonjë gjë tjetër, ekzekutuesi i testamentit ka sidomos për detyrë të kujdeset për ruajtjen e pasurisë trashëgimore, ta drejtojë atë, të kujdeset për pagimin e borxheve dhe legeve, dhe në përgjithësi të kujdeset që testamenti të ekzekutohet ashtu si ka dashur testatori.</p>	<p>legacy, and three years from the day when it is possible to discharge the legacy.</p> <p>CHAPTER IX – EXECUTORS</p> <p>Article 1568 Appointment of an executor</p> <p>1. A testator can appoint with a will one or more persons as executor.</p> <p>2. An executor of a will can be any person that has the full legal capacity to act.</p> <p>3. The person appointed to be a will executor is not obliged to take over this duty.</p> <p>Article 1569 The duties of an executor</p> <p>1. Unless otherwise determined by the testator, the executor shall in particular protect the inheritance, administer it, to discharge debts and legacies, and in general to see to an execution of the will according to the testator’s intentions.</p>	<p>dana kada je imao mogućnosti da traži izvršenje legata.</p> <p>POGLAVLJE IX - IZVRŠIOCI</p> <p>Član 1568 Određivanje izvršioca</p> <p>1. Zaveštalac može testamentom da odredi jedno ili više lica za izvršioce.</p> <p>2. Izvršilac testamenta može da bude svako lice koje ima sposobnost da deluje.</p> <p>3. Lice određeno za izvršioca testamenta nije obavezno da preuzme ovu dužnost.</p> <p>Član 1569 Dužnosti izvršioca</p> <p>1. Osim slučajeva kada zaveštalac nije odredio nešto drugo, izvršilac testamenta ima posebnu dužnost da se stara o čuvanju zaostavštine, da njome upravlja, da se stara o isplati dugova i legata i uopšte da se stara da testament bude izvršen onako kako je to zaveštalac hteo.</p>
---	--	--

<p>2. Nëse ka disa ekzekutues të testamentit ata kryejnë detyrat që u janë besuar së bashku, përveç nëse testatori ka caktuar ndryshe.</p> <p>3. Ekzekutuesi duhet të dëgjojë trashigimarrët para se të ndajë trashëgiminë në mes tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1570 Llogaridhënia dhe shpërblimi i ekzekutuesit</p> <p>1. Ekzekutuesi i testamentit është i detyruar t'i japë llogari gjykatës apo noterit për punën e vet.</p> <p>2. Ai ka të drejtë për shpërblimin e shpenzimeve dhe shpërblimin për punën e vet që do të paguhet në ngarkim të pjesës disponibël të pasurisë trashëgimore e sipas vendimit të gjykatës apo noterit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1571 Shkarkimi i ekzekutuesit</p> <p>1. Gjykata apo noteri në bazë të propozimit, ose sipas detyrës zyrtare, mund të shkarkojë ekzekutuesin e testamentit, po që se puna e tij nuk është në pajtim me vullnetin e testatorit ose me ligjin.</p>	<p>2. If there are several executors, they shall carry out the duties they were given together, unless the testator disposed otherwise.</p> <p>3. The executor must hear the heirs prior of partitioning the inheritance between the heirs.</p> <p style="text-align: center;">Article 1570 Being accountable and executor's reward</p> <p>1. The executor shall be accountable for his work before the court or notary.</p> <p>2. He is entitled to be reimbursed for his expenses and the work performed, which shall be payable from the available inheritance share, by order of the court or notary.</p> <p style="text-align: center;">Article 1571 Dismissal of the executor</p> <p>1. The court or notary, upon requisition or <i>ex officio</i>, may dismiss the executor, if his work is not in compliance with testator's intentions, or with the law.</p>	<p>2. Ako ima više izvršilaca testamenta, oni obavljaju dužnosti koje su date zajedno, osim ukoliko je zaveštalac drukčije odredio.</p> <p>3. Izvršilac treba slušati naslednike prije nego podeli nasledstvo između njih.</p> <p style="text-align: center;">Član 1570 Odgovornost i nagrada izvršioca</p> <p>1. Izvršilac testamenta dužan je da položi sudu ili javnom beležniku računa o svom radu.</p> <p>2. Izvršilac testamenta ima pravo na naknadu troškova i na nagradu za njegov trud koji će da bude isplaćen na teret raspoloživog dela zaostavštine, a na osnovu odluke suda ili javnog beležnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 1571 Razrešenje izvršioca</p> <p>1. Sud ili javni beležnik može na osnovu predloga ili po službenoj dužnosti, da razreši izvršioca testamenta, ako njegov rad nije u skladu sa voljom zaveštaoca ili sa zakonom.</p>
--	---	---

<p>2. Ekzekutuesi i shkarkuar i testamentit përgjigjet për dëmin që është shkaktuar nga veprimet e tij si ekzekutues.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1572 Ekzekutuesi i caktuar nga gjykata apo noteri</p> <p>Testatori mund t'i kërkojë gjykatës apo noterit të emërojë një ekzekutues, ose të emërojë një të tillë nëse ekzekutuesi i caktuar nga testatori refuzon të marrë detyrën ose është shkarkuar nga gjykata kompetente</p>	<p>2. The dismissed executor shall be liable for the damage caused by his actions as executor.</p> <p style="text-align: center;">Article 1572 Court-appointed executor</p> <p>The testator may require the Inheritance Court or notary to appoint an executor, or to appoint one if the executor appointed by the testator refuses to assume the office or is dismissed by the Inheritance Court.</p>	<p>2. Razrešeni izvršilac testamenta biće odgovoran za štetu prouzrokovanu njegovim postupcima kao izvršilac.</p> <p style="text-align: center;">Član 1572 Izvršilac imenovan od strane suda ili javnog beležnika</p> <p>Zaveštalac može tražiti od suda ili javnog beležnika da postavi izvršioca, ili da imenuje takvog ako izvršilac imenovan od zaveštaoca odbije da prihvati dužnost ili je razrešen od strane nadležnog suda.</p>
<p>KAPITULLI X – REVOKIMI I TESTMANETIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 1573 Parimi</p> <p>1. Testatori mund të revokojë kurdoherë testamentin në tërësi ose pjesërisht në njërën nga format e parapara me dispozitat për përpilimin e testamentit.</p> <p>2. Testatori mund të revokojë testamentin me shkrim dhe me asgjësimin e dokumentit.</p>	<p>CHAPTER X – REVOCATION OF THE WILL</p> <p style="text-align: center;">Article 1573 Principle</p> <p>1. A testator may revoke any time a will entirely or partially, in one of the forms foreseen by law for the preparation of the will.</p> <p>2. A testator may also revoke a written will by destroying the document.</p>	<p>POGLAVLJE X - OPOZIV TESTAMENTA</p> <p style="text-align: center;">Član 1573 Načelo</p> <p>1. Zaveštalac može uvek da opozove testament u celini ili delimično u jednoj od predviđenih formi odredbama za sastavljanje testamenta.</p> <p>2. Zaveštalac može da opozove pisani testament i uništavanjem dokumenta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1574 Raporti midis testamentit të mëparshëm dhe të mëvonshëm</p> <p>1. Nëse me testamentin e mëvonshëm nuk revokohet shprehimisht testamenti i mëparshëm dispozitat e testamentit të mëparshëm mbeten në fuqi, po qe se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e testamentit të mëvonshëm.</p> <p>2. Nëse testatori ka asgjësuar testamentin e mëvonshëm, testamenti i mëparshëm mbetet në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1574 Relationship between the previous and subsequent will</p> <p>1. In case the subsequent will does not expressly revoke the previous will, the provisions of the former will shall remain in force if they are not in contradiction with the provisions of the subsequent will.</p> <p>2. In case the testator has destroyed the subsequent will, the previous will shall re-enter into force.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1574 Odnos ranijeg i docnijeg testamenta</p> <p>1. Ako se docnijim testamentom izričito ne opozove raniji testament, odredbe ranijeg testamenta ostaju na snazi ukoliko nisu u suprotnosti sa odredbama docnijeg testamenta.</p> <p>2. Ako je zaveštalac uništio docniji testament, raniji testament ostaje na snazi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1575 Disponimi i sendit të lënë me testament</p> <p>Çdo disponim i mëvonshëm nga ana e testatorit të sendit të caktuar që ia ka lënë dikujt me testament ka si pasojë revokimin e lënies me testament të këtij sendi.</p> <p>KAPITULLI XI – PADENJËSIA DHE PËRJASHTIMI I TRASHËGIMTARËVE TË DOMOSDOSHËM</p>	<p style="text-align: center;">Article 1575 Dispositions over the object of a legacy</p> <p>Any subsequent disposition over a thing left to someone by the testator in a will, shall have as result the revocation of such bequest.</p> <p>CHAPTER XI – UNWORTHINESS AND EXCLUSION OF COMPULSORY HEIRS</p>	<p style="text-align: center;">Član 1575 Raspolaganje zaveštanom stvari</p> <p>Svako docnije raspolaganje zaveštaoca određenom stvari koju je bio nekom zaveštao u svom testamentu ima za posledicu opozivanje zaveštanja te stvari.</p> <p>POGLAVLJE XI - NEDOSTOJNOST I ISKLJUČENJE OBAVEZNIH NASLEDNIKA</p>

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli I – Padjenësia</p> <p style="text-align: center;">Neni 1576 Mbi padenjësinë në përgjithësi</p> <p>1. Nuk mund të trashëgojë personi i padenjë për të trashëguar.</p> <p>2. Padjenësia nuk i pengon pasardhësit e personit të padenjë të trashëgojnë njësoj sikur personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimlënësit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1577 Padenjësia për trashëgim</p> <p>1. I padenjë për të trashëguar është ai person që:</p> <p>1.1. me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij;</p> <p>1.2. ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie;</p> <p>1.3. me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter I – Unworthiness</p> <p style="text-align: center;">Article 1576 On unworthiness in general</p> <p>1. An unworthy person cannot inherit.</p> <p>2. The unworthiness shall not prevent descendants of the unworthy person to inherit, as if the unworthy person had died before the decedent.</p> <p style="text-align: center;">Article 1577 Unworthiness for inheritance</p> <p>1. A person is unworthy if he:</p> <p>1.1. has intentionally killed, or has attempted to kill, the decedent, his spouse, his children, or parents;</p> <p>1.2. has falsely denounced the decedent of a crime which carries imprisonment, or made a false testimony to that effect;</p> <p>1.3. with the use of fraud, threat, or actual violence, has forced the decedent to draft,</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje I - Nedostojnost</p> <p style="text-align: center;">Član 1576 O nedostojnosti uopšte</p> <p>1. Nedostojno lice ne može da bude naslednik.</p> <p>2. Nedostojnost nekog lica ne sprečava potomke tog nedostojnog lica da nasleđuju, kao da je nedostojno lice umrlo pre smrti ostavioca.</p> <p style="text-align: center;">Član 1577 Nedostojnost za nasleđivanje</p> <p>1. Lice je nedostojno nasleđivanja ako je on:</p> <p>1.1. ubio sa umišljajem ili pokušao da ubije, ostavioca, njegovog supružnika, njegovu decu i roditelje;</p> <p>1.2. izneo je protiv ostavioca krivičnu prijavu ili lažno svedočenje, za izvršenje krivičnog dela za koje se predviđa zatvorska kazna;</p> <p>1.3. ako je prevarom, pretnjom nasiljem naveo ostavioca da sačini, ili izmeni, ili</p>
--	--	--

<p>ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;</p> <p>1.4. është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë; ose</p> <p>1.5. nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtuar apo ndihmuar trashëgimlënësin.</p>	<p>or change, or abrogate, a will, or has drafted himself a false will, or has used such will for his own interests, or the interests of third parties;</p> <p>1.4. behaved towards the decedent in a humiliating manner and has mistreated him; or</p> <p>1.5. did not fulfil an obligation to maintain or assist the decedent.</p>	<p>opozove testament ili je samo sastavilo lažni testament ili je to koristio za svoje sopstvene interese ili za interese drugih ;</p> <p>1.4. ponašao se prema ostaviocu na ponižavajući način i maltretirao ga; ili</p> <p>1.5. nije ispunio obavezu izdržavanja ili ukazivanja pomoći ostaviocu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1578 Vlerësimi kryesisht i padenjesisë sipas detyrës zyrtare</p> <p>Për padenjësinë gjykata apo noteri kujdeset sipas detyrës zyrtare, përveç në rast padenjësie për shkeljen e detyrimit të mbajtjes dhe për mosdhënien e ndihmës së domosdoshme trashëgimlënësit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1578 On Consideration of unworthiness <i>ex officio</i></p> <p>Unworthiness shall be considered by the court <i>ex officio</i>, except in the cases when the heir has not fulfilled his obligation to maintain or assist the decedent.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1578 Ocenjivanje nedostojnosti prema službenoj dužnosti</p> <p>Na nedostojnost sud ili javni beležnik pazi po službenoj dužnosti, osim u slučajevima kada naslednik nije ispunio svoju obavezu izdržavanja ostavioca ili ukazivanja pomoći ostaviocu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1579 Falja për padenjësi</p> <p>Trashëgimlënësi ka të drejtë të falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja e tillë të bëhet shprehimisht me testament, ose kur faljen, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi e ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë dhe megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1579 Exemption to ineligibility</p> <p>A decedent shall have the right to authorize an unworthy person to inherit, provided that the authorization is granted by will, or, where such authorization is not given expressively, the decedent notes in the will that he or she has recognized the unworthiness and still assigns him or her as an heir.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1579 Opraštanje nedostojnosti</p> <p>Ostavilac ima pravo da ovlasti nedostojno lice da bude naslednik, pod uslovom da je takvo ovlašćenje sadržano u samom testamentu ili, u slučaju da takvo ovlašćenje nije bilo dato izričito, kad ostavilac načini napomenu na testamentu da shvata nedostojnost lica za nasleđivanje ali da i pored toga to lice određuje</p>

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Përfjashtimi i Trashëgimtarëve të Domosdoshëm nga Trashëgimi dhe Privimi nga Pjesa e Domosdoshme në Dobi të Pasardhësve</p> <p style="text-align: center;">Neni 1580 Shkaqet e përfjashtimit</p> <p>1. Trashëgimlënësi në testamentin e tij mund të përfjashtojë nga trashëgimi trashëgimtarin që ka të drejtë për pjesën e domosdoshme:</p> <p>1.1. nëse ai me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenim të rëndë ndaj trashëgimlënësit;</p> <p>1.2. nëse ka bërë me dashje ndonjë vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1581 Përfjashtimi i plotë ose i pjesshëm</p> <p>Përfjashtim nga trashëgimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm.</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Exclusion of a Compulsory Heir from Inheritance and the Deprivation of the Compulsory Share to the Benefit of his or her Descendants</p> <p style="text-align: center;">Article 1580 The reasons of exclusion</p> <p>1. The decedent can exclude from inheritance, in his will, an heir who has the right to the compulsory share:</p> <p>1.1. If he has committed a grave offence against the decedent by violating a legal or moral obligation;</p> <p>1.2. If he has deliberately committed a criminal act against the decedent, or his or her spouse, child, or parent.</p> <p style="text-align: center;">Article 1581 Partial or full exclusion</p> <p>Exclusion from inheritance may be completely or partially</p>	<p>za naslednika.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Isključenje nužnih naslednika iz nasleđa i lišenje nužnog dela u korist potomaka</p> <p style="text-align: center;">Član 1580 Razlozi za isključenje iz nasleđa</p> <p>1. Ostavilac može u njegovom testamentu, da isključi iz nasleđa naslednika koji ima pravo na nužni deo:</p> <p>1.1. ako je povredom neke zakonske ili moralne obaveze teže ugrozio ostavioca;</p> <p>1.2. ako je umišljajem izvršio neko krivično delo nad ostavioca, njegovog supružnika, deteta ili roditelja.</p> <p style="text-align: center;">Član 1581 Delimično ili potpuno isključenje iz nasleđa</p> <p>Isključenje iz nasleđa može biti potpuno ili delimično.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 1582 Kushtet për vlefshmërinë e përjashtimit</p> <p>1. Trashëgimlënësi që dëshiron të përjashtojë ndonjë trashëgimtar duhet ta shprehë këtë në mënyrë të qartë si dhe të tregojë shkakun e këtij përjashtimi.</p> <p>2. Shkaku i përjashtimit duhet të ekzistojë në kohën e përpilimit të testamentit.</p> <p>3. Në rast kontesti rreth bazueshmërisë së përjashtimit, detyrën për të provuar se përjashtimi është i arsyeshëm e ka ai që mbështetet në përjashtim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1582 Conditions for valid exclusion</p> <p>1. A decedent who wishes to exclude an heir from inheritance should express it in a clear manner and also indicate the reason for such exclusion.</p> <p>2. The cause of exclusion should exist at the time when the will is made.</p> <p>3. In case of conflict regarding exclusion, the person supporting the exclusion shall have to prove that there are grounds for it.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1582 Uslovi za punovažnost isključenja iz nasledstva</p> <p>1. Ostavilac koji želi da isključi nekog naslednika iz nasleđa treba to da izrazi u testamentu na jasan način i da pokaže razlog isključenja.</p> <p>2. Razlog za isključenje treba da postoji u vreme sastavljanja testamenta.</p> <p>3. U slučaju spora o osnovanosti isključenja, dužnost dokazivanja da je isključenje bilo opravdano leži na onome koji se oslanja na izuzetak.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1583 Pasojat e përjashtimit</p> <p>Me përjashtimin trashëgimtari humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar, kurse të drejtat e personave të tjerë që mund të trashëgojnë trashëgimlënësin caktohen sikur i përjashtuari të kishte vdekur para trashëgimlënësit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1583 Consequences of exclusion</p> <p>With the exclusion the heir loses the part of inheritance equal to the amount it is excluded, and the remaining heir's rights shall be assessed as if the excluded person had predeceased the decedent.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1583 Posledice isključenja</p> <p>Isključenjem iz nasledstva naslednik gubi pravo nasledstva u meri u kojoj je isključen, a prava ostalih lica koja mogu da naslede ostavioca biće određena kao da je isključeno lice umrlo pre ostavioca.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 1584 Privimi nga pjesa e domosdoshme në dobi të trashëgimtarëve</p> <p>1. Nëse trashëgimtari i domosdoshëm ka shumë borxhe ose është plangprishës, trashëgimlënësi mund ta privojë në tërësi ose pjesërisht nga pjesa e domosdoshme e tij në dobi të pasardhësve të tij.</p> <p>2. Ky privim mbetet i plotëfuqishëm vetëm nëse në momentin e hapjes së trashëgimisë i privuari ka fëmijën e mitur ose nipin e mitur nga fëmija i vdekur më parë ose ka fëmijën madhor ose nipin madhor nga fëmija i vdekur më parë që janë të paaftë për punë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1584 Deprivation of the compulsory share to the heir's benefit</p> <p>1. If a compulsory heir is deeply indebted, or is a dissipative person, the decedent may deprive him, completely or partially, of the compulsory share, to the benefit of his descendants.</p> <p>2. This deprivation remains in force only if at the moment of opening the inheritance, the deprived person has a child under 18 or a grandchild under 18 from a predeceased child, or a mature child or mature grandchild from a predeceased child, who is unable to work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1584 Lišenje nužnog dela u korist potomaka</p> <p>1. Ako je potomak koji je imao pravo na nužni deo prezadužen ili je rasipnik, zaveštalac može njega da liši u celini ili delimično od njegovog nužnog dela u korist njegovih potomaka.</p> <p>2. Ovo lišenje ostaje punovažno samo ako u trenutku otvaranja nasleđa lice lišeno nasleđstva ima maloletno dete ili maloletnog unuka, odnosno ako ima punoletno dete ili punoletnog unuka od ranije umrlog deteta, koji su nesposobni za rad.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI XII – KREDITORËT E PASURISË TRASHËGIMORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1585 Mbi borxhet e trashëgimisë në përgjithësi</p> <p>1. Trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që ngarkojnë trashëgiminë në proporcion me pjesën e tyre dhe deri në vlerën e tyre të pjesës trashëgimore.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER XII – CREDITORS OF THE INHERITANCE PROPERTY</p> <p style="text-align: center;">Article 1585 On the debts of the inheritance in general</p> <p>1. The heirs are liable for the debts encumbering the inheritance, in proportion to their share, and up to the amount of their hereditary share.</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE XII - POVERIOCI NASLEDNE IMOVINE</p> <p style="text-align: center;">Član 1585 O dugovima nasleđstva uopšte</p> <p>1. Naslednici odgovaraju za dugovanja koja opterećuju nasleđstvo srazmerno svom naslednom delu i do iznosa svog naslednog dela.</p>

<p>2. Borxhet që ngarkojnë trashëgiminë janë: barrët mbi trashëgiminë, borxhet personale të trashëgimlënësit, shpenzimet e varrimit, shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë deri në momentin e ndarjes së trashëgimisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1586 Përgjegjësia e legatarit për borxhet e trashëgimlënësit</p> <p>Legatari nuk përgjigjet për borxhet e trashëgimlënësit nëse trashëgimlënësi nuk ka përcaktuar ndryshe në testament.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1587 Legu i lënë kreditorit</p> <p>Kur testatori i ka lënë legun kreditorit të vet, ky ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit ndaj tij, po qe se nga testamenti nuk rezulton se qëllimi i testatorit ka qenë ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1588 Prioriteti i kreditorëve mbi legatarët</p> <p>1. Kreditorët e trashëgimlënësit kanë përparësi në përmbushjen e kërkesave para legatarëve.</p>	<p>2. Debts encumbering the inheritance are: those secured on inheritance property, the personal debts of the decedent, the cost of the decedent's funeral, and expenses required for the safeguarding and administration of the hereditary property up to the division of the inheritance.</p> <p style="text-align: center;">Article 1586 Liability of a legatee for testator's debts</p> <p>A legatee shall not be liable for the decedent's debts, unless otherwise provided in the will.</p> <p style="text-align: center;">Article 1587 Legacy left to a creditor</p> <p>When a testator has left the legacy to his creditor, such creditor has the right to request the discharge of the obligation towards him, except when the context of the will shows that the testator's aim was otherwise.</p> <p style="text-align: center;">Article 1588 Priority of creditors over legatees</p> <p>1. The decedent's creditors shall have the right to have the obligations towards them be fulfilled before the legacies are discharged.</p>	<p>2. Dugovanja koja opterećuju nasledstvo su: ona koja su bila obezbeđena zaostavštinom, lična dugovanja ostavioca, troškovi sahrane, troškovi potrebni za čuvanje i upravljanje zaostavštinom do trenutka podele nasleđa.</p> <p style="text-align: center;">Član 1586 Odgovornost legatora za dugove ostavioca</p> <p>Legator ne odgovara za dugove ostavioca, osim ukoliko je u testamentu drugačije određeno.</p> <p style="text-align: center;">Član 1587 Legat ostavljen poveriocu</p> <p>Kad je zaveštalc ostavio legat njegovom poveriocu, on ima pravo da zahteva ispunjenje dužnosti prema njemu, osim ako iz testamenta ne proizilazi da je namera zaveštaoca bila drugačija.</p> <p style="text-align: center;">Član 1588 Prvenstvo poverilaca u odnosu na legatore</p> <p>1. Poverioci ostavioca imaju prednost u ispunjavanju zahteva pre legatora.</p>
---	--	--

<p>2. Nëse leget janë ekzekutuar para pagimit të kreditorëve, kreditorët duhet ta kërkojnë këtë leg sipas dispozitave të Librit 2 të këtij kodi për pasurimin e pa bazë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1589 Veçimi i pasurisë trashëgimore</p> <p>1. Kreditorët e trashëgimlënësit brenda afatit prej tre muajsh nga hapja e trashëgimit mund të kërkojnë që pasuria trashëgimore të veçohet nga pasuria e trashëgimtarit. Në këtë rast trashëgimtari nuk mund të disponojë sendet dhe të drejtat e pasurisë trashëgimore, as të paguajë kreditorët e tij prej trashëgimisë, derisa nuk janë paguar kreditorët që kanë kërkuar veçimin.</p> <p>2. Kreditorët e trashëgimlënësit që kanë kërkuar veçimin e pasurisë trashëgimore borxhet e veta mund t'i nxjerrin vetëm nga pasuria trashëgimore.</p> <p>3. Për pasurinë trashëgimore të veçuar gjykata apo noteri mund të caktojë kujdestar.</p>	<p>2. If legacies have been discharged before the creditors had been paid, the creditors shall be entitled to reclaim such legacy according to the provisions of this Code on Obligations for unjust enrichment.</p> <p style="text-align: center;">Article 1589 Separation of inheritance property</p> <p>1. The creditors of the decedent may request separation of the inheritance from the heir's property within a three months' time period following opening of inheritance. In this case, the heir may not take possession of heirlooms or Chapters things or rights that of inheritance, nor are the object of the inheritance, or pay his creditors from such inheritance, until the creditors who had requested claimed such separation have been compensated.</p> <p>2. The creditors of the decedent, who requested separation of inheritance, may recover their debts only from the inheritance property.</p> <p>3. The court or notary may appoint the custodian for the separated inheritance.</p>	<p>2. Ako su legati izvršeni pre isplate poverioca, poverioci imaju pravo da traže legat prema odredbama knjige 2. ovog zakonika o neosnovanog bogaćenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 1589 Odvajanje nasledne imovine</p> <p>1. Poverioci ostavioca mogu da zahtevaju, u roku od tri (3) meseca od otvaranja nasleđa, da se zaostavština odvoji od imovine naslednika. U tom slučaju naslednik ne može da preuzme stvari i prava iz zaostavštine, niti da plati svoje poverioce iz takvog nasleđa, sve dok se ne naplate poverioci koji su tražili odvajanje.</p> <p>2. Poverioci ostavioca koji su tražili odvajanje zaostavštine mogu da naplate svoja potraživanja samo iz sredstava zaostavštine.</p> <p>3. Za odvojenu zaostavštinu sud ili javni beležnik mogu postaviti staratelj.</p>
--	--	---

<p>KAPITULLI XIII – KALIMI I PASURISË TRASHËGIMORE TE TRASHËGIMTARËT</p> <p>Nënkapitulli I – Hapja e Trashëgimit</p> <p>Neni 1590 Vdekja dhe shpallja e personit i vdekur</p> <p>1. Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij.</p> <p>2. Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur.</p> <p>Neni 1591 Hapja e trashëgimit të personit të shpallur i vdekur dhe fillimi i afateve</p> <p>1. Si ditë e hapjes së trashëgimit të personit që është shpallur i vdekur konsiderohet dita kur</p>	<p>CHAPTER XIII – TRANSFER OF INHERITANCE PROPERTY TO HEIRS</p> <p>Sub-chapter I – Opening of Inheritance</p> <p>Article 1590 Death and announcement of a deceased person</p> <p>1. Upon the death of a person his inheritance shall be opened.</p> <p>2. The declaration of a person as dead shall have the same effect.</p> <p>Article 1591 Opening the inheritance of a person announced as deceased and starting timelines</p> <p>1. The day on which the decision on the declaration of death of a person has become</p>	<p>POGLAVLJE XIII - PRENOS ZAOSTAVŠTINE NA NASLEDNIKE</p> <p>Potpoglavlje I - Otvaranje nasleđa</p> <p>Član 1590 Smrt i proglašenje lica za umrlo</p> <p>1. Smrću lica otvara se njegovo nasleđe.</p> <p>2. Isto dejstvo ima i proglašenje lica za umrlo.</p> <p>Član 1591 Otvoranje nasleđe lica proglašenog za umrlo i početak toka rokova</p> <p>1. Kao dan otvaranja nasleđa lica koje je proglašeno za umrlo smatra se dan kad je</p>
---	---	--

<p>aktvendimi mbi shpalljen e personit i vdekur ka marrë formën e prerë, po qe se në vetë vendimin si ditë e vdekjes nuk është caktuar ndonjë ditë tjetër.</p> <p>2. Në rast të shpalljes së personit i vdekur, afatet fillojnë të llogariten nga dita kur aktvendimi për shpalljen e tij person i vdekur ka marrë formën e prerë.</p>	<p>final shall be considered the day the inheritance of such person is opened, unless the decision itself specifies another day of death.</p> <p>2. When a person is declared dead, the timeline starts from the day the decision to declare this person dead has become final</p>	<p>rešenje o tome postalo pravosnažno, ako u samoj odluci kao dan smrti nije određen neki drugi dan.</p> <p>2. U slučaju proglašenja lica za umrlo, rokovi se računaju od dana kada je rešenje o njegovom proglašenju mrtvim postalo pravosnažno.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1592 Vdekja në të njëjtën kohë</p>	<p style="text-align: center;">Article 1592 Simultaneous death</p>	<p style="text-align: center;">Član 1592 Istovremena smrt</p>
<p>Nëse dy ose më shumë persona vdesin në të njëjtën kohë ose nëse nuk është e njohur cila është radha kronologjike e vdekjes, asnjëri prej tyre nuk do të konsiderohet i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimisë. Nëse dihet momenti i vdekjes, personat e vdekur më pas, konsiderohet se i trashëgojnë personat e vdekur më parë.</p>	<p>If two or more persons die at the same time, or if it is not known in which chronological order they have died, neither of them shall be considered alive at the moment the inheritance was opened. If the moment of death is known, the later deceased person is considered to inherit the person who died before him</p>	<p>Ako u isto vreme poginu dvoje ili više ljudi, ili nije poznat hronološki red smrti, nijedan od njih se neće smatrati živim u trenutku otvaranja nasljedstva. Ako je poznat trenutak smrti, lica koja su umrla kasnije, smatra se da nasleđuju lica koja su umrla ranije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1593 Trashëgimtarët e panjohur</p>	<p style="text-align: center;">Article 1593 Unknown heirs</p>	<p style="text-align: center;">Član 1593 Nepoznati naslednici</p>
<p>1. Nëse nuk dihet nëse ka trashëgimtarë, gjykata apo noteri me anë të shpalljes do t'i thërrasë personat që pretendojnë se kanë të</p>	<p>1. When it is not known whether there are heirs or not, the court or notary shall by an announcement summon the persons claiming</p>	<p>1. Ako nije poznato da li ima naslednika, sud ili javni beležnik će oglasom pozvati lica koja polažu pravo na nasleđe da se prijave u sudu ili kod javnog beležnika.</p>

<p>drejtë për trashëgim që të paraqiten në gjykatë apo te noteri.</p> <p>2. Nëse me kalimin e një viti nga dita e shpalljes nuk paraqitet asnjë trashëgimtar, pasuria trashëgimore i dorëzohet komunës kompetente, por me këtë trashëgimtari që do të paraqitet më vonë nuk privohet nga e drejta që t'i dorëzohet pasuria trashëgimore ose pjesa që i takon</p>	<p>the right of inheritance to appear before the court or notary.</p> <p>2. If one year has passed after the day of the announcement, and no heir has appeared, the inheritance shall be entrusted to the competent municipality, but this does not deprive an heir, who may appear later, to such inheritance or the part he is entitled to .</p>	<p>2. Ako se po isteku roka od jedne godine od dana objavljenog oglasa ne pojavi nijedan nasljednik, zaostavština biće predata nadležnoj opštini, ali time nasljednik koji bi mogao da se pojavi kasnije nije lišen prava da mu se preda zaostavština ili deo koji mu pripada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1594 Kujdestaria për trashëgimtarët e panjohur</p>	<p style="text-align: center;">Article 1594 Custody for unknown heirs</p>	<p style="text-align: center;">Član 1594 Starateljstvo za nepoznate naslednike</p>
<p>1. Pasuria e paluajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet, kurse pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin në Kosovë.</p> <p>2. Nëse trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim në Kosovë, pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet gjykata apo noteri kompetente.</p> <p>3. Nëse trashëgimtari nuk e ka kërkuar trashëgiminë brenda 20 viteve nga data e shpalljes së testamentit, ose kur nuk ka testament që nga vdekja e trashëgimlënësit, trashëgimlënësi do të konsiderohet pa trashëgimtarë ligjor ose testamentarë dhe do të</p>	<p>1. Immovables shall be handed over to the municipality, in the territory of which the immovable is located, while movables shall be handed over to the municipality in which the testator had his residence in Kosovo.</p> <p>2. If the testator did not have any residence in Kosovo at the time of his death, movables shall be handed over to the municipality in the territory of which the court or notary of inheritance is located.</p> <p>3. If the inheritance has not been claimed by the heirs within 20 years from the date of the announcement of the will, or if there is no will, from the death of the decedent, the decedent shall be considered without legal and testamentary heir and the provisions</p>	<p>1. Nepokretna imovina biće predata opštini na čijoj teritoriji se ta imovina nalazi, dok će pokretna imovina da bude predata onoj opštini u kojoj je ostavilac imao njegovo boravište na Kosovu.</p> <p>2. Ako ostavilac nije imao svoje prebivalište na Kosovu u vreme njegove smrti, njegova pokretna imovina biće predata opštini na čijoj teritoriji su nadležni sud ili javni beležnik.</p> <p>3. Ako se niko od nasljednika ne pojavi da polaže pravo na nasleđe u roku od 20 godina od dana proglašenja testamenta, ili ukoliko nije bilo testamenta, od dana smrti ostavioca, onda će se smatrati da ostavilac nije imao zakonske ni testamentarne naslednike i biće primenjene</p>

<p>aplikohen dispozitat e këtij ligji në lidhje me të drejtat në trashëgimi të komunave, sipas nenit 20.</p>	<p>regarding inheritance rights of the municipalities under Article 20 shall apply.</p>	<p>odredbe ovog zakonika koje se odnose na pravo opština na nasleđivanje shodno članu 20.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1595 Kujdestari i pasurisë trashëgimore</p>	<p style="text-align: center;">Article 1595 Inheritance custodian</p>	<p style="text-align: center;">Član 1595 Staratelj nad zaostavštinom</p>
<p>1. Kur nuk dihen të gjithë ose disa prej trashëgimtarëve, kur nuk dihet vendbanimi i tyre, si edhe në rastet e tjera kur ka nevojë për këtë, gjykata apo noteri cakton kujdestarin e përkohshëm të pasurisë trashëgimore, i cili është i autorizuar që në emër të trashëgimtarit të padisë dhe të paditet, të realizojë kërkesat dhe të paguajë borxhet dhe të përfaqësojë trashëgimtarët në përgjithësi.</p>	<p>1. When all or some of the heirs are not known or their residence is unknown, and in other cases when required, the court or notary shall appoint a provisional inheritance custodian, who shall be entitled to sue, or be sued, on behalf of the heir, to recover the claims, and pay the debts, and to generally represent in heirs.</p>	<p>1. Kad su svi ili samo neki od naslednika nepoznati ili je nepoznato njihovo mesto boravka, kao i u ostalim slučajevima kad je to potrebno, sud ili javni beležnik određice privremenog staratelja zaostavštine koji je ovlašćen da u ime naslednika tuži i bude tužen, da naplaćuje potraživanja i isplaćuje dugove, i uopšte da zastupa naslednike.</p>
<p>2. Caktimi i kujdestarit të përkohshëm nga gjykata apo noteri për trashëgimtarin që është i paaftë të mbrojë interesat e tij apo është i mitur rregullohet me dispozitat e Librit të Familjes.</p>	<p>2. The appointment of a provisional custodian by a court or notary for an heir who is unable to protect his interest or who is a child under 18, shall be governed by the Family Book provisions.</p>	<p>2. Određivanje privremenog staratelja od strane suda ili javnog beležnika za naslednika koji nije sposoban da štiti sopstvene interese ili koji je maloletan, uređuje se na osnovu odredaba knjige o porodici.</p>
<p>3. Gjyka apo noteri është i autorizuar të caktojë të drejta dhe detyra të veçanta të kujdestarit të pasurisë trashëgimore.</p>	<p>3. The court or notary has authority to assign specific rights and duties to an inheritance custodian.</p>	<p>3. Sud ili javni beležnik je ovlašćen da staratelju nad zaostavštinom dodeli neka određena prava i obaveze.</p>
<p>4. Nëse vetëm një ose disa bashkëtrashëgimtarë nuk janë të njohur, ose vendbanimi i këtyre bashkëtrashëgimtarëve nuk dihet, gjykata apo noteri mund të caktojë njërin prej bashkëtrashëgimtarëve të mbetur si</p>	<p>4. If only one or several co-heirs are not known, or if the residence of such co-heirs is unknown, the court or notary may appoint one of the remaining co-heirs as inheritance custodian.</p>	<p>4. Ako samo jedan naslednik ili više njih nisu poznati, ili ukoliko nije poznato mesto boravka takvih zajedničkih naslednika, sud ili javni beležnik može da postavi jednog od preostalih zajedničkih naslednika kao staratelja nad</p>

<p>kujdestar të trashëgimisë.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli II – Heqja Dorë nga Trashëgimi</p> <p style="text-align: center;">Neni 1596 Heqja dorë në përgjithësi</p> <p>1. Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës apo noterit deri në përfundimin e procedurës së trashëgimisë. Heqja dorë vlenë edhe për pasardhësit e atij që heq dorë, përveç nese shprehimisht ka deklaruar se heq dorë vetëm në emër të vetë.</p> <p>2. Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar.</p> <p>3. Pasardhësit e trashëgimtarit që heq dorë vetëm për vete, të cilët do të trashëgojnë në vend të tij, mund të heqin dorë nga trashëgimi sipas të njëjtave rregulla si çdo trashëgimtar i menjëhershëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1597 Shpjegimi dhe forma</p> <p>1. Gjykata apo noteri do të lexojë deklaratën dhe të shpjegojë pasojat e saj trashëgimtarit që heq dorë. Gjykata apo noteri sigurohet që</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter II – Renouncement to Inheritance</p> <p style="text-align: center;">Article 1596 Renouncement in general</p> <p>1. The heir may renounce to the inheritance by a statement made to the court or notary, until the inheritance proceedings are completed. Renouncement applies also to the descendants of the one who renounces, unless expressly stated that he renounces only on his own behalf.</p> <p>2. An heir who has renounced shall be deemed never to have been an heir.</p> <p>3. The descendants of the renouncing heir, who will inherit instead of him, may renounce to the inheritance under the same rules as any immediate heir.</p> <p style="text-align: center;">Article 1597 Enlightenment and form</p> <p>1. The court or the notary will read out the statement and explain its consequences to the renouncing heir. The court or the notary</p>	<p>zaostavštinom.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje II - Odricanje od nasleđa</p> <p style="text-align: center;">Član 1596 Odricanje uopšte</p> <p>1. Naslednik se može odreći nasleđa izjavom datom pred sudom ili javnim beležniku do okončanja procedure o zaostavštini. Odricanje važi i za potomke onog lica koje se odrekao, osim ako je to lice izričiti izjavio da se odriče samo u svoje ime.</p> <p>2. Naslednik, koji se odrekao nasleđa smatra se kao da nikada nije ni bio naslednik.</p> <p>3. Potomci naslednika koji se odriče samo u svoje ime, koji će naslediti na njegovom mestu, mogu se odreći nasledstva po istim pravilima kao i svaki neposredni naslednik.</p> <p style="text-align: center;">Član 1597 Objašnjenje i forma</p> <p>1. Sud ili javni beležnik pročitace izjavu i objasniti njene posledice nasledniku koji se odriče nasledstva. Sud ili javni beležnik se</p>
--	--	--

<p>trashëgimtari që heq dorë e kupton këtë dhe se ai me vullnet vendos për të dhënë deklaratën.</p> <p>2. Deklarata do të bëhet në formën me shkrim, nënshkruhet para gjyqtarit apo noterit pas shpjegimit të dhënë dhe verifikohet nga noteri. Nëse trashëgimtari që heq dorë është një fëmijë i mitur, ai përfaqësohet nga prindërit e tij, ose, nëse prindërit nuk mund të ushtrojnë të drejtën prindërore, përfaqësohen nga kujdestari i tij. Leja për heqjen dorë nga Organi i Kujdestarisë është e nevojshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 1598 Kalimi i së drejtës së heqjes dorë nga trashëgimi</p> <p>1. Nëse trashëgimtari ka vdekur para se të përfundojë shqyrtimi i pasurisë trashëgimore dhe nuk ka hequr dorë nga trashëgimi, e drejta e heqjes dorë kalon tek trashëgimtarët e tij.</p> <p>2. Nëse janë disa trashëgimtarë të trashëgimtarit të vdekur, ata nuk janë të detyruar të heqin dorë bashkarisht dhe secili prej këtyre trashëgimtarëve të trashëgimtarit të vdekur mund të heqin dorë për pjesën e trashëgimisë së trashëgimlënësit që i takon pjesës së tij në trashëgiminë e trashëgimtarit të vdekur.</p>	<p>ensures that the renouncing heir understands this and he decides freely to make the statement.</p> <p>2. The statement shall be made in writing, signed in front of the judge or notary after the enlightenment and then shall be certified by the judge. If the renouncing heir is a minor, he is represented by his parents, or, if parents cannot exercise the parental right are represented by their custodian. Permission for the renouncement from the Custodian Body is required.</p> <p style="text-align: center;">Article 1598 The transfer of the right to renounce to inheritance</p> <p>1. If an heir dies before the inheritance proceedings are completed, and has not renounced to his inheritance, the right of renouncement shall be transferred to his heirs.</p> <p>2. If there are several heirs to the deceased heir, they are not required to renounce to the inheritance jointly, and each of these heirs to the deceased heir may renounce to such part of the decedent's inheritance as corresponds to his part in the inheritance of the deceased heir.</p>	<p>osigurava da naslednik koji se odriče nasleđa razume to i da dobrovoljno odluči dati izjavu.</p> <p>2. Izjava treba biti u pisanoj formi, potpisana pred sudijom ili javnim beležnikom nakon datog objašnjenja i utvrđuje od strane javnog beležnika. Ako je naslednik koji se odriče nasleđa maloletno dete, zastupaju ga njegovi roditelji, ili, ako roditelji ne mogu ostvariti roditeljsko pravo, zastupa ga njegov staratelj. Za odricanje potrebna je dozvola od Organa starateljstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 1598 Prenošenje prava odricanja od nasleđa</p> <p>1. Ako je naslednik umro pre okončanja postupka za raspravljanje o zaostavštine a nije se odrekao njegovog nasleđa, pravo odricanja prelazi na njegove naslednike.</p> <p>2. Ako je nekoliko naslednika, umrlog naslednika, oni nisu u obavezi da se zajednički odriču nasleđa i svaki od tih naslednika umrlog naslednika može da se odrekne onog dela nasleđa ostavioca koji odgovara njegovom delu nasleđa umrlog naslednika.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 1599 Personi që nuk mund të heqë dorë nga trashëgimi</p> <p>1. Nuk mund të heqë dorë nga trashëgimi trashëgimtari që ka disponuar tërë pasurinë trashëgimore ose një pjesë të saj.</p> <p>2. Masat që merr një trashëgimtar i vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, si dhe masat e administrimit vijues, nuk e privojnë nga e drejta që të heqë dorë nga trashëgimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1599 Who is not entitled to renounce to inheritance</p> <p>1. An heir, who made dispositions on the entire inheritance, or on parts thereof, shall not be able to renounce to such inheritance.</p> <p>2. Measures taken by an heir only to secure the inheritance, as well measures of ongoing administration shall do not deprive such heir of the right to renounce to his inheritance.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1599 Lice koja se ne može odreći nasleđa</p> <p>1. Ne može se odreći nasleđa naslednik koji je raspolagao celom zaostavštinom ili jednim njenim delom.</p> <p>2. Mere koje jedan naslednik preduzme samo radi očuvanja zaostavštine kao i mere tekuće uprave nad zaostavštinom, ne lišavaju prava tog naslednika da se odrekne nasleđa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1600 Përmbajtja e deklaratës mbi heqjen dorë nga trashëgimi</p> <p>1. Heqja dorë nga trashëgimi nuk mund të jetë e pjesëshme apo me kusht.</p> <p>2. Heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar.</p> <p>3. Cedimi e ka statusin ligjor të dhuratës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1600 The content of a statement on the renouncement of inheritance</p> <p>1. A renouncement to inheritance shall be neither partial nor conditional.</p> <p>2. A renouncement made for the benefit of a specific heir shall not be considered as a renouncement, but as a declaration of transfer of the inheritance share to that heir.</p> <p>3. The transfer has the legal status of the gift.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1600 Sadržina izjave o odricanju od nasleđa</p> <p>1. Odricanje od nasleđa ne može da bude dato delimično ni pod uslovom.</p> <p>2. Odricanje u korist određenog naslednika ne smatra se kao odricanje od nasleđa, nego kao izjava o ustupanju svog naslednog dela kod određenog naslednika.</p> <p>3. Ustupak ima pravni status poklona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1601 Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur</p>	<p style="text-align: center;">Article 1601 Renouncement to an inheritance that has not been opened</p>	<p style="text-align: center;">Član 1601 Odricanje od nasleđa koje nije otvoreno</p>

